

MËSIMDHËNIA E HISTORISË MODERNE TË EUROPËS JUGLINDORE
Materiale Mësimore Plotësuese

Lufta e Dytë Botërore

Mësimdhënia e Historisë Moderne të Europës Juglindore. Materiale mësimore plotësuese. Redaktor për botimin në gjuhën shqipe: Helian Demiri

Titulli në origjinal: Teaching Modern Southeast European History, Alternative Educational Materials, World War II (*Mësimdhënia e Historisë Moderne të Europës Juglindore, Materiale mësimore plotësuese, Lufta e Dytë Botërore*), Selanik, 2009

Përkthyen nga anglishtja: Danjela Shkalla, Lumnis Çela, Sonila Danaj, Ymer Leksi

Redaktor gjuhësor: Prof. Dr. Tomor Plangarica

Recensentë për botimin në gjuhën shqipe: Prof. Dr. Xhevat Lloshi, Prof. Dr. Remzi Përnaska

Faqosja dhe botimi: Shtypshkronja „Obod” ad Cetinje

Numri i kopjeve: 700

Ky botim është financuar nga Bashkimi European



The European Union's Instrument for
Pre-accession Assistance (IPA)

“The contents of this publication are the sole responsibility of the author and can in no way be taken to reflect the views of the European Union.”

Përmbajtja e këtyre librave është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk mund të thuhet se paraqet pikëpamjet e Bashkimit European

Raportues i CDRSEE-së në bordin drejtues të *Projekti i Historisë së Përbashkët*: Costa Carras

Drejtor ekzekutiv: Nenad Šebek

Drejtor i programeve: Corinna Noack-Aetopoulos

Koordinatorë të projektit: Antonis Hadjiyannakis, Zvezdana Kovač, Jenny Demetriou & Susan Nadeau Bustamante

Sponsorë për botimin në gjuhën shqipe:

THE PUBLICATIONS AND TEACHER TRAINING ACTIVITIES OF THE JOINT HISTORY PROJECT HAVE BEEN MADE POSSIBLE THROUGH THE KIND FINANCIAL BACKING OF THE FOLLOWING:



Copyright: Center for Democracy and Reconciliation in Southeast Europe (CDRSEE)

Krispou 9, Ano Poli, 54634 Thessaloniki, Greece

Tel.: +30 2310 960820-1; Fax: +30 2310 960822

e-mail: info@cdrsee.org, web: www.cdrsee.org

ISBN: 978-9928-133-01-4

MËSIMDHËNIA E HISTORISË MODERNE TË EUROPËS JUGLINDORE
M a t e r i a l e M ë s i m o r e P l o t ë s u e s e

LIBRI I PUNËS 4

Lufta e Dytë Botërore

Redaktor: KRESHIMIR ERDELJA

Redaktore e përgjithshme e serisë: KRISTINA KOULOURI

Redaktor për botimin në gjuhën shqipe: HELIAN DEMIRI

Botimi i dytë



Cetinë 2012

Pasqyra e Lëndës

Hyrje	13
Kronologjia	17
Harta 1: Lufta e Dytë Botërore, 1939-1942	28
KAPITULLI I: POLITIKAT	29
Ia. Udhëheqësit dhe ideologjitë	29
I-1. Ficroi Meklejni (Fitzroi MacLean), përfaqësuesi i Çurçillit tek partizanët, përshkruan J. B. Titon në vitin 1943	29
Fig. 1. Udhëheqësi i Lëvizjes Popullore Çlirimtare partizane, Josif Broz Titoja dhe komandanti i Ushtrisë Jugosllave në Atdhe (çetnikët), gjenerali Drazha Mihajloviçi	30
I-2. Përshkrim i personalitetit të Paveliçit nga fotografi i tij	31
Fig. 2. Ante Paveliçi	31
I-3. Përshkrim i Mehmet Shehut dhe Enver Hoxhës	32
I-4. Një spiun anglez përshkruan udhëheqësin e opozitës politike në Rumani – Juliu Maniu	32
I-5. Fjalimi i Metaksasit, drejtuar redaktorëve dhe botuesve të të gjitha gazetave greke (30 tetor 1940)	33
Fig. 3. Biletë lotarie për të mbledhur para për familjet e ushtarëve që luftonin në frontin shqiptar kundër italianëve, në vitet 1940-1941	33
I-6. Udhëzim i Hitlerit, nr. 26 (3 prill 1941)	34
I-7. Jon Antonesku rreth ‘problemit hebre’	34
I-8. Deklarata e mbretit Mihai, drejtuar popullit (23 gusht 1944)	35
I-9. “Rezoluta e Bujanit”: Rezoluta e dalë nga Konferenca e parë e Këshillit Nacional Çlirimtar për Kosovën dhe Rrafshin e Dugagjinit, mbajtur më 31 dhjetor 1943 dhe më 1 dhe 2 janar 1944	35
I-10. Rezolutë e Kuvendit Popullor Krahinor të Kosovës e Metohisë, korrik 1945	36
I-11. Ideologjia komuniste e LNÇ-së, e paraqitur nga Sejfulla Malëshova	38
I-12. Udhëzime për themelimin e Organizatës Popullore të Rinisë Malazeze, të lëshuara nga Këshilli Rajonal i Partisë Komuniste Jugosllave për Malin e Zi, Bokën dhe Sanxhankun, shtator 1941.	38
I-13. Trakt i shkruar nga Dega e Komitetit të Partisë Komuniste të Jugosllavisë për Maqedoninë, drejtuar popullit maqedonas	39
Ib. Ushtritë dhe ushtarët	40
I-14. Raport i amerikanëve mbi veprimtarinë e rezistencës shqiptare	40
I-15. Përfaqësuesit e Aleatëve në Ballkan përshkruajnë strategjitë e luftës guerrile në Shqipëri	40
I-16. Hermann Neubacher përshkruan politikën e ndjekur nga nazistët në zonën e Kosovës dhe Metohisë	41
I-17. Raporti i Sekretarit të Komitetit Rajonal të Partisë Komuniste Jugosllave për Kosovën dhe Metohinë drejtuar Komitetit Qendror për situatën ushtarake dhe politike dhe për situatën e organizimit të partisë në rajon, më 21 gusht 1942	42

I-18.	Përfaqësuesi ushtarak kroat në Sofje rreth situatës në Maqedoni	43
Fig. 4.	Zëvendësimi i ushtrisë gjermane me atë bullgare, pas pushtimit fashist të Maqedonisë Jugosllave (prill 1941)	43
I-19.	Deklaratë (trakt) e Frontit Nacional Çlirimtar (EAM) (Komiteti i Sterea Elladas)	43
I-20.	Deklaratë (trakt) e Bashkimit Demokratik Kombëtar Grek (EDES), 1943	43
Fig. 5.	Fotografi e partizanëve (burra dhe gra) të rezistencës së majtë në Greqi	45
I-21.	Proklamatë e Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovën dhe Metohinë më 1 tetor 1941, drejtuar popujve të kësaj krahine në lidhje me luftën e përbashkët kundër okupatorit dhe shërbëtorëve të tij	45
I-22.	Vendim i komitetit krahinor të Partisë Komuniste Jugosllave për Malin e Zi, Bokën dhe Sanxhakun, për fillimin e një kryengritjeje të armatosur, 8 korrik 1941	46
I-23.	Kuvendi i Petrovdanit	46
I-24.	Deklarata e miratuar njëzëri në Kuvendin e Ditës së Shën Pjetrit	46
I-25.	Nga ditari i një komandanti partizan jugosllav	47
I-26.	Pjesë nga protokollin e takimit të D. Mihailloviçit me përfaqësuesit e komandës gjermane në Serbi, në fshatin Divçi	47
I-27.	Fragment nga udhëzimet e Drazha Mihailloviçit për majorin Gjorgje Lashiç dhe kapitenin Pavle Gjurishiç	47
Fig. 6.	Pllakat serb	48
I-28.	Betimi i pjesëmarrësve në Konferencën e Ostrogut, 8 shkurt 1942	
I-29.	Bashkëpunim midis ustashëve dhe çetnikëve	49
I-30.	Fillimet e lëvizjes në Bosnjë	49
I-31.	Krijimi i Divizionit eses [SS] "Hanxhar" në Bosnjë	50
I-32.	Fillimet e lëvizjes partizane në Kroaci	51
I-33.	Dëshmi për mënyrën si e përjetoi Ohri ardhjen e gjermanëve, italianëve, bullgarëve dhe partizanëve gjatë Luftës së Dytë Botërore	51
Fig. 7.	Boshnjakë në forcat ustashe	52
I-34.	Një fëmijë flet mbi rivalitetin mes grupimeve politike në Shqipëri	52
I-35.	Letërqarkore e Komitetit Qendror të LNÇ-së, drejtuar të gjitha këshillave rajonale në Shqipëri (datë 9 shtator 1943)	52
I-36.	"BRIGADAT SHQIPTARE NË KOSMET" – Artikull i Xhavid Nimanit në gazetën "Liria", nëntor 1944	53
I-37.	"U FORMUA BRIGADA E 4-t E KOSMETIT" – Artikull i Milan Miqkoviçit në gazetën "Liria", nëntor 1944	53
I-38.	Letra e Melihate Dedës dërguar Komitetit Krahinor të Partisë Komuniste të Jugosllavisë për Kosovën, dhjetor 1944	54
Ic. Marrëdhëniet me dy koalicionet dhe me shtetet fqinje		54
I-39.	Kronikë lajmesh për grushtin ushtarak të shtetit në Jugosllavi	54
I-40.	Raporti i kreut të rabinëve në Jugosllavi, mbi reagimin e popullit ndaj grushtit ushtarak të shtetit të 27 marsit 1941	54
Fig. 8.	27 mars 1941. Demonstrata kundër Forcave të Boshtit në Beograd	55
I-41.	Nga kujtimet e juristit të njohur bullgar, Konstantin Kacarov, gjatë vitit të parë të Luftës së Dytë Botërore	55
I-42.	Një gazetar i njohur bullgar, Danail Krapçevi, bën komente në lidhje me akuzat që iu bënë Bullgarisë ngaqë nuk organizoi qëndresë ndaj ushtrisë gjermane	56
I-43.	Daniel Krapçevi, komenton fitoren e shpejtë të Gjermanisë ndaj Jugosllavisë në prill të vitit 1941	56
Fig. 9.	Gazetë rumune: mbreti Mihai, gjenerali Antonesku, Musolini, Hitleri (1941)	57
Fig.10.	Gazetë rumune: mbreti Mihai dhe Stalini (1945)	57

I-44.	Fragment nga përkujtesa (18. 10. 1941) e kryeministrit të atëhershëm të qeverisë greke në Kajro, Cuderos, drejtuar britanikëve	57
I-45.	Mesazh i Ministrisë së Jashtme Britanike për ambasadorin britanik në Kajro (14 gusht 1944)	57
I-46.	Gjeneral-brigade Majersi, vlerëson ndikimin e qëndresës ndaj nazistëve, në kuadër të zhvillimit të përgjithshëm të luftës	58
Fig.11.	Miqësia midis ushtrisë rumune dhe Ushtrisë së Kuqe: oficerë në front (fotografi nga një gazetë rumune)	59
I-47.	Trajtimi i të burgosurve anglezë në Rumani (1944)	59
I-48.	Fragmente nga protokolli i bisedës ndërmjet J.B. Titos dhe U. Çurçillit në Napoli, 12 gusht 1944	59
I-49.	Urdhri i mbretit italian, Viktor Emanueli III, më 3 maj 1941, me anë të të cilit Italia anekson provincën e Lubjanës	60
I-50.	Një anekdotë e treguar nga arkeologu i famshëm bullgar, Ivan Venedikovi, rreth marrëdhënieve të tij me gjermanët në Maqedoni	60

Id. Organizatat fetare 61

I-51.	Deklaratë e kryepeshkopit të Janinës (Greqi), drejtuar të gjithë të krishterëve nën juridiksionin e tij (10 shtator 1943)	61
I-52.	Letër e kryepeshkopit Damaskinos dhe figurave të tjera të shquara greke, drejtuar Gunter von Altenburgut, ambasadorit gjerman në Greqi	61
I-53.	Kisha katolike e Shqipërisë mbi pushtimin italian	62
I-54.	Letër e shkruar nga një grup priftërinjsh ortodoksë malazez, 16 qershor 1942	
I-55.	Boshnjakët e Sarajevës rreth gjendjes në Bosnjë	63
I-56.	Klerikët islamikë dhe krijimi i divizionit SS boshnjak në vitin 1943	64
I-57.	Fjalimi i mbajtur në vitin 1942 nga patriarku rumun, Nikodimi	64
I-58.	Artikull në shtyp: Kishat motra. Një e ardhme e shkëlqyer për ortodoksinë, nga Mihai Burlacu	64
I-59.	Në manastirin e Ostrogut, më 23 prill 1941, Gestapoja gjermane arreston patriarkun Gavriilo	65
I-60.	Thirrja që Stepinaci i bën klerit katolik për të mbështetur Shtetin e Pavarur Kroat, 28 prill 1941	66
I-61.	Letër e Stepinacit dërguar Paveliçit, më 14 maj 1941	66
I-62.	Atë Zlatko Sviriči, mbi konvertimin e serbëve ortodoksë në katolikë	67

KAPITULLI II: Jeta në kohë lufte 69

Ila. Varfëria, pasiguria 69

II-1.	Shpërndarja e racionuar e bukës në Rumani gjatë luftës (1942)	69
II-2.	Shpërndarja e racionuar e bukës në Rumani gjatë luftës (1944)	69
Fig.12.	Shpërndarja e racionuar e bukës në Stamboll	70
II-3.	Një fshatar grek përshkruan pushtuesit italianë	70
II-4.	Diplomati bullgar, Ivan D. Stançov, përshkruan jetën e familjes së tij gjatë luftës	70
II-5.	Konsulli i përgjithshëm amerikan në Stamboll, mbi atmosferën e krijuar në Bullgari në shtator të vitit 1942	70
Fig.13.	Radhë njerëzish në një dyqan në Lubjanë në kohën e Luftës	71
Fig.14.	Radhë për të blerë mish në Zagreb	71
II-6.	Gazetarët serbë kërkojnë që tregtarët mashtrues të detyrohen të mbajnë shirita turpi	71
Fig.15.	Karikaturë turke	72
II-7.	Njerëzve në qytet u duhej të shitnin gjithçka që mund të shitnin	72
II-8.	Pasiguria e jetës gjatë Luftës në Shqipëri	72

II-9.	Qytetarët e Beogradit mbjellin perime	73
Fig.16.	Të vdekur prej urisë, gjatë dimrit tragjik të vitit 1941/1942 në Greqi	73
II-10.	Faik Okteji mbi taksën për kapitalin turk	73
II-11.	Rrëfimi që u përhap në popull në kohën e mbledhjes së taksës së pasurisë në Turqi	74
IIb. Civilët		74
II-12.	Autoritetet gjermane kërcënojnë banorët e Beogradit	74
Fig.17.	Afische propagandistike gjermane	75
II-13.	Vendim i Këshillit Nacional Çlirimtar të Beranesë, më datë 21 korrik 1941	75
II-14.	Puna gjatë periudhës së Luftës në Rumani	75
II-15.	Shërbimet Sekrete raportojnë në lidhje me pakënaqësitë e popullit për kushtet e jetesës në Rumani	76
Fig.18.	Stërvitje për mbrojtjen civile në sheshin Bajazid të Stambollit	77
II-16.	Përfaqësuesi ushtarak i Shtetit të Pavarur Kroat në Sofje raporton për situatën në Maqedoninë e Vardarit që qeverisej nga Bullgaria	77
II-17.	Gjendja në Maqedoni në vitin 1941, sipas Komitetit Rajonal të Partisë Komuniste Jugosllave	77
II-18.	Fjala e mbajtur nga Emin Duraku në këshillimin e Komitetit Krahinor të Partisë Komuniste Jugosllave për Kosovën dhe Metohinë, në shkurt 1942	78
II-19.	Dashuria në kohë lufte	78
IIc. Jeta e ushtarëve		79
II-20.	Odise Elitisi, fitues i çmimit Nobel për letërsinë në vitin 1979, përshkruan përvojën e një ushtari grek në frontin shqiptar	79
Fig.19.	Litografi ku paraqitet një luftëtar grek i lashtësisë nga Beteja e Maratonës, një luftëtar i Luftës Greke për Pavarësi, të vitit 1821 dhe një 'evzon' (luftëtar grek i kohëve moderne)	80
II-21.	Ditët e para të Ivan Shiblilit, në çetat partizane në Kroaci	80
II-22.	Ivan Shibli përshkruan gratë partizane	80
II-23.	Gratë në fshatrat e Grevenasë (Greqi) kërkojnë më tepër respekt dhe pjesëmarrje më të madhe në çështjet publike, pasi kishin marrë pjesë në lëvizjen e rezistencës	81
II-24.	Gratë e reja partizane (këngë nga një autor i panjohur maqedonas)	81
Fig.20.	Heroinat e vitit 1940	81
Fig.21.	Gazetat partizane: Gazeta xhepi për trupat e ndërlidhjes, Zadar (Kroaci), 1944	82
II-25.	Partizanët e paepur	82
II-26.	Denço Znepolski, komandant i shquar i forcave guerrile bullgare, flet për marrëdhëniet ndërmjet burrave dhe grave në njësinë e tij	82
II-27.	Beteja në Bërrylin e Donit – Stalingrad	83
II-28.	Neagu Djuvara, historian dhe diplomat i njohur, kujton periudhën kur mori pjesë në luftë, në Frontin Lindor	83
Fig.22.	Ata që i kënduan Luftës	84
II-29.	Ditari i Luftës i Fadil Hoxhës - <i>Kur pranvera vonohet</i> , Prishtinë 1980	84
II-30.	Vështirësitë që hasin luftëtarët për t'u përshtatur me jetën si qytetarë	85
Fig.23.	Pasqyrë e gazetave të botuara nga njësitë ushtarake maqedonase në Jugosllavi që nga viti 1944	85
II-31.	Gabimi i tmerrshëm	85
IId. Kultura dhe arsimi		86
II-32.	Rekomandime për mësuesit nga Inspektorati Rajonal i Shkollave në Manastir	86
Fig.24.	Shkolla partizane	87
II-33.	Statuti i Klubit qendror kulturor "Kliment Ohridski" në Maqedoni	87
II-34.	Qeveria e Antoneskut nxit kultin e heronjve	87

II-35.	Fragment nga një libër shkollor për arsimin fillor, botuar nga Fronti Nacional Çlirimtar (që udhëhiqej nga komunistët) në zonat e çliruara të Greqisë	88
Fig.25.	Ilia Beshkov: Pa një hapësirë për të jetuar, 1942	88
II-36.	Konsulli i përgjithshëm amerikan në Stamboll mbi propagandën që zhvillohet në shkollat bullgare	89
Fig.26.	Fotografi në një gazetë rumune: artikull mbi modën e veshjeve të grave (1942)	89
Fig.27.	Skenë nga filmi Pafajësi pa mbrojtje, i regjisorit Dragoljub Aleksić	89
II-37.	Ligji rumun për organizimin e arsimit të hebrenjve	90
II-38.	Ndryshimet në programin mësimor në Shqipëri gjatë pushtimit italian	90
Fig.28.	Reklama filmash në kinematë e Beogradit në mes të shtatorit të vitit 1942	90
Fig.29.	Fëmijë duke hyrë në shkollën fillore "Hasan Prishtina"	91
II-39.	Jeta në qendrën rinore Italo Balbo, e ngritur në Shqipëri nga fashistët	91
Fig.30.	Skuadra kombëtare e futbollit e NDH-së (Shtetit të Pavarur Kroat)	91
Fig.31.	Reportazh në një gazetë rumune, që bën fjalë për një ndeshje futbollit ndërmjet Rumanisë dhe Kroacisë në vitin 1942	92
II-40.	Ministria e Arsimit Kombëtar të Rumanisë ndalon hartat që mund t'i kujtojnë popullit pushtimin sovjetik të vitit 1940	92
II-41.	Pastrimi i gjuhës që donte të arrinte Paveliçi	92

KAPITULLI III: Tmerret e Luftës 95

IIIa. Vija e Frontit 95

III-1.	Ligji ushtarak që zbatohet nga partizanët shqiptarë	95
III-2.	Letra e komandantit të shtabit suprem të UNÇ-së e datës 22 janar 1944, dërguar misionit të aleatëve në lidhje me shtrirjen dhe armatimet e forcave armike	96
III-3.	Letra e komisarit politik të shtabit suprem të UNÇ-së dhe Kk të Kosmetit e datës 14 prill 1944, mbi përmbajtjen e raportit lidhur me gjendjen politiko-ushtarake në regjion drejtuar sekretarit të komitetit krahinor të PKJ-së	96
III-4.	Trajtimi i robërve nga nacionalistët shqiptarë	97
Fig.32.	Divizioni i katërt partizan në malet e Malit të Zi, 1944	97
Fig.33.	Ushtarë rumunë mbi deve në Betejat e Kaukazit	97

IIIb. Krimet 98

III-5.	Njoftime, drejtuar popullit grek nga ana e komandantëve të ushtrisë gjermane në Greqi (1943)	98
III-6.	Pamflet gjerman (tetor 1943), pas raprezaljeve të para masive në Greqi	98
III-7.	Urdhri i Hitlerit (shtator 1941), në lidhje me qëndrimin e ushtrisë në territoret e pushtuara në Europën Juglindore	98
Fig.34.	Raprezalje nga ana e ushtrisë gjermane në Greqi (fotografi e ekzekutimeve në masë në Agrinio, 1943)	99
III-8.	Mizoritë gjermane gjatë pushtimit të Shqipërisë	99
III-9.	Mizoritë italiane në Slloveni	99
Fig.35.	Fotografi të fshatrave të djegur dhe të shkatërruar gjatë raprezaljeve	100
III-10.	Fragment nga intervista me Cveto Kobalin	100
Fig.36.	Faqja e parë e pamfletit mbi Mauthausenin.	101
III-11.	Një letër drejtuar Hitlerit	101
III-12.	Masat e marra nga gjermanët, si përgjigje ndaj kryengritjes në Serbi	102
III-13.	Masakra ndaj civilëve në Kragujevac	102
III-14.	Raport partizan rreth veprimeve të italianëve dhe çetnikëve në zonën e Likas, gjatë verës dhe vjeshtës së vitit 1942	103
III-15.	Krimet e çetnikëve kundër myslimanëve në Sanxhak, shkurt 1943	103

III-16.	Torturat e tmerrshme të kryera nga ustashët në burgjet e Sarajevës	104
Fig.37.	Fotografi e sheshit kryesor në Beograd, më 17 gusht 1941	104
III-17.	Raport për gjendjen e romëve në Transnistria	104
Fig.38.	Afische me emrat e pengjeve të vrarë në pjesën e Sllovenisë së pushtuar nga gjermanët	105
III-18.	Jeta në kampin e përqendrimit Stara Gradishka..	105
III-19.	Letër dërguar familjarëve nga kampi i përqendrimit “Stara Gradishka”	105
III-20.	Një ushtar ustash përshkruan veprimet e tij mizore	106
III-21.	Krimet e partizanëve në Bleiburg	106
III-22.	Titoja flet për krimet e partizanëve	106
Fig.39.	Viktimat (pikturë vaji nga Vladimir Filakovaci, Zagreb, 1943)	106
III-c. Holokausti		108
III-23.	Pjesë nga Ligji Bullgar për Mbrojtjen e Kombit	108
III-24.	Deputetët bullgarë protestojnë ndaj dëbimit të hebrenjve	109
III-25.	Urdhër i lëshuar nga Komanda Ushtarake, Beograd	109
III-26.	Jon Antonesku dënon masakrat në Jashi	109
Fig.40.	Karikaturë turke	110
Fig.41.	Karikaturë turke	111
III-27.	Kampi i përqendrimit Sajmishte, Beograd	111
Fig.42.	Një vajzë e panjohur që pret të dërgohet në internim (pranë Celjes në Slloveni)	112
III-28.	Vuajtjet e një vajze të vogël hebre nga Sarajeva	112
III-29.	Masa kundër hebrenjve në Greqi	112
III-30.	Fragment nga kujtimet e një hebreu grek në Selanik (1941-43)	113
Fig.43.	Kampi i përqendrimit i Beogradit në Banjica	114
Fig.44.	Kampi i përqendrimit Ushtica, 1942	114
III-31.	Letër dërguar zyrës së Paveliçit nga Rozalia Kremer	114
Fig.45.	Faqja e parë e një katalogu nga ekspozita kundër hebrenjve në Zagreb, 1942	115
KAPITULLI IV: Solidariteti njerëzor		117
IV-1.	Bashkëbisedim midis një partizani dhe një ustashi	117
Fig.46.	Njoftim në një gazetë rumune: Ndhmoni jetimët	118
IV-2.	Festimi i ditës së emrit në një kamp përqendrimi	118
IV-3.	Letra e intelektualëve drejtuar J. Antoneskut (prill 1944)	119
IV-4.	Fragment nga një letër e kryeministrit grek (7 tetor 1943), drejtuar autoriteteve gjermane	120
IV-5.	George Enesku përpiket të mbrojtje romët	120
IV-6.	Memorandum i një grupi berberësh dhe parukierësh bullgarë drejtuar ministrave lidhur me Ligjin për Mbrojtjen e Kombit	120
IV-7.	Ndihma dhe mbështetja turke dhënë Greqisë	121
IV-8.	Ambasadori turk shpëton hebrenjtë turq në Marsejë, Francë	121
IV-9.	Pjesë nga ditari i një ushtari bullgar në Trakinë Perëndimore	122
IV-10.	Marrëdhëniet midis ushtarëve rumunë, të burgosurve rusë dhe komunitetit bullgar në Rumani gjatë Luftës së Dytë Botërore	123
IV-11.	Një hebre grek përshkruan ndihmën që i dhanë atij dhe familjes së tij grekët ortodoksë	123
Fig.47.	Hebrenj turq që qëndrojnë përpara konsullatës turke në Paris, në vitin 1943, për të marrë pasaporta dhe viza për t'u kthyer në Turqi	124

IV-12.	Trajtimi njerëzor që u bëhet hebrenjve nga ana e zyrtarëve rumunë	124
IV-13.	Një oficer gjerman shpëton një diplomat bullgar nga Gestapoja në Bullgari	125
Fig.48.	Spitali i fshehtë partizan "Franja", pranë Cerknos në Slloveni	125
IV-14.	Alfonz Baroni, përfaqësues i fabrikës së karamелеve dhe çokollatave "Bashkimi", i drejtohet policisë së ustashëve (9 korrik 1941)	126
Fig.49.	Letër anonime nga një qytetar i Beogradit, drejtuar komandantit ushtarak gjerman në Serbi	126
KAPITULLI V: Pasojat		127
Va. Humbjet dhe viktimat e luftës		127
V-1.	Në Konferencën e Paqes në Paris, Enver Hoxha flet për të vrarët dhe dëmet materiale që pësoi Shqipëria	127
Fig.50.	17 nëntor 1944	127
V-2.	Një gazetar zviceran përshkruan shkatërrimin e Podgoricës	127
<i>Tabelat</i>		
	1. Numri i të vrarëve në Jugosllavi sipas kombësisë	128
	2. Humbjet që pësoi Greqia gjatë Luftës së Dytë Botërore	128
	3. Humbjet e anijeve tregtare greke gjatë Luftës së Dytë Botërore	129
Vb. Shpërnguljet gjatë dhe pas Luftës		130
<i>Tabelat</i> 4.	Emigracioni në Malin e Zi 1941-1945	130
V-3.	Raport gjerman mbi dëbimin në masë të sllovenëve	130
V-4.	Raport i komisionerit të lartë të provincës së Lubjanës, 24 gusht 1942, mbi programin e veprimeve në rajon	131
Fig.51.	Refugjatë të ardhur nga Bosnja në Serbi, 1941	131
V-5.	Persekutimi i pakicave gjermane në Rumani pas Luftës	132
V-6.	Uinston Çurçill, mbi internimin e qytetarëve rumunë me origjinë gjermane në Rusi	132
Fig.52.	Kthimi i Gardës Kombëtare Sllovene (Domobranci) në qershor të vitit 1945	133
Vc. Ndryshimet në sistemet politike		134
V-7.	Oferta e U. Çurçillit për një marrëveshje me "përqindje"	134
Fig.53.	Populli i Athinës feston mbërritjen e ushtrisë britanike pas çlirimit	134
V-8.	Forcimi i autoriteteve të Lëvizjes Nacional Çlirimtare në Bosnjë dhe Hercegovinë	134
V-9.	Largimi i ustashëve dhe mbërritja e partizanëve në Zagreb	135
Fig.54.	Hyrja e partizanëve në Zagreb, më 8 maj 1945	135
Fig.55.	Mitingu në sheshin "Ban Jelačić" në Zagreb, në maj të vitit 1945, pasi partizanët morën pushtetin	135
V-10.	Fragment nga raporti i mbajtur në një nga mbledhjet e Partisë së Punës Bullgare (Komuniste), ku vihet në dyshim gjykimi i anëtarëve të regjimit të kaluar	136
V-11.	Raporti i ministrit të Drejtësisë, lidhur me numrin e njerëzve të dënuar nga Gjykata e Popullit në Bullgari	136
V-12.	Memorandum i Britanisë, lidhur me gjyqet dhe zbatimin e vendimeve ndaj të ashtuquajturve kriminelë luftime në vendet e çliruara dhe satelite	136
Fig.56.	Udhëheqësve ushtarakë, politikë dhe shtetërorë maqedonas u bëhet një pritje e ngrohtë në Shkupin e çliruar, (13 nëntor 1944)	137
V-13.	Pushtimi i Bullgarisë nga Ushtria e Kuqe dhe marrja e pushtetit nga Fronti për Atdheun	137
Fig.57.	Populli i Beogradit mirëpret ushtrinë bullgare	137

KAPITULLI VI: Kujtimet e Luftës	139
VI-1. Intervistë e Jozhe Pozharit, jetim i Luftës së Dytë Botërore (i lindur në vitin 1932 në Slloveni)	139
VI-2. Fragment nga romani gjysmëbiografik i Fikret Demiragut	139
VI-3. Komandanti partizan bullgar Denço Znepolski rrëfen se si u rishkrua, pas Luftës së Dytë Botërore, historia e rezistencës	140
Fig.58. Afresk i punuar nga Borko Lazeski	140
Fig.59. Skenë nga filmi <i>Republika Uzhice</i>	140
VI-4. Gjenerali Ctin Sanatesku flet rreth informimit “publik”, që nuk është në përputhje me realitetin në vijën e frontit	141
Fig.60. Gjorgje Andrejeviç-Kun (1904-1964), <i>Pushkatimi</i> , 1943	141
VI-5. Në tregimin e saj të shkurtër, <i>Takimi</i> , Andjelka Martiçi përshkruan një djalë që kërkon të atin partizan	141
VI-6. <i>I Arratisuri</i> – këngë e shkruar nga lakovos Kambanellisi	142
VI-7. Ivlin Uofi [Evelin Waugh] përshkruan sulmin partizan (shkëputur nga pjesa e fundit e trilogjisë së tij mbi luftën, <i>Shpata e Nderit</i>)	142
Fig.61. Poster nga filmi grek <i>Tradhtia</i> , 1964	143
Fig.62. Poster nga filmi grek <i>Thanas, ç'bëre gjatë luftës?</i> , 1971	144
VI-8. Romani i parë i Dobrica Çosiçit, <i>Dielli është larg</i>	144
Fig.63. Pikturë nga Guri Madhi, ku paraqitet sulmi partizan ndaj trupave gjermane	145
Fig.64. Pikturë e Fatmir Haxhiut, e cila paraqet një episod beteje gjatë Luftës së Dytë Botërore	145
VI-9. Marin Preda përshkruan një ngjarje nga këndvështrimi i një ushtari	146
Fig.65. Një pjesë e pllakatit komik <i>Ekspres ballkanas</i> , nga Branislav Keraci dhe Branko Plavshiqi, bazuar në skenarin e Gordan Mihiçit.	146
VI-10. Atmosfera në burgun e Kolashinit	147
VI-11. Pjesë nga romani <i>Duhani</i> i Dimitar Dimovit	147
VI-12. Një qipriot turk, Qemal Rexhep Susuzlui, rrëfen ditët e burgut që i kaloi me një udhëheqës qipriot grek, Glafkos Kleridesin	148
Fig.66. Skenë nga filmi shqiptar <i>Kur zbardhi një ditë</i>	149
VI-13. “ <i>Vëllai im Ramiz</i> ”, poezi kushtuar Ramiz Sadikut dhe Boro Bukmiroviçit	149
Tabela: Festat kombëtare që lidhen me Luftën e Dytë Botërore	150
Harta 2: Europa Juglindore pas Luftës së Dytë Botërore	151
Bibliografia	153

Sipas historianit Mark Mazouer, “asnjë ngjarje tjetër nuk ka qenë më e rëndësishme në zhvillimin e Europës së shekullit të njëzetë [sesa Lufta e Dytë Botërore]... kjo qe një luftë për të ardhmen shoqërore dhe politike të vetë kontinentit... Ne s’mund të mëtojmë që ta kuptojmë rrjedhën e mëvonshme të historisë europiane, pa trajtuar këtë ngjarje tepër të madhe dhe pa u përpjekur të përcaktojmë pasojat e saj shoqërore dhe politike. Vitet e pushtimit nazist, të pasuara nga kaosi që karakterizoi periudhën e pasluftës, përveç lidhjeve midis njerëzve, shkatërruan shtëpi dhe komunitete, dhe në shumë raste, shkulën vetë themelet e shoqërisë.”

Megjithëse historianët vlerësojnë një numër jo të vogël faktorësh si shkaqe për fillimin e Luftës së Dytë Botërore, e konkretisht: qysh pas Luftës së Parë Botërore, popullsitë e vendeve që u mundën mendonin se ishin trajtuar në mënyrë të padrejtë nga fituesit, demokracia në shumë vende të Europës ishte e brishtë dhe kriza ekonomike ndërkombëtare e viteve ‘30-të goditi ashpër kontinentin, por përsëri, pothuajse të gjithë historianët, si shkakun kryesor për fillimin e Luftës së Dytë Botërore konsiderojnë politikën agresive imperialiste të Gjermanisë naziste, Italisë fashiste dhe Japonisë.

Burimet historike në këtë përmbledhje janë përzgjedhur, duke u bazuar në parametra të përcaktuar gjeografikë dhe mbulojnë rajonin e Europës Juglindore. Ndryshe nga Musolini, në planet e të cilit territoret e Ballkanit konsideroheshin si pjesë kryesore për zgjerimin e Perandorisë Italiane (ushtria italiane pushtoi Shqipërinë në vitin 1939, dhe Greqinë në fund të vitit 1940), Hitleri nuk e kishte këtë rajon në listën e tij të përparësive, të paktën jo aq sa të angazhonte fuqimisht atje ushtrinë gjermane. Duke pasur parasysh planet e mëdha naziste për zgjerim territorial në Lindje dhe pushtimin e territoreve më të mëdha, një operacion ushtarak në Juglindje të Europës do të thoshte shpenzime të panevojshme në njerëz dhe burime. Trysnia diplomatike ndaj vendeve tashmë të frikësuara prej forcës së *Blitzkriegut* gjerman do të ishte e mjaftueshme për të siguruar epërsinë dhe hegjemoninë gjermane, si dhe bashkëpunimin e tyre. Fillimisht dukej se ngjarjet po ecnin në këtë drejtim: kontrolli gjerman u vendos mbi burimet hungareze dhe rumune nëpërmjet trysnisë diplomatike, ndërsa Bullgaria dhe Jugosllavia hynë në “Paktin Tripalësh” në fillim të vitit 1941. Udhëheqja politike, rihapja e hesapeve të vjetra nga ultranacionalistët dhe frika prej luftës ose dhe frika nga komunizmi i çoi vendet e Ballkanit të ndryshonin pozicionin e tyre nga ai asnjans në pronazist.

Shqipëria iu la Italisë dhe Greqia, më në fund, u vu nën kontrollin nazist. Operacionet ushtarake të Hitlerit në Ballkan qenë të pashmangshme, pasi Musolini dështoi në përpjekjen për të nënshtruar Greqinë dhe Britania vendosi të çonte atje trupat e saj. Kur forcat e armatosura organizuan një grusht shteti të suksesshëm për rrëzimin e qeverisë në Beograd, e cila pak ditë më parë kishte nënshkruar hyrjen e Jugosllavisë në Paktin Tripalësh, Hitleri urdhëroi Vermahtin të pushtonte Jugosllavinë, gjithashtu dhe Greqinë. Njëkohësisht, madje edhe pak përpara këtij grushti shteti, një pjesë e popullsisë ishte shprehur e pakënaqur ndaj përgatitjeve të Jugosllavisë për të hyrë në Paktin Tripalësh dhe kur kjo u bë realitet, nisën demonstratat publike. Këto ngjarje patën një rëndësi simbolike, por edhe morale, sepse ato qenë shembulli i parë i kundërshtimit publik ndaj vendimit të qeverisë për t’u bashkuar me Paktin Tripalësh. Përveç rëndësisë morale dhe simbolike të shprehjes së opinionit publik, këto ngjarje të pazakonta patën edhe pasojat ushtarake: sipas disa historianëve, vendimi i Hitlerit për të sulmuar Europën Juglindore ishte një kundërveprim nervoz ndaj këtyre akteve. Në një farë mase, ky kundërveprim ndryshoi drejtimin e Luftës së Dytë Botërore, sepse sulmi nazist ndaj Bashkimit Sovjetik u shty për më vonë. Në këtë rast, mund të ngremë një pyetje hipotetike: Ç’rrjedhë do të kishte marrë lufta, nëse trupat gjermane do të kishin hyrë në Moskë në shtator dhe jo në nëntor të vitit 1941?

Aty nga mesi i vitit 1941, të gjitha shtetet e Ballkanit, përveç Turqisë, ishin nën sundimin nazist ose ishin aleate të nazistëve. Jugosllavia ishte e ndarë: Kroacia (me Bosnjën dhe Hercegovinën si krahina të saj) u

kthye në një shtet kukull në duart e Forcave të Boshtit, ndërkohë që pjesa tjetër e vendit ishte ndarë në zona të pushtuara nga Italia, Gjermania, Hungaria dhe Bullgaria. Gjithashtu edhe Greqia ishte e ndarë në tri zona të pushtuara nga Italia, Gjermania dhe Bullgaria. Turqia u përpoq të ruante asnjësinë, megjithëse *Traktati i Paqes* midis Turqisë dhe Gjermanisë, nënshkruar në qershor të vitit 1941, mund të interpretohet si një hap drejt afrimit me Forcat e Boshtit.

Bindjet raciste të Hitlerit dhe ideja e industrializimit të vrasjeve në masë sollën vdekjen e 5-6 milion hebrenjve në Europë, deri në përfundim të luftës. Gjithashtu, nga politikat raciste të Hitlerit u ndikuan edhe grupe të tjera etnike, siç ishin romët dhe sllavët, por natyra sistematike e asaj që ai e quajti "Zgjidhja përfundimtare" kishte të bënte me "Problemin hebre". Prandaj ky është një rast i veçantë, i cili ia vlen të studiohet veçmas. Në Ballkan, ashtu si edhe në vende të tjera të Europës, pushtimi nazist nxori në dukje dhe shfrytëzoi qëllimisht tensionet që zienin midis grupeve të ndryshme etnike dhe u dha mundësinë disa minoriteteve të hakmerreshin ndaj shtypjes që u ishte bërë, ose "të ndreqnin" padrejtësitë. Kështu për shembull, Shteti i Pavarur Kroat, i cili fitoi pavarësinë si një shtet kukull në duart e Forcave të Boshtit, dhe që drejtohej nga një parti ultranacionaliste, nga ustashët, persekutoi serbët dhe hebrenjtë. Kjo dukuri nuk ishte karakteristike e një zone të vetme; edhe në vende të tjera, grupimet ultranacionaliste nisën programe për ndryshime të thella demografike. Nazistët dhe mbështetja që ata patën në Ballkan, sollën një transformim të përbërjes etnike të rajonit. Popullsia çifute ra nga 856 000 në vitin 1930, në më pak se

50 000 në vitin 1950. Pas luftës, qindra mijëra njerëz me etni gjermane u dëbuan nga Jugosllavia dhe u shpërngulën nga Rumania, ndërsa sllavët dhe shqiptarët u shpërngulën nga Greqia Veriore.

Në fund të viteve '30-të, diktaturat e djathta i kishin zëvendësuar qeveritë demokratike kudo në Ballkan dhe partitë komuniste u ndaluan. Por diktaturat në Ballkan ndryshonin nga regjimet fashiste, sepse në këtë rajon partitë populiste nuk mbijetuan, ndoshta me përjashtim të lëvizjes së vetme popullore me pikëpamje fashiste në rajon, ajo e Kodreanut në Rumani. Tronditja shkatërrimtare nga lufta totale dhe largimi i disa krerëve të shtetit në mërgim zhdukën elitën politike të paraluftës. Pushtimi nazist e shtoi pamundësinë e shtetit për të mbrojtur civilët nga dhuna, nga kequshqyerja dhe mungesa e çdo gjëje. Trauma e shkaktuar nga jeta në një regjim dhune të paparë dhe sistematik, bashkë me vuajtjet e mëdha dhe shkatërrimin që goditi civilët për një periudhë gjashtëvjeçare, i transformuan thellë të gjitha shoqëritë europiane, por veçanërisht shoqëritë e vendeve të Europës Juglindore, ku politika naziste e konfiskimeve dhe raprezaljeve krijoi një atmosferë tmerrri. Në këto kushte, uria dhe terrori bënë fillimisht që shumë njerëz të hidheshin në luftë kundër nazizmit, por më vonë, këto veprime spontane fituan edhe mbështetje ideologjike dhe politike. Përveç rëndësisë së tyre ushtarake (megjithëse kjo ishte e ndryshme nga njëri vend në tjetrin), lëvizjet e rezistencës patën ndikim të madh politik dhe moral. Shumica e këtyre lëvizjeve synonte një shoqëri të re në botën e pasluftës, ku do të mbizotëronin barazia dhe virtytet morale; për më tepër, qëllimi i tyre ishte një ndarje më e drejtë e pasurisë. Megjithatë, lëvizjet e rezistencës ishin të përçara dhe në kushtet e pasigurisë dhe çoroditjes ideologjike të shkaktuara nga lufta, nisën përplasjet ndërmjet grupimeve, që shpesh çuan deri në luftë civile. Ndërkohë që lëvizjet e rezistencës pas vitit 1943 u intensifikuan, ato nxitën raprezalje nga milicia kolaboracioniste, duke filluar kështu, në shumë shtete, një lloj tjetër lufte civile. Sidoqoftë, në vitin 1944, lëvizjet masive të rezistencës, të mbizotëruara nga komunistët, dukej se ishin gati të merrnin pushtetin në shumë vende të rajonit kur nazistët të tërhiqeshin.

Megjithatë, fuqitë jashtë Europës Juglindore po punonin për qëllimet e tyre, dhe pavarësisht nga fuqizimi i rezistencës, kishin plane të tjera, që nuk merrnin parasysh vetëvendosjen e shteteve ose popujve të Ballkanit. Në tetor të vitit 1944, kur këto lëvizje ishin gati për të marrë pushtetin, Çurçilli dhe Stalini ranë në një mendje për sferat e ndikimit në Europën Juglindore pas luftës: Greqia do të vendosej nën kontrollin britanik; pjesa tjetër, me përjashtim të Jugosllavisë, për të cilën marrëveshja ishte 50 me 50, do t'i lihej Bashkimit Sovjetik. Pas një lufte të gjatë civile, komunistët grekë, më në fund, u mposhtën (1946-49). Në Jugosllavi dhe në Shqipëri partizanët komunistë morën menjëherë pushtetin. Bullgaria dhe Rumania u pushtuan nga trupat sovjetike, të cilat sollën në pushtet regjime komuniste. Në fund të viteve 40-të, ndarja

e Europës në dy zona influence kishte përfunduar dhe armiqësitë e periudhës së Luftës u transformuan nën trysninë e Luftës së Ftohtë.

Nga këndvështrimi i sotëm është e qartë që Lufta e Dytë Botërore ishte shumë më tepër sesa një varg betejash dhe negociatash diplomatike (megjithëse fatkeqësisht kjo është përshtypja kryesore dhe ndonjëherë e vetme që nxënësit krijojnë nga librat shkollorë). Përveç karakterit ushtarak, Lufta e Dytë Botërore shfaqti edhe konflikte fetare, etnike dhe racore. Siç e përmendëm më lart, në disa shtete u kthye në luftë civile - konflikte midis disa lëvizjeve të rezistencës dhe gjithashtu, ndërmjet lëvizjeve të rezistencës dhe forcave kolaboracioniste, veprimet e të cilave shpesh herë ia kalonin egërsisë naziste. Shembuj të tillë gjenden në historinë e Europës Juglindore të kësaj periudhe, dhe si rrjedhojë janë përfshirë edhe në këtë përmbledhje me burime historike. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë që mund të harrojmë, qoftë edhe për një sekondë të vetme, se cilët ishin keqbërësit kryesorë, siç nuk mund t'i lejojmë ta mohojnë përgjegjësinë për të keqen që u shkaktuan kombeve dhe popujve të Ballkanit. Përgjegjësia që ka nazizmi për fillimin e luftës dhe pasojat e saj, nuk mund të zvogëlohen, dhe s'bëhet fjalë që të vihen në dyshim. Megjithatë, duke pasur parasysh karakterin kriminal të regjimit nazist që nisi luftën, mbetet fakt që elita politike në shumë vende u priir drejt nazizmit. Është e qartë se shumë veta nga radhët e kësaj elite shfrytëzuan mundësinë (nën mbrojtjen e Hitlerit) të zgjidhnin disa kontradikta të vjetra me fqinjët e tyre, të rishikonin vendimet e Versajës, të hiqnin qafe minoritetet e "bezdisshme", ose të zgjeronin tokat e tyre dhe të shtonin pasuritë vetjake. Kuptohet që kjo elitë nuk u krijua nga hiçi, as nuk u zhvillua në një vakuum a zbrazëti politike. Në shumicën e vendeve të rajonit kishte simpatizues të shpallur dhe të fshehtë të nazizmit që, në një farë mase, ishin të një mendjeje me ideologjinë naziste ose kishin një prirje të fshehtë drejt filozofive të ndarjes racore. Kur një shtet bashkohej me Paktin Tripalësh ose pushtohej nga nazifashistët, këtyre simpatizantëve u jepej mundësia që të tregonin besnikërinë dhe përkrahjen e tyre për ideologjinë naziste. Kjo përkrahje e palëkundur i hapi rrugën nazizmit dhe kontribuoi për krimet që pasuan.

Qëllimi ynë është që t'u paraqesim nxënësve një panoramë sa më të larmishme të Luftës së Dytë Botërore. Për këtë arsye, një numër relativisht i vogël burimesh në këtë Libër pune kanë të bëjnë me veprimet luftarake. Zgjedhëm këtë qasje jo për të zvogëluar rëndësinë ushtarake që patën lëvizjet e rezistencës në Europën Juglindore, as kontributin e madh që rajoni dha në rrëzimin e fashizmit dhe nazizmit; qëllimi ishte që të hidhnim dritë, qoftë edhe pjesërisht, në aspektet e luftës të cilat në librat shkollorë trajtohen më pak dhe për të plotësuar dëshirat e sugjerimet e mësuesve që t'i përdorin në klasat e tyre. Është e ditur tashmë, se në shumicën e teksteve shkollorë në Europën Juglindore, i jepet përparësi historisë politike dhe kështu ndodh edhe në rastin e Luftës së Dytë Botërore. Aspekte të tjera, që të paktën janë njëlloj të rëndësishme dhe padyshim më interesante për nxënësit, për shembull, jeta e përditshme, statusi i grave dhe fëmijëve, jeta kulturore, pasqyrimi i luftës në letërsi dhe degë të tjera të artit, dashuria në kohë lufte e kështu me radhë, në shumicën e rasteve mënjahohen ose mund të gjenden vetëm pak gjurmë të tyre në tekstet shkollorë.

Kjo përmbledhje përmban burime nga 11 vende të Europës Juglindore dhe kjo gjë ka përparësitë dhe dobësitë a mangësitë e veta. Përparësia kryesore e kësaj përmbledhjeje me burime historike ka të bëjë me faktin se ajo u mundëson nxënësve të marrin njohuri nga këndvështrime të ndryshme për periudhën historike në fjalë. Trajtimi i një periudhe historike, në këtë rast i Luftës së Dytë Botërore, nga dy ose më tepër këndvështrime nuk është vetëm interesant, por, gjithashtu, tepër i dobishëm: nxënësve u jepet mundësia të lexojnë dhe analizojnë se si i njëjti problem a proces, apo e njëjta ngjarje shihet/shihej nga fqinjët e rajonit.

Në shumë raste, nëpërmjet shqyrtimit të burimeve, nxënësit do të gjejnë ngjashmëri jo të pakta, si varfërinë, urinë, pasigurinë dhe vuajtjet e shumta që karakterizuan këtë periudhë në të gjithë Europën Juglindore. Nga ana tjetër, ata do të ndeshen me disa burime kontradiktore, të cilat e trajtojnë të njëjtin problem nga këndvështrime krejt të ndryshme, ose që e trajtojnë të njëjtin problem nga një tjetër këndvështrim, në përfaqje me interpretimin që bëhet në tekstet e tyre shkollorë. Në këto raste, sugjerojmë

se nuk është e nevojshme t'u kërkohet nxënësve të gjykojnë se cili burim është i saktë, i vërtetë ose më afër së vërtetës. Është e mjaftueshme që nxënësit të jenë në dijeni të ekzistencës së tyre, pra, që të ndërgjegjësohen se disa ngjarje dhe procese historike nuk janë aq të thjeshta sa paraqiten në tekstet e tyre shkollore. Konkretisht, në disa vende (ose në shumicën e vendeve të Europës Juglindore), mësimdhënia e Historisë (dhe si rezultat, edhe tekstet e Historisë që bartin këtë koncept) është e bazuar në të "vërtetën e vetme"; pra, ky është një përjashtim, sepse nxënësit do të ndeshen me burime kontradiktore. Duke pasur parasysh këtë fakt, jemi të ndërgjegjshëm se për ata mësues dhe nxënës, të cilët nuk janë mësuar të gjejnë në tekstet e tyre shkollore ose në mësimdhënien e Historisë në përgjithësi burime kontradiktore që kundërshtojnë njëri-tjetrin, kjo përmbledhje burimore, e bazuar në qasjen nga shumë këndvështrime, mund të shkaktojë një farë çorientimi, madje edhe mospranimi. Megjithatë, ne jemi të mendimit se me një trajtim nga disa këndvështrime, mund të kuptohet e mësohet historia e vërtetë dhe me cilësi të lartë; në rast të kundërt, ajo kthehet thjesht në mësim datash përmendsh.

Nga ana tjetër, përmbledhja e burimeve, e konceptuar në këtë mënyrë, ka një të metë të ndjeshme. Duke pasur parasysh faktin që në këtë përmbledhje të kufizuar përfshihen materiale dokumentare dhe pamore nga 11 vende të Europës Juglindore, është e qartë se ajo nuk mund të bëjë një pasqyrim të plotë të Luftës së Dytë Botërore në këtë rajon – kjo do të ishte tepër ambicioze për t'u pretenduar. Qysh në fillim të këtij projekti, e kemi patur parasysh këtë fakt, prandaj ishte e nevojshme që të bëhej një përzgjedhje e temave, p.sh., të zgjidhnim vetëm disa nga aspektet e shumta të Luftës së Dytë Botërore, ndërkohë që disa të tjera, megjithëse jo më pak të rëndësishme, mund të mos jenë përmendur. Përveç përzgjedhjes së temave që trajtohen më pak në tekstet shkollore, kriteri tjetër i ndjekur në përzgjedhjen e burimeve ishte ai metodologjik: ne u përpoqëm të përfshinim sa më shumë që të ishte e mundur burime, të cilat mund të shkaktonin një farë kundërveprimi emocional tek nxënësit (zemërim, tronditje, simpati, admirim, të qeshura...). Fatet e njerëzve të thjeshtë - tragjike, heroike, komike - shpesh na japin një paraqitje më të mirë, më jetësore të kohës së luftës, sesa shpalljet, deklaratat politike ose raportet diplomatike (sigurisht që nuk kemi si qëllim t'u ulim atyre vlerat që kanë, prandaj edhe ato janë përfshirë në këtë përmbledhje).

Me pak fjalë, qëllimi ynë është t'u japim nxënësve dhe kolegëve tanë mësues një paraqitje disi të ndryshme, nga shumë këndvështrime, të kësaj periudhe të zymtë të historisë sonë dhe shpresojmë që kjo përmbledhje me burime parësore, do të ndihmojë për ta kuptuar më mirë këtë kohë. Pavarësisht nga tejdukshmëria dhe thjeshtësia e ngjarjeve të Luftës së Dytë Botërore (të paktën, kur bëhet fjalë për aspektin moral, si për shembull, për dallimin e qartë midis së mirës dhe së keqes), në disa vende të Europës Juglindore ngrihen artificialisht disa dyshime rreth kësaj çështjeje, bazuar në faktin se në shumicën e lëvizjeve të rezistencës, rolin udhëheqës e patën komunistët. Përveç kësaj, në historinë botërore dhe europiane, në këndvështrimin perëndimor, roli i Europës Juglindore në Luftën e Dytë Botërore është paraqitur si i parëndësishëm dhe disa herë është veshur me paragjykimet e hershme mbi rajonin. Mendojmë se kjo përmbledhje dokumentesh do të kontribuojë për të kuptuarit më mirë të historisë sonë si pjesë e historisë së njerëzimit.

Kronologji

Viti	Muaji	Në botë	Në Europën Juglindore
1939	Prill		7 – Italia pushton Shqipërinë. 12 – Asambleja Kushtetuese Shqiptare shpall <i>Bashkimin Personal</i> me Italinë, dhe Viktor Emanuelin III, mbret të Shqipërisë. Italianët krijojnë një qeveri fashiste kukull, drejtuar nga Shefqet Vërlaci, dhe pak kohë më pas, shërbimi ushtarak dhe ai diplomatik i Shqipërisë përfshihet në atë të Italisë.
	Gusht	23 – Pakti sovjeta-gjerman “Ribentrop-Molotov” përmban një marrëveshje sekrete për pushtimin e Besarabisë rumune nga Bashkimi Sovjetik, në të ardhmen.	
	Shtator	1 – Gjermania pushton Poloninë. 3 – Britania dhe Franca i shpallin luftë Gjermanisë. 17 – Bashkimi Sovjetik pushton Poloninë.	7 – Rumania shpallet asnjëse. 15 – Bullgaria shpallet asnjëse.
	Tetor		19 – Turqia, Franca dhe Britania nënshkruajnë Traktatin e Ankarasë për të ndihmuar njëri-tjetrin, në rast sulmi nga një fuqi europiane në Mesdhe.
1940	Shkurt		15 – Krijimi i qeverisë së re mbretërore, të udhëhequr nga profesor Bogdan Filovi.
	Prill	9 – Gjermania pushton Danimarkën dhe Norvegjinë.	
	Maj	10 – Gjermania pushton Holandën, Belgjikën dhe Luksemburgun; Uinston Çurçilli bëhet kryeministër i Britanisë së Madhe. 12 – Gjermania pushton Francën.	
	Qershor	10 – Italia i shpall luftë Britanisë dhe Francës. 22 – Franca nënshkruan armëpushimin me Forcat e Boshtit	26-27 – Rumania lëshon Besarabinë dhe Bukovinën e Veriut, pas ultimatumit të Bashkimit Sovjetik.

Viti	Muaji	Nëbotë	Në Europën Juglindore
	Gusht		10 – Ligji antisemit në Rumani. 30 – Nën trysninë gjermane dhe italiane, Rumania i dorëzon Transilvaninë e Veriut Hungarisë.
	Shtator	13 – Italia pushton Egjiptin. 27 – Japonia hyn në Aleancën e Boshtit.	4 – Jon Antonesku caktohet Kryetar i Këshillit të Ministrave të Rumanisë. 6 – Karli II i lë fronin djalit të tij, Mikaeli I; <i>de facto</i> , Rumania sundohet nga “Conducator” Jon Antonesku. 7 – Marrëveshja e Krajovës. Rumania i kthen Bullgarisë Dobrukhën e Jugut.
	Tetor		12 – Ushtria gjermane hyn në Rumani si “këshilluese ushtarake”. 28 – Italia pushton Greqinë, duke përdorur si bazë Shqipërinë.
	Nëntor	5 – Rusvelti rizgjidhet president i Shteteve të Bashkuara. 11 – Britanikët mundin flotën italiane në Taranto. 20 – Hungaria bashkohet me Forcat e Boshtit.	Bullgaria nuk pranon të bashkohet me Forcat e Boshtit, të sulmojë Greqinë ose të nënshkruajë një pakt garancie me BRSS-në. 14 – Trupat greke kundërsulmojnë në frontin shqiptar, duke u marrë italianëve, brenda një muaji, të gjitha qytetet kryesore në jug të Shqipërisë. 23 – Rumania bashkohet me Forcat e Boshtit. 25 – Turqia shpall Ligjin e Luftës, në një zonë që mbulon Stambollin, Edernenë, Kirklarelin, Tekirdagun, Çanakalanë dhe Koxhaelin. 30 – Në Stamboll nis errësimi i detyrueshëm.
	Dhjetor	9 – Trupat britanike fillojnë të ligjet përzënë italianët nga Egjipti.	Në parlamentin bullgar votohen profashiste: Ligji për Organizimin e Rinisë Bullgare dhe Ligji antisemit për Mbrojtjen e Kombit. 19 – Materiale ndihme dërgohen nga Turqia për në Greqi, nëpërmjet anijes së mallrave “Kurtulush” [Pavarësia].

Viti	Muaji	Në botë	Në Europën Juglindore
1941	Janar	9 – Britanikët pushtojnë Eritrenë.	20 – Kabineti bullgar voton për nënshkrimin e Paktit Tripalësh. 21-23 – Rebelimi i Gardës së Hekurt (fashiste) në Rumani mposhtet nga gjenerali Antonesku.
	Shkurt		8 – Gjermania dhe Bullgaria nënshkruajnë paktin ushtarak. 17 – Deklarata bullgaro-turke e asnjansisë.
	Mars	11 – SHBA fillojnë të furnizojnë me materiale ushtarake Britaninë dhe aleatët e tjerë. 24 – Romeli fillon mësymjen e parë në Libi.	1 – Bullgaria bashkohet me Forcat e Boshtit; ushtria gjermane hyn në territorin bullgar. 24 – Deklarata turko-ruse: Në rast se Turqia sulmohet nga ndonjë shtet, Rusia Sovjetike do të qëndrojë asnjansë. 25 – Jugosllavia bashkohet me Forcat e Boshtit. 27 – Pas protestave masive, qeveria jugosllave rrëzohet nga një grusht shteti ushtarak.
	Prill	11 – Fillon rrethimi i Tobrukut nga gjermanët. 13 – Bashkimi Sovjetik dhe Japonia nënshkruajnë paktin e mosulmimit për pesë vjet.	Dështon përpjekja për një grusht shteti probritanik nga e majta agrare në Bullgari. 6 - Gjermania pushton Jugosllavinë dhe Greqinë. 10 – Krijohet Shteti i Pavarur Kroat (SHPK), një shtet kukull nën sundimin gjerman/italian 11-15 Ushtria hungareze pushton Baçkacin në Serbinë Veriore (Vojvodinë). 17 – Dorëzohet ushtria jugosllave. 17 – Ushtria italiane pushton Malin e Zi. 19 – Ushtria bullgare hyn në Maqedoni, në Serbinë Juglindore dhe në Trakinë e Egjeut. 23 – Greqia nënshkruan armëpushimin me Gjermaninë. 30 – Ante Paveliçi nxjerr disa dekrete që kanë të bëjnë me racën në Shtetin e Pavarur Kroat.

Viti	Muaji	Nëbotë	Në Europën Juglindore
	Maj	27 – Fundoset <i>Bismarku</i> ; Rusveldi shpall emergjencë kombëtare për shkak të ngjarjeve në Europë dhe Afrikë.	12-13 – Një grup oficerësh dhe ushtarësh të Armatës së Dytë, të udhëhequr nga koloneli Dragoljub Mihailović, filluan të organizojnë lëvizjen guerrile në malin Ravna Gora 17 – Në Tiranë dështon atentanti i të riut revolucionar, Vasil Laçi (1922-1941), ndaj Viktor Emanuelit III. 18 – Paveliçi dhe Musolini nënshkruajnë një marrëveshje në Romë: SHPK i jep Italisë pjesën më të madhe të bregdetit kroat. 21-31 Beteja e Kretës. Qeveria greke dhe mbreti largohen nga vendi dhe vendosen në Kajro; Greqia ndahet në tri zona pushtimi, të kontrolluara nga ushtritë gjermane, italiane dhe bullgare. 31 – Hiqet kryqi i thyer nga Akropolis: veprimi i parë simbolik i rezistencës.
	Qershor	22 – Gjermania, Italia dhe Rumania sulmojnë Bashkimin Sovjetik; Turqia shpallet asnjëse. 26 – Finlanda i shpall luftë Bashkimit Sovjetik.	5 – Në afërsi të qytetit Gako, në Hercegovinë, filloi një lëvizje spontane kundër dhunës së ushtruar nga autoritetet ustashe. 18 – Nënshkruhet <i>Traktati Turko-Gjerman i Miqësisë dhe Mossulimit</i> . 22 – Krijohet njësisia e parë partizane jugosllave pranë Sisakut (Kroaci); fillon lëvizja në Kroaci. 24 – Komunistët bullgarë nisin rezistencën e armatosur. 25 – Nga Asambleja Kombëtare Turke, miratohet njëzëri <i>Traktati Turko-Gjerman</i> . 29 – Musolini shpall “Shqipërinë e Madhe”.
	Korrik	12 – Britania dhe Bashkimi Sovjetik nënshkruajnë marrëveshjen që siguron ndihma britanike për sovjetikët. 24 – Japonia pushton Indokinën Franceze. 26 – SHBA ndalojnë tregtinë me Japoninë.	7 – Nis lëvizja partizane në Serbi. 13 – Nis kryengritja malazeze, me pjesëmarrjen e 30 000 luftëtarëve. 13 – Nis lëvizja partizane në Malin e Zi. 21 korrik 1941 – Zgjidhet <i>Komiteti Nacional Çlirimtar</i> në Berane, komiteti i vetëm i zgjedhur në periudhën e kryengritjes nga një asamble e përbërë nga përfaqësues të të gjitha krahinave.
	Shtator	8 – Gjermanët rrethojnë Leningradin. 19 – Gjermanët marrin Kievin.	Krijohet <i>Organizata Popullore e Rinisë Malazeze</i> . 7 – Krijohen tri organizatat kryesore të rezistencës në Greqi: Bashkimi Demokratik Kombëtar Grek (EDES), Çlirimi Kombëtar dhe Shoqëror (EKKA) dhe Fronti Nacional Çlirimtar (EAM); Ustashët hapin kampin e përqendrimit në Jasenovac, rreth 100 km në jug të Zagrebit. Në Rumani fillon dëbimi i më shumë se 100 000 hebrenjve për në Transnistria, mes të cilëve një pjesë e madhe vdiqën për shkak të kushteve të këqija të jetesës.

Viti	Muaji	Në botë	Në Europën Juglindore
	Tetor	17 – Hideki Tojo bëhet kryeministër i Japonisë.	Nga autoritetet pushtuese gjermane bëhen raprezalje në masë ndaj popullsisë civile në Serbi. 11 – Nis lëvizja partizane në Maqedoni.
	Nëntor	18 – Britanikët nisin mësymjen në Libi	Në Serbi fillon lufta civile midis partizanëve dhe çetnikëve. 8 – Themelohet Partia Komuniste Shqiptare 13 – Gjermanët nuk pranojnë kushtet e çetnikëve për të bashkëpunuar kundër partizanëve jugosllavë. Megjithatë, çetnikët vazhdojnë të luftojnë kundër partizanëve dhe shmangin luftën me gjermanët.
	Dhjetor	5 – Ndalet marshimi i gjermanëve drejt Moskës. 7 – Japonia bombardon Përl Harborin [Pearl Harbour]. 8 – Japonia i shpall luftë SHBA-së dhe Britanisë. 11 – Gjermania dhe Italia i shpallin luftë SHBA-së.	12 – Shteti i Pavarur Kroat i shpall luftë SHBA-së dhe Britanisë. 13 – Bullgaria i shpall luftë Britanisë dhe SHBA-së.
1942	Janar	21 – Nis në Libi kundërmësymja nga Korpusi i Afrikës i Romelit.	
	Shkurt	15 – Japonia pushton Singaporin.	EAM-i vendos të krijojë grupe të armatosura guerrile (Ushtria Popullore Nacional Çlirimtare – ELAS). 8 shkurt 1942 – Mbahet <i>Konferenca e Ostrogut</i> , ku marrin pjesë patriotë të të gjitha shtresave.
	Qershor	4-6 Beteja e Miduejt. 21 – Romeli pushton Tobrukun.	16 – Në Tjentishte mbahet konferenca e patriotëve malazezë, ku marrin pjesë edhe priftërinj ortodoksë.
	Korrik		Krijohet krahu i armatosur i EDES-it.
	Gusht	12 – Çurçilli dhe Stalini takohen me përfaqësues të SHBA-së dhe Francës së Lirë për të biseduar mbi Frontin e Dytë. 13 – Gjenerali Montgomery merr drejtimin e forcave britanike në Egjipt 19 – Përfundon me dështim sulmi i aleatëve në Diep.	Deri në fund të verës së vitit 1942, forcat pushtuese gjermane “zgjidhin problemin hebre” në Serbi, duke vrarë pothuajse 90% të popullsisë çifute. 25 – Del numri i parë i <i>Zërit të Popullit</i> , gazetë periodike që përfaqësonte ideologjinë e lëvizjes komuniste në Shqipëri.

Viti	Muaji	Nëbotë	Në Europën Juglindore
	Shtator	22 – Gjermanët arrijnë në qendër të Stalingradit.	Një njësi e posaçme britanike zbarkon në Greqi. 16 – Konferenca e Pezës: krijohet Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar Shqiptar.
	Tetor	23 – Trupat e Montgomerit sulmojnë në El Alamein, Egjipt.	Krijohet në Shqipëri organizata politike “Balli Kombëtar”, me një program antikomunist.
	Nëntor	8 – Për herë të parë, Aleatët pushtojnë në shkallë të gjerë Marokun dhe Algjerinë. 13 – Britanikët rimarrin Tobrukun. 19 – Sovjetikët fillojnë kundërmësymjen në Stalingrad.	12 – Hyn në fuqi <i>Taksa për kapitalin turk</i> . 25 – Nga forcat britanike dhe ato guerrile të EAM-it dhe EDES-it, hidhet në erë ura hekurudhore e Gorgopotamos (Greqi). 26 – Në Bihaç (Bosnjë dhe Hercegovinë), partizanët krijojnë organin e tyre më të lartë politik – AVNOJ-in (Këshillin Antifashist për Çlirimin e Popujve të Jugosllavisë).
1943	Janar	31 – Gjenerali Paulus dorëzon Armatën VI Gjermane në Stalingrad.	Janar-shkurt 1943 – Njësitë e çetnikëve, të drejtuara nga Pavle Gjurishiçi, kryejnë spastrim etnik në popullsinë myslimane të Sanxhakut. Rreth 9 000 myslimanë u vranë gjatë kësaj fushate spastrimi.
	Mars	5 – Fillon bombardimi i Ruhrit nga ana e Aleatëve.	5 – Në Athinë, një grevë e përgjithshme ndalon marrjen ushtarë të punëtorëve grekë. Mars-maj – shoqëria bullgare kundërshton me sukses “Zgjidhjen përfundimtare” dhe internimin e hebrenjve bullgarë. Mars-qershor – internohen rreth 50 000 hebrenj nga Selaniku në Aushvic.
	Qershor	13 – Forcat e Boshtit thyhen në Tunizi; përfundon fushata në Afrikë.	14 – Në Otoçak, partizanët krijojnë organin më të lartë politik për Kroacinë – ZAVNOH-in (Këshillin Antifashist për Çlirimin e Popullit të Kroacisë).
	Korrik	5-17 – Beteja e madhe me tanke në Kursk, në Frontin Lindor: fitore e sovjetikëve. 9 – Aleatët zbarkojnë në Sicili. 25 – Musolini rrëzohet nga pushteti dhe arrestohet. Ai pasohet nga Pietro Badoglio.	10 – Krijohet Ushtria Nacionalçlirimtare Shqiptare.
	Gusht		2 – Nënshkruhet “Marrëveshja e Mukjes”, midis Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare dhe Ballit Kombëtar. Vetëm pak ditë më pas, ajo hidhet poshtë nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Shqiptare (PKSH) dhe Këshilli Nacional Çlirimtar. 28 – Mbreti Boris III i Bullgarisë vdes në Sofje; Simeoni II shpallet mbret.

Viti	Muaji	Nëbotë	Në Europën Juglindore
	Shtator	3 – Aleatët zbarkojnë në Italinë Kontinentale nëpërmjet Ngushticës së Mesinës. 8 – Italia u dorëzohet Aleatëve. 12 – Musolini lirohet nga forcat esese (SS) dhe dërgohet në Gjermani.	8 – Njësitë partizane marrin përkohësisht Splitin dhe një depo të madhe furnizimesh italiane që gjendej atje. 9 – Zgjidhen regjentët në Bullgari: princi Kiril, profesori Filov dhe gjenerali Mihov. 9 – 10 tetor – Partizanët jugosllavë çarmatosin dhjetë divizione italiane; dy prej tyre bashkohen me partizanët. 17 – Misioni ushtarak anglo-amerikan mbërrin në territoret e çliruara në Bosnjë-Hercegovinën Perëndimore 20 – ZAVNOH-i shpall ribashkimin me Kroacinë dhe Jugosllavinë të territoreve të pushtuara nga Italia.
	Tetor	13 – Italia i shpall luftë Gjermanisë.	
	Nëntor	7 – Çlirohet Kievi; Fillon të bjerë mbrojtja gjermane në Dniepër. 28 – 1 Dhjetor – Çurçilli, Rusveldi dhe Stalini takohen në Teheran për të planifikuar pushtimin e Francës. Partizanët jugosllavë njihen si Aleatë.	15 – Themelohet në Kolashin, <i>Këshilli Antifashist Nacional Çlirimtar (ZAVNO)</i> për Malin e Zi dhe Bokën. 20 – Mbështetësit e mbretit Zogu I, të kryesuar nga Abaz Kupi, krijojnë Partinë e Legalitetit, e cila synonte të rivendoste në Shqipëri, pas Luftës, monarkinë e Zogut. 25-26 – Partizanët themelojnë ZAVNOBiH si institucionin politik drejtues të Bosnjë dhe Hercegovinës 29 – Në Jajcë (Bosnjë dhe Hercegovinë), AVNOJ-i krijon qeverinë partizane (NKOJ-in – Komitetin Kombëtar për Çlirimin e Jugosllavisë).
	Dhjetor	24 – Ajzenhaueri caktohet të drejtojë pushtimin e Europës.	7 – Rusveldi, Çurçilli dhe Inonuja takohen në Kajro.
1944	Janar	27 – Sovjetikët thyejnë gjermanët në Leningrad.	Në Bullgari krijohet një xhandarmëri për të luftuar rezistencën e armatosur. 8 – Në letrën e tij për presidentin e NKOJ-it (Qeverisë Partizane Jugosllave), Çurçilli deklaroi se Britania do të ndalojë ndihmat për çetnikët. Që nga kjo kohë, të gjitha ndihmat iu dhanë partizanëve.
	Mars	15 – Japonia pushton Indinë.	10 – EAM-i ngre Komitetin Politik për Çlirim Kombëtar (PEEA), një administratë e dytë greke, paralele me qeverinë zyrtare në Kajro.

Viti	Muaji	Në botë	Në Europën Juglindore
	Maj	9 – Sovjetikët rimarrin Sevastopolin. 18 – Gjermanët tërhiqen nga Monte-Kasinoja.	Një takim në Liban i hap rrugën marrëveshjes për krijimin e një qeverie greke koalicioni, me G. Papandreun si kryeministër. Më shumë se 100 000 hebrenj nga Transilvania e Veriut (nën administrimin hungarez) internohen në kampet gjermane të shfarosjes në masë. 24 – Në Kongresin e Përmetit, komunistët shqiptarë zgjedhin Këshillin Antifashist Nacionalçlirimtar si organin më të lartë legjislativ, dhe krijojnë një komitet, me funksionet e një qeverie të përkohshme.
	Qershor	6 – Dita-D, Aleatët zbarkojnë në Normandi.	1 – Krijohet qeveria e re mbretërore në Bullgari, e drejtuar nga Ivan Bagrianovi.
	Korrik	20 – Dështon atentati ndaj Hitlerit. 25 – Aleatët nisin depërtimin nga Normandia	13 – <i>Asambleja Antifashiste Nacional Çlirimtare Malazeze (CASNO)</i> vendoset në Kolashin dhe merr një vendim të rëndësishë historike – rishpall shtetin malazes, megjithëse brenda Federatës Jugosllave.
	Gusht	15 – Aleatët zbarkojnë në Francën Jugore. 25 – Çlirimi i Parisit.	2 – Turqia vendos të shkëpusë marrëdhëniet me Gjermaninë. Mblidhet Asambleja e parë e ASNOM (Asambleja antifashiste për çlirimin e popullit maqedonas) e cila u shpall institucioni më i lartë legjislativ dhe ekzekutiv popullor i shtetit maqedonas. 12 – Çurçilli dhe Titoja takohen në Napoli. 23 – Grushti i shtetit në Rumani: mbreti Mikael, i mbështetur nga një koalicion i partive më të mëdha dhe nga komunistët, arreston Antoneskun dhe qeverinë e tij; Rumania u dorëzohet sovjetikëve. 26 – Kryeministri bullgar Bagrianov e shpall vendin asnjans dhe bën në Ankara përpjekjet e para për të negociuar me SHBA-në dhe Britaninë e Madhe, si dhe dërgon një delegacion në Kajro. 29 – Mbreti jugosllav Peter II mohon Drazha Mihailoviçin dhe njeh Titon si udhëheqës të rezistencës në Jugosllavi. 30 – Paveliçi parandalon një grusht shteti në Shtetin e Pavarur Kroat dhe vazhdon të qëndrojë besnik ndaj Forcave të Boshtit.

Viti	Muaji	Në botë	Në Europën Juglindore
	Shtator	<p>3 – Çlirohet Brukseli.</p> <p>19 – Nënshkruhet armëpushimi midis Finlandës dhe Aleatëve.</p> <p>25 – Aleatët çajnë nëpër Vijën Gotike, në Itali.</p>	<p>Nga partizanët dhe njësitë e Ushtrisë së Kuqe nisin luftimet për çlirimin e Serbisë.</p> <p>2 – Nga regjentët bullgarë zgjidhet një qeveri e përbërë nga parti politike proruse, e drejtuar nga Konstantin Muravievi (qeveria e parë e krijuar nga partitë politike që nga maji i vitit 1934).</p> <p>3 – Nga koalicioni kombëtar nën drejtimin e G. Papandreut, në Greqi krijohet një qeveri e re.</p> <p>5 – Bashkimi Sovjetik i shpall luftë Bullgarisë.</p> <p>8 – Ushtria e Kuqe hyn në Bullgari; Nënshkruhet armëpushimi midis Bashkimit Sovjetik dhe Bullgarisë; Bullgaria i shpall luftë Gjermanisë.</p> <p>9 – Në Bullgari, komunistët marrin pushtetin; krijohet Qeveria e Frontit të Atdheut, e drejtuar nga Kimon Gjeorgjevi (udhëheqësi i partisë Zveno), e mbizotëruar nga komunistët.</p> <p>12 – Rumania nënshkruan armëpushimin me Aleatët: njeh administrimin e Besarabisë dhe Bukovinës Veriore nga sovjetikët dhe autoritetin më të lartë të një Komiteti Kontrolli Aleat, i cili mbizotërohet nga sovjetikët.</p>
	Tetor	<p>2 – Gjermanët shtypin revoltën në Varshavë, ndërkohë që ushtritë sovjetike pushojnë dhe përgatiten pak milje larg; Aleatët çajnë Murin Perëndimor dhe hyjnë në Gjermani.</p> <p>9 – “Marrëveshja e përqindjeve” midis Çurçillit dhe Stalinit në Moskë.</p> <p>23 – Aleatët njohin De Golin si drejtues të Qeverisë së Përkohshme Franceze.</p>	<p>5 – Britanikët zbarkojnë në Greqi.</p> <p>8 – Bullgaria fillon veprimet ushtarake kundër Gjermanisë.</p> <p>12 – Ushtria gjermane largohet nga Athina.</p> <p>14 – Britanikët hyjnë në Athinë.</p> <p>18 – Qeveria greke hyn në Athinë.</p> <p>20 – Beogradi çlirohet nga Ushtria e Kuqe Sovjetike dhe nga partizanët jugosllavë.</p> <p>23 – Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar kthehet në Qeverinë e Përkohshme Demokratike të Shqipërisë, me kryeministër Enver Hoxhën.</p> <p>25 – Ushtria hungareze detyrohet prej forcave rumune dhe atyre të Ushtrisë së Kuqe të largohet nga territori i Transilvanisë.</p> <p>28 – Armëpushim midis forcave të Koalicionit Antifashist dhe Bullgarisë.</p>
	Nëntor	<p>7 – Për herë të katërt, Rusvelti fiton zgjedhjet për president të SHBA-së.</p>	<p>13 – Partizanët çlirojnë Shkupin.</p> <p>29 – Partizanët çlirojnë Shqipërinë prej gjermanëve.</p>

Viti	Muaji	Në botë	Në Europën Juglindore
	Dhjetor	15 – Zbarkimet e SHBA-së në Mindoro, Filipine.	3 – EAM-i organizon një demonstratë në Athinë, që përfundon me gjakderdhje; fillojnë luftimet midis EAM-ELAS-it nga njëra anë, dhe forcave të qeverisë, të mbështetura nga britanikët, nga ana tjetër.
1945	Janar	17 – Varshava pushtohet nga sovjetikët. 19 – Gjermania tërhiqet plotësisht nga Fronti Lindor. 20 – Hungaria nënshkruan armëpushimin me Aleatët.	Rreth 70 000 veta me etni gjermane internohen nga Rumania për në BRSS. 3 – Me çlirimin e Bijello Poljes, i gjithë territori i Malit të Zi shpallet i çliruar.
	Shkurt	4-11 – Çurçilli, Rusvelti dhe Stalini takohen në Jaltë. 8 – Aleatët fillojnë mësymjen e përgjithshme përtë arritur në lumin Rin. 13-14 – Bombardimet e Aleatëve shkatërrojnë Dresdenin. 19 – Zbarkimi i SHBA-së në Iwo Zhima.	Në Greqi nënshkruhet Marrëveshja e Varkizës, për mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme dhe një plebishiti në lidhje me monarkinë, si dhe shpërbërjen e organizatave guerrile dhe dorëzimin e ushtrive të ELAS. 23 – Turqia i shpall luftë Gjermanisë dhe Japonisë.
	Mars	3 – Finlanda i shpall luftë Gjermanisë. 9 – SHBA bombardojnë Tokion. 22 – Patoni kapërcen Rinin në Openhaim. 23 – Montgomeri kapërcen Rinin në veri të Ruhrit.	6 – Në Rumania, sovjetikët imponojnë krijimin e një qeverie koalicioni, të drejtuar nga Petru Groza, por të kontrolluar nga komunistët. 7 – Krijohet Qeveria e Përkohshme Demokratike Federative e Jugosllavisë, me kryeministër J. B. Titon dhe me mbizotërimin e partizanëve në raport me anëtarët e qeverisë në mërgim (23:5).
	Prill	12 – Vdes Rusvelti, Herri Trumani bëhet president. 23 – Sovjetikët hyjnë në Berlin. 25 – Forcat e SHBA-së dhe ato sovjetike takohen në Lumin Elbë; fillon Konferenca e Kombeve të Bashkuara në San Francisko. 28 – Musolini ekzekutohet nga partizanët italianë. 30 – Hitleri vret veten në Berlin.	6 – Çlirohet Sarajeva. 14 – Krijohet Qeveria Federative e Kroacisë, e mbizotëruar nga komunistët. 28 – SHBA njohin Qeverinë e Përkohshme Jugosllave të J. B. Titos.
	Maj	1 – Berlini u dorëzohet forcave sovjetike. 7 – Gjermania shpall zyrtarisht kapitullimin.	2 – Ushtria partizane jugosllave hyn në Trieste, duke e ndarë atë në mënyrë të tensionuar midis Italisë dhe Jugosllavisë (në zona që më vonë u emërtuan Zona A dhe B). 6 – Paveliçi dhe qeveria e tij, bashkë me një numër të madh ushtarësh dhe civilësh largohen nga Zagrebi drejt Austrisë. 8 – Partizanët çlirojnë Zagrebin. 15 – Në Bleiburg partizanët jugosllavë vrasin një numër robërish lufte (ustashë dhe disa çetnikë e <i>domobranci</i> slovenë) dhe civilësh. Pjesa tjetër u mor përgjatë "Rrugës së Kryqit" nga e cila pjesa më e madhe nuk shpëtoi gjallë.

Viti	Muaji	Në botë	Në Europën Juglindore
	Qershor	5 – Aleatët e ndajnë Gjermaninë në katër zona pushtimi. 26 – Nga përfaqësues të 50 vendeve, nënshkruhet Karta e Kombeve të Bashkuara; krijohen Kombet e Bashkuara.	10 – AVNOJ-i kthehet në Asambleenë e Përkohshme Popullore të Jugosllavisë.
	Korrik	17 – 2 Gusht – Çurçilli, Stalini dhe Trumani takohen në Potsdam, për të planifikuar paqen në Europë dhe sulmin përfundimtar kundër Japonisë.	
	Gusht	6 – Hidhet në Hiroshima bomba atomike. 9 – Hidhet në Nagasaki bomba atomike. 14 – Japonia dorëzohet.	



KAPITULLI I:

Politikat

Qëllimi i këtij kapitulli është që të shërbejë si një lloj kornize, pasi, ndryshe nga të gjithë kapitujt e tjerë, shumica e dokumenteve në të i përkasin historisë politike. Në fillim jepet përshkrimi i disa figurave të njohura politike të kohës, për t'i njohur e kuptuar më mirë, por gjithashtu, edhe këndvështrimin e autorëve të teksteve. Për këtë arsye, këto materiale janë të rëndësishme dhe interesante për t'u analizuar. Këto përshkrime pasohen nga disa deklaratatë të rëndësishme ideologjike, nëpërmjet të cilave *strukturat qeverisëse* po përpqeshin të justifikonin veprimet dhe/ose vetë ekzistencën e tyre; ato pasohen, gjithashtu, edhe nga disa deklaratatë me ngjyrimet ideologjike nga ana e *lëvizjeve të rezistencës*.

Nënkaptulli *Ushtritë dhe ushtarët*, për arsye të kuptueshme, është disi më i gjatë. Kjo, sepse në disa vende, disa ushtri (forcat pushtuese, ushtritë kolaboracioniste, lëvizjet e rezistencës) u ndeshën në zona relativisht të vogla. Ndaj u përpoqëm të bënim të qartë të paktën veprimtarinë e tyre, rrymën ideologjike, ushtritë dhe marrëdhëniet e ndërsjella (shpesh shumë të ndërlikuara) midis tyre. Përveç këtyre, janë përfshirë edhe dokumente që trajtojnë marrëdhëniet gjatë Luftës midis palëve kundërshtare dhe midis vendeve fqinje.

Nënkaptulli i fundit, *Organizatave Fetare*, paraqet dokumente që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organizatave fetare gjatë Luftës: sa hapur ose sa qartë organizatat fetare shfaqën qëndrimin e tyre ndaj vetë luftës, ndaj palëve luftuese, ndaj njerëzve të kombeve ose besimeve të tjera, ndaj vuajtjeve dhe krimeve të luftës etj.

Ia. Udhëheqësit dhe ideologjitë

I-1. Ficroi Meklejni (Fitzroi MacLean), i dërguari i Çurçillit tek partizanët, përshkruan J. B. Titon në vitin 1943

“Titoja ka shtat mesatar dhe është i rruar me kujdes, fytyrën e ka të zeshkët dhe flokët ngjyrë gri të shkëlqyer. Gojën e ka shumë të qëndrueshme dhe sytë ngjyrë blu, plot gjallëri. (...) Pyesja veten se ç’përshtypje duhej të krijoja për këtë njeri, kur e krahasoja me komunistët që kisha takuar në Rusi. (...) Një gjë më bëri shumë përshtypje: gatishmëria e tij për ta trajtuar problemin nga të gjitha këndvështrimet dhe, nëse ishte e nevojshme, për të marrë një vendim të menjëhershëm. Më dukej tepër i sigurt, kishte përvojë, nuk ishte i ri në këto punë. Ishte diçka e re për mua të zbuloja te një komunist kaq shumë siguri dhe besim tek vetja.”

Bashkëbisedimi i Ficroi Meklejnit me Titon, në Beogradin e marrë nga partizanët në vitin 1944¹

Meqë m’u dha rasti, e njoftova Titon për zemërimin që u kishte shkaktuar Aleatëve, kur ishte larguar fshehtas nga Visi. (...) I thashë Titos se Çurçilli ishte fyer shumë nga mënyra se si ishte larguar. Gjithashtu i tregova për sjelljen e parregullt të disa vartësve të tij, si dhe për mosmarrëveshjet dhe disa vështirësi të vogla që patëm pasi u largua.

U pa qartë se kjo e mërzi me të vërtetë. Më tha se i vinte keq që vartësit e tij na kishin trajtuar jo ashtu siç duhej, por shtoi se çdo gjë do të rregullohej menjëherë (...) lu përgjigja se isha i kënaqur për këtë. “Sidoqoftë, - shtova unë, - më duket se nuk po e kuptoni se shkaku kryesor i gjithë kësaj ishte zhdukja juaj në atë mënyrë dhe fakti që nuk na

¹ Takimi i tyre i parë pas largimit të fshehtë të Titos nga ishulli Vis (ku ai qëndronte nën mbrojtjen e forcave britanike) për të takuar Stalinin.

thatë se ku po shkonit.” Por Titoja nuk mund ose nuk donte që ta kuptonte këtë, prandaj u përgjigj me naivitet: “Jo shumë kohë më parë, Çurçilli shkoi në Kebek për t’u takuar me presidentin Rusvelt dhe unë u informova për këtë vetëm pasi ai ishte kthyer. Megjithatë, kjo gjë nuk më zemëroi.”

MacLean, f. 14-15, 240-241.



Josif Broz Titoja lindi në Kumrovec, pranë Zagrebit, në vitin 1892. Në rininë e hershme, pasi mori zanatin e çelësabërësit, punoi si çelësabërës dhe si punëtor fabrike. Lufta e Parë Botërore e gjeti të mobilizuar në ushtrinë austro-hungareze, dhe në radhët e saj luftoi në Frontin e Lindjes. Atje u kap rob nga rusët dhe u mbajt në burg për rreth dy vjet, ku edhe u njoh me idetë bolshevike. Në vitin 1920 u kthye në atdhe, në shtetin e sapoformuar të Jugosllavisë. Hyri në partinë komuniste dhe kaloi disa vite në burg, pasi u arrestua dy herë. Në vitin 1937 u vu në krye të Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe, qysh nga viti 1941, u bë bashkërenduesi kryesor i Lëvizjes së Rezistencës dhe më vonë, “Komandant i përgjithshëm” i forcave partizane. Pas luftime, u bë president i Jugosllavisë dhe e drejtoi vendin me një sistem totalitar deri në fund të jetës së tij, në vitin 1980.



Çfarë i pëlqente Meklejnit te Titoja? Çfarë nuk i pëlqente te ai? Përse Titoja i la përshtypje të mirë Meklejnit? Cili ishte opinionimi për të si komunist? Çfarë i acaroi marrëdhëniet e tyre? Sipas mendimit tuaj, a u soll Titoja në mënyrë të parregullt ndaj aleatëve të tij britanikë? Në takimin e fundit me Meklejnin, sjellja “dinake” e Titos vlerësohet nga simpatizuesit e tij, sepse konsiderohet si një veprim që simbolizon shpirtin e pavarur të Jugosllavisë. Ç’mendoni ju për këtë? A po kërkonin britanikët që marrëdhëniet e tyre të ishte e baraspeshuar apo donin që ta mbizotëronin ata aleancën me partizanët?

► **Fig 1. Udhëheqësi i Lëvizjes Popullore Çlirimtare partizane, Josif Broz Titoja dhe komandanti i Ushtrisë Jugosllave në Atdhe (çetnikët), gjenerali Drazha Mihajloviçi**



Beograd, Narodna biblioteka Srbije, Zbirka plakata [Beograd, Biblioteka Kombëtare Serbe, Koleksioni i posterave].



Përkthim: “Shpërblim 100 000 marka ari gjermane!

100 000 marka ari gjermane do t’i jepen atij që dorëzon udhëheqësin komunist Tito, gjallë ose vdekur.”

“Shpërblim 100 000 marka ari gjermane!

100 000 marka ari gjermane do t’i jepen atij që dorëzon udhëheqësin e çetave Drazha Mihajloviç, gjallë ose vdekur.”

I-2. Përshkrim i personalitetit të Paveliçit nga fotografi i tij, në vitin 1961

T'i bëje fotoportret Paveliçit, ishte veçse e bezdisshme, pasi ai dilte ashtu siç ishte në të vërtetë: i zyrtër dhe me atë shprehjen e njohur të fytyrës prej gangsteri. Sigurisht që e shoqja e tij, *e shoqja e faraonit*, Mara, nuk i pëlqente fotografitë, kështu që fotografimi vazhdonte pafundësisht me urdhrin e saj të drejtpërdrejtë. (...) Më në fund, ajo e gjeti zgjidhjen se si ta bënte të shoqin të dukej miqësor përpara fotografëve; në kohën që pozonte, kërkoi që atij t'i tregoheshin barceleta.

Vojinović, f. 16.

🔑 Ante Paveliç lindi në Bradina (Bosnjë dhe Herzegovinë), në vitin 1889. Ai studioi për drejtësi dhe që i ri u bë anëtar i Partisë së Djathtë. Në vitin 1929, pas vendosjes së diktaturës në Jugosllavi, ai shkoi në emigracion dhe, me *lëvizjen e tij të ustashëve*, ngulmoi për rrëzimin e diktaturës dhe shpërbërjen e shtetit jugosllav. Fitoi simpatinë e udhëheqësve fashistë dhe sidomos të Musolinit, i cili mendonte se duke përkrahur Paveliçin, do mund t'i aneksonte Italisë pjesë nga bregdeti kroat. Pas shpërbërjes së Jugosllavisë, Musolini dhe Hitleri bënë të mundur që Paveliçi të ngrinte një shtet kukull, SHPK-në (Shtetin e Pavarur Kroat - këtej e tutje: SHPK). Në fund të Luftës së Dytë Botërore, Paveliçi u largua jashtë shtetit (Argjentinë, Spanjë). Ai vdiq në vitin 1959.

? Shikoni me kujdes fotografinë. A thotë fotografi të vërtetën? A është e mundur të kuptohet nëpërmjet fotografive diçka nga karakteri i një njeriu? Ç'tregon fakti se Paveliçi nuk mund të buzëqeshte? Që e përfytyronte veten një udhëheqës shumë serioz? Fotografi e ka bërë këtë përshkrim shumë kohë pas rënies së Paveliçit nga pushteti; a do të ndryshonte ky përshkrim, nëse do të ishte bërë në kohën kur Paveliçi ishte në pushtet? Çfarë kërkon të thotë fotografi për Paveliçin kur përmend marrëdhëniet e tij me të shoqen? A mund të jenë thashethemet burim historik?

► Fig. 2. Ante Paveliçi



www.pavelicpapers.com

? Shiko pyetjet mbi dëshminë e fotografit të Paveliçit (teksti I-2).

I-3. Përshkrim i Mehmet Shehut dhe Enver Hoxhës

“Disa ditë më vonë, Mекlejni u kthye dhe na u bë vizita e parë, që do pasohej nga shumë të tilla, prej Shtabit të Përgjithshëm të LNÇ-së², udhëheqësit

² LNÇ – Lëvizja Nacional Çlirimtare ishte organizata që udhëhiqej nga komunistët gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Ajo organizoi qëndresën më të madhe të armatosur në vend. Duke mënjanuar të gjitha grupet e tjera politike gjatë dhe pas Luftës, morën të gjitha meritat për çlirimin e Shqipërisë dhe si rezultat u bënë forca drejtuese e vendit pas Luftës.

kryesorë të të cilit ishin Mehmet Shehu³ dhe Enver Hoxha⁴. Mehmet Shehu ishte një burrë i shkurtër, i imët, ezmer dhe me pamje të zbehtë. Ai ishte rreth të tridhjetave dhe nuk qeshte, përveçse me fatkeqësitë e të tjerëve. Fliste mirë anglisht, ishte shumë i aftë dhe kishte njohuri ushtarake më tepër se shumica e shqiptarëve të tjerë.

“Enver Hoxha ishte një figurë krejt e ndryshme – trupmadh, i shëndoshë dhe kishte një shtrëngim dore të qullët. Ai nuk ishte ushtarak, megjithëse hiqej si i tillë, por ishte më i shoqërueshëm se Shehu dhe fliste me ne me një frëngjishte të rrjedhshme. Ai mund të mos na pëlqente, por të paktën i fshihte ndjenjat e tij, ndërsa Shehu e shprehte armiqësinë ndaj nesh. Hoxha ishte rreth 35 vjeç. Ai ishte arsimuar në Gjirokastrë, në shkollën qytetëse e më pas në Liceun e Korçës dhe në Universitetin e Monpeljesë në Francë, të cilin u detyrua ta linte pasi kishte ngelur në disa provime. Shkoi në Bruksel dhe në Paris për të studiuar jurisprudencë, por nuk u diplomua kurrë, dhe u kthye në Shqipëri për të punuar si mësues i gjuhës frënge në Gjymnazin Shtetëror të Tiranës; më pas u transferua në Liceun e Korçës, ku punoi sërish si mësues i gjuhës frënge. Ne e thërrisim “profesor” Enver Hoxha – ndoshta për shkak të punës në mësimdhënie. Ai hoqi dorë nga mësimdhënia në vitin 1940 dhe punoi në Tiranë, në një dyqan si shitës duhani, vend i cili u kthye në bazë komuniste dhe vendtakimi të elementëve kundërshtarë të qeverisë; pas themelimit të Partisë Komuniste Shqiptare në vitin 1941, u bë Sekretar i Përgjithshëm i Komitetit Qendror të Partisë, pozitë të cilën ndoshta e mbante ende, kur e takuam për herë të parë.”

Smiley⁵, f. 56.

³ Mehmet Shehu lindi më 10 janar 1913 në Çorush, në Shqipërinë e Jugut. Nga viti 1937 deri në vitin 1939 ai mori pjesë në Luftën Civile në Spanjë, me Brigadën Ndërkombëtare “Garibaldi”. Nga viti 1944 deri në vitin 1945, ishte anëtar i Këshillit Antifashist Nacional Çlirimtar Shqiptar (Qeverisë së Përkohshme). Pas çlirimit, Shehu konsiderohej si krahu i djathtë i Enver Hoxhës dhe cilësohej si “numri dy” në Shqipëri. Mendohet se në vitin 1981, ai kundërshtoi politikën e izolimit të Enver Hoxhës dhe pas kësaj, u akuzua si spiun jugosllav. Më 17 dhjetor 1981, ai u gjend i vdekur në shtratin e tij me një plumb në kokë. U shpall “armik i popullit” dhe pas vdekjes u akuzua si agjent jo vetëm i shërbimeve sekrete jugosllave, por gjithashtu i CIA-s dhe KGB-së.

⁴ Enver Hoxha lindi në Gjirokastrë, më 16 tetor 1908. Nga viti 1930 deri në vitin 1936 studioi dhe punoi në Paris, e më pas në Bruksel. Në vitin 1936, ai u kthye në Shqipëri dhe filloi të japë mësim në Gjymnazin e Tiranës, dhe më pas në Liceun e Korçës. Në vitin 1939, ai u pushua nga puna, si “person kundërshtar i regjimit”. Më 8 nëntor 1941, kur u krijua Partia Komuniste Shqiptare, ai u bë sekretar i parë i Komitetit Qendror të Partisë, dhe më pas komisar politik i Ushtrisë Nacional Çlirimtare. Ai u zgjodh kryeministër i Shqipërisë në vitin 1944 dhe drejtoi Shqipërinë si diktator deri kur vdiq, më 11 prill të vitit 1985.

⁵ Deivid Smaili (David Smiley) ishte kapiten i Ushtrisë Britanike, që doli vullnetar për të marrë pjesë në Drejtorinë e Operacioneve Speciale në Ballkan dhe veçanërisht në Shqipëri. Në këtë libër, bën një përshkrim të gjallë të Luftës së Dytë Botërore dhe detyrave të tij me komunistët dhe më pas me Legalitetin, për organizimin e qëndresës antifashiste në Shqipëri.



Ç’ndryshime mund të vëreni ndërmjet dy udhëheqësve të përshkruar më lart? A mendoni se ndryshimet që kishin në karakter, ishin të rëndësishme për suksesin e tyre? Ç’të dhëna na jep autori në bazë të përshlytyjeve të tij mbi Shehun dhe Hoxhën?

I-4. Një spiun anglez përshkruan udhëheqësin e opozitës politike në Rumani – Juliu Maniu

“Maniu (...) ishte një nga heronjtë më pak pompozë që mund të ketë patur ndonjëherë ndonjë shtet – i ndershëm, i kujdesshëm, në shumicën e rasteve kishte të drejtë dhe i mungonte tërësisht e folura bombastike që ishte në modë gjatë Luftës. I imët, me sy të butë dhe të zgjuar, gjithnjë me një veshje disi zyrtare, ai dukej më tepër si një noter nga provinca, sesa një udhëheqës i rezistencës. Në vitin 1938, ai duhet të ishte 68 vjeç, por tregonte më i ri (...) Që në fillim, ai vendosi standarde të larta për sjelljen e vet dhe të partisë së tij. U morën masa që të parandaloheshin çdo lloj demonstrimesh antisemite. Ai përkrahu investimet e huaja dhe, megjithëse disa nga kolegët e tij, pa dyshim që mbushën xhepat e tyre, për Maniun ishte e paimagjinueshme që të merrte për vete ryshfet të çfarëdolloji. Ai dhe bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë – njerëz si Jon Mihalaçe dhe ekonomisti Madgaru – ishin ndër rumunët më të shquar të shekullit.”

Porter, f. 18, 20.

I-5. Fjalimi i Metaksas-it, drejtuar redaktorëve dhe botuesve të të gjitha gazetave greke (30 tetor 1940)

Turqia nuk është siç ishte në vitin 1916, aleate e Gjermanisë, por është aleate e Anglisë. Bullgaria si atëherë edhe sot pret të shikojë si do të shkojnë ngjarjet, por tani për tani nuk guxon që të ndër marrë ndonjë veprim. Sidoqoftë, koha nuk po punon në dobi të Forcave të Boshtit. Ajo është në dobi të vendeve kundërshtarë me ta. Për Gjermaninë, fitorja do të ishte e mundur, vetëm nëse do të arrinte të sundonte botën. Por synimi i Gjermanisë për të sunduar botën u bë përfundimisht i pamundur në Dankirk. [...]

Që tani, pas sulmit të padrejtë nga ana e Italisë, politika që po ndjek është politika e paharruar e Venizellosit, sepse kjo është politika që e njëjtëson politikën greke me fatin e asaj *fuqie* për të cilën, ashtu si edhe për Greqinë, oqeani ka qenë gjithmonë jo një pengesë e cila ndan, por një rrugë detare që bashkon. [...]

Për Greqinë, Anglia është aleati i natyrshëm dhe vazhdimisht ka provuar që është mbrojtësja, dhe nganjëherë, edhe mbrojtësja e vetme e saj. Ajo do të fitojë dhe fitorja i përket vetëm asaj. Kjo do të jetë një fitore e botës anglosaksone, në duart e të cilës Gjermania, përdërisa nuk ka arritur një rezultat përfundimtar deri tani, është e destinuar

► Fig. 3. Biletë lotarie për të mbledhur para për familjet e ushtarëve që luftonin në frontin shqiptar kundër italianëve, në vitet 1940-1941



IEEE, *To epos tou '40. Laiki Eikonografia*, 166.

të shtypet. Sepse, që nga ky çast, për Forcat e Boshtit, në horizont nuk do të ketë qiell pa re, as në drejtim të Lindjes dhe Lindja është gjithmonë vendi i mistereve. Ka qenë e tillë gjithmonë, por sot, më tepër se kurrë më parë, ajo është e mbushur me zhvillime të papritura dhe me mistere. Kështu, në fund, do të triumfojmë. [...]

Ka çaste kur një popull e ka për detyrë ndaj vetes, nëse dëshiron të mbetet një popull i madh, që të luftojë, edhe kur shpresa për fitore duket e largët. Është pikërisht kjo gjë, çka duhet të bëjë ai.

Metaxas, f. 525-526.



Më 28 tetor 1940, Italia i dërgoi Greqisë ultimatum. Joanis Metaksasi, diktatori dhe kryeministri grek qysh prej 4 gushtit 1936, iu përgjigj menjëherë "OQI" ["JO"], dhe dita "OQI" mbetet edhe sot festa e dytë kombëtare e Greqisë, edhe pse diktatura e Metaksasit nuk simpatizohet nga njerëzit. Më 30 tetor, kur trupat italiane vazhdonin të përparonin dhe kur avionët italianë kryenin bombardime, Metaksasi iu drejtua me këtë letër redaktorëve dhe botuesve të të gjitha gazetave greke, që në atë kohë ishin të censuruara. Metaksasi vdiq më 29 janar të vitit 1941, kur forcat greke kishin hyrë thellë në Shqipëri dhe nuk arriti të shikonte pushtimin gjerman të 6 prillit.



Komentoni paragrafin e fundit. Ç'donte të arrinte Metaksasi me anë të tij?



Përkthim: "Grekë, Ushtarët tanë heroikë që po ndjekin rrugën e Leonidhas, ju kanë besuar mbrojtjen e frontit të brendshëm.

Një nga armët e kësaj mbrojtjeje është LOTARIA E LUFTËS SË MADHE.

Gjysma e të ardhurave nga kjo lotari e re do të përdoren për ndihma, në periudhën e dimrit: për veshje, për ngritjen e mensave, për kujdesin shëndetësor etj., për fëmijët dhe prindërit e moshuar të luftëtarëve tanë. Gjysma tjetër do të fitohet nga blerësit e kësaj lotarie, të cilët mund të fitojnë çdo muaj deri në 10 000 000 dhrahmi.

Çmimi i parë: 2 500 000 dhrahmi

Biletat kushtojnë 200, 100 dhe 50 dhrahmi."

I-6. Udhëzim i Hitlerit, nr. 26 (3 prill 1941)

Bashkëpunim me aleatët në Ballkan

1. Në fushatën ushtarake kundër Jugosllavisë, detyrat e shteteve të Europës Juglindore do të jenë në përputhje me objektivat politikë të mëposhtëm: Hungarisë, që do të marrë Banatin, do t'i duhet që ta pushtojë vetë këtë rajon; ajo duhet të zotohet se do të japë ndihmesën e saj për shkatërrimin e armikut. Bullgarisë do t'i kthehet Maqedonia dhe, si rrjedhojë, do ta përqendrojë sulmin e saj në këtë rajon, pa pasur ndonjë mbështetje të veçantë nga ana e Gjermanisë. Gjithashtu, bullgarët do të kenë detyrë të mbështesin sulmin kundër Turqisë, i cili do të shoqërohet nga divizioni gjerman i tankeve. Për këtë operacion, Bullgaria do të angazhojë, gjithashtu, edhe tri divizionet e vendosura në kufirin me Greqinë.

Në interes të saj dhe të Gjermanisë, Rumania do të ketë detyrë që të ruajë kufirin me Jugosllavinë dhe me Rusinë. Kreu i misionit ushtarak gjerman duhet të sigurojë që gatishmëria për mbrojtjen nga sulmet ruse të jetë më e madhe, dhe që forcat rumune, të vendosura në Temesvar, duhet të lëvizin më në lindje, në mënyrë që të mos pengohet bashkërendimi i Armatës së Dytë Hungareze me forcat gjermane.

Më së paku, misioni i përbashkët hungarez dhe gjerman duhet që ta kalojë kufirin rumuno-hungarez pa vështirësi.

2. Për bashkëpunimin ushtarak dhe për drejtimin e këtij operacioni do të zbatohen udhëzimet e mëposhtme:

Përsa u përket operacioneve të forcave italiane dhe hungareze, drejtimi i fushatës së përbashkët ushtarake do të jetë nën urdhrat dhe drejtimin tim. Ato do të drejtohen, duke marrë parasysh interesat e këtyre aleatëve dhe do të bëhet e mundur që krerët e shtetit italian dhe hungarez të shfaqen përpara popujve dhe forcave ushtarake të tyre si udhëheqës ushtarakë të pavarur. [...]

Hitlers Weisungen für die Kriegsführung, f. 108-109.

I-7. Jon Antonesku⁶ rreth *problemit hebre*

17 shtator 1940

Mjetet e propagandës, shtypi dhe radioja do të funksionojnë në harmoni të plotë, në planin e brendshëm dhe atë të jashtëm. Ky veprim duhet të jetë i njësuar dhe duhet të shmangen problemet. *Në planin e jashtëm*

Duhet të bëhet e ditur se pika e vetme e mbështetjes sonë në planin e politikës së jashtme është: *Boshti*. Gjeneral Antonesku nuk do të ndjekë të njëjtën politikë si paraardhësit e tij; gjeneral Antonesku ka vendosur të ndjekë një rrugë të vetme. Politika e Rumanisë është njëqind për qind në krahun e Boshtit. Ne do të mbajmë një qëndrim plotësisht besnik dhe të rregullt ndaj Forcave të Boshtit...

Problemi hebre është një problem jetësor. Me mjete të qytetëruara do të përpiqem që hebrenjtë t'i largoj nga strukturat ekonomike rumune. Të gjithë hebrenjtë që kanë ardhur si klandestinë dhe janë vendosur këtu pas Bashkimit, do t'u kërkohet që të kthehen mbrapsht, të largohen nga vendi me çdo mënyrë. Ta anashkalosh *problemin hebre* ose të mos i japësh zgjidhje të qartë, do të thotë të tradhtosh konceptin e të qenit rumun. Megjithatë, ta shkelësh këtë koncept ose këtë fjalë, nuk e zgjidh problemin, por ul reputacionin e atij që e bën këtë. Gjeneral Antonesku mori përgjegjësinë që ta zgjidhë këtë problem parimisht dhe në mënyrë të vazhdueshme, që të mos prishë baraspeshën në jetën ekonomike. Largimi i elementit të huaj do të zëvendësohet nga krahu i punës vendës.

Evreii din România între anii 1940-1944, vëll.II, dok. 44.



Këto ishin udhëzimet që iu dhanë shtypit, radios dhe agjencive telegrafike.

Në lidhje me "problemin hebre" u dhanë udhëzime të veçanta. Ishte kjo një mënyrë që tregonte se si censura politike mbi shtypin, e vendosur nga regjimi i mëparshëm, vazhdoi të praktikohej edhe në ato vite.

⁶ Jon Antonesku (1882-1946) ishte ushtarak dhe politikan. Mbajti funksione të larta në ushtrinë rumune. Nga 4 shtatori 1940 deri në 23 gusht 1944 ishte kryeministër dhe udhëheqës i vendit. Bëri aleancë me Gjermaninë e Hitlerit, dhe në vitin 1946 u ekzekutua si kriminel lufte.

? Sipas mendimit të Antoneskut, cili ishte aleati kryesor i Rumanisë në vitin 1940? Sipas tij, cilat ishin mjetet për zgjidhjen e “problemit hebre”? Krahasoni situatën në Rumani, me atë në vendet e tjera, në të njëjtën periudhë. A mendoni se vërtet “problemi hebre” ishte “një problem jetësor” për Rumaninë në vitin 1940 (kur ajo kishte humbur 1/3 e territorit të saj dhe po futej me forcë në luftë)?

I-8. Deklarata e mbretit Mihai⁷, drejtuar popullit (23 gusht 1944)

Rumunë,

Në çastin më të vështirë të historisë sonë, unë bashkë me njerëzit e mi gjykojmë se ka vetëm një rrugë për ta shpëtuar vendin nga një katastrofë e plotë: duhet të prishim aleancën me Forcat e Boshtit dhe menjëherë të ndalojmë luftën kundër Kombeve të Bashkuara.

Rumunë,

Një qeveri e re e bashkimit kombëtar u ngarkua me detyrën që të përmbushë vullnetin e vendit dhe të vendosë paqen me Kombet e Bashkuara. Rumania e pranoi armëpushimin e ofruar nga Bashkimi Sovjetik, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Që nga ky çast, çdo luftim ose veprim armiqësor kundër ushtrisë sovjetike duhet të ndërpritet, ashtu si edhe gjendja e luftës me Britaninë e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ju lutem, t’i prisni ushtarët e këtyre ushtrive me besim. Kombet kanë garantuar pavarësinë e vendit tonë dhe mosndërhyrjen në çështjet e brendshme. Ata e kanë njohur padrejtësinë e vendimit të Vjenës, pas të cilit na u mor Transilvania...

Rumunë,

Diktaturës i erdhi fundi dhe bashkë me të, edhe shtypjes. Kjo qeveri e re shënon fillimin e një epo-ke të re, në të cilën të drejtat dhe liritë e të gjithë qytetarëve të vendit janë të garantuara dhe do të respektohen.”

Istoria Romaniei între 1918-1944 (culegere), f. 261.

⁷ Mihai I (1921-) mbret i Rumanisë në vitet 1927-1930; 1940-1947. Më 23 gusht 1944, i mbështetur nga opozita politike, arrestoi Jon Antoneskun dhe e shpalli të mbyllur luftën kundër Kombeve të Bashkuara. Në vitin 1947, nëpërmjet kërcënimeve, u detyrua të hiqte dorë nga froni dhe Rumania u shpall republikë popullore.

⁸ Dokumenti gjendet në Arkivin e Kosovës. Ky dokument është printuar origjinal pa asnjë ndërhyrje e as përshtatje gjuhësore.

? Cilat janë pikat kryesore në programin e qeverisë së re rumune? Si konsiderohet qeveria e mëparshme? Në fillim, mbreti Mihai e përkrahu udhëheqësin fashist, Antoneskun; përse ndryshoi mendim? A ishte ai i sinqertë, apo thjesht oportunist? Krahasojeni këtë me shembuj të tjerë të udhëheqësve që ndryshojnë drejtimin e tyre politik.

I-9. “Rezoluta e Bujanit”: Rezoluta e dalë nga Konferenca e parë e Këshillit Nacional Çlirimtar për Kosovën dhe Rrafshin e Dugagjinit, mbajtur më 31 dhjetor 1943 dhe më 1 dhe 2 janar 1944⁸

Përfaqësues nga të gjitha viset e Kosovës e Rrafshit Dukagjinit, Shqiptar, Serb, e Malazez: nacionalist, komunist, rinia antifashiste, rinia komuniste, gra antifashiste, përfaqësues t’ushtres Nacional – Çlirimtare etj., të frymëzuar nga ideali i naltë për bashkimin e tendencave të ndryshme politike, për zhvillimin e bashkimin e popujve të Kosovës e të Rrafshit Dukagjinit dhe për forcimin e luftës s’armatosur t’organizuar të popujve t’onë kundra zaptuesve fashista dhe hyzmeqarëve të tyre, u mbledhën në çastin kur situata e jashtme dhe e brendshme asht e kartë, shqyrtuen punën e deritashme të Këshillit Nacional – Çlirimtare dhe zgjodhën Kryesin e Këshillit Nacional – Çlirimtar. b) Lufta e parë imperialiste muer fund me traktatin e Versajës i cili përveç padrejtësive të tjera krijoi edhe Jugosllavin për me kënaqë klikën hegjemoniste të Serbve të mëdhenj me në krye Mbretin Aleksandër. Kjo Jugosllavi e krijueme, pa e pyet popullin dhe kundër vullnetit të popullit, ka qenë vendi tipik i shtypjes kombtare, politike dhe ekonomike i Evropës.

Populli shqiptar i Kosovës e i Rrafshit Dukagjinit jo vetëm që ka qenë i shtypun politikisht, kombtarisht dhe ekonomikisht, por edhe i nënshtuem çfarosje fizike. I janë mohue të gjitha të drejtat kombtare

(mungesa e shkollave në gjuhën amtare, pengimi i zhvillimit politik e kultural). T'ashtuquajtnit përfaqësues të tij kanë qenë agjenda besnikë të klikës hegjemoniste të Serbve të mëdha për plaçkitje dhe shtypje.

Kulmi i shfytzimit ekonomik ka qenë reforma Agrare që kishte për qëllim me mprehë urrejtjen shoviniste në mes të popullit Shqiptar, Serb e Malazet, me i vorfënue shqiptarët në një shkallë të tillë sa të detyrohen me u shpërngulë, me formue një mbështetje reacioni me këlyshët reacionar në Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit nën këto kushte.

Populli Shqiptar i Kosovës e Rrafshit të Dukagjinit mbas shkatërrimit të Jugosllavis, si popull pa vetdije të mjaftueshme politike dhe mbasi i kishte ardhë thika në fyt, qe gati me përshëndetë si mik çdo kënd që do t'a përmbyste këtë gjendje. Deri ushtarët gjakësorë të Fashizmit që i kishin lye duert me gjakun e shqiptarve në Shqipni iu paraqitën si shpëtimtarë

...

Kosova e Rrafshi i Dukagjinit asht një krahinë e banuese në shumicë nga populli shqiptar, i cili si gjithmonë ashtu edhe sot dëshiron me u bashkue me Shqipni. Prandaj e ndiejmë për detyrë me i tregue rrugën e drejtë që duhet me ndjekë populli shqiptar për me realizue aspiratat e veta. Rruga e vetme pra që populli shqiptar i Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit të bashkohet me Shqipnin asht lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavis kundër okupatorit nazist gjaksuer e rroghtarve të tij sepse kjo asht e vetmja rrugë për me fitue lirinë, në të cilën të gjithë popujt, pra edhe populli shqiptarë, do të kenë mundësi me vetëvendosë mbi fatin me të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje. Garancija për këtë ashtu ushtria sNacional-Çlirimtare e Jugosllavis dhe ushtria Nacional-Çlirimtare e Shqipnis, me të cilën ngushtësisht asht e lidhun. Përveç këtyre për këtë garantojnë aleatët t'onë të mëdhej Bashkimi Sovjetik, Anglija e Amerika (Karta e Atlantikut, Konferenca e Moskës dhe e Teheranit).

II

Na përfaqësuesit e Kosovës e Rrafshit Dukagjinit përshëndesim Komitetin Kombtar të Çlirimit Jugosllavis me Mareshalin Tito në krye dhe bashkohemi me protesten e drejtë kundra Qeveris

tradhtarë jugosllave t'ikun në Londër dhe kthimit të Mbretit Pjetër e dytë. Gjithashtu kërkojmë që këta e të gjithë gjakpirësit të dalin para Gjyqit të popullit për me dhanë hesapë për të gjitha krimet e tyne.

III

Këshilli Nacional-Çlirimtar nuk asht parti, por një organ i përbashkët ku marrin pjesë të gjitha rrymat politike dhe prandaj i ftojme të gjithë patriotët e ndershëm pa dallim kombisje, feje, tendence politike e pozite shoqnore që të mblidhen rreth Këshillit Nacional-Çlirimtar në luftë kundër okupatorit dhe sherbtorve të tij në këtë çast vendimtar për fitimin e liris së vërtetë. Ftojme edhe ata që kanë qenë në shërbim t'okupatorit, por që nuk i kanë përlye duert me gjakun e popullit.

I-10. Rezolutë e Kuvendit Popullor Krahinor të Kosovës e Metohisë, korrik 1945

Kuvendi popullor krahinor i Kosovës e Metohisë konstaton faktin e gëzueshëm se kushtet në Krahinë janë rregullue e normailizue n'atë masë, sa ka mujtë me u zhvillue puna e favorshëme në limit e ndryshme të jetës shoqnore, ekonomike e kulturore. Ky fakt shihet edhe në ngritjen e të gjitha organeve të pushtetit popullor, në zgjedhjet e këshillave popullore të vendeve, këshillave popullore të rretheve e të kuvendit, si dhe në mbledhjen e këtij kuvendi krahinor, n'organizimin e gjyqeve e t'organeve tjera të pushtetit civil, të cilët kanë marrë në duar të gjitha punët në Krahinë mbas suprimimit t'administratës ushtarake. Banorët e kësaj Krahine gëzojnë sot begatitë e veta të demokracisë jugosllave dhe të pushtetit të vërtetë popullor, i cili ka lindë nga lufta shumëvjeçare e të gjithë popujve të Jugosllavisë kundra okupatorit fashist. Me qenë se puna në konsolidimin e zhvillimit e matejshëm t'organeve të tashëme të pushtetit popullor dhe puna në lidhjen e tyne me masat e gjana popullore asht kusht për mbrojtjen e konsolidimin e fitoreve të Luftës nacional-çlirimtare, me qenë se të gjitha këto janë ndihma e jonë për Jugosllavinë Federative Demokratike, atëherë asht detyrë e çdo qytetari me i ndihmue këshillat popullore dhe me i kontrollue në punë.

Fakti ma i rëndësishëm në jetën e sotëshme të kësaj Krahine asht ndryshimi themelor i cili, në sajë të lëvizjes nacional çlirimtare të politikës së saj dhe të barazisë e vëllazërimit në mes të të gjithë popujve të Jugosllavisë, asht ban ë marrëdhانيت në mes të banorëve të kombësisë shqiptare e serbëve e malazezëve. I asht dhanë fund njëherë e përgjithmonë politikës së zhvillimit të përçarjes reciproke dhe të luftës ndërmjet serbëve e shqiptarëve, të cilën e përkrahnin dhe e nxisnin në dam edhe të njanit edhe të tjetrit popull, të gjithë regjimët e mëparshme antipopullore, sin ë Perandorinë e dikurshme turke, ashtu edhe në Jugosllavinë e vjetër, e po ashtu edhe pushteti i okupatorit gjatë viteve të fundit. Për këtë arsye zhvillimi i mëtejshëm, thellimi e konsolidimi i vëllazërisë e bashkimit, asht detyrë e shenjtë e çdo qytetari të Kosovës e Metohisë, pa u bazue në përkatësinë fetare e nacionale – ky është parimi udhëheqës në punën e të gjitha organeve të pushtetit popullor tek ne.

Sot banorët shqiptarë gëzojnë barazi të vërtetë dhe kanë të gjitha mundësitë që në bashkëpunim të ngushtë me banorët serbë e malazezë, dhe me ndihmën e Serbisë demokratike dhe të mbarë Jugosllavisë Federative Demokratike, të përkushtojnë të gjitha fuqitë e veta për zhvillimin e përshtatshëm kulturor dhe përparimin ekonomik e shoqëror. Sot banorët shqiptarë kanë organizatën e tyre politike nacionale – Komitetin shqiptar, i cili asht pjesë përbërëse e FUNSH në Krahinë, një nga faktet ma të randësishme, të cilin e gëzojnë shqiptarët në Jugosllavi, asht barazia e gjuhës shqipe n'administratën shtetnore dhe shkollat në gjuhën shqipe. Të vetëdëshëm për këtë pozitë të barabartë, banorët shqiptarë kanë dhanë me mijra bij të vetët n'Armatën e tyne të lavdishme jugosllave, e shumë shqiptarë, të cilët kanë qenë të tërhequr nga reaksionarët në shërbim të okupatorit, janë çlirue nga ndikimi i damshëm i reaksionarëve dhe sot bashkëpunojnë me gjithë zemër në ndërtimin e jetës së re të Krahinës sonë. Nga kjo rrjedh se puna në rindërtimin, në ngritjen e forcimin ekonomik asht vijim i pakëputur i luftës çlirimtare, kusht për krijimin e jetës ma të mirë e ma të lumtur dhe të gjithë qytetarët e krahinës sonë e kanë për detyrë me marrë pjesë në të.

Për shkak të kushteve të vështira që kanë mbretëruar

para një viti e gjysëm në Krahinën tonë, banorët e kësaj Krahine nuk kanë pasë mundësinë me qenë të përfaqësuar në Mbledhjen e dytë të Këshillit antifashist të çlirimit kombëtar të Jugosllavisë në Jajcë, në nëntor të vitit 1943. Për këtë arsye populli i kësaj Krahine me anën e kuvendit të vet krahinor të zgjedhur lirisht, mundet qysh tash me shprehë në mënyrë të lirë pëlqimin e vet të plotë me vendimet historike të AVNOJ-it, me të cilat ju vunë themele të forta Jugosllavisë së re Federative Demokratike dhe lirisë e barazisë së popujve të saj e pakicave kombëtare.

Kuvendi popullor krahinor i Kosovës e Metohisë deklaroi njëzëri se banorët e kësaj krahine, po ashtu, sikurse edhe të gjithë popujt e Jugosllavisë, nuk kanë pranuar kurrë coptimin e Krahinës së vet, që e ka ba okupatori, as coptimin e Jugosllavisë dhe pra shpreh dëshirën e tanë banorëve të Krahinës që kjo të bashkohet me Serbinë federale si pjesë përbërëse e saj. Populli i kësaj krahine asht i bindur se do ta ketë mbrojtjen e plotë të Qeverisë popullore të Serbisë dhe se nga pushteti popullor i mbarë Jugosllavisë do të ndihmohet në ngritjen e tij politike, nacionale, ekonomike e kulturore, dhe përfaqësuesit e Krahinës në Kuvendin popullor të Serbisë e në AVNOJ do të kontribuojnë me të gjitha fuqitë në ndërtimin Serbisë demokratike dhe të Jugosllavisë Federative Demokratike.



Në konferencën e Këshillit Nacional Çlirimtar të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit, të mbajtur në fshatin Bujan të Shqipërisë (më 31 dhjetor 1943 dhe 1-2 janar 1944) morën pjesë 49 përfaqësues nga të gjitha etnitë e Kosovës (43 shqiptarë, 6 boshnjakë dhe serbë). Pjesëmarrësit miratuan një rezolutë, në të cilën ndër të tjera, deklaruan në mënyrë të qartë vullnetin e popullit të Kosovës për tu bashkuar me Shqipërinë, si një e drejtë e patjetërsueshme e popujve për vetëvendosje.

Konferenca dhe Rezoluta u kritikuan nga Titoja si dhe nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Jugosllavisë - duke theksuar se vërtet vendimet e Këshillit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Jugosllavisë (AVNOJ) të marra në nëntor të vitit 1943 në Jajcë lejojnë të drejtën e vetvendosjes të popujve, por kjo duhet të justifikohet me luftë kundër nazistëve gjermanë. Udhëheqja e lëvizjes jugosllave të rezistencës argumentonte se hapja e

çështjes së kufirit midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë në një kohë kur të dyja vendet janë duke luftuar kundër gjermanëve ishte e gabuar, sepse kjo vetëm i ndihmonte gjermanët për të armiqësuar të dy vendet me njeri-tjetrin. Pra, në fillim, të dyja vendet duhet të çlirohen nga pushtuesit dhe më pas të vendosin mbi çështjen e kufirit. Gjithashtu u kritikua përdorimi i emrit Dukagjin në vend të emrit Metohia për organet politike sepse Dukagjin përdorej si një emër gjeografik jo vetëm për Metohinë (pjesë e territorit të Jugosllavisë), por edhe për territoret në anën shqiptare të kufirit.

Rezoluta e Bujanit nuk u vu në fuqi. Pas tërheqjes së ushtrisë gjermane në 11 nëntor 1944, ushtria partizane jugosllave hyri në Kosovë. Menjëherë pas kësaj, nisi një kryengritje masive e popullsisë shqiptare e cila ishte e bindur se ky ishte një tjetër pushtim jugosllav, i ngjashëm me atë të Luftërave Ballkanike. Në shtypjen e kryengritjes bashkëpunuan edhe dy brigada nga Shqipëria. Në shkurt të vitit 1945 Kosova u vendos nën administrimin ushtarak të ushtrisë jugosllave. Në korrik të vitit 1945, Kuvendi i Kosovës, në kushtet e administrimit ushtarak, miratoi Autonominë e Krahinës së Kosovës e Metohisë, krahinë e cila gjatë mbajtjes së seancës së tretë të AVNOJ në gusht të vitit 1945, u përfshi në Republikën Popullore të Serbisë.

I-11. Ideologjia komuniste e LNÇ-së, e paraqitur nga Sejfulla Malëshova⁹

Që sot, në luftë kundër okupatorit dhe klikave reaksionare, populli shqiptar po edukohet politikisht, po fiton ndërgjegjen e interesave të tij, po kupton se s'ka tjetër udhë të drejtë, përveç rrugës që shpie në demokracinë popullore. Karakteri i regjimit të nesërm në Shqipëri dhe vrulli demokratik e popullor i këtij regjimi janë në raport direkt me aktivitetin dhe me kontributin e popullit tonë në luftën e sotme. Sot, në betejat e Luftës Nacional-çlirimtare, vendoset fati i nesërm i Shqipërisë.

Fakti që shumica e madhe e popullit shqiptar është grumbulluar rreth Frontit Antifashist Nacional-çlirimtar, fakti që mundëm të bëjmë zgjedhje të lira në krahinat më të përparuar dhe organizuam

një Kongres me delegatë nga gjithë Shqipëria; fakti që kemi sot një Këshill Antifashist, që përfaqëson pushtetin politik të popullit dhe të Shtetit Shqiptar; fakti që sot kemi një ushtri me brigada e divizione, një ushtri të popullit, të zonjën t'u bëjë ballë divizioneve gjermane dhe bandave reaksionare dhe t'i shkatërrojë, janë garancia e parë për triumfin e një regjimi demokratik e popullor në Shqipëri. (...) Populli ynë, në fakt me gjithë botën progresive antifashiste, s'do të lërë që frytet e gjakut të tij t'i mbledhin të tjerët, ata që e kanë shtypur dhe e kanë rrjepur gjer më sot.

Nuk do të përsëritet më ajo që ka ngjarë dje, që populli të vritet e të shuhet dhe të tjerët të zënë kolltukët e të punojnë kundër interesave të tij.

Bashkimi, qershor 1944.



Sejfulla Malëshova ishte një nga udhëheqësit më të shquar komunistë të qëndresës antifashiste në Shqipëri. Ideologjia komuniste e LNÇ-së që paraqitet në këtë burim, shpалos platformën komuniste për drejtimin e vendit pas luftës, duke i etiketuar të gjitha grupet e tjera politike si bashkëpunëtorë të armikut dhe tradhtarë. Nëpërmjet këtij artikulli, mund të kuptohet qartë propaganda komuniste gjatë Luftës.



Analizoni gjuhën e përdorur në këtë fragment. Cilat elemente të këtij artikulli mund të konsiderohen si propagandë?

I-12. Udhëzime për themelimin e Organizatës Popullore të Rinisë Malazeze, të lëshuara nga Këshilli Rajonal i Partisë Komuniste Jugosllave për Malin e Zi, Bokën dhe Sanxhankun, shtator 1941.

· Luftë për çlirimin kombëtar të popullit malazes dhe për arritjen e barazisë së plotë për popullin e Bokës dhe Sanxhakut, si dhe për gjithë kombësitë e shtypura dhe të shfrytëzuara. Bashkim i rinisë dhe

⁹ Sejfulla Malëshova lindi në Malëshovë, pranë Përmetit, në vitin 1900. Në moshën 24 vjeçare filloi të shkruante poezitë dhe artikujt e parë. Më pas shkoi në Moskë, si anëtar i Kominternit. Mori pjesë shumë aktive në Luftën e Dytë Botërore. Pas luftës u caktua kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe më pas, ministër i Arsimit në Shqipëri. Ai ka përkthyer disa vepra të Gëtes, Nekrasovit etj. Për pikëpamjet e tij liberale u burgos nga regjimi komunist për 20 vjet. Sejfulla Malëshova vdiq në vitin 1971, në Fier, ku qëndronte i internuar.

popullit në luftën kundër pushtuesve; bashkëpunim vëllazëror me të gjithë popujt jugosllavë – serbë, kroatë dhe të tjerë.

- Vetëvendosje dhe barazi për popullin malazes dhe barazi të plotë për popullin e Bokës dhe Sanxhakut, si dhe për të gjithë popujt e tjerë të Jugosllavisë: luftë kundër çdo lloj hegjemonie dhe shovinizmi të drejtuar ndaj çdo kombësie ose pakice kombëtare.

- Solidaritet sllav dhe zhvillim të dashurisë për të gjithë popujt sllavë, veçanërisht për popullin rus dhe ukrainas, të cilët po mbajnë barrën më të rëndë të luftës kundër fashizmit; luftë kundër urrejtjes shoviniste ndaj popullit gjerman, italian dhe popujve të tjerë dhe ngritje lart të internacionalizmit.

- Vendosje të rendit demokratik popullor dhe shkatërrim të të gjitha gjurmëve të fashizmit, armikut më të madh të rinisë dhe popullit; në këtë kuadër, luftë kundër anëtarëve të kolonës së pestë¹⁰, të çfarëdo lloji qofshin, si dhe mbeturinave të regjimeve të kaluara reaksionare, të cilat i shërbyen armikut dhe prishën unitetin e popullit duke e tradhtuar; luftë për të drejtat e rinisë sonë: rinisë punëtore, fshatare dhe intelektuale, si dhe për barazinë e të reja.

Stanišić, f. 255-256.



Aspirata e udhëheqjes së Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Malit të Zi për të organizuar rininë antifashiste, bëri që në fund të gushtit 1941, Këshilli Rajonal i PKJ-së për Malin e Zi dhe Bokën të lëshojë një direktivë mbi krijimin e organizatës së Rinisë Popullore Malazeze (RPM). Procesi i forcimit dhe organizimit politik të RPM-së nisi në fillim të shtatorit 1941. Si organizatë, ajo u themelua në një konferencë të mbajtur në Stijena Piperska të Podgoricës, më 30 nëntor 1941. RPM-ja u kthye shpejt në organizatën politike me më shumë anëtarë. Në vetëm më pak se tre muaj, në të u anëtarësuan rreth 20 000 vetë.

I-13. Trakt i shkruar nga Dega e Komitetit të Partisë Komuniste të Jugosllavisë për Maqedoninë, drejtuar popullit maqedonas

Nëntor 1941

... Qeveria bullgare kreu masakra në Kumanovë, ku pati 7-8 të vdekur dhe midis tyre, disa gra, (...) Qytetet tona janë rrethuar dhe pushtuar, dhe njerëzit nuk lejohen të dalin nga shtëpitë qysh prej disa ditësh; në Prilep (dhe në disa vende të tjera), me qindra njerëz janë arrestuar dhe janë rrahur për vdekje në rrugë. Një rrugë mund të shikosh shpesh maqedonas të ndershëm që dërgohen në burg nga policia fashiste bullgare – këta janë djemtë më të mirë të popullit maqedonas. Kush po e bën të gjithë këtë? A po e bëjnë bullgarët? Jo. Populli bullgar nuk ka të bëjë me këtë; kjo është organizuar nga tradhtarët e popullit bullgar, të cilët e kanë shitur veten për një grusht parash të pista fashiste. Këta tradhtarë po bëjnë gjithçka që kanë në dorë për t'iu bindur përbindëshit Hitler, dhe të na detyrojnë ne maqedonasve të urrejmë dhe të luftojmë bullgarët, rusët, serbët dhe popujt e tjerë sllavë. Hitleri i mallkuar do që t'i heqë qafe popujt sllavë, dhe t'i kthejë ata në skllëvër – skllëvër, të cilët do të punojnë dhe lërojnë tokën për kontët dhe baronët gjermanë. Pa asnjë logjikë, Hitleri bërtet se 4-5 milion sllavë duhet të largohen, në mënyrë që të mbillet fara gjermane, dhe për këtë arsye, ai lufton kundër Ruisë Sovjetike, tokës së socializmit, mbrojtëses së të gjithë popujve pa të dreja, sidomos popujve të vegjël sllavë.

Sot, lufta heroike e popullit sovjetik është lufta e të gjithë popullit sllav kundër armikut të përbashkët. Fitorja e tyre është edhe jona. Kjo është një fitore që do t'i japë fund skllavërisë, urisë dhe terrorit që kanë mbjellë fashistët.

Sources for the liberation war and revolution in Macedonia [Burime nga lufta çlirimtare dhe revolucioni maqedonas], f. 28-29.



Cilat janë qëllimet e këtij trakti? Cili është qëndrimi i DK-së të PKJ-së për Maqedoninë ndaj popullit bullgar? Shpjegoni rolin që pati Bashkimi Sovjetik në luftën e popullit maqedonas. Krahasoni gjuhën e përdorur, me atë të tekstit të mëparshëm.

¹⁰ Kolona e pestë quheshin bashkëpunëtorët me pushtuesin. Të tillë kishte në të gjitha zonat e Jugosllavisë. Në Malin e Zi, kolona e pestë përbëhej nga: çetnikët, malazezët separatistë, milicia myslimane dhe shqiptarët kuislingë.

Pyetje të përgjithshme mbi nënkapitullin Ia.

A i paraqitin këto burime udhëheqësit politikë ashtu siç janë në të vërtetë? Çfarë ngjashmëri mund të gjeni midis këtyre udhëheqësve? Çfarë ndryshimesh mund të shikoni midis tyre?

Gjeni përshkrime të udhëheqësve të së njëjtës periudhë në vendin tuaj. A mund të gjeni ngjashmëri midis tyre? Gjeni përshkrime të ndryshme të të njëjtit udhëheqës. Si mendoni, përse i njëjti person është përshkruar në mënyra të ndryshme?


Në ç'përfundim dilni kur shihni fotografite propagandistike – ç'tregojnë ato? Ç'donin t'i thonin popullit? Për secilin burim, përpikuni të gjeni: Cilën ideologji mbështeste? Përse gjatë luftës, propaganda ishte aq e rëndësishme? A mund të përcaktoni kontradiktat kryesore politike dhe ideologjike në secilin shtet? A mund të gjeni prijje të përbashkëta tek të gjitha shtetet?

Ib. Ushtritë dhe ushtarët

I-14. Raport i amerikanëve mbi veprimtarinë e rezistencës shqiptare

“Ballistët¹¹ nuk luftuan as kundër italianëve, dhe as kundër gjermanëve. Në fillim, politika e tyre ishte: “Të lëmë Aleatët të luftojnë për ne.” Tani që LNÇ-ja¹² i ka forcuar pozitat e saj, dhe kur duket se ka shanse të mira që të marrë drejtimin e vendit pas lufte, ballistët janë trembur dhe po thërrasin gjermanët të luftojnë për ta, në mënyrë që të zhdukin LNÇ-në, pa luftuar vetë. Sido që të ndodhë, duket se zotërinjtë ballistë, siç quhen nga LNÇ-ja, janë të vendosur të mos luftojnë me ndershmëri. Ata do të bëjnë ndonjë sulm të rafinuar dhe ndoshta ndonjë vrasje të bujshme, dhe më pas, disa do ta quajnë këtë luftë civile, por ata nuk do të ngrihen të luftojnë. Të paktën, të gjitha gjasat në këtë përfundim të çojnë.”

Costa, f. 166.

 Ky fragment është pjesë e një raporti zyrtar të datës 23 dhjetor 1943, hartuar nga përfaqësuesi amerikan i Zyrës për Shërbime Strategjike dhe atyre të Veprimeve Speciale, dërguar komandës qendrore, lidhur me veprimtarinë e rezistencës në Shqipëri. Këtu paraqitet strategjia e luftës e këtyre grupimeve dhe kjo jepet në mënyrë krahasuese.

I-15. Përfaqësuesit e Aleatëve në Ballkan përshkruajnë strategjitë e luftës guerrile në Shqipëri


BK (Balli Kombëtar) në fakt thotë: “Të përgatitemi tani, por të luftojmë më vonë.”


Ose siç thuhet në një raport tjetër:

“Ne do të futemi në veprim, kur britanikët të zbarkojnë në Durrës.”

LNÇ-ja thotë: “Të organizohemi dhe të luftojmë tani. Të vazhdojmë të luftojmë, derisa të ketë edhe një ushtar të vetëm nazist në tokën shqiptare.”

Costa, f. 167.

 Ky është një fragment nga raportet e përgatitura nga të dërguarit e Aleatëve në Ballkan, mbi luftën guerrile dhe strategjitë e luftës së Ballit Kombëtar¹³ dhe LNÇ-së gjatë vitit 1943.

 A jeni në një mendje me strategjitë e përshkruara në burimet e mësipërme? A duhet vërtet që “kombet e vegjël” të qëndrojnë të fshehur, ndërkohë që Fuqitë e Mëdha luftojnë? Shpjegoni pozicionin tuaj.

¹¹ Ballistët: anëtarë të Ballit Kombëtar.

¹² Lëvizja Nacional Çlirimtare e drejtuar nga komunistët.

¹³ Balli Kombëtar ishte një organizatë politike dhe ushtarake në Shqipëri, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Synonte që pas luftës, Shqipëria të bëhej republikë. Luftoi kundër pushtuesve, por në një pikë të caktuar të luftës bashkëpunoi me gjermanët për të shkatërruar komunistët. Ky fakt u përdor nga propaganda komuniste për t'i diskredituar në popull.

I-16. Hermann Neubacher përshkruan politikën e ndjekur nga nazistët në zonën e Kosovës dhe Metohisë

Regjioni i Kosovës dhe Metohisë, i banuar kryesisht nga popullsia shqiptare, pas kapitullimit të Jugosllavisë në vitin 1941 u bashkua Mbretërisë Italiane të Shqipërisë, që u themelua në vitin 1939. Shqiptarët nuk humbën kohë për të dëbuar sa më shumë serbë jashtë vendit. Shumë shpesh të dëbuarit detyroheshin nga autoritetet lokale për të paguar kompensim në ar që t'u lejohej largimi nga vendi. Thjesht, ata ndiqnin shembullin e taksës së emigracionit të Rajhut Gjerman. Kur gjenerali Nediq¹⁴ u ankua lidhur me këtë gjë, rekomandova që qeveria shqiptare të pengojë urgjentisht dëbimin e serbëve. Duke parë se ndërhyrja ime ishte e pasuksesshme, kërcënova se do të jap dorëheqje nga misioni në Shqipëri, duke deklaruar se do t'më duhet ta lë për t'i mundësuar dikuj tjetër që ta mbrojë Shqipërinë nga qëllimet ekspansioniste të Bullgarisë. Xhafer Deva¹⁵, i cili kishte ndikim në Kosovë, premtoi se do të ndërhyjë, gjë që e bëri me sukses. Pavarërisht nga këto, në vitin 1941 u bënë shumë dëme. ... (Himlari) u autorizua nga Hitleri për të formuar një Divizionin SS malor Waffen me emrin Skenderbeu, për të luftuar kundër partizanëve brenda kufijve të vendit. Në fazën e parë, divizioni pati humbje të rënda dhe avancoi shumë pak në territorin e partizanëve. Unë nuk isha aspak i lumtur për

formimin e këtij divizioni, por kjo nuk e shqetësonte qeverinë shqiptare, sepse shpresonte se ky në të ardhmen do të shërbente si bazë për një ushtri dhe forca policore të stërvitura mirë. Shtabi i divizionit ishte në Prizren. Unë e pengova angazhimin e tij në zonën e Mitrovicës së Kosovës që mbeti në kuadrin e Serbisë për arsye se kisha frikë se do të provokonte ekseksion ndaj popullsisë serbe. Serbët dhe shqiptarët nuk kanë ndonjë dashuri të madhe për njëri-tjetrin. Hermann Neubacher, Sonderauftrag Südost 1940-1945. Bericht eines fliegenden Diplomaten, Musterschmidt



Hermann Neubacher (1893 - 1960) ishte politikan austriak nazist i cili mbajti disa poste diplomatike në Rajhun e Tretë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, u emërua si zyrtari kryesor gjerman për Ballkanin. Ndër të tjera, pas kapitullimit italian në vitin 1943, u ngarkua nga Hitleri për të krijuar Shqipërinë e Madhe të "pavarur", në të cilën përfshihej edhe Kosova. Pas luftës, Neubacher u gjykua në Jugosllavi dhe në vitin 1946 një gjykatë ushtarake në Beograd e dënoi atë me 20 vjet burg. Ai u lirua nga burgu në vitin 1951. Pasi u kthye në Austri, ai shkroi një libër të titulluar *Sonderauftrag Südost 1940-1945 (Rend i veçantë Juglindor 1940-1945)* në të cilin përshkruan punën e tij në Ballkan dhe shpreh simpatinë për kombin dhe politikanët shqiptarë. Gjithashtu, ka punuar si konstruktor në Salzburg dhe nga viti 1954 deri në vitin 1956 mbajti postin e këshilltarit të perandorit Haile Selasie të Etiopisë. Ai vdiq në Vjenë.

¹⁴ Milan Nedić (1877-1946) ishte politikan dhe gjeneral serb. Gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte shefi i shtabit të përgjithshëm të ushtrisë jugosllave, ministër i luftës në qeverinë mbretërore jugosllave dhe kryeministër i një qeverie kukull serbe që kontrollohej prej gjermanëve, e themeluar për të qetësuar rezistencën serbe. Sipas Nedić, qëllimi i tij ishte "të ruante thelbin e popullit serb", i cili ishte i pushtuar dhe i rrethuar nga armiqtë. Pushtuesit gjermanë nuk kishin aspak respekt për autoritetin e tij ose të serbëve dhe gjatë luftës vazhduan me reprezaljet dhe me masakrat. Nedić mbështeti fshehurazi lëvizjen çetnike të udhëhequr nga Draža Mihailović. Pas luftës ai u burgos dhe mendohet që në vitin 1946 ka kryer vetëvrasje duke u hedhur papritmas nga dritarja (sipas disa dëshmitarëve, ai është vrarë).

¹⁵ Xhafer Ibrahim Deva (1904-1978) lindi në Mitrovicë, në provincën e Kosovës të Perandorisë Osmane dhe u arsimua në Stamboll dhe në Vjenë për inxhinieri. Ai ishte figurë kryesore politike në Kosovën e pushtuar. Ai punoi me Ballin Kombëtar - Frontin Kombëtar (një strukturë nacionaliste, antikomuniste dhe bashkëpunëtoare, e themeluar në nëntor të vitit 1942) dhe me gjermanët për të krijuar një shtet shqiptar pro-gjerman ku do të përfshihej edhe Kosova. Ai pati lidhje të ngushta me Hermann Neubacherin. Pas kapitullimit të Italisë, vazhdoi bashkëpunimin me gjermanët. Deva, së bashku me disa politikanë të tjerë shqiptarë (p.sh: Bedri Pejani) dhe me ndihmën e gjermanëve, krijoi *Lidhjen e Dytë të Prizrenit*, me qëllim mbrojtjen e të ashtuquajturës Shqipëri e Madhe, bazuar në rrethanat e reja që ishin krijuar. Ai gjithashtu ndihmoi në ngritjen e një Komiteti Kombëtar me udhëheqës shqiptarë nga Shqipëria dhe Kosova, që me ndihmën e Neubauer shpallën Shqipërinë e pavarur dhe ngritën qeverinë në Tiranë. Deva u emërua Ministër i Brendshëm. Në fund të luftës në Ballkan u përfshi në përpjekje për të ngritur një qeveri antikomuniste në Kosovë. Gjermanët e mbështetën atë me armë dhe municione, por kjo qeveri nuk dha rezultate. Në fillim Deva u largua për në Kroaci dhe më pas për në Vjenë. Pas luftës ai jetoi në vende të ndryshme, ka punuar për CIA-n në Itali dhe në vitin 1956 emigroi në SHBA. Ai vdiq në Kaliforni në vitin 1978.

I-17. Raporti i Sekretarit të Komitetit Rajonal të Partisë Komuniste Jugosllave për Kosovën dhe Metohinë drejtuar Komitetit Qendror për situatën ushtarake dhe politike dhe për situatën e organizimit të partisë në rajon, më 21 gusht 1942.

Drejtuar: Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave

21 gusht 1942

Të dashur shokë,
[...]

Shqiptarët përbëjnë 70% të popullsisë në Kosovë dhe në Metohi. Ata janë mashtruar nga forcat pushtuese, menjëherë mbas mbërritjes së tyre këtu. Ata krijuan "Shqipërinë e Madhe". Hapën shkolla në gjuhën shqipe, flitet për krijimin e qeverisë së tyre, e gjëra të tjera. Ata janë *Kulakë* dhe fermerë të nivelit të mesëm. E gjithë kjo i ka bërë shqiptarët të besojnë se kanë fituar lirinë (kjo është edhe arsyeja pse sulmuan Malin e Zi vitin e kaluar). Ata i thurin lavde Hitlerit, por zhvillimet ndërkombëtare, mposhtja e gjermanëve, betejat në Jugosllavi, shpirti luftarak dhe antifashist në Shqipëri, demaskimi i propagandës fashiste, restaurimi i pronave të bejlerëve dhe spekulimet tashmë famëkeqe, bënë që ky popull, (veçanërisht të varfërit) të ndryshojnë mendje aty nga fundi i vitit 1941.

Pati një dorëheqje nga ana e Kosovës ndaj qeverisë së Nediçit. Më parë, të gjithë ishin të gatshëm të shkonin në Frontin Lindor, por sot ata nuk do të dëgjojnë të shkojnë askund përtej territorit të tyre. U tremben ngjarjeve të ardhshme sepse kanë frikë nga hakmarrja. Ky moment, gjithashtu, ka ndikuar që ata të besojnë në propagandën e *kolonës së pestë*. Një tipar karakteristik i këtij rajoni është se deri më sot, forcat pushtuese kanë dështuar të vendosin regjimin e racioneve dhe përvetësimin e ushqimit me forcë (nga fshatarët). Ata u përpoqën, por pasi dështuan, hoqën dorë. Të gjitha prodhimet mund të blihen në tregjet e perimeve. Siç e theksuam në rezolutën e shpallur pas konsultimeve të Komitetit Rajonal në korrik të vitit 1942, do të dëshironim të vinim në dukje se në përgjithësi populli shqiptar është i lëkundur midis forcave reaksionare dhe luftës Nacional Çlirimtare.

Komunistët duhet të bëjnë një punë të madhe në rritjen e ndërgjegjësimit, me anë të fushatave dhe me agjitacion e propagandë, për t'i orientuar drejt luftës Nacional Çlirimtare. Por ka një moment të rrezikshëm; reaksionarët e "Shqipërisë së Madhe" mund të mobilizojnë sot shqiptarët rreth çështjes së mbrojtjes së Shqipërisë. Sot ata kanë 4000-5000 vullnetarë.

Ndikimi i ideologjisë së *kolonës së pestë* bazuar në lidhjet e saj me forcat pushtuese është i madh, sepse ajo mbështetet mbi terrorin dhe frikën. Ndikimi i Partisë Komuniste është i dobët ose nuk ekziston aspak.

Rreth nesh: ndikimi dhe reputacioni i partisë u rrit në vendet ku partia ndër morri fushata agjitacioni dhe propagande (Pejë) ose pranë vendeve ku luftuan partizanët (Mitrovicë, Podujevë). Serbët dhe malazeztë janë pro Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike dhe luftës Nacional Çlirimtare. Ndikimi ideologjisë së *Kolonës së Pestë* atje është i papërfillshëm ose nuk ekziston. Shumica dërmuese e masave është nën ndikimin e Partisë Komuniste Jugosllave.

Kolona e Pestë shqiptare është duke u fuqizuar. Gëzon mbështetjen e kulakëve dhe klasës së mesme. Në gjirin e saj ka mjaft elementë tepër të komprometuar (Sefedin Beu, Iliaz Agus ministër në qeverinë e Mustafa Krujës, Ferhad Draga, Xhafer Deva e të tjerë). Ata kishin shërbyer në të gjitha regjimet e mëparëshme në Jugosllavi. Ekzistojnë disa fraksione të ndryshme në forcat reaksionare serbe, por tashmë ato janë të gjitha të bashkuara nën flamurin e Drazhës [udhëheqësit çetnik, Dragosllav Mihailoviç]. Kohët e fundit janë shumë aktivë duke nxitur urrejtje shoviniste, fushata për masakrimin e shqiptarëve kur të vijë koha, duke sulmuar pa mëshirë komunistët dhe partizanët. Ata kanë krijuar komanda por nuk kanë ushtri.

Edhe këtu vazhdon procesi i bashkimit. Forcat pushtuese janë duke u përpjekur për ta arritur atë. Ata po përpiqen të shkaktojnë konflikte në popull (kohët e fundit ata kanë vrarë serbë). Njerëzit e Drazhës kanë lidhje me bejlerët. Çetnikët në Pejë kanë marrë pushkët dhe ka katër muaj që arrestojnë malazeztë. Mustafa Kruja dhe Kol Biba, ministër i partisë fashiste, kanë etiketuar komunistët si armikun kryesor gjatë fushatave të tyre.

http://www.znaci.net/00001/4_1_19.pdf

I-18. Përfaqësuesi ushtarak kroat në Sofje rreth situatës në Maqedoni

[...] Marrëdhëniet midis bullgarëve dhe gjermanëve janë të mira. Pak kohë më parë ndodhi një incident me karakter politik, në një klub nate në Shkup dhe aty ndërhyjnë disa oficerë gjermanë. Në këtë klub, grupi muzikor luajti himnin maqedonas, të cilin një oficer bullgar me gradë të ulët e duartrokiti. Më pas, një oficer bullgar i një grade më të lartë iu afrua dhe e pyeti përse po duartrokiste dhe ai iu përgjigj: “Ç’është maqedonase, është edhe bullgare”. Pas këtyre fjalëve, oficeri bullgar e qëlloi me pëllëmbë. Ky veprim u vu re nga disa oficerë gjermanë, të cilët ishin ulur në po të njëjtin klub dhe e pyetën oficerin bullgar përse e qëlloi oficerin tjetër. Ai nuk u përgjigj, por u largua nga klubi. Oficerët gjermanë e ndoqën jashtë klubit dhe e rrahën. Ky incident shkaktoi një farë pakënaqësie për të gjithë ata që gjendeshin në klub dhe që e duan Maqedoninë [...]

Dokumenti za borbata na makedonskiot narod za samostojnost i nacionalna država, f. 308-9.

🔑 Ky fragment është shkëputur nga një raport më i gjatë rreth situatës në Maqedoninë e pushtuar, përgatitur nga përfaqësuesi ushtarak i Ministrisë së Mbrojtjes të SHPK-së, në Sofje. Kjo histori, disi e çuditshme, tregon disa aspekte të marrëdhënieve ndërmjet ushtarakëve bullgarë dhe gjermanë në Maqedoninë e Vardarit, që në atë kohë, zyrtarisht ishte territor bullgar.

❓ Përshkruani marrëdhëniet midis ushtarakëve gjermanë dhe bullgarë në Maqedoni.

► Fig. 4. Zëvendësimi i ushtrisë gjermane me atë bullgare, pas pushtimit fashist të Maqedonisë Jugosllave (prill 1941)



I-19 dhe I-20.

Deklaratë (trakt) e Frontit Nacional Çlirimtar (EAM) (Komiteti i Sterea Elladas) DEKLARATË Popullit të Rumelisë

Vëllezër,
Organizata EDES hoqi maskën dhe tregoi fytyrën e saj të vërtetë. Fraksione të kësaj organizate sulmuan turpshëm, pas shpine, forcat tona në Epir dhe kapën anëtarë të Frontit Nacional Çlirimtar, pa u provokuar prej tyre. Qëllimi është i qartë: në bashkëpunim me aleatët e tyre gjermanë [...], të shpërbëjnë Frontin Nacional Çlirimtar, organizatën nismëtare, që lufton për çlirimin e Greqisë. Vëllezër,

Ne e njihnim organizatën EDES, e dinim që ajo bashkëpunon me tradhtarët e poshtër [...]. Ne e dinim qëllimin e tyre: të masakronin Greqinë, të shkatërronin lëvizjen nacional çlirimtare, të nënshtronin popullin grek dhe të vendosnin një regjim diktatorial. Të gjitha këto i dinim. Megjithatë, ne bëmë ç’ishte e mundur për të ruajtur paqen, sepse kjo ishte në interes të popullit grek – sepse kjo kërkohej nga lufta për liri. Por tani që organizata EDES po bashkëpunon hapur me gjermanët [...], tani që ata organizojnë operacione të përbashkëta kundër popullit grek, në mënyrë që ta masakrojnë atë dhe të përçajnë luftën e tij për liri, në emër të interesave të këtij populli shpallim që do t’i thyejmë dhe s’do t’i lejojmë që të dëmtojnë qëllimin e madh që populli grek i ka vënë vetes, çlirimin, për të cilin ai ka dhënë dhe vazhdon të japë gjakun e tij.

Vëllezër,
Kini besim të plotë tek EAM–ELAS-i. Hyni në radhët e saj. Vetëm EAM-i lindi nga populli dhe lufton për popullin.

U bëjmë thirrje të gjithë atyre që mund të kenë shkuar në rrugë të gabuar, pas organizatës EDES, që të hapin sytë dhe të bashkohen me ne, në luftën e shenjtë për LIRI. Rroftë EAM-i! Rroftë ELAS-i!

Vdekje pushtuesve, tradhtarëve dhe vrasësve të kombit!

KOMITETI i EAM-it për STEREA HELLAS-in

Fleischer, Stemma kai svastika, 2, f. 229.

Deklaratë (trakt) e Bashkimit Demokratik Kombëtar Grek (EDES), 1943

BASHKIMI DEMOKRATIK KOMBËTAR GREK [EDES]

DEKLARATË

Partia Komuniste, që po e flijon vendin, që me mjeshtëri dhe dinakëri ka përvetësuar traditat e tij të shenjta, që pa qenë nevoja, ka shkaktuar viktima pas viktimash, që ka organizuar vrasje dhe akte terroriste kudo, që ka marrë me forcë para nga qytetarët, që ka shfrytëzuar gjithkënd dhe gjithçka, tashmë po i kalon të gjitha kufijtë e fyerjeve dhe turpit, duke guxuar të akuzojë EDES-in, se ajo përbëhet nga gjermanofilë, agentë gestapoje dhe vrasës!!! [...]

EDES-i qëndron shumë lart dhe kjo shpifje e ulët nuk e cenon atë. EDES-i ka në radhët e saj të gjithë krenarinë e ushtrisë moderne greke, të gjitha figurat politike të moralshme dhe çdo element përparimtar në vend.

Parulla e EDES-it është Demokracia Socialpopullore, dhe këtë parullë e mban lart dhe me vendosmëri, dhe do të vazhdojë ta mbajë derisa Demokracia Socialpopullore të vendoset dhe të kthehet në burim lumturie për të gjithë grekët.

EDES-i mban pishtarin e shpirtit patriotik të vërtetë. Rrënjët e tij dhe tradita e hershme, historia vetjake e anëtarëve të tij e bëjnë armik të betuar të të gjithë armiqve të Greqisë dhe ujqërve gjakpirës nga Sofja. [...]

Demokratë dhe patriotë grekë!

Qëndroni larg tradhtarëve dhe shpifësve!

Larg atyre që duan të helmojnë gëzimin e çlirimt tonë. Larg atyre që kundërshtojnë Epirin e Veriut të përgjakur dhe atyre që vazhdojnë të flirtojnë me arinjët e Bullgarisë. Larg nga armiqtë e paqes dhe lumturisë suaj. Me një fjalë, larg nga Partia Komuniste. Bashkohuni me EDES-in, Arkën e Noes së pastërtisë dhe lartësisë. Bashkohuni me EDES-in, valën e fuqishme të baticës së vërtetë të Fuqisë Popullore.

EDES

Fleischer, *Stemma kai svastika*, 2, f. 230.



Në fillim të qershorit të vitit 1941, e gjithë Greqia ishte nën pushtimin e trefishtë të Gjermanisë, Italisë dhe Bullgarisë. Gjermanët vendosën një regjim të ashpër pushtimi, duke grabitur burimet bujqësore dhe industriale të Greqisë dhe kërkuan që të paguante për shpenzimet e pushtimit. Një periudhë urie shkatërruese, që shkaktoi me dhjetëra mijëra viktima, pasoi pushtimin gjatë dimrit të vitit 1941-1942. Në shtator të vitit 1941, Partia Komuniste nisi të krijojë Frontin Nacional Çlirimtar (EAM). Ky front shpalli dy qëllime: organizimin e qëndresës dhe një zgjedhje të lirë për formën e qeverisjes, pas çlirimit përfundimtar të Greqisë. Në krijimin e EAM-it morën pjesë edhe grupime të vogla, si ai agrar dhe socialist. Pak pas formimit të EAM-it u krijua edhe një forcë e armatosur (ELAS). Paaftësia e "botës politike" tradicionale për t'i ofruar vendit udhëheqje vijoi edhe pas pushtimit të Greqisë. Boshllëku politik që u krijua gjatë diktaturës së Metaksasit, u thellua edhe më shumë, sepse një pjesë e madhe e udhëheqësve liberalë të vendit ishin në mërgim. Komunistët, që kishin qenë një forcë e parëndësishme në periudhën midis dy luftërave, shpejtuan të plotësonin këtë boshllëk. Ata ofruan vizionin e një të ardhmeje më të mirë dhe më të drejtë. Ata jo vetëm që u kishin mbijetuar persekutimeve të mëparshme, sidomos nën diktaturën e Metaksasit, por kishin fituar përvojë dhe aftësi për të vepruar në fshehtësi. Megjithëse udhëheqësit e partisë mbajtën role drejtuese në EAM dhe në ELAS, pjesa më e madhe e anëtarëve të tyre nuk ishin komunistë. Gjithashtu u krijuan edhe një numër grupesh të rezistencës jokomuniste, nga të cilët më i rëndësishmi ishte Bashkimi Nacional Demokratik Grek (EDES), i ngritur nga ish-oficerë liberalë. Në vitin 1943, një pjesë e madhe e zonave malore ishin nën kontrollin e forcave të rezistencës.



Krahasoni dy burimet e mësipërme. Cilat ideologji përfaqësojnë këto dy deklarata? Ç'argumente përdorin ato? A mendoni se të bashkohesh me njërin krah, ishte thjesht çështje ideologjie? A ishte e lehtë, për pjesën më të madhe të popullsisë, që ta bënte këtë zgjedhje (duke patur parasysh mesataren e nivelit të arsimit të popullsisë në atë kohë)?

► **Fig. 5. Fotografi e partizanëve (burra dhe gra) të rezistencës së majtë në Greqi**



Muzeu i Luftës, Athinë, Koleksioni Britanik (Istoria, vëll. 16, f. 16).



Forca të ELAS-it në marshim. Me EAM/ELAS-in u bashkua një numër i madh njerëzish që donin të luftonin pushtuesin. Kjo ishte organizata më e rëndësishme që luftoi kundër forcave pushtuese në Greqi, përgjatë gjithë periudhës së pushtimit nga Forcat e Boshtit.

I-21. Proklamata e Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovën dhe Metohinë¹⁶, më 1 tetor 1941, drejtuar popujve të kësaj krahine në lidhje me luftën e përbashkët kundër okupatorit dhe shërbëtorëve të tij

POPUJ TË KOSOVËS DHE METOHISË: SHQIPTARË, SERBË, MALAZEZË DHE TË TJERË!

Popujt e Kosovës dhe të Metohisë u goditën në mënyrë të veçantë pas ardhjes së forcave okupatore. Ata iu nënshtruan terrorit, plaçkitjes, burgosjes dhe vrasjes së egër. Okupatori dhe shërbëtorët e tij përhapin urrejtje shoviniste dhe fetare ndërmjet popujve në mënyrë që ata më lehtë t'i plaçkisë dhe t'i mbajë në robëri, duke dobësuar luftën

nacionalçlirimtare. Për këtë arsye, popujt të Kosovës dhe Metohisë, për çlirimin tuaj të vërtetë kombëtar, para jush shtrohet detyra e luftës së përgjithshme dhe aksioneve të përbashkëta, që së bashku me popujt e tjerë të Jugosllavisë ta dëboni armikun e përbashkët - okupatorin fashist.

SHQIPTARË: PUNËTORË, FSHATARË DHE QYTETARË!

Okupatori fashist gjermano-italian përmes shërbëtorëve të vet bejlerë dhe agallarë, tradhëtarë të popullit shqiptar, e ka njoollur emrin tuaj. Ju u keni zënë besë se duke djegur, vvarë dhe dëbuar kolonistët e mjerë do të arrini lirinë tuaj kombëtare, ashtu vepruat dhe i shërbuyet fashizmit. Po çka ju dha okupatori fashist për këtë? Ju dha të ashtuquajturën "Shqipërinë e madhe" në të cilën ju burgosin, rrahin, vrasin, përdhosin nderin e grave dhe bijave tuaja, ku mbretëron uria, papunësia, intrigat, shtrenjtësia dhe skamja e artikujve më të nevojshëm për jetesë, ku janë kthyer marrëdhëniet feudale me ç'rast fshatari është bërë përsëri skllav i agallaravë dhe bejlerëve.

PUNËTORË, FSHATARË, QYTETARË DHE RINI E KOSOVËS DHE METOHISË!

Në luftë! Në luftë kundër okupatori gjakatar fashist i cili përpiqet t'i shfarosë luftëtarët më të mirë të popullit, ta skllavërojë gjithë botën, ta ushtrojë sundimin më të egër që mban mend historia mbi popuj. Në luftë! Ka ardhur çasti vendimtar që, pa marrë parasysh kombësinë, fenë dhe përkatësinë politike, ta hedhim poshtë zgjedhën fashiste. Në luftë, sepse këtë ia kemi borxh popullit sovjetik i cili, lufton për lirinë tonë. Në luftë, në betejën e fundit për zhdukjen e epidemisë fashiste!

1. X. 1941, Partia Komuniste e Jugosllavisë, Komiteti Regjional i Kosovës dhe Metohisë

http://www.znaci.net/00001/4_1_19.pdf

¹⁶ Në dokumentat serbe kjo krahinë emërtohet "Kosova dhe Metohija", ndërsa në dokumentat shqiptare "Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit". Në Rrafshin e Dukagjinit përfshihen qytetet e Pejës, Istogut, Klinës, Deçanit, Gjakovës, Prizrenit, Rahovecit, Suharekës dhe Sharrit (Dragashit).

I-22. Vendim i komitetit krahinor të Partisë Komuniste Jugosllave për Malin e Zi, Bokën dhe Sanxhakun, për fillimin e një kryengritjeje të armatosur, 8 korrik 1941

- Të krijohen çeta guerrile prej grupeve të armatosura dhe këto të nisin menjëherë sulmet kundër armikut.
- Të shkatërrohen postat e karabinierëve dhe zyrat e taksave nëpër fshatra. Të sulmohen autokolonat armike dhe të shkatërrohen linjat e komunikimit të tyre, si dhe të digjen të gjitha postat e xhandarmërisë.
- Të gjitha aksionet të përgatiten në fshehtësi dhe të kryhen sulme të befasishme.
- Ushtarët italianë të zënë rob të lirohen, ndërsa komandantët e tyre të dërgohen në komanda ose në shtabe.
- Komitetet lokale dhe rajonale të PKJ-së të drejtojnë këto aksione nëpërmjet shtabeve ushtarake, të cilat duhet të përbëhen nga anëtarët më të spikatur të partisë dhe prej oficerëve.

Stanišić, 2005.



Në frymën e vendimeve të marra nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Jugosllave (PKJ-së), në mbledhjen e Politbyrosë të mbajtur në Beograd, në 4 korrik 1941, në lidhje me fillimin e një lufte të armatosur kundër forcave pushtuese, Komitetit Rajonal i PKJ-së për Malin e Zi, Bokën dhe Sanxhakun mbajti një takim më datë 8 korrik 1941 në Stijena Piperska të Podgoricës. Në këtë takim mori pjesë përfaqësuesi i Komitetit Krahinor të PKJ-së, Blazho Jovanoviçi, si dhe anëtarët e Komitetit Rajonal të PKJ-së, Radoje Dakiçi, Savo Bërkoviçi, Budo Tomoviçi, Vido Uskokoviçi, Kërsto Popivoda dhe Perisha Vujosheviçi. Ata njëzëri mbështetën vendimet e Komitetit Qendror të PKJ-së për fillimin e luftës së armatosur.



Përse të gjitha aksionet duhet të kryeshin si sulme të befasishme? Sipas mendimit tuaj, përse duhej që ushtarët italianë të liheshin të lirë? A bëhej kjo thjesht për humanizëm apo...?

I-23. Kuvendi i Petrovdanit

Pasi ushtria italiane pushtoi Malin e Zi, një pjesë e *Partisë malazeze*, e cila ishte e grupuar rreth dr.

Sekula Dërljeviçi, mbajti një konferencë në Cetinë në 12 korrik 1941. Kjo konferencë u quajt *Kuvendi i Ditës së Shën Pjetrit*, sipas emrit të festës ortodokse që festohet në atë datë. Qëllimi kryesor i kësaj konference ishte rishpallja e pavarësisë së Malit të Zi, nën mbrojtjen italiane. Pjesë e shkëputur nga fjala e dr. Sekula Dërljeviçi, mbajtur në Kuvendin e Ditës së Shën Pjetrit:

“Kombi malazez është krenar që vendosja e pavarësisë së Malit të Zi lidhet me Duçen e pavdekshëm, themeluesin gjenial të Perandorisë Fashiste, si dhe me arritjet e ushtrisë së lavdishme fitimtare italiane. Në mënyrë të veçantë do të theksoja që qysh në fillim, Duçja luftoi kundër padrejtësisë që iu bë Malit të Zi, kur atij iu mohua ekzistenca si shtet dhe, që nga ajo kohë, ai nuk ka reshtur së luftuari me shpatën e tij fitimtare kundër kësaj padrejtësie, deri sa u arrit shpallja e pavarësisë së Malit të Zi... I bëj thirrje këtij kuvendi që të dëgjojë deklaratën dhe ta miratojë atë njëzëri.”

Zëri i malazezëve (Glas Crnogorca), organ i Këshillit të Lartë italian për Malin e Zi, botim nr. 9, 13 korrik, 1941, f. 1.

I-24. Deklarata e miratuar njëzëri në Kuvendin e Ditës së Shën Pjetrit

“Në emër të popullit malazez dhe si përfaqësues i vërtetë i dëshirës dhe vullnetit të tij, kuvendi malazez që u mbledh në Cetinë ditën e Shën Pjetrit, më 12 korrik 1941, shpall se:

I. Pushtimi i Malit të Zi prej Serbisë, të cilin e ashtuquajtura Asembleja e Madhe Popullore e Podgoricës e miratoi me vendimin e saj të 26 nëntorit 1918, kundër dëshirës së popullit malazez, tashmë merr fund.


II. Regjimi i vendosur në Malin e Zi prej mbretërisë së dikurshme jugosllave dhe dinastisë së Karagjeorgjeviçëve nuk është më në fuqi. Kushtetuta e Ditës së Shën Vitut dhe Kushtetuta e 3 shtatorit 1931, të miratuara prej këtij regjimi, që nga ky çast pushojnë së funksionuari.

III. Sot shpallim shtetin sovran dhe të pavarur të Malit të Zi, si monarki kushtetuese.

IV. Nëpërmjet këtij kuvendi shpallim se të gjithë malazezët – mirënjohës ndaj forcave të ushtrisë fashiste, falë të cilave u çlirua atdheu i tyre, dhe në nderim të lidhjeve të ngushta që dinastia Petroviçi

Njegosh ka me familjen mbretërore italiane, dhe me bindjen e plotë se Duçja dhe Italia fashiste kudo dhe kurdoherë kanë ringjallur dhe rindërtuar – vendosën të bashkojnë jetën dhe fatin e Malit të Zi me atë të Italisë dhe të vendosin solidaritet të ngushtë me të. Marrëveshja, që do të nënshkruhet së shpejti ndërmjet Malit të Zi dhe Italisë, do të mbizotërohet nga fryma e solidaritetit dhe e mirëkuptimit për futjen e Malit të Zi në sferën e veprimit të Romës. V. Duke qenë se mungon një pushtet suprem, pra kreu i shtetit, kuvendi malazez vendosi të krijojë një regjencë mbretërore dhe t'i kërkojë madhërisë së tij, mbretit dhe carit italian, që të ketë mirësinë të caktojë regjentin për *Mbretërinë e Malit të Zi*, i cili më pas do të shpallë Kushtetutën."

Zëri i malazezëve, (Glas Crnogorca), organ i Këshillit të Lartë italian për Malin e Zi, botim nr. 9, 13 korrik, 1941, f. 2.

 Çfarë cilësish i atribuon Sekula Dërljeviçi, Duçës, dhe për çfarë e falenderon atë? Në cilin paragraf të deklaratës shpallet pavarësia e Malit të Zi? Cilës ngjarje i referohet "pushtimi i Malit të Zi prej Serbisë" në paragrafin e parë të deklaratës? Cili paragraf është krejtësisht në kundërshtim me të? Jepni shpjegime.

I-25, I-26 dhe I-27.

Nga ditari i një komandanti partizan jugosllav

1 nëntor 1941

Pak netë më parë shpërthyen luftimet kundër 500 çetnikëve të çetave të Drazha Mihailloviçit. Ata u mundën dhe 140 prej tyre u arrestuan. Forcat tona kanë shkatërruar çetnikët në Pozhega. Në këto luftime, partizanët pësuan humbje të mëdha. Komandanti i batalionit, shoku Kapelan, u vra së bashku me dy komandantë kompanish dhe shumë partizanë të tjerë. (...)

Ja pra, po ndodh që, në vend që të luftojmë kundër agresorëve fashistë, po luftojmë kundër vëllezërve tanë; në vend që të derdhim gjakun e armikut, po vritemi me njëri-tjetrin. Në vend që njerëzit e Drazha Mihailloviçit të kapin kamionët e armikut dhe t'i plaçkisin ato, ata kapin kamionët tanë dhe plaçkisin atë që populli serb ka mbledhur me mund

për t'ia dhënë luftës popullore; në vend që të ndjekin gjermanët dhe t'i vrasin, ata ndjekin njerëzit tanë dhe u zënë atyre pusi.

Dudić, f. 230, 231.

Pjesë nga protokollin e takimit të D. Mihailloviçit me përfaqësuesit e komandës gjermane në Serbi, në fshatin Divçi

11 nëntor 1941

Drazha Mihailloviçi: Si ushtarak, nuk më vjen turp të jem nacionalist. Si i tillë, unë kërkoj vetëm që t'i shërbej popullit tim. Për këtë arsye, nuk jam në krahun e atyre që duan të largojnë gjermanët nga vendi; por duke patur parasysh forcat e pakta gjermane në vend, nuk do të lejoj që Serbia të bëhet komuniste. Lufta ka filluar me disa oficerë me grada dhe pa grada, por ata përbëjnë një numër të vogël. Detyra jonë si ushtarakë është që të mos dorëzohemi deri në fund. Kështu që ne s'mund të na kritikojnë përse nuk dorëzohemi.

...Lufta kundër pushtuesve ishte një e keqe e nevojshme, në mënyrë që të parandalonim masat e popullit të bashkoheshin me komunistët. Për mua si ushtarak, situata është shumë e qartë. Unë kurrë nuk do të ndërmerrija sulme, nëse s'do të kishin nisur sulmet komuniste dhe gjermanët s'do të kishin dorëzuar qytete dhe fshatra.

Branko Petranović, Momčilo Zečević, f. 529-530.

Fragment nga udhëzimet e Drazha Mihailloviçit për majorin Gjorgje Lashiç dhe kapitenin Pavle Gjurishiç:

20 dhjetor 1941

...Qëllimi i çetave tona është:

Lufta për çlirimin e të gjithë kombit tonë, nën skeptrin e mbretit Petar II. Krijimi i Jugosllavisë së Madhe dhe brenda saj, i Serbisë së Madhe, etnikisht homogjene, në kufijtë e Serbisë - Malit të Zi - Bosnjës dhe Hercegovinës - Sirmiumit - Banatit dhe Backas. Lufta për të përfshirë në shtetin tonë të gjitha territoret sllave, që ende mbahen të pushtuara nga italianët dhe gjermanët (Trieste - Gorizia - Istria - Karinthia), si edhe Bullgarinë dhe veriun e Shqipërisë, duke përfshirë Shkodrën. Largimi nga territori i shtetit i të gjitha pakicave etnike dhe elementëve jokombëtarë. (...)

Nuk mund të ketë bashkëpunim me komunistët partizanë, sepse ata po luftojnë kundër familjes mbretërore dhe duan të bëjnë revolucion shoqëror. (...)

Mënyra e veprimit: shqiptarët, myslimanët dhe ustashët, në varësi të krimeve të urryera që kanë kryer ndaj popullit, do të gjykohen nga “Gjykata Popullore”; kroatët që ndodhen nën pushtimin italian, do të trajtohen në bazë të qëndrimit që kanë mbajtur.

Zbornik dokumenata i podataka o NOR naroda Jugoslavije, XIV, libri I, dok. nr. 34.

Key Këto tri burime hedhin dritë mbi rolin dhe pozicionin e çetnikëve, si dhe mbi marrëdhëniet e tyre me partizanët dhe gjermanët. Çetnikët udhëhiqeshin nga koloneli i ushtrisë së mundur jugosllave, Dragoljub Mihajloviçi. Në verë të vitit 1941, çetnikët dhe partizanët bashkëpunuan dhe arritën të çlirojnë disa qytete në Serbinë Perëndimore dhe Qendrore. Që në fillim, partizanët dhe çetat e Mihajloviçit patën konflikte rreth kontrollit të qyteteve që çlirojuan. Në fillim të nëntorit të vitit 1941, konflikti midis dy lëvizjeve u kthye në luftë civile. Luftëtarët në të dyja ushtritë mëtonin se ishin të vetmit luftëtarë të vërtetë kundër forcave pushtuese dhe që rivalët respektivë po bashkëpunonin me pushtuesit. Deri kur u zhvillua Konferenca e Teheranit, Aleatët i kishin konsideruar çetnikët si partnerë të tyre dhe vetëm pas kësaj, partizanët filluan të ndihmoheshin nga Aleatët.

? Çfarë shpjegimi i dha Mihajloviçi komandantit gjerman, lidhur me arsyen e sulmit çetnik kundër gjermanëve, në muajt e parë të pushtimit? Sipas mendimit tuaj, a i konsideronte ai partizanët si rrezik më të madh se gjermanët? Vini re qëndrimet dhe paragjykimet ndaj kombësive të tjera në tekstin I-27. Cilat pjesë të udhëzimeve janë, në fakt, ftesë për të kryer krime lufte?

► Fig. 6. Pllakat serb



Nikolić, f. 37.

Key Përkthim: Serbia është pjesë e Frontit Antikomunist.

I-28. Betimi i pjesëmarrësve në Konferencën e Ostrogut, 8 shkurt 1942

Në këtë vend ku edhe gjyshërit tanë janë betuar për hakmarrje dhe liri, ne, patriotët e Malit të Zi dhe Bokës, betohemi se do t'i qëndrojmë besnikë popullit tonë, i cili gjatë luftës së tij heroike për liri nxori heronj, poetë dhe shenjtorë, ngriti fortesat dhe manastiret tona – Ne betohemi se nuk do t'i lëshojmë armët deri sa të zhdukim çdo pushtues fashist, deri sa t'u sjellim fëmijëve tanë lumturinë e fitores, deri sa dielli të ndriçojë mbi varret e të parëve tanë.

*“Vëllezër, kushdo që tradhton këta heronj...
U mbuloftë me gjak,
Emri i tij i pagëzimit qoftë i mallkuar përjetë,
Qoftë i detyruar të qajë fëmijët e tij!...
Vëllezër, kushdo që tradhton këta heronj,
Zija i mbuloftë shtëpinë,
E kaloftë jetën në skamje dhe errësirë!”*

Lakić, f. 6.



Patriotë të shquar malazezë u mbledhën në Konferencën e Manastirit të Ostrogut, më 8 shkurt 1942. Gjashtëdhjetë e pesë delegatë, përfaqësues të të gjithë shtresave shoqërore, morën pjesë në punimet e konferencës. Përfaqësues nga të gjitha zonat e Malit të Zi u zgjedhën si anëtarë të Këshillit Nacional Çlirimtar për Malin e Zi. Gjatë punimeve të konferencës u vunë në dukje dy rreziqe që i kanoseshin popullsisë së Malit të Zi: shfaqja e lëvizjes çetnike, e cila rrezikonte unitetin e popullit në luftën kundër forcave pushtuese dhe uria, e cila kishte pllakosur popullsinë malazeze.

I-29. Bashkëpunim midis ustashëve dhe çetnikëve

Dëshmi e Savo Pregjasit

Nën trysninë e gjermanëve, udhëheqësit e ustashëve kanë filluar të ndryshojnë politikën e tyre ndaj popullsisë serbe në Bosnje dhe Hercegovinë. Për pushtuesit gjermanë ishte shumë e rëndësishme të ruanin paqen dhe të kishin mundësi të shfrytëzonin burimet natyrore e t'i përdornin ato për frontin. Për këtë, qeveria e Paveliçit ka marrë një sërë masash. Ata kanë përfshirë disa përfaqësues serbë në *Parlamentin e Shtetit Kroat*, kanë themeluar *Kishën Ortodokse Kroate* dhe disa rekrutëve të rinj serbë iu bë thirrje të hyjnë në ushtrinë kroate. Udhëheqësit e ustashëve kanë pranuar politikën e bashkëpunimit me çetnikët. Në Ozren dhe Trebava

u arritën marrëveshjet e para mes komandantëve çetnikë dhe autoriteteve të Shtetit të Pavarur Kroat (SHPK). Me anë të kësaj marrëveshjeje, çetnikët njohën SHPK-në dhe kanë shprehur besnikërinë e tyre ndaj kreut të shtetit kroat. Të gjitha veprimet luftarake ndaj autoriteteve ushtarake dhe civile të SHPK-së u ndërpre, dhe kështu do të veprohet në të gjitha territoret ku ka çeta çetnikësh. Në mënyrë që të zhvillojnë një luftë të përbashkët kundër partizanëve, çetnikët do të mbajnë formacionet e tyre ushtarake, armët dhe udhëheqësit e tyre, dhe në veprimet kundër partizanëve, do të mbështeten nga njësitë luftarake të SHPK-së. Çetnikët e plagosur do të mjekohen në spitalet ushtarake të SHPK-së.

Albahari et al, f. 398-399.



Megjithëse forcat e Shtetit të Pavarur Kroat ishin në gjendje lufte me përfaqësuesit e ultranacionalistëve serbë (çetnikët), çka gjatë vitit 1942 solli një numër të madh viktimash mes civilëve të pafajshëm, nën trysinë gjermane, nacionalistët kroatë dhe serbë u bashkuan për të luftuar kundër komunistëve.



Çfarë i bëri armiq të (çetnikët dhe ustashët) të bashkëpunonin me njëri-tjetrin? Sipas mendimit tuaj, a ishte trysnia e ushtruar nga gjermanët e vetmja arsye?

I-30. Fillimet e lëvizjes në Bosnjë

*Dëshmi nga Zharko Zgonjanini*¹⁷

Ne ishim entuziastë për krijimin e grupit të parë partizan dhe shumë të kënaqur me zhvillimin e përpjekjeve tona, por, papritur, pati një ndryshim të gjendjes në të gjithë Kozarën¹⁸. Midis datës 28 dhe 30 korrik¹⁹ u shfaqën shumë të dërguar të mirinformuar, që shpërndanë lajmin për fillimin e një kryengritjeje dhe se çdokush duhej të bashkohej me të.

¹⁷ Zharko Zgonjanini ishte serb i Bosnjës, lindi afër Prijedorit (në Bosnjën Veriperëndimore) në vitin 1916. Ai ishte një nga organizatorët e kryengritjes në malin Kozara dhe në krahinën Bosanska, në vitin 1941. Pas Luftës së Dytë Botërore, ishte një nga drejtuesit e policisë së shtetit në Bosnjë dhe Hercegovinë. Vdiq në Zagreb, në vitin 1970.

¹⁸ Mal në Bosnjën Veriperëndimore.

¹⁹ 1941.

Rebelët nga rajoni i Dubicas²⁰, ndoshta me nismën e tyre, kishin sulmuar dhe shkatërruar postën e policisë në Knjezica. Ky ndodhet afërsisht në qendër të Kozarës dhe kështu, fjala që kryengritja kishte filluar, u përhap në të gjithë malësinë. Ne na u ngarkua detyra që t'u themi njerëzve se duhet të kthehen nëpër shtëpitë e tyre, derisa të pyesim udhëheqjen²¹ çdo të bëhet më tej. Disa prej tyre pranuan, disa të tjerë jo. Shkova atje dhe gjeta Shoshën²². I tregova rreth situatës së tanishme dhe e pyeta nëse kishte ndonjë udhëzim të ri. Shosha m'u përgjigj se as ai nuk e dinte se çfarë po ndodhte. Populli ishte ngritur në këmbë dhe kishte filluar të qëllonte nga të gjitha krahët.

Albahari et al, f. 101.



Pas Luftës së Dytë Botërore, autoritetet komuniste ngulnin këmbë që kryengritja kishte filluar si një lëvizje e cila ishte frymëzuar vetëm nga Partia Komuniste Jugosllave. Megjithatë, ky burim tregon se rebelimi ishte frymëzuar, gjithashtu, prej instinktit të mbijetesës.



Përse udhëheqësit partizanë të Kozarës i këshilluan njerëzit të ktheheshin nëpër shtëpi dhe të qëndronin atje derisa të konsultoheshin dhe të vendosnin me udhëheqjen mbi atë që duhej bërë? Përse ishte e rëndësishme që kryengritjen ta organizonin ata (komunistët)? Gjithashtu, përse interpretimi i ngjarjes historike nganjëherë ndryshon nga vetë ngjarja?

I-31. Krijimi i Divizionit eses [SS] "Hanxhar"²³ në Bosnjë²⁴

Dëshmi nga Xhemal Bijediçi²⁵

Kjo është periudha kur armiku po zhvillon një veprimtari të gjerë propagandistike për mobilizimin

e njerëzve në Sarajevë, me qëllim që të krijojë Divizionin XIII SS, të quajtur "Hanxhar". Kjo është arsyeja përse agjenti gjerman, El Huseini, udhëheqës fetar palestinez, ka ardhur në Sarajevë. Ai ka vendosur kontakte me grupin e myslimanëve reaksionarë. Kemi patur njoftime rreth çështjeve që janë diskutuar, sepse një nga njerëzit tanë të infiltruar ka qenë i pranishëm në takimet e tyre. El Huseini ka ngulmuar që myslimanët duhet të japin kontributin e tyre në fitoren e gjermanëve dhe kishte ndërmend të krijonte divizionin special eses të sipërpërmendur, Divizionin SS "Hanxhar" dhe më pas, edhe një divizion tjetër. Pjesa më reaksionare e myslimanëve, e orientuar drejt Shtetit të Pavarur të Kroacisë dhe Gjermanisë, beson se një divizion i tillë mund të jetë forca e aftë për të përmbushur interesat myslimanë. Duke shfrytëzuar gjendjen tashmë tejet të rëndë të refugjatëve myslimanë, armiku ka arritur që të përfshijë një numër të madh (refugjatësh) në këtë divizion eses. Divizioni SS "Hanxhar" ishte i organizuar dhe kishte numër të njëjtë trupash me njësitë e tjera gjermane. Nazistët e çuan divizionin për t'u stërvitur në Francë dhe Gjermani. Në fillim të vitit 1944, kjo njësi arriti, së pari në Srem, dhe më pas në pjesën lindore të Bosnjës, ku edhe kreu krime të shumta. Divizioni përbëhej nga ustashë të etur për gjak dhe njerëz të paorientuar mirë, dhe gjithashtu mbështetej nga shumica e myslimanëve reaksionarë, të prirur drejt qarqeve fashiste. Se nga ç'mjedis vinin anëtarët e këtij divizioni, mund ta shikojmë nga dokumentet e ruajtura të Rajhut të Tretë, që bëjnë fjalë për institucionet ushtarake dhe policore në Shtetin e Pavarur Kroat. Konkretisht, me rastin e rekrutimit të "vullnetarëve" në divizionin eses mysliman, një shumë parash dhe ushqimesh, e barabartë me atë që ushtarët gjermanë merrnin në luftë, i "jepej" çdo familjeje që kishte të paktën një "vullnetar". Megjithatë, kjo nuk u zbatua kurrë, sepse të afërmit (e vullnetarëve) – gratë, prindërit ose

²⁰ Qytet në Bosnjën Veriperëndimore.

²¹ Udhëheqjen komuniste.

²² Hero partizan nga Kozara, shumë i njohur gjatë Luftës.

²³ Hanxhar quhet një thikë e gjatë luftarake, që përdorej në periudhën osmane.

²⁴ Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Bosnja bënte pjesë në Shtetin e Pavarur Kroat.

²⁵ Xhemal Bijediçi lindi në Mostar, në vitin 1917. Ai ishte anëtar i Partisë Komuniste Jugosllave që nga viti 1939, dhe anëtar i lëvizjes komuniste partizane, qysh nga viti 1941. Gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, ishte një nga njerëzit më të rëndësishëm në hierarkinë politike jugosllave. Megjithëse ishte mysliman boshnjak, ai nuk ngurroi të shkruante rreth bashkëpunimit të myslimanëve me nazistët (për shembull, një histori rreth Divizionit SS "Hanxhar"). Ai vdiq në një aksident ajror pranë Kreshevos (Bosnjë dhe Hercegovinë), në vitin 1977. Në kohën kur vdiq, ishte ende një nga udhëheqësit kryesorë politikë jugosllavë.

fëmijët - duhej të plotësonin një formular dhe ata s'mund ta bënin këtë, pasi ishin të gjithë analfabetë.

Albahari et al, f. 398-399.



Sipas jush, cilat ishin arsytet për t'u bashkuar me esesët? A mendoni se ushqimi dhe paratë e premtuara për familjet e vullnetarëve nuk u dhanë kurrë, për arsyen që jepet në tekst?

I-32. Darko Stupariçi shkruan rreth krijimit të njësisë së parë partizane kroate pranë Sisakut (Kroaci), në qershor të vitit 1941

"Atë natë, rreth dhjetë komunistë, bashkë me anëtarët e Lidhjes së Komunistëve të Rinj, u mbledhën në kopshtin e shtëpisë së familjes Lasiç, në Zhabno. Ata vajtën rreth njëqind metra larg fshatit, dhe nën një lis bënë takimin. Folën deri në mesnatë. Anëtarët e partisë nga fshatrat përreth u larguan për të kryer disa detyra po atë natë. Kapoja dhe Marjani qëndruan vetëm nën lis, ngritën një tendë dhe u shtrinë. Për ta ishte nata e parë si partizanë. Ata ishin partizanët e parë jugosllavë."

Në ditët e para të luftës partizane...

"...të gjithë donin të dinin se sa do të zgjaste lufta. Sa kohë do të luftonim, nëse kishim shanse për të t'ia dalë mbanë, etj. (...) Disa pyesnin: "Nëse fshihemi në hangar dhe qëndrojmë aty për pesë- gjashtë javë, do të ketë mbaruar e gjitha?" Ne u përgjigjeshim se nuk kishte gjasa të mbaronte aq shpejt, se gjëja më e rëndësishme për ne ishte të luftonim me armë, se ky ishte vendimi që kishim marrë dhe se një vendim i tillë do të merrej nga e gjithë partia."

Dedijer, f. 397.



Cili ishte realiteti partizan në ditët e para të lëvizjes së rezistencës? Ç'mendoni në lidhje me idenë për t'u futur në "hangar"?

I-33. Dëshmi për mënyrën si e përjetoi Ohri ardhjen e gjermanëve, italianëve, bullgarëve dhe partizanëve gjatë Luftës së Dytë Botërore

Ardhja e gjermanëve në Ohër (10 prill 1941)

"Të enjten mbrëma, rreth orës pesë, kambanat filluan të bien të gjitha, sepse atëherë filluan të

vinin njësitë gjermane [...] Disa i pritën në qendër dhe Panto Rilkoski u nxori bukë, kripë dhe ujë. Ngaqë kishin frikë se mos ishin të helmuara, Pantosit iu desh që t'i provonte vetë në fillim, dhe më pas hëngrën edhe ata. Më pas, një farë oficeri i marinës serbe i çoi tek reparti dhe ua dorëzoi atyre. Ai dinte gjermanisht, dhe ndoshta ishte kroat. Pasi shëtitën nëpër qytet, ata u ulën për darkë dhe hëngrën ushqim të konservuar... Dyqanet ishin mbyllur. Vetëm dy kafene punonin, por nuk shërbenin lëngje, kafe ose çaj, sepse nuk kishte sheqer..."

Ardhja e italianëve (11 prill 1941)

"Në mbrëmjen midis së premtes dhe së shtunës, njësitë italiane erdhën me makina të mbushura me ushtarë dhe armatime...Italianët ishin shumë të uritur dhe po kërkonin në popull për vezë e pula, të blinin bukë dhe ushqime të tjera. Fëmijët u shitën ushqim, në këmbim të parave – lirave dhe lekëve shqiptare."

Ardhja e bullgarëve (12 maj 1941)

"Më 12 maj, në orën pesë mbasdite, erdhi fillimisht policia bullgare. Ata u pritën nga kryetari i bashkisë, Ilija Kocareski. Pas 15 ditësh erdhi edhe pjesa tjetër e trupave bullgare. Gjenerali gjerman Linderman mbajti një fjalim, që u përkthye, e ku theksoi se ua dorëzoi qytetin bullgarëve, sepse kishte qenë i tyre dhe ata duhej ta qeverisnin. Më pas, gjenerali bullgar mbajti një fjalim, ku tha se ne kishim qenë skllëvër të popullit serb, dhe shprehu mirënjohjen për ushtrinë çlirimtare gjermane. Kështu Ohri ndërroi drejtues tri herë brenda muajit..."

Ardhja e partizanëve (15 tetor 1944)

"Më 15 tetor (1944), të dielën në mëngjes, erdhën partizanët. Populli e priste ardhjen e tyre. Ata erdhën hipur mbi kuaj. Populli u bëri një pritje të mrekullueshme. Pati shumë njerëz, të rinj dhe pleq [...] Në ditët në vazhdim erdhën edhe partizanët të tjerë. Mes tyre kishte edhe gra të armatosura me bomba, automatikë, plumba, e që kishin veshur pantallona, çka ishte krejt e re për ne..."

Mitreski, f. 230-232, 280.



Cilat janë ngjashmëritë dhe ndryshimet midis këtyre përshkrimeve? A është e mundur të dallohet qëndrimi i autorit ndaj ushtrive të ndryshme që hynë në Ohër?

► **Fig. 7. Boshnjakë në forcat ustashe**



Krišto, f. 257.



Ustashët u kushtuan vëmendje të veçantë boshnjakëve. Paveliçi argumentonte se shifrat 7.5 milion serbë, dhe vetëm 2.5 milion kroatë, ishin të gabuara; kishte 5.5 milionë “Kroatë të krishterë dhe myslimanë”. Në mënyrë që të tërhiqnin myslimanët në krahun e tyre, ustashët i quajtën ata “lulen e popullit kroat”. Boshnjakët krijuan njësi të veçanta në forcat e ustasheve. Ata dalloheshin nga njësitë e tjera nga “festja”, kësula tradicionale myslimane që ata mbanin.

I-34. Një fëmijë flet mbi rivalitetin mes grupimeve politike në Shqipëri

“Dredhia tjetër që ata përdorën ishte se partizanë të veshur me uniforma ushtarake gjermane, të vinin tek ne dhe të shanin komunistët, dhe të shihnin

nëse do të binim në një mendje me ta. Përkrahësit e gjermanëve bënë të njëjtën gjë me të gjithë në Arzë. Të tria fraksionet politike bënë të njëjtën hile, me të gjithë Arzën. Burrat që vinin nëpër shtëpi, ishin gjithmonë nga zona të tjera të vendit dhe askush nuk i njihte ata në Arzë. Në këtë mënyrë, zbuluan se çfarë ndiente gjithë secili për çdo grupim.”

Hysolli, f. 58.



Si u përpoqën fraksionet politike të zbulonin se kush i përkrahte me të vërtetë dhe kush jo? Çfarë tregon ky fragment për jetën e përditshme të civilëve? Sipas mendimit tuaj, cila do të ishte mënyra më e mirë për t’iu përgjigjur pyetjeve rreth ushtrive/grupimeve të ndryshme?

I-35. Letërçarkore e Komitetit Qendror të LNÇ-së, drejtuar të gjitha këshillave rajonale në Shqipëri (datë 9 shtator 1943)

“Në rast zbarkimi nga ana e Aleatëve, Këshillat Nacionalçlirimtarë duhet të jenë pushteti i vërtetë. Ata duhet të mobilizojnë të gjithë popullin dhe të mos lejojnë forca të tjera, si Balli Kombëtar, të ushtrojnë ndikim në popull (...) Forcat Nacionalçlirimtare duhet të fillojnë që tani të jenë aktive kudo dhe, kur të ndodhë zbarkimi, t’u paraqiten Aleatëve si i vetmi pushtet i popullit shqiptar (...) Drejtimi i Shqipërisë duhet të jetë plotësisht në duart e Këshillave Çlirimtarë.”

Smiley, f. 89.



Në këtë letër, në rast zbarkimi të Aleatëve në Shqipëri, si udhëzohen anëtarët e Këshillave Nacionalçlirimtarë të sillen në lidhje me pushtetin? Si duhet ta shmangin ata përfaqësimin e forcave të tjera politike? Cili ishte qëndrimi i LNÇ-së ndaj grupeve rivale politike në Shqipëri? A është ardhja në pushtet qëllimi përfundimtar apo qëllimi kryesor i lëvizjeve të rezistencës?

I-36. "BRIGADAT SHQIPTARE NË KOSMET" – Artikull i Xhavid Nimanit në gazetën "Liria", nëntor 1944

BRIGADAT SHQIPTARE NË KOSMET

Më gjashtëmbëdhjetë tetor arritën në territorin e Kosmetit dy brigada shqiptare heroike: e III-ta dhe e V-ta. Ato erdhën që të na ndihmojnë për t'i çliruar popujt tanë nga okupatori gjakpirës gjerman dhe nga tradhtarët e ndryshëm, që u bashkuan aty për të gjetur strehim. Ato erdhën që së bashku, një herë e përgjithmonë, ta zhdukim shovenizmin, të cilin - për rreth tridhjetë vite - e hodhën të papenguar ndërmjet popujve tanë ngatërrestarët serbo-shqiptarë dhe ata malazezë; shovinizmin, të cilin edhe fashistat e zin, të ndihmuar nga shpirtrat e shitur vendorë, ditën ta shfrytëzojnë mirë si mollë shërri, duke i kthyer popujt njërin kundër tjetrit, për t'ua pamundësuar që të shohin gjendjen reale - robërinë dhe plaçkitjen, të cilat ata ua imponuan. Shokët tanë, luftëtarët e brigadave shqiptare, nuk i kemi të panjohur; janë të njohur të vjetër. Bashkë me ta kemi kaluar burgje dhe kampe përqendrimi. Së bashku, krah për krah, kemi derdhur gjak në Kërçovë, Peshkopi, Dibër të Madhe, në minierat e Korçës, në Lumë dhe në vende të tjera. Vuajtjet e përbashkëta dhe gjaku i derdhur kundër armikut të përbashkët na kanë afruar dhe vëllazëruar.

Arritja e brigadave shqiptare në territorin e Kosovës dhe Metohisë na lartëson - ne krenohemi me këtë. Sepse parullat lidhur me ne, të armiqve dhe tradhëtarëve, varrosen. Populli tani do të shohë se partizanët e Jugosllavisë dhe ata të Shqipërisë luftojnë së bashku kundër armiqve të njëjtë; do të shohin se të luftëtarët që derdhin gjakun e vet për lirinë e popullit, një jetë më të mirë dhe të drejta të barabarta për të gjithë, ekziston vetëm një gjë: bashkimi dhe vëllazërimi; do të mësojnë që, njësoj siç bëjnë armiqtë tanë - pavarësisht se cilit komb i përkasin - ia shtrijnë duart njëri-tjetrit kur bëhet fjalë për interesat e tyre, po ashtu janë të vëllazëruara edhe ushtritë popullore në luftën për qëllime dhe për interesa të përbashkëta kundër armikut të përbashkët.

http://www.znaci.net/00001/4_1_19.pdf



Xhavit Nimani (1919-2000), ishte shqiptar nga Kosova, aktivist dhe luftëtar në Luftën e Dytë Botërore. Në mars të vitit 1974 ai u emërua në postin e sapo krijuar, të Kryetarit të Kryesisë së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Në këtë post qëndroi për 7 vite, deri më shpërthimin e demonstratave të ashtuquajtura në atë kohë nga regjimi "kundër-revulucionare".

I-37. "U FORMUA BRIGADA E 4-t E KOSMETIT" – Artikull i Milan Mičkoviqit në gazetën "Liria", nëntor 1944

U FORMUA BRIGADA E 4-t E KOSMETIT

Në krahasim me trevat e tjera të Jugosllavisë, lëvizja nacional-çlirimtare në Kosovë dhe Metohi kryesisht ka munguar. Kjo gjë me siguri i ka arsyet e veta. Përveç tjerash, njëri prej shkaqeve më të rëndësishme është urrejtja shoveniste ndërmjet popujve tanë që është fryt i politikës antipopullore njëzetetrevjeçare e ish regjimeve të Jugosllavisë, - të cilën okupatori fashist, i ndihmuar nga tradhëtarët vendorë, e ka thelluar edhe më tepër dhe e ka shfrytëzuar në mënyra të ndryshme dhe me shumë shkathtësi. Falë këtyre gjërave dhe rrethanave të tjera, kushtet në të cilat është zhvilluar lufta nacional-çlirimtare në Kosovë dhe Metohi kanë qenë me të vërtetë të vështira. Mirëpo, megjithëse me vonesë, edhe te ne janë pjekur të gjitha kushtet për shpërthimin e kryengritjes nacional-çlirimtare. Në një situatë kaq të volitshme, kur flaka e luftës çlirimtare po depërton edhe në Kosovë dhe Metohi dhe kur jemi në prag të çlirimit të të gjithë atdheut tonë, më 13 tetor të këtij viti, në territorin e çliruar afër Gjakovës, u formua Brigada IV sulmuese nacional-çlirimtare e Kosovës dhe Metohisë. Formim i i saj është bërë në praninë e brigadës I të lavdishme të Kosmetit dhe brigadave vëllazërore heroike III dhe V shqiptare.

Brigada jonë IV është shumë e rëndësishme për luftën çlirimtare të popujve të Kosovës dhe Metohisë. E përbëjnë djemtë dhe bijat më të mira të të tre popujve të Kosovës dhe Metohisë: shqiptarë, serbë dhe malazez, ajo është mishërim i bukur i vëllazërimit dhe bashkimit të popujve tanë, çka është me të vërtetë arma më e fuqishme në luftën kundër xhelatëve gjermanë dhe të gjithë armiqve të fshehur të popullit.

http://www.znaci.net/00001/4_1_19.pdf

I-38. Letra e Melihate Dedës dërguar Komitetit Krahinor të Partisë Komuniste të Jugosllavisë për Kosovën, dhjetor 1944²⁶

[...]

Derisa në fillim mendoja se ushtria jonë u tregua shoviniste vetëm duke pasur parasysh se luftoi kundër shqiptarëve, më vonë erdha në përfundim se është fjala për faktet se në radhët e UNÇ-së u infiltruan edhe elementet armiqësore, të cilët nën flamurin e ushtrisë sonë i sigurojnë vetes komoditet, që me punën e tyre shkatërruese vazhduan të njollosin emrin e Ushtrisë sonë NÇ. Dyshimi im, shoke, tani nuk bazohet vetëm në përshtypje. Kam për obligim që të paraqit të gjitha rastet në mënyrë që të bëjmë hetime rutinore dhe në bazë

të rezultateve të dënimeve të gjithë ata që në një mënyrë ose një tjetër pengojnë luftën tonë.

Kur Partia jonë në tubime sqaronte qëllimet e LNÇ-së në këtë trevë, populli haptas thoshte se veprat flasin ndryshe. Unë kam ardhur në përfundim se Ushtria jonë, në vend të ndihmës, ka sjellë dëme ngase na është marrë arma kryesore në luftë kundër elementeve të ndryshme reaksionare, gjegjësisht armiqësore. Ne nuk kemi mundur që me shembuj t'i tregojmë popullit se propaganda të cilën e zhvillonte armiku, okupatori dhe shërbëtorët e tij, kishte për qëllim luftën vëllavrasëse, e cila u sillte dobi vetëm atyre tradhtarëve të popujve tanë.

[...]

MIMI.

Pyetje të përgjithshme mbi nënkapitullin Ib.

Bëni një tabelë me tri kolona. Duke u mbështetur në burimet e mësipërme, shkruani në kolonën e parë ushtritë pushtuese, në të dytën, ushtritë partizane, dhe në të tretën, ushtritë antikomuniste. Përshkruani marrëdhëniet midis ushtrive partizane dhe antikomuniste, që vepronin në të njëjtin vend. Bëni një listë të ushtrive që ekzistonin në vendin tuaj. Gjeni informacion shtesë për udhëheqësit dhe qëllimet e tyre. Si ishin organizuar ushtritë partizane? Çfarë problemesh kishin ato? Ushtritë e rezistencës luftuan jo vetëm për çlirim, por edhe për një sërë qëllimesh të tjera. Cilat qenë këto qëllime?

Ic. Marrëdhëniet me dy koalicionet dhe me shtetet fqinje

I-39 dhe I-40.

Kronikë lajmesh për grushtin ushtarak të shtetit dhe përmbysjen e qeverisë përkrahëse të Boshtit në Mbretërinë Jugosllave. Kjo ngjarje ndodhi më 27 mars 1941, pas bashkimit të Jugosllavisë me Paktin Tripalësh

Duke ardhur nga rrugicat e rrethinave të qytetit, turmat u bashkuan dhe u shndërruan në një lumë të madh njerëzish. Në këtë turmë njerëzish kishte punëtorë, nëpunës, të rinj, qytetarë, fshatarë dhe gra. Në krye të protestës valëvitëshin flamujt kombëtarë. Njerëzit shprehnin ndjenjat e tyre përgjatë gjithë demonstratës. Ata thërrisnin: "Rroftë Qeveria

Popullore!", "Rroftë Ushtria Popullore!", "Ushtria është me popullin!", "Të lëshohen të burgosurit politikë!".

(...) Përfaqësues nga rinia dhe punëtorët, si edhe dr. Dragoljub Jovanoviçi²⁷, folën në sheshin Slavija. Ata të gjithë shprehën gëzimin për përmbysjen e qeverisë dhe theksuan dëshirën e popullit të Beogradit për të mos u ndalur në gjysmë të rrugës, dëshirën që ai të ruante paqen dhe pavarësinë kombëtare.

(...) Disa fjalime u mbajtën përpara monumentit të Vuk Karaxhiçit. Profesori i universitetit, Sima Milosheviçi, ishte një nga folësit. Populli jugosllav, sipas z. Milosheviçi, dëshiron të ruajë pavarësinë

²⁶ Origjinali i këtij dokumenti ruhet në Arkivin Shtetëror të Kosovës (F.OKKM, K. 10/29, nr. 1305) në Prishtinë. Dokumenti është i shkruar me penë në gjuhën serbe me alfabet cirilik dhe ka gjithsej 4 faqe. Relacioni është i nënshkruar në fund me MMI, që është emri ilegal i Melihate Dedës.

²⁷ Dr. Dragoljub Jovanoviçi (1895-1977), profesor në universitet, ishte drejtuesi i krahut të majtë të Partisë së Fermerëve. Pas Luftës së Dytë Botërore, regjimi i Titos e dënoi me një periudhë të gjatë burgimi, për shkak të veprimtarisë së tij opozitare.

dhe lirinë kombëtare dhe të sigurojë të drejta demokratike.

Politika, 28 mars 1941.

Raporti i kreut të rabinëve në Jugosllavi, dr. Isak Alkalaj, drejtuar qeverisë jugosllave në mërgim, mbi ngjarjet nga fundmarsi deri në fundqershorin e vitit 1941

Atë ditë (26 mars) protestat shpërthyen njëkohësisht në të gjitha shkollat e mesme... Thirrja "Më mirë luftë sesa pakt, më mirë në varr sesa skllëvër!" vinte nga të gjitha klasat ... Mësimi u ndërpre në të gjitha shkollat dhe në mbrëmje filluan demonstratat në Kalemegdan dhe në Slavja... Konsullata greke u mbush me të rinj nga mosha 17 deri në 20 vjeç, të cilët donin të shkonin në Greqi dhe të luftonin si vullnetarë. (...)

Kur morën vesh njerëzit lajmin për këtë kthesë që kishim marrë ngjarjet, të gjitha rrugët i zbuluan me flamuj dhe shumë të tjera edhe me lule. Në orën 6 të mëngjesit (më 27 mars), rrugët ishin mbushur me njerëz; me fshatarë të veshur me rroba festive, të cilët vazhdonin të vinin nga fshatrat aty pranë, me punëtorë, intelektualë, studentë dhe qytetarë, të rinj dhe të moshuar. Ata vinin të shprehnin gëzimin e tyre, përqafoheshin, këndonin, thërrisnin me zë të lartë dhe këndonin himnin. Përshëndetja atë ditë ishte: "Rroftë mbreti, rroftë Jugosllavia!" (...) Ambasadat angleze, amerikane, ruse dhe greke ishin praktikisht të bllokuara. Grupe njerëzish shkonin nga një ambasadë tek tjetra, hynin në kopshtin e tyre dhe kërcenin 'kolo'; krerët dhe stafi i misioneve diplomatike i mirëpriste i prekur thellë. (...) Turma njerëzish që mbanin në krye flamujt jugosllavë dhe ata të Aleatëve drejtoheshin për në qendër të qytetit, duke thirrur "Rroftë mbreti, atdheu dhe ushtria!", dhe hidhnin parulla kundër Hitlerit dhe mercenarëve të tij. (...) Rreth mesditës u zhvilluan demonstrime të mëdha përpara Zyrës Gjermane të Trafikut ... Një burrë doli në një nga dritaret dhe i vuri flakën portretit të Hitlerit që mbante në dorë. Fotografia u dogj ngadalë, ndërsa duartrokitjet e zhurmshme të turmës u shtuan dhe mund të dëgjoheshin edhe në rrethinat e qytetit. Më pas, dy

veta morën një flamur gjerman me kryqin e thyer dhe e shqyen me dhëmbë."

Tokovi istorije, 1-2/1997, f. 181-182.



Cili ishte reagimi i popullit pas nënshkrimit të Paktit Tripalësh nga qeveria jugosllave dhe pas grushtit ushtarak të shtetit? Ku shfaqet ndërgjegjësimi i demonstruesve se këto ngjarje mund të provokonin sulm ndaj Jugosllavisë, nga ana e Gjermanisë?

► Fig. 8. 27 mars 1941. Demonstrata kundër Forcave të Boshtit në Beograd



Branko Petranović, Nikola Žutić, 27 mars 1941.



Reagimi i ashpër i Hitlerit ndaj grushtit ushtarak të shtetit, i cili u organizua nga një grup oficerësh jugosllavë, si kundërveprim ndaj bashkimit të qeverisë jugosllave me Paktin Tripalësh më 25 Mars, solli sulmin mbi kryeqytetin jugosllav më 6 prill 1941 dhe shpërbërjen e shtetit të parë jugosllav.

I-41. Nga kujtimet e juristit të njohur bullgar, Konstantin Kacarov²⁸, gjatë vitit të parë të Luftës së Dytë Botërore

Në këtë fazë të "drôle de guerre", lufta në Bullgari, të paktën në sipërfaqe, si në aspektin politik, ashtu edhe në atë ushtarak mezi ndihej. Gjendja e brendshme kishte të bënte me autoritetin e carit,

²⁸ Konstantin Kacarovi lindi në Sofje, në vitin 1898. Ai ishte profesor në departamentin e jurisprudencës në Universitetin e Sofjes (1931-1953). U dënua në vitin 1953 dhe u lirua më pas nga burgu, sepse dënimi i tij kishte qenë i padrejtë. Pas rrëzimit të akuzës kundër tij, ai emigroi në Zvicër.

që mbështetej në ushtrinë e pastruar nga oficerët e përfshirë në politikë dhe tek ministrat që nuk bënin pjesë në asnjë parti. Politika e jashtme e vendit ishte një politikë pritjeje dhe dukej sikur donte “të kalonte pa u vënë re” (...) Bullgaria ishte asnjënjë. Kjo fjalë i tërhoqte në mënyrë të veçantë bullgarët. Ne kishim zhvilluar tri luftëra dhe kishim pësuar dy katastrofa kombëtare, të cilat kishin shkatërruar idealet kombëtare që frymëzuan brezin tonë. Bullgarët nuk besonin se nëpërmjet luftës ose bashkimit në një aleancë të madhe ndërkombëtare do të përmirësonin kushtet e tyre të jetesës. Shembull tipik që tregon se bullgarët e kishin humbur besimin se mund të arrinin lumturinë nëpërmjet politikës ndërkombëtare të kohës, është kjo anekdotë që në atë kohë ishte shumë e përhapur: Pizhoja takohet me mësuesin e fshatit dhe e pyet: “Mësues, ne do të qëndrojmë asnjënjë kësaj here, apo jo?” “Jo, jo! - përgjigjet mësuesi, i cili është specialist në politikën ndërkombëtare. Këtë herë, Bullgaria nuk do të jetë aleatja e Gjermanisë. Tani do të bëhemi me Anglinë.” “Shumë mirë! Le të mundet edhe Anglia një herë!”

Katsarov, f. 547-548.

❓ Përse shumica e bullgarëve donin ta shmangnin një luftë të re? A prisnin ata për vete ndonjë përfitim nga ky konflikt botëror?

I-42. Një gazetar i njohur bullgar, Danail Krapçevi, bën komente në lidhje me akuzat që iu bënë Bullgarisë ngaqë nuk organizoi qëndresë ndaj ushtrisë gjermane

Përse nuk e ndalën ata ushtrinë gjermane? Disa shtete e kritikojnë Bullgarinë, sepse e lejoi ushtrinë gjermane, aleaten e saj në Luftën e Përbotshme, që të kalonte nëpër territorin e saj. Duhet theksuar se këto shtete janë Fuqitë e Mëdha. Ne bullgarët, kemi të drejtë t'i pyesim: Përse ata që e kritikojnë Bullgarinë se lejoi ushtrinë gjermane të kalonte në territorin e saj, nuk e ndalën të njëjtën ushtri në marshimin e saj vitin e kaluar apo dy vjet më parë? (...) Përse nuk erdhën në pjesën e poshtme të Danubit për të ndalur gjermanët, por duan që shtatë milionë bullgarë, të cilët ishin aleatë të

Gjermanisë gjatë Luftës Botërore dhe ndanë të njëjtin fat me të, të mos e lejojnë të kalojë lumin e madh? ... Në fund të fundit, nuk duhet harruar që Bullgaria është viktimë e sistemit të Versajës, që filloi për të në Bukuresht dhe përfundoi në Njëi. Përse kombet shtatëmilionësh qenkan të detyruar të ndalojnë tetëdhjetë milionë gjermanë në rrugën e tyre për të ndërtuar një Europë të re? Bullgaria dhe Gjermania janë të dyja viktima të fituesve në luftën e dy dhjetëvjeçarëve të shkuar dhe ne po presim që të fitojë drejtësia (...)

Gazeta 'Zora', Sofje, 6 mars 1941.

Krapçev, 210-211.

❓ Cilat janë argumentet e autorit? A janë ato bindëse? Cili është qëndrimi i Krapçevit ndaj Gjermanisë dhe popullit gjerman?

I-43. Daniel Krapçevi, komenton fitoren e shpejtë të Gjermanisë ndaj Jugosllavisë në prill të vitit 1941

U shkatërrua vendi që në vitin 1885 sulmoi Principatën Bullgare, sepse Bullgaria e Jugut u bashkua me atë të Veriut. U shkatërrua vendi që në vitin 1913, pabesisht shkeli traktatin e aleancës midis Bullgarisë dhe Serbisë, dhe filloi Luftën midis Aleatëve (Luftën e Dytë Ballkanike). U shkatërrua vendi që në negociatat e paqes në Bukuresht donte të merrte edhe Carevo Selon, të “na thyente dhëmbët në Sofje”, siç pohoi përfaqësuesi serb, Spalaikoviçi. U shkatërrua vendi që u dha grekëve vendlindjen e Shën Cirilit dhe Metodit. U shkatërrua vendi që shkaktoi vrasjen e Princit Trashëgimtar të Austrisë, dhe bëri që të shpërthente Lufta Botërore. U shkatërrua vendi, i cili ndihmoi që Bullgaria të dëbohej tej nga rajoni i Egjeut. Them i vendi dhe jo populli serb, sepse populli nuk është fajtor; fajtorë është inteligjencia drejtuese e tij, që e ka urreyer gjithmonë Bullgarinë... Jo vetëm që ky vend shtypi më shumë se një milion bullgarë, duke i ndarë ata nga ne dhe duke u përpjekur t'u marrë zemrën, shpirtin dhe gjuhën amtare, por gjithashtu, u përpoq ta minonte Bullgarinë nga brenda... Jezu Krishti u ngrit nga varri! Që tani, çdo qytetar bullgar do të marrë frymë më lirshëm. Qofshi të gëzuar!

Krapçev, f. 145-146.

? Cilat janë arsyet përse Krapçevi gëzohet nga kjo ngjarje? A ka lidhje ky gëzim me të gjithë Jugosllavinë apo vetëm me një pjesë të saj? Përse? Çfarë kuptojmë për vetë autorin nga ky artikull?

► Fig. 9. Gazetë rumune: mbreti Mihai, gjenerali Antonesku, Musolini, Hitleri (1941)



“Universul”, nr. 130, 15 maj 1942.

► Fig. 10. Gazetë rumune: mbreti Mihai dhe kryekomandanti Stalin (1945)



“Universul”, 26 tetor 1944.

? Krahasoni këto dy foto. Çfarë mendoni për ushtrinë dhe politikanët rumunë që ndryshuan krah? A mendoni se “miqësia” e re është e sinqertë? Shpjegoni përgjigjen tuaj.

I-44 dhe I-45.

Fragment nga përkujtesa (18. 10. 1941) e kryeministrit të atëhershëm të qeverisë greke në Kajro, Emanuil Cuderos – ish-bankier, i njohur për pikëpamjet e tij liberale dhe kundërshtar i regjimit të Metaksasit – drejtuar britanikëve

“... Kthimi i mbretit dhe i familjes së tij në vendin tonë është një çështje nderi, sepse ai ndoqi një politikë të guximshme, por edhe sepse kjo është në interesin tonë dhe të aleatëve tanë. Çdo diskutim mbi çështjen e regjimit pas luftës do të shkaktojë kontradikta dhe anarki pa fund në Greqi. Nëse miqtë tanë duan që Greqia e pasluftës të ketë vazhdimësi në politikën e jashtme dhe të mbetet vend me ndikim politik të dobishëm në Mesdhe dhe në Ballkan, ata duhet të përgatisin që tani terrenin, në mënyrë që të parandalohen çrregullime të tilla në Greqi”.

Fleischer, vëll. 1, f. 181.

? Si përpiqet Cuderosi t’i bindë aleatët që kthimi i mbretit është në interes të tyre? Ç’mendoni për argumentet që ai përdor?

Mesazh i Ministrisë së Jashtme Britanike për ambasadorin britanik në Kajro, datë 14. 8. 44

“Ajo çka do t’u shërbente interesave tanë, do të ishte që gjermanët të dorëzoheshin, kur forcat britanike të ishin gati për të hyrë në Greqi, dhe me kusht që t’i dorëzonin të gjitha armët dhe furnizimet, në mënyrë që të mos bien në duart e EAM-it dhe që të mos krijohej një periudhë zbrazëtie nga e cila EAM-i mund të përfitonte. Kjo do të arrihej më mirë, nëse materialet do të dorëzoheshin nëpër porte, ku mund të arrijmë më lehtë. Sigurisht që gjenerali për Lindjen e Mesme po vlerëson disa mënyra dhe mjete dhe do të marrë parasysh sugjerimet e mësipërme”.

latridis, f. 227.



Pushtimi i Greqisë nga ushtria gjermane nisi në prill të vitit 1941, dhe forcat greke e britanike u mundën shpejt. Tri ditë para se Athina të pushtohej, më 23 prill, gjeneral Çollakoglu, pa autorizimin e qeverisë, negocioi armëpushimin me gjermanët. Mbreti dhe qeveria e tij u larguan në Lindjen e Mesme. Në Greqi u vendos një qeveri kolaboracioniste. Në mars të vitit 1944, EAM-i krijoi Komitetin Politik Nacional Çlirimtar që do të qeveriste Greqinë e lirë dhe që sfidonte drejtpërdrejt qeverinë në mërgim. Kryeministri i ri i qeverisë në mërgim nën mbrojtjen e britanikëve, George Papandreu, filloi të ngrajë një qeveri të bashkimit kombëtar. Përfundimisht, ai i dha EAM-it pesë ministri të rangut jo të lartë në qeverinë e re. Qeveria e Papandreut u kthye në Athinë në tetor të vitit 1944, e shoqëruar nga një forcë e vogël ushtarake britanike. Papandreu nuk u dha përparësi kërkesave për të ndëshkuar bashkëpunëtorët, por problemi kryesor ishte çmobilizimi i ushtrive guerrile dhe zëvendësimi i tyre me një ushtri kombëtare. Përfaqësuesit e EAM-it dhanë dorëheqjen nga kabineti, dhe pas disa ditësh, më 3 dhjetor 1944, EAM-i organizoi një demonstratë masive. Policia qëlloi me armë dhe 15 veta mbetën të vdekur. Çetat e ELAS-it sulmuan rajonet e policisë dhe nëpër rrugë pati luftime të përgjakshme ndërmjet çetave të ELAS-it dhe forcave britanike e qeveritare në Athinë. Në fund, në pjesën më të madhe të betejës fituan trupat britanike.



Ç'boshllëku i druhej Ministria e Jashtme e Britanisë? Përse?

I-46. Gjeneral-brigade Majersi, komandanti i Misionit Ushtarak Britanik në Greqi, vlerëson ndikimin e qëndresës ndaj nazistëve, në kuadër të zhvillimit të përgjithshëm të luftës

Pak kohë pas pushtimit, Greqia u kthye në një vend me rëndësi të madhe strategjike për armikun. Prej saj merrej pothuajse i gjithë prodhimi vendas. Gjithashtu, portet e saj, veçanërisht Pireu, përdorshin për të furnizuar ishujt që ishin baza ajrore të armikut në Mesdheun Lindor, si dhe për të dërguar furnizime nëpërmjet detit në Afrikën Veriore. Në vjeshtë të vitit 1942, sapo ne çamë vijën në El Alamein, shkatërrimi i urës Gorgopotamos bllokoi rrugën e vetme hekurudhore për në Athinë, për gjashtë javë²⁹ kritike, gjatë të cilave armiku nuk pati mundësi të përdorte Pireun për të furnizuar trupat në Afrikën Veriore, përveçse me ato pak rezerva që kishte grumbulluar në Greqinë e Jugut. Sabotimi në masë i linjave të komunikacionit, në qershor dhe korrik të vitit 1943, pengoi përkohësisht dy divizione gjermane që të hynin në betejën kryesore të frontit në Sicili. Gjithashtu, kjo ndikoi jo pak në planin e përgjithshëm, në suksesin e zbarkimit dhe marrjen e ishullit. Është vlerësuar se midis viteve 1941 dhe 1944, partizanët kanë vrarë mbi 25 mijë veta nga radhët e armikut. Dihet se mbi njëqind e pesëdhjetë lokomotiva u dëmtuan ose shkatërruan. Mbi njëqind ura u hodhën në erë. Mbi dyqind e pesëdhjetë anije, me gjithsej rreth 68 mijë ton, u mbytën ose u dëmtuan nga sabotimet. Gjatë vitit 1943, aksionet partizane bënë që 13 divizione italiane të qëndronin të angazhuara në Greqi. Pas kapitullimit italian, gjermanët ishin të detyruar të mbanin atje gjashtë divizione. Nëse armiku do ta kishte dobësuar ushtrinë e vet pushtuese përpara se të shpërthente lufta civile në male, do kishte rrezik që të fillonte një luftë mbarëkombëtare greke kundër tyre.

Myers, f. 280-281.



Përse Greqia kishte rëndësi strategjike për gjermanët? Cila ishte rëndësia e shkatërrimit të urës Gorgopotamos?

²⁹ Shkatërrimi i urës hekurudhore Gorgopotamos, në nëntor të vitit 1942, mbi të cilën kalonte linja Selanik-Athinë, ishte një nga veprimet më spektakolare të rezistencës në gjithë Europën e pushtuar. Ky aksion u krye nga trupa guerrile të ELAS-it dhe EDES-it dhe sabotatorë të parashutuar në Greqi nga Drejtoria e Operacioneve Speciale Britanike.

► **Fig. 11. Miqësia midis ushtrisë rumune dhe Ushtrisë së Kuqe: oficerë në front (Fotografi nga një gazetë rumune)**



“Universul”, Bukuresht, 6 tetor 1944.

? Në ç’vit duhet të jetë bërë kjo fotografi? Argumentoni përgjigjen tuaj.

I-47. Trajtimi i të burgosurve anglezë në Rumani (1944)

“Antonesku njoftoi Çasin se do të na mbronte nga gjermanët, megjithëse kishim ardhur këtu si armiq. Ata nuk kishin nevojë që t’u nxirrnin ndonjë pretekst gjermanëve për të marrë nën mbajtje, dhe për këtë arsye, profesor Mihai Antonesku... do të na ndihmojë që të formulojmë deklaratat tona. Nuk duhej, në asnjë mënyrë, që të prananim se ishim dërguar për të sabotuar naftën, meqë ky ishte mall me rëndësi strategjike, dhe kështu gjermanët do kishin një arsye të fortë që të na merrnin në dorëzim ... Kështu pra, një nga aleatët më të ngushtë të Hitlerit – një kuisling – arrestonte 3 parashutistë britanikë, më pas u ofronte mbrojtje dhe dërgonte ministrin e tij të Punëve të Jashtme t’i udhëzonte si të vepronin kur t’i merrnin në pyetje gjermanët. Kush nga ata që ishin në atdhe – që e gjykonte luftën në vija të përgjithshme dhe pa dykuptimësi – do të mendonte se diçka e tillë mund të ndodhte?”

Porter, f. 161.

🔑 Ky rrëfim u shkrua nga Ivor Porteri, spiun anglez që u dërgua në Rumani me misionin për të marrë kontakt me Juliu Maniun³⁰, udhëheqësin e opozitës demokratike. Trajtimi që u bëhet të burgosurve, na bën të kuptojmë qëndrimin e qeverisë së Antoneskut e cila, me gjithë deklaratat zyrtare për besnikëri ndaj Gjermanisë, kërkonte të fitonte simpatinë e fuqive të Kombeve të Bashkuara.

? Sipas mendimit tuaj, cila është arsyeja që të burgosurit e luftës u trajtuan në këtë mënyrë të pazakontë?

I-48. Fragmente nga protokollin e bisedës ndërmjet J.B. Titos dhe U. Çurçillit në Napoli, 12 gusht 1944

(...) Marshalli Tito tha se (...) përsa u përket serbëve, nuk kishte ndonjë kontradiktë me ta, por vetëm me grupin e Mihajloviçit, i cili ktheu armët kundër partizanëve në çastin më kritik.

(...) Kryeministri tha se zgjidhja e vërtetë për Jugosllavinë është vendosja e një sistemi demokratik, i cili do të mbështetet tek fshatarët, ndërkohë që gjendja në fermat private do të përmirësohet shkallë-shkallë.

Marshalli Tito, siç kishte deklaruar disa herë publikisht, tha se nuk donte të vendoste një sistem komunist në Jugosllavi, për arsyen e thjeshtë se pas luftës, shumica e vendeve europiane pritej të kishin një sistem demokratik dhe Jugosllavia nuk duhet të bënte përjashtim nga kjo.

Tito-Churchill: Strogo tajno, f. 277.

? A ishte Titoja i sinqertë me Çurçillin?

³⁰ Juliu Maniu (1873-1953). Politikan rumun. Udhëheqës i rëndësishëm i Lëvizjes Kombëtare Rumune në Transilvani, në Monarkinë Austro-Hungareze. Gjatë periudhës midis luftërave botërore, Maniu ishte një nga figurat politike kryesore që nxiti idetë demokratike. Gjatë qeverisë së Antoneskut, ai ishte udhëheqës politik i opozitës demokratike. Maniu u dënua dhe u burgos nga komunistët në vitin 1947, dhe vdiq në burgun “Sighet”.

I-49. Urdhri i mbretit italian, Viktor Emanueli III, më 3 maj 1941, me anë të të cilit Italia anekson provincën e Lubjanës

URDHËR I MBRETIT, MË 3 MAJ 1941 – XIX, NO 291
KRIJIMI I PROVINCËS SË LUBJANËS

VIKTOR EMANUELI III

(...) Pika 2. Në bazë të urdhrin të mbretit, lëshuar pas propozimit të Duçes së Fashizmit dhe ministrit të Brendshëm, Provinca e Lubjanës – për shkak të dendësisë së popullsisë sllovene - do të gëzojë një status autonomie, ku do të merren parasysh karakteristikat etnike të popullsisë, pozicioni gjeografik dhe nevojat e veçanta të vendit.

Pika 3. Pushteti administrativ do jetë në duart e Komisionerit të Lartë, të caktuar me urdhër të mbretit dhe me propozim të Duçes së Fashizmit, kryeministrit, si dhe ministrit të Mbrojtjes.

Pika 4. Komisioneri i Lartë do të mbështetet nga një këshill i përbërë prej 14 anëtarësh të zgjedhur nga shtresat elitare të popullit slloven.

Pika 5. Shërbimi ushtarak nuk do të jetë i detyrueshëm për banorët e Provincës së Lubjanës.

Pika 6. Mësimi në shkollat fillore do të zhvillohet në gjuhën sllovene. Në shkollat e nivelit të mesëm

I-50. Një anekdotë e treguar nga arkeologu i famshëm bullgar, Ivan Venedikov, rreth marrëdhënieve të tij me gjermanët në Maqedoni

Në atë çast Stamen Mihailovi solli një ushtarak gjerman, një arkeolog. Ai ishte gjerman tipik, bjond, i gjatë, mbante uniformë; kishte ardhur me repartin e tij në Shkup. Ai ishte rreth 35 vjeç dhe ishte specialist i periudhës parahistorike...

Herën e fundit që e takova, Langeja më tregoi një anekdotë për ne, bullgarët:

dhe të lartë, mësimi në gjuhën italiane do të jetë me zgjedhje. Të gjitha dekretet zyrtare do të hartohen në të dyja gjuhët. (...)

Ferenc, f. 33.



Trupat italiane pushtuan pjesën perëndimore dhe jugore të Sllovenisë. Pas një periudhe të shkurtër administrimi ushtarak, pushtuesit italianë i quajtën territoret e pushtuara *Provinca e Lubjanës* [*Provincia di Ljubliana*]. Këto territore drejtoheshin nga një komisioner i lartë. Pak ditë pas pushtimit u krijua Këshilli Kombëtar, një organizëm slloven, i cili pati jetë vetëm pak muaj dhe nuk kishte pushtet të vërtetë. Zyrtarisht, Provinca e Lubjanës ishte një provincë italiane. Ajo gëzonte statusin e autonomisë dhe ndryshonte nga provincat e tjera italiane vetëm në disa tregues: prej emërtimit të atij që e drejtonte ('komisioner i lartë', kur në pjesët e tjera të Italisë quhej 'prefekt'), në përdorimin e dy gjuhëve, në administrimin formal me komitet këshillimor, anëtarët e të cilit ishin sllovenë dhe, së fundi, nga fakti se qytetarët sllovenë nuk e kishin të detyrueshëm shërbimin ushtarak. Pas kapitullimit të Italisë, territoret që më parë mbaheshin të pushtuara prej saj, u morën nga Gjermania.



Komento pikën nr. 4.

"Njerëzit thonë se jeni dymbëdhjetë milionë", - tha ai. "Jo, vetëm gjashtë."

"Jo, dymbëdhjetë. Gjashtë janë me ne, dhe gjashtë të tjerët me Bashkimin Sovjetik", - tha ai.

Kjo më mërzi, por nuk thashë asgjë. Vallë, a kishte ai të drejtë?

Venedikov, f. 238-239.



Çfarë qortimi fshihet në fjalët e gjermanit? Mbi ç'baza ngrihet?



Pyetje të përgjithshme mbi nënkapitullin Ic.

Cilët ishin faktorët që ndikuan në vendimet e vendeve dhe shteteve të caktuara për t'u bashkuar me njërin apo tjetrin koalicion? Përse udhëheqësit politikë ndërruan pjesëmarrjen në koalicion? A pëputhen veprimet e udhëheqësve politikë me deklaratat e tyre në fillim të Luftës?

Id. Organizatat fetare

I-51. Deklaratë e kryepeshkopit të Janinës (Greqi), drejtuar të gjithë të krishterëve nën juridiksionin e tij (10/9/43)³¹

Të krishterëve të vendit tonë,
Që nga data 9 e këtij muaji, administrimi ushtarak i Epirit është në duart e autoriteteve pushtuese gjermane. Zyrtarë të këtyre autoriteteve kanë deklaruar se ushtria gjermane e ka ndërmarrë këtë veprim për të mbrojtur popullin paqësor që zbaton ligjin. Ata i konsiderojnë partizanët si armiq jo vetëm të ushtrisë gjermane, por, gjithashtu, edhe të qytetarëve paqësorë, që do të mbajnë barrën kryesore të ndëshkimeve të ashpra, sepse do të jetë e nevojshme të merren masa, pa bërë dallim mes fajtorëve dhe të pafajshmëve.

E shfrytëzojmë këtë rast për t'iu drejtuar edhe një herë popullit të krishterë dhe për t'i kujtuar atij se në ç'periudhë kritike gjendemi, si dhe për t'i bërë një paralajmërim dhe këshillë prindërore njerëzve tanë që të distancohen nga veprimet e jashtëligjshme si dhe për t'i bindur më naivët që të mos të bashkëpunojnë dhe të mos ndihmojnë partizanët, në mënyrë që të shmangin vrasjen e njerëzve të pafajshëm.

E kuptojmë plotësisht ankthin në zemrën e çdonjërit prej jush, por në emër të detyrës sonë fetare, në emër të dashurisë së pastër për grigjën, në emër të jetës që ia kemi kushtuar mbrojtjes dhe shërbimit ndaj grigjës që na është besuar, ne i bëjmë thirrje gjithësecilit që të lërë mënjanë interesat vetjake dhe të mendojë për të mirën e përbashkët, të mirën e një numri të madh njerëzish të pafajshëm, të cilët janë të pambrojtur nga rreziqet e panumërta; dhe u kërkojmë të kenë kujdes, të kuptojnë situatën e rëndë në të cilën ndodhemi dhe të jenë të durueshëm.

Presim dhe shpresojmë që kjo thirrje e fundit e jona do të merret parasysh dhe do të mirëpritet.

Duke iu lutur Zotit

Janinë, 10 shtator 1943

Spiridon, Kryepeshkop i Janinës

Fleischer, vëll. 2, f. 222.

? Çfarë u këshillohet të krishterëve nën juridiksionin e tij kryepeshkopi i Janinës? Cilat janë arsyet e këtij veprimi? A mund të kuptohet nga kjo letër nëse kryepeshkopi i miratonte veprimet e autoriteteve gjermane apo jo?

I-52. Letër e kryepeshkopit Damaskinos dhe figurave të tjera të shquara greke, drejtuar Gunter von Altenburgut, ambasadorit gjerman në Greqi

Kryepeshkopi Damaskinos dhe figura të tjera të shquara greke i drejtohen Gunter von Altenburgut, ambasadorit të plotfuqishëm të Rajhut në Greqi

Athinë, 24 mars 1943

Shkëlqesia Juaj,

Ne që kemi nënshkruar këtë letër, nuk kërkojmë që të ndërhyjmë në taktikat e autoriteteve gjermane në vendin tonë ose gjetkë, por thjesht duam t'ju bëjmë të ditur disa mendime lidhur me një ngjarje që në ditët e fundit ka mbajtur pezull dhe ka tronditur të gjithë shoqërinë greke. Jemi të bindur se ju do t'i shqyrtoni ato, i prirur nga një ndjenjë e thellë vullneti të mirë dhe mirëkuptimi akoma më të thellë. Çështja në fjalë ka të bëjë me dëbimin nga Selaniku të komunitetit hebre me kombësi greke. Qysh prej një kohë të gjatë, ky komunitet është integruar plotësisht dhe vepron në përputhje me ligjin dhe rregullat e institucioneve të këtij vendi ; dhe jo vetëm që grekët nuk kanë pasur arsye të ankohen për ta, por përkundrazi, ata kanë qenë shembull i një solidarizimi serioz dhe bashkëpunues me grekët ; dhe në periudha krize, ata kanë provuar se janë të gatshëm për vetëmohim dhe vetësakrifikim për çështjen e këtij vendi. (...)

Duhet theksuar, gjithashtu, se hebrenjtë në Greqi kanë një mentalitet që ndryshon nga ai i hebrenjve në Gjermani, dhe ata nuk dinë as gjuhën e hebrenjve

³¹ Shiko gjithashtu burimet III-6 dhe III-7.

në Poloni, vend në të cilin po dërgohen për të jetuar. Duke marrë në konsideratë ç'përmendëm më lart dhe duke pasur parasysh se përgjatë gjithë historisë greke marrëdhëniet tona me komunitetin hebre kanë qenë gjithmonë në harmoni dhe të qeta – që nga antikiteti i hershëm, në kohën e Aleksandrit të Madh dhe pasardhësve të tij, nëpër periudhat e tolerancës së ortodoksisë greke ose në kohën e krijimit të shtetit tonë kombëtar – besojmë se me statusin e lartë që gëzon Shkëlqesia Juaj, si administrues i çështjeve të vendit tonë gjatë periudhës së Luftës, nuk do të ngurroni të mbështesni kërkesën tonë dhe të vendosni që dëbimi i komunitetit hebre nga Greqia të ndërpritet, të paktën për një farë kohe, derisa çështja e hebrenjve në Greqi të studiohet në mënyrë të veçantë dhe më të thellë.

(...)

Shkëlqesia Juaj,

Në emër të atyre idealeve madhore që shpirti grek dhe kultura e lartë e vendit tuaj i kanë bërë të fitojnë një reputacion universal dhe autoritet të padiskutueshëm, ju lutemi që të ndërpritet dëbimi i bashkatdhetarëve tanë hebrenj sa më shpejt të jetë e mundur, dhe ju sigurojmë se i gjithë populli grek do t'ju jetë mirënjohës për gjestin e shkëlqyer historik që do të bëni.

Dokumente mbi historinë e hebrenjve grekë, f. 264-265.



Kisha ortodokse që vazhdoi të funksiononte në Athinë gjatë pushtimit, luajti një rol të rëndësishëm në çështje fetare dhe politike gjatë kësaj kohe dhe u përpoq që t'i ndihmonte hebrenjtë të largoheshin nga vendi ose të fshiheshin që të shpëtonin. Pasi kishin filluar deportimet e para, kryepeshkopi Damaskinos organizoi një takim me akademikë të shquar, gjykatës dhe juristë, si dhe me presidentët e sindikatave dhe shoqatave të profesionistëve. Në këtë takim u përgatitën peticione për qeverinë kuislinge dhe përfaqësuesin e plotfuqishëm të Rajhut, të firmosura nga Damaskinos dhe 21 figura të tjera publike, ku shprehej tmerri i popullit grek në lidhje me deportimet dhe u kërkohej atyre që këto veprime të ndërpriteshin menjëherë.



Çfarë shkruajnë autorët e kësaj letre mbi komunitetin hebre në Greqi? Ç'kërkojnë ata që të bëjë ambasadori? A e vinin veten në rrezik këto figura të respektuara publike duke firmosur këtë letër (kini parasysh politikën antisemite gjermane dhe egërsinë e vetë regjimit)? Sipas mendimit tuaj, përse autorët e kësaj letre theksojnë se "...hebrenjtë në Greqi kanë një mentalitet që ndryshon nga ai i hebrenjve në Gjermani..."?

I-53. Kisha katolike e Shqipërisë mbi pushtimin italian

Që prej datës historike të 7 prillit 1939, Shqipëria pati fatin e lumtur për vullnet të Duçes së Madh të Fashizmit, Shkëlqesisë së Tij Benito Mussolinit, Shpëtimtarit të Shqipërisë, dhe pas dëshirës të shfaqur prej popullit shqiptar me anë të Asamblesë Kushtetuese të datës 12 prill të vitit 1939: shqiptarët dhe populli vëlla italian u bashkuan, në fatet e tyre të destinuar prej kohësh sipas fatit të caktuar prej natyrës që nga kohërat më të lashta e gjer më sot, nën Kurorën e shkëlqyer dhe të ndritshme Savoja dhe nën personin e Lartë të Madhërisë së Tij Viktor Emanuelit III, Mbretit të madh dhe tri herë fitimtar dhe u bënë një, në kuadrin e Perandorisë së re Romane dhe nën shenjat e shquara të Liktorit. Që në këtë kohë të lumtur, Shqiptarët janë të lirë të shfaqin pa ndrojtje ndjenjat e tyre dhe aspiratat që kanë për çdo pikëpamje, gjë që nuk guxonin ta bënin që prej kohës së trimit të tyre Legjendar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

Hylli i Dritës, dhjetor 1940, f. 601.



Ky fragment është shkëputur nga një artikull i botuar në revistën "Hylli i Dritës", organ i Kishës Katolike Shqiptare dhe një nga revistat më të rëndësishme të kohës në vend.

I-54. Letër e shkruar nga një grup priftërinjsh ortodoksë malazez, 16 qershor 1942

Pas fundit të dinastisë malazeze të Cërnojeviçeve³², udhëheqësit e popullit u bënë klerikët, të cilët drejtuan me dinjitet luftën për kryqin e bekuar dhe për lirinë e lavdishme kundër pushtuesve aziatikë për pesëdhjetë vjet me radhë. Shembulli i dhënë prej Shën Peterit të Cetinës³³, peshkopit Rade³⁴ dhe shumë priftërinjve të tjerë, të cilët dhanë kontribut të madh për fitoren e kësaj lufte, frymëzoi shumë prej klerikëve të ngrihen me armë në dorë dhe të luftojnë përkrah popullit të tyre kundër pushtuesit dhe shërbëtorëve të tij, sot kur populli ynë është nënshtruar prej pushtimit më të tmerrshëm të hordhive të egra fashiste imperialiste. Por, fatkeqësisht, jo të gjithë klerikët zgjodhën këtë rrugë. Disa prej tyre morën rrugën e turpits dhe u bënë bashkëpunëtorë dhe shërbëtorë të pushtuesit të urryer, u bënë spiunë dhe minus të luftës sonë popullore.

Ne, priftërinjtë dhe luftëtarët popullorë, i demaskojmë këta priftërinj, qofshin këta kryepeshkopë, zyrtarë të kishës ose dhe priftërinj të thjeshtë, sepse ata janë tradhtarë të popullit dhe vendit të tyre. Ne nuk i njohim peshkopët, të cilët kanë bashkëpunuar me pushtuesin, deri sa ata të provojnë se nuk kanë tradhtuar vendin e tyre. Lufta nacionalçlirimtare nuk është luftë partiake, është lufta e popullit të ndershëm e të drejtë të Malit të Zi dhe Bokës, i cili është ngritur në këmbë për të luftuar deri sa të shfarosë pushtuesin dhe bashkëpunëtorët e tij, tradhtarët e kombit: Nediçin³⁵,

Mihailoviçin³⁶, Stanishiçin³⁷, Dërljeviçin³⁸, Kërsta Popoviçin³⁹ dhe shumë të tjerë të cilët janë shitur për para dhe pushtet tek armiku ynë i përjetshëm, fetar dhe kombëtar. Lufta e sotme bëhet për liri fetare dhe kombëtare, kundër çdo lloj hegjemonie. Ne nuk pyesim kush e drejton këtë luftë, për sa kohë që ajo bëhet në emër të çlirimit popullor. Çdo malazez dhe banor i Bokës, pa dallim bindjesh politike, mund të futet në radhët tona.

Ne, të mbledhur sot në këtë takim, u bëjmë thirrje vëllezërve tanë që janë internuar ose burgosur, që të durojnë me dinjitet deri ditën e çlirimit kombëtar. Vuajtjet e tyre dëshmojnë se ata janë anëtarë të denjë të kishës sonë.

Zbornik dokumenta NOR[Përmbledhje me dokumente nga Lufta Nacional Çlirimtare], f. 368-369.

I-55 dhe I-56.

Boshnjakët e Sarajevës rreth gjendjes në Bosnjë dhe Hercegovinë (në atë kohë, pjesë e Shtetit të Pavarur Kroat)

Më 12 tetor 1941, pas propozimit të bërë nga Kryesia e "El Hidajas"⁴⁰, shoqata e klerikëve myslimanë, u hartua një rezolutë nga rreth 100 myslimanë nga Sarajeva. Në rezolutë përmendeshin kushtet e vështira në të cilat gjendeshin myslimanët e Bosnjë-Hercegovinës, kritikoheshin dhuna ndaj serbëve dhe hebrenjve, mohoheshin se myslimanët ishin përgjegjës për krimet e kryera dhe, në të njëjtën kohë, kritikoheshin ata myslimanë që kishin marrë pjesë në akte dhune. Nënshkruesit e kësaj rezolute bënin të ditur kërkesat e tyre, mes të cilave më të

³² Dinastia Cërnojeviç sundoi në Malin e Zi gjatë shekullit të 15^{te}.

³³ Peteri I Petroviç Njegoshi ishte sundimtar i Malit të Zi dhe mitropolit i Cetinës (1784-1830). Ai u shpall shenjtor në vitin 1834.

³⁴ Peshkopi Rade ose Petar II Petroviç Njegoshi (1830-1851), ishte sundimtar i Malit të Zi, kreu i kishës malazeze dhe poet i shquar.

³⁵ Milan Nediçi ishte ministër i Mbrojtjes në qeverinë e Mbretërisë së Jugosllavisë. Ai u bë kreu i administratës kuislinge në Serbi, në gusht të vitit 1941.

³⁶ Dragoljubi ose Drazha Mihajloviç ishte udhëheqësi i lëvizjes çetnike në vitet 1941-1945.

³⁷ Bajo Stanishiçi ishte kolonel në ushtrinë mbretërore jugosllave, si dhe komandant çetnik. Deri në vitin 1942, ai mori pjesë në lëvizjen çlirimtare. Më pas, i vuri trupat e tij ushtarake në dispozicion të forcave italiane, në luftën e tyre kundër Lëvizjes Nacional Çlirimtare.

³⁸ Sekula Dërljeviçi punoi për ringritjen e shtetit malazez nën protektoratin e Italisë fashiste, pasi forcat italiane pushtuan Malin e Zi në prill të vitit 1941. Ai ishte një ndër organizatorët e konferencës së mbajtur ditën e Shën Pjetrit, në vitin 1941. Ai gjithashtu bashkëpunoi me regjimin e ustasëve, të drejtuar prej Ante Paveliçit.

³⁹ Kërsto Popoviçi ishte komandant i Brigadës së Gjellbër të Lovcenit gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai bashkëpunoi me forcat pushtuese italiane dhe gjermane.

⁴⁰ El Hidaja ishte organizata kryesore islamike në Bosnjë dhe Hercegovinë.

rëndësishmet ishin: vendosja pa ndonjë dallim e “sigurisë për jetën, nderin, pronën dhe besimin e të gjithë qytetarëve të shtetit” dhe parandalimin në të ardhmen të “veprimeve të cilat mund të shkaktojnë kryengritje dhe gjakderdhje në popull”.

Redžić, f. 16.



Disa përfaqësues boshnjakë u tronditën nga krimet e kryera prej autoriteteve të Shtetit të Pavarar Kroat ndaj popullsisë serbe dhe çifute në Bosnjë dhe Hercegovinë gjatë vitit 1941. Në tetor të këtij viti, ata nxorën një rezolutë në të cilën shprehnin qëndrimin e tyre.

Klerikët islamikë dhe krijimi i divizionit SS boshnjak në vitin 1943

Rol kryesor në rekrutimin e njerëzve për divizionin eses patën myftitë dhe imamët myslimanë. Veçanërisht aktivë në këtë detyrë ishin imamët Mustafa Malkoçi dhe Halim Malkoçi, të cilët i mbledhnin njerëzit përpara xhamive, mbanin fjalime propagandistike dhe bënë thirrje për rekrutë që të bashkoheshin me Divizionin XIII SS. Rekrutët çoheshin në Gjermani, dhe më pas në Francën Jugore, ku i nënshtroheshin një disipline të rreptë, bënë stërvitje ushtarake dhe merrnin edukim politik. Qëllimi kryesor i kësaj forme edukimi ishte që t'i kthente anëtarët e këtij divizioni në ekstremistë islamikë, të betuar për qëllimet e luftës së Rajhut të Tretë. Ushtarakët e Divizionit XIII SS merrnin mësim nga myftinj të rinj, të cilët ishin shkolluar më parë në mënyrë panislamike në një shkollë speciale të ngritur në Berlin nga El Huseini, myftiu i madh i Jeruzalemit.

Redžić, f. 120.



Krahasoni këto dy burime. Në ç'aspekte ndryshojnë veprimet e klerikëve myslimanë nga njëri-tjetri? A mund të gjeni shembuj të ngjashëm nga vendi juaj?

I-57 dhe I-58.

Fjalimi i mbajtur në vitin 1942 nga patriarku rumun, shenjtëria e tij Nikodimi, në Fakultetin e Juridikut në Bukuresht

“Ka mbetur vetëm një gjë për të cilën duhet të mendojmë. Armiqtë tanë janë edhe armiqtë e Kryqit, armiq të një civilizimi, i cili u krijua me mund dhe sakrifica të papershkrueshme, bazuar në Ungjillin e Shenjtë dhe në shkencë. Bolshevikët lëshojnë blasfemi kundër Zotit dhe luftojnë për të shkatërruar Kryqin dhe çdo gjë të ngritur prej tij. Ata rrënojnë tokën e të parëve tanë dhe prishin varret e tyre⁴¹ (...) Duke i patur rrënjët thellë në një të shkuar të mbuluar me gjak, ne e mbrojmë këtë trashëgimi që na kanë lënë të parët dhe që i përket të gjithë botës së qytetëruar. Ne luftojmë për Kryqin e Shenjtë dhe për Ungjillin e Shenjtë dhe lutemi tek Zoti dhe Jezu Krishti”.

“Universul”, 79/2.03.1942, f. 4.

Kishat motra. Një e ardhme e shkëlqyer për ortodoksinë

(Artikull në shtyp, shkruar nga Mihai Burlacu)

“Sapo në Lindje ndaloi lufta, ra velloja e zezë që ndau dy kishat ortodokse motra – kishën motër më të madhe, Patriarkanën Ortodokse Ruse, me motrën e saj më të vogël, Patriarkanën e kishës sonë Ortodokse Rumune. (...)”

Fjalët e shenjtërisë së tij Nikodimit, patriarkut të kishës ortodokse rumune, ... nderuan Patriarkanën Ortodokse Ruse, motrën tonë më të madhe: “Kohët e fundit, Shenjtëria e tij, kryepeshkopi Aleksi i Leningradit dhe Novgorodit, ... iu drejtua besimtarëve ortodoksë në vendin tonë të dashur me fjalë vëllazërore që nxisnin dhe frymëzonin shpresë për popullin tonë të dashur dhe për të mirën e kishës sonë të shenjtë. Këto mendime të kishës motër që beson në Jezu Krisht, na gëzuan shumë. Dëshira jonë e madhe është të shikojmë të rivendosen dhe të forcohen lidhjet më të ngushta me motrën tonë që beson në të njëjtin Zot, kishën ortodokse të Bashkimit të Republikave Socialiste

⁴¹ Ky pohim i referohet pushtimit të Besarabisë dhe Bukovinës nga Bashkimi Sovjetik në verën e vitit 1940.

Sovjetike, bazuar në frymën e dashurisë vëllazërore të krishterë”. (...)

Por zhvillime të reja të mëdha priten në të ardhmen e ortodoksisë. Një këshill i përgjithshëm me teologë dhe klerikë nga të gjitha kishat ortodokse të Ballkanit pritej të ngrihej, por s’mund të ketë një këshill të tillë pa pjesëmarrjen e motrës së madhe, Patriarkanës Ortodokse Ruse. Për më tepër, teologët kanë nisur studime dhe kërkime serioze mbi organizimin e Kishës Anglikane, në krahasim me kishat motra ortodokse. Por ata nuk arritën në një konkluzion përfundimtar, pa një mirëkuptim të përgjithshëm të të gjitha kishave ortodokse. Pra, është e kuptueshme, gjithashtu, nga pikëpamja jonë fetare, përse Kisha anglikane përshëndeti me një lutje të ngrohtë dhe me një nderim fetar çastin e ribashkimit si vëllezër të dy popujve të krishterë ortodoksë.

“Universul”, 291/28. 10. 1944.



Ku ndryshojnë këto dy tekste nga njëri-tjetri? Çfarë mund të kuptoni nga këto dy deklarata të patriarkut Nikodim lidhur me trysninë e jashtme që ushtrohej mbi të? Sipas mendimit tuaj, a ndryshoi qëndrimi ndaj bolshevikëve? Nëse po, cilat ishin arsyet për këtë?⁴² Shpjegoni përgjigjen tuaj.

I-59. Në manastirin e Ostrogut, më 23 prill 1941, Gestapoja gjermane arreston patriarkun Gavriilo

Pas kapitullimit të ushtrisë jugosllave më 16 prill, unë qëndrova në Ostrog. Kisha si qëllim të kthehesha sa më shpejt të ishte e mundur në Patriarkanë, në Beograd. Sidoqoftë, kjo nuk ishte diçka e lehtë. Rrugët ishin dëmtuar, nuk kishte karburant dhe s’kishte as nga të merrje. Për më tepër, me mjetet e

blinduara dhe tanket e tyre, pushtuesit i shkatërruan rrugët, që gjithsesi kishin qenë në gjendje të mjerë. Kështu që po prisja çastin e duhur për t’u kthyer. Më 23 prill, pak para orës 6 të mëngjesit, Milutini⁴³ trokiti në derën time... Sapo hyri në dhomë, më tha: “Hirësi, kanë ardhur gjermanët dhe po ju kërkojnë.” Ai ishte shumë i trembur dhe i shqetësuar. Duke e parë në këtë gjendje, i thashë: “Të lutem qetësohu, mos u shqetëso. Ty nuk do të të ndodhë asgjë... gjermanët më kërkojnë mua.” Sapo mbarova fjalën, katër gjermanë me uniforma ushtarake u futën në dhomën time pa trokitur. Ata kishin inicialet SD tek mëngët dhe jakat e xhakave, që tregonte se ishin të policisë politike apo GESTAPO-s...

(...) Koloneli më tha: “Ti cilësohesh si kriminel kryesor i luftës dhe shkaktari i futjes së Jugosllavisë në luftë kundër Forcave të Boshtit. Mbi këtë bazë, kam marrë urdhër nga komandanti i përgjithshëm i forcave ushtarake dhe civile, Fyhreri Adolf Hitler, të të marr në pyetje rreth veprimtarisë tënde kriminale dhe më pas, t’ia kaloj çështjen një gjykate më të lartë ushtarake, e cila do të japë një vendim të drejtë, të bazuar në ligjin ushtarak...; ti je futur në politikë, në mënyrë që të përhapësh idetë e tua dhe të frymëzosh popullin që të bëjë qëndresë të fortë kundër Forcave të Boshtit. Sidomos, që nga nënshkrimi i Paktit më 25 mars, kur Jugosllavia u bashkua me Paktin Tripalësh me dëshirën e saj... çdo gjë që ti ke bërë u përkrah nga anëtarët e bashkësisë tënde, të cilët i brumose me idenë e revoltës dhe së bashku përgatitën një grusht shteti...; ti personalisht e çove Jugosllavinë në luftë dhe rrëzove Regjencën e ligjshme Mbretërore dhe qeverinë e saj..., sapo filloi lufta, në vitin 1939, ti fillove të bësh takime më të shpeshta me popullin serb dhe në fjalimet e tua mbizotëronte një frymë lufte... se duhej bërë çdo lloj qëndrese ndaj Forcave të Boshtit, sepse ishin armiq të shtetit jugosllav.”

Memoari patriarjha srpskog Gavriilo [Kujtimet e patriarkut serb, Gavriilo], f. 291, 299, 300.

⁴² Një nga arsyet mund të jetë ndryshimi i qëndrimit të regjimit bolshevik ndaj kishës ruse nga njëra periudhë në tjetrën. Pas persekutimit në vitet 30-të dhe në fillim të viteve 40-të, në vitin 1943 Kisha ruse u lejua përsëri me ligj. Ky ndryshim në politikën e Stalinit mund t’i ketë dhënë shpresa edhe Kishës rumune se mund të jetohej me bolshevikët. Për më tepër shiko: Pospiclovski: “Kisha ruse nën regjimin sovjetik”, vol. I.

⁴³ Shoqëruesi i përhershëm i patriarkut (shënim i përkthyesit).



Patriarku i kishës ortodokse serbe, Gavriilo (Dozhiç, patriark qysh nga viti 1938 deri më 1950) u internua në fillim të Luftës në manastirin e Ostrogut, në Malin e Zi, si kundërshtar i politikës së ndjekur nga Forcat e Boshtit dhe afrimit të Jugosllavisë me këto shtete. Pas shumë vuajtjesh, ai u transferua në Sarajevë, dhe më pas në një burg të Gestapos në Beograd. Autoritetet gjermane e internuan në manastirin e Rakovicës, pranë Beogradit dhe më pas në manastirin e Vojlovicës. Ai qëndroi atje nën mbikëqyrje dhe izolim të plotë deri në shtator të vitit 1944, kur u transferua, së bashku me peshkopin Nikolaj Velimiroviç, në kampin e përqendrimit të Dahaut, ku qëndruan disa muaj. Megjithëse ishte kundërshtar i regjimit të ri komunist, ai u kthye në atdhe në vitin 1946 dhe u përpoq të ndihmonte në rimëkëmbjen e vendit të shkatërruar nga lufta dhe në rivendosjen e organizmave të kishës, që në disa zona ishin shkatërruar pothuajse plotësisht (veçanërisht në territoret që ishin pjesë e Shtetit të Pavarur Kroat).



Si reagoi patriarku kur i thanë që po e kërkonin gjermanët? Për çfarë akuzohej ai? Krahasoni besimin e patriarkut Gavriilo me atë të kryepeshkopit Stepinac (në dy burimet e mëposhtme).

I-60 dhe I-61.

Thirrja që Stepinaci i bën klerit katolik për të mbështetur Shtetin e Pavarur Kroat, 28 prill 1941

Tani nuk është më koha për të fjalosur, por për të derdhur gjakun, i cili na lidh në mënyrë të mistershme me tokën në të cilën pamë dritën e Zotit dhe me kombin në të cilin lindëm. A ka nevojë të përmendim se edhe zemrat filluan të na rrahin më fort në gjoks? (...) E kush mund të na kundërshtojë, nëse ne, si udhëheqës shpirtërorë, japim ndihmesën tonë për lumturinë dhe harmoninë e kombit, duke iu drejtuar Zotit të madhërueshëm me përlujë dhe mirënjohje të thellë (...)

Duke ju drejtuar juve si përfaqësues të kishës dhe barinj të shpirtërave, ju lutem dhe ju bëj thirrje që të bëni të pamundurën për Kroacinë, që ajo të bëhet toka e Zotit, sepse vetëm kështu do të jetë në gjendje të përmbushë ato detyrime të rëndësishme që ka ndaj shtetasve të saj... Prandaj

duhet t'i përgjigjeni menjëherë kësaj thirrjeje dhe të bëni këtë përpjekje fisnike për të ruajtur dhe zhvilluar SHPK-në.

Živojinović, Lučić, f. 554-556.

Letër e Stepinacit dërguar Paveliçit, më 14 maj 1941

“Poglavnik [Udhëheqës]!

Sapo mora lajmin se në Glina ustashët pushkatuan pa hetim dhe pa gjyq 260 serbë. E di që serbët kryen krime të rënda në vendin tonë gjatë këtyre 20 viteve të sundimit të tyre, por përsëri e ndiej për detyrë që si peshkop të ngre zërin dhe të them se kjo është e papranueshme për moralin katolik; prandaj po ju kërkoj që të merrni masat më të ngutshme në të gjithë territorin e Shtetit të Pavarur Kroat, në mënyrë që asnjë serb i vetëm të mos vritet, nëse nuk provohet se është fajtor dhe që meriton vdekjen. Në të kundërt, nuk mund të shpresojmë në bekimin e Zotit, pa të cilin jemi të gjithë të mallkuar. Shpresoj se nuk ju kam ofenduar duke folur hapur.”

Krišto, f. 134-135.



Një pjesë e klerikëve të lartë katolikë në Kroaci, midis të cilëve edhe kryepeshkopi i Zagrebit që mbante një post të rëndësishëm, Alojsije Stepinaci, në fillim mbështetën krijimin e Shtetit të Pavarur Kroat. Stepinaci, që u shpall edhe kleriku më i lartë i Forcave të Armatosura të SHPK-së, më 4 maj 1941 urdhëroi mbajtjen e një meshe solemne në të gjitha kishat e vendit për nder të shpalljes së SHPK-së; në të do të ftoheshin të merrnin pjesë edhe autoritetet vendore dhe banorët e këtyre zonave. Megjithatë, pak pas krijimit të SHPK-së, kryepeshkopi Stepinac u shkroi disa letra zyrtarëve ustashë, në të cilat ai zyrtarisht protestonte ndaj krimeve të kryera nga regjimi i ustashëve, dhe më vonë filloi t'i kritikonte hapur në predikimet e tij. Në atë kohë, ndryshime të tilla në qëndrimin ndaj regjimit të ustashëve nuk ishin karakteristike vetëm e Stepinacit, por edhe e pjesës më të madhe të popullit në Kroaci. Megjithëse denoncoi disa aspekte të regjimit të ustashëve, Stepinaci, duke qenë një radikal antikomunist, gjithsesi nuk u distancua nga SHPK-ja, sepse i konsideronte partizanët (ose për të qenë më të saktë, komunistët) si armiqtë kryesorë. Pas Luftës, autoritetet komuniste e dënuan si bashkëpunëtor me 16 vjet burg dhe punë të detyruar. Gjatë kohës që ishte në

burg, Selia e Shenjtë e nderoi me titullin kardinal dhe Jugosllavia reagoi ndaj këtij veprimi, duke ndërprerë marrëdhëniet diplomatike me Vatikanin. Në vitin 1960, Stepinaci vdiq në internim. Papa Gjon Pali II e lumturoi atë në vitin 1998⁴⁴.

I-62. Atë Zlatko Sviriči⁴⁵, mbi konvertimin e serbëve ortodoksë në katolikë

“Një ditë të bukur qershori, përpara famullisë u shfaqën rreth 30 burra të moshuar, të gjithë të krishterë ortodoksë... (...)

Dukeshin të zymtë, të shqetësuar, shumë të frikësuar dhe të pasigurtë, gjë që më la një shije të papëlqyer. ‘Çfarë ka ndodhur, o vëllezër, o njerëz të mirë, ç’e mirë ju ka sjellë të gjithëve këtu?’ - i pyeta me zë të lartë, që t’u hiqja atë hije të zymtë që u kishte rënë dhe nga ana tjetër ta kisha më të lehtë për të folur me ta.

‘Asgjë e mirë, atë Zlate’, - m’u përgjigjën me një gojë. ‘Shiko! Na kërkoni që të ndryshojmë fenë me forcë në këtë moshë. Ku është dëgjuar një gjë e tillë sot, në shekullin e njëzetë?’ Flisnin duke psherëtirë thellë dhe lotët u rridhnin nëpër faqe. E kuptova se ishin shtyrë nga mjerimi dhe fati i tmerrshëm që u kishte rënë. Më erdhi në mend se ndoshta nuk kishin ngrënë ose pirë asgjë atë mëngjes, kështu që i ftova të ulen në hije dhe i thashë djalit të sillte ndonjë gjë për të ngrënë, pak raki dhe verë. Ndërkohë po mendoja se këta njerëz duhej të ndihmoheshin. Do t’u fallsifikoj certifikatat e pagëzimit. Ndjeva sikur u çlirova atë çast. Gjeta përsëri paqen dhe besimin tek vetja. (...)

Pasi hëngrën dhe pinë dhe pasi ishin qetësuar pak, iu drejtova Lazarit me zë të lartë, në mënyrë që të më dëgjonin të gjithë:

‘Më thuaj, Lazar, a ke lindur si serb i besimit ortodoks?’

‘Po, ashtu kam lindur, atë Zlatko (...)’

‘A jeton si i tillë, Lazar?’

‘Po, ashtu jetoj, dhe Zoti më është dëshmitar, atë Zlatko.’

‘Atëherë do të vdesësh si i tillë, Lazar. Nuk do ta ndryshosh besimin dhe askush nga ju nuk do ta ndryshojë, sa të jem unë gjallë këtu!’

Burrat ngritën kokat dhe më vështruan ngulmas dhe në sy iu shfaq dyshim dhe frikë. Filluan të më bëjnë pyetje. Çfarë duhet të bënin tani? Ishte e kuptueshme që ishin të frikësuar. U shpjegova vendimin që kisha marrë. Fatkeqësisht në famulli më gjendeshin vetëm pak certifikata pagëzimi, prandaj u thashë se nesër do të merrja për të gjithë. Hyra në shtëpi dhe fillova menjëherë të mbushja formularët. Të parin për Lazarin.”

Cvitković, f. 113-114.



Një nga mënyrat e përdorura nga autoritetet ustashe për të “zgjidhur” çështjen serbe ishte konvertimi i tyre në katolikë⁴⁶. Megjithëse zyrtarisht Shteti i Pavarur Kroat, i drejtuar nga Paveliçi, nuk e përkrahu konvertimin e besimit fetar, në praktikë sigurisht që e mbështeti atë, pasi konvertimi nëpër famulli ishte diçka e zakonshme. Kryepeshkopi Stepinac, në deklaratat e tij, u distancau nga praktikimi i konvertimeve me forcë dhe madje protestoi kundër tyre, por disa historianë ende mendojnë se është e dyshimtë nëse ai bëri gjithçka që ishte e mundur për ta parandaluar këtë fenomen. Konvertimi bëhej me justifikimin se vetëm kështu mund të shpëtoheshin serbët ortodoksë nga terrori i ustasëve. Megjithatë, edhe pse mund të shpëtonin kokën duke vepruar në këtë mënyrë, shumica e tyre nuk e pranoi me dëshirë këtë “bujari”. Siç tregohet edhe në këtë fragment, disa priftërinj nëpër famulli e kundërshtuan politikën e konvertimit në katolicizëm.

⁴⁴ Në Jugosllavinë komuniste, historiografia e kohës e paraqiste Stepinacin, bazuar në vendimin e gjyqit, si bashkëpunëtor me fashistët dhe figurë krejtësisht negative. Rreth kësaj çështjeje nuk lejohej asnjë debat publik. Me rënien e komunizmit, figura e Stepinacit u paraqit në historiografi krejtësisht ndryshe dhe tani, në përgjithësi ai vlerësohet si figurë pozitive, si një njeri i drejtë, martir dhe viktimë e rrethanave historike (ky përshkrim jepet më së shumti në librat shkollorë të Historisë). Ndërmjet këtyre dy skajëve ka një numër historianësh të cilët vlerësojnë meritat e tij (shpëtimin e hebrenjve, protestat dërguar autoriteteve), por ka të tjerë, gjithashtu, që marrin parasysh edhe dështimet e tij (faktin që ai kurrë nuk arriti të distancohej nga SHPK). Në librin e tij *Historia kroate*, një historian i nderuar kroat, Ivo Goldstein, thotë ndër të tjera se faji i Stepinacit “... në ato ngjarje të turbullta lufte mund të ishte vetëm moral dhe politik, por ai kurrë nuk duhej të gjykohej si kriminel”. (Ivo Goldstein, *Hrvatska povijest*, Zagreb, 2003, f. 309). Historiografia serbe nuk e ndryshoi mendimin e saj për Stepinacin, duke e konsideruar atë përgjegjës për bashkëpunimin me autoritetet ustashe dhe për faktin që ai nuk dënoi krimet kundër civilëve dhe klerikëve të Kishës ortodokse serbe.

⁴⁵ Një prift katolik.

⁴⁶ Dy mënyrat e tjera ishin: internimi dhe shfarosja e tyre.

? Ç'mendoni për veprimin e atë Zlatkos? Përse ai vendosi t'i ndihmonte ata njerëz?

? **Pyetje të përgjithshme mbi nënkapitullin Id.**

Përshkruani qëndrimet e drejtuesve fetarë ndaj forcave pushtuese, ndaj ushtrisë partizane dhe ushtrisë antikomuniste. Çfarë ngjashmëri dhe ndryshimesh mund të gjeni në deklaratat e drejtuesve të besimeve të ndryshme? A u lejohet apo a janë ata të detyruar të përkrahin njërin palë në luftë?

KAPITULLI II: Jeta në kohë lufte

Ky kapitull paraqit qartë se vuajtjet njerëzore ishin për të gjithë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Uria, varfëria dhe pasiguria ishin pjesë e jetës së përditshme për shumicën e njerëzve në këtë rajon dhe dallimet ishin thjesht në gjuhët që ato flisnin. Gjithsesi, është vështirë të thuhet nëse jeta ishte më e vështirë në qytet ose në fshat.

Në përpjekjen tonë për të treguar rreth jetës së përditshme të veprimtarëve të lëvizjeve të rezistencës, u përpoqëm ndër të tjera të vëmë në dukje ndryshimin në statusin e grave gjatë kësaj kohe. Në lëvizjet e rezistencës, barazia e grave me burrat ishte diçka që u pranua me gëzim, megjithëse koha do të tregonte se ndryshimi i vërtetë ishte shumë më i vogël ngasa mëtohej për arsye propagandistike: pas luftës, gjërat u kthyen në rutinën e njohur patriarkale, prandaj dhe shkrimet mbi barazinë gjinore janë më tepër në planin formal.

Në pjesën e fundit të këtij kapitulli jepen disa burime që kanë të bëjnë me ndryshime të dukshme në kulturë dhe arsim në vendet e rajonit dhe që e paraqitin elitën e cila e mori pushtetin në atë kohë, më të plotë dhe nga një këndvështrim interesant.

Ila. Varfëria, pasiguria

II-1 dhe II-2.

Shpërndarja e racionuar e bukës në Rumani gjatë luftës (1942)

Lidhur me racionimin e konsumit të grurit, Nënsekretariati i Shtetit për Furnizimin e Ushtrisë dhe Popullsisë Civile njofton publikun se duke filluar nga një datë që do të shpallet më vonë, buka do të shpërndahet në kryeqytet vetëm me triskë dhe vetëm 5 ditë në javë. Dy ditët e tjera, populli do të ushqehet me kaçamak misri dhe prandaj duhet që të furnizohet në kohë me miell misri nga furrat e bukës ose nga dyqanet ku shitet bukë.

“Universul”, 5/01.1942, f. 1.

Shpërndarja e racionuar e bukës në Rumani gjatë luftës (1944)

Me urdhër të prefekturës së rrethit Brashov, no. 26/1944, konsumi i bukës në të gjithë territorin e rrethit dhe qytetit Brashov do të jetë si më poshtë: Ditët kur do të konsumohet bukë e zezë: Të martave, të enjteve dhe të shtunave; Ditët kur do të konsumohet bukë e bardhë: Të dielave; Ditët kur do të konsumohet miell misri: Të mërkurave; Ditët kur do të konsumohen patatet: Të hënave dhe të premteve.

Njerëzit duhet të zbatojnë rregullat e mësipërme. Çdo thyerje e tyre do të ndëshkohet me masa ligjore.

Arkivat Kombëtare – Rrethi Brashov, fondi mbi Pushtetin vendor të komunës Bod, dosja. 74/1944, f. 83.



Ç'ndryshime shikoni nga njëra periudhë në tjetrën? Si shpjegohen ndryshimet, nëse ka të tilla? Ky shembull është marrë nga Rumania: A dini ndonjë shembull të ngjashëm nga vendi juaj?

► **Fig. 12. Shpërndarja e racionuar e bukës në Stamboll**



Cumhuriyet Ansiklopedisi vëll. 2 (1941-1960).

? Në Stamboll, shpërndarja e bukës me racion filloi më 14 janar të vitit 1942. Në maj, për njerëzit që ishin mbi moshën 7 vjeçare, racioni ditor ishte 150 gr për person.

? Si e shpjegoni faktin që në Turqi buka u shpërnda me racion, edhe pse ky vend nuk mori pjesë në Luftën e Dytë Botërore?

II-3. Një fshatar grek përshkruan pushtuesit italianë

“[italianët dhe bashkëpunëtorët e tyre vllëh] shkonin e vinin të poshtrit, na hanin pulat tona, na pinin verën tonë, na merrnin vezët... dhe ia kalonin shkëlqyeshëm! Na detyronin edhe t’i çonim ku të donin, me mushkat tona. E gjitha kjo na xhindosi shumë dhe thoshim gjithmonë: ‘Vallë, nuk do të dalë në krye një njeri që të na udhëheqë si Kolokotroni [luftëtar i revolucionit grek] e të fillojmë një revolucion?’”

Van Bouschoten, f. 80.

? Përshkruani ndjenjat e fshatarit. Nëse do të ishit në vend të tij, a do të ndienit të njëjtën gjë?

II-4. Diplomati bullgar, Ivan D. Stançov, përshkruan jetën e familjes së tij gjatë luftës

Familja ime kaloi tre muaj interesantë dhe aktivë, duke luftuar kundër çimkave dhe duke u përpjekur

të mbijetojë me kërpudha, boronica, hithra të njomë dhe me supë lëpjete. Sistemi me triska ishte i pamëshirshëm; jo vetëm që ishte e pamundur të gjeje mish, por askush nuk kishte të drejtë të therte ndonjë kafshë. Mund ta imagjinoni se sa i lumtur ishte bariu, kur ndonjë viç thyente këmbën dhe duhej therur. Familjarët e mi arritën të blenin një të tillë dhe hanin nga pak çdo herë, në mënyrë që ta shtynin sa më gjatë. Megjithëse për arsye të pashpjegueshme kripa ishte zhdukur nga tregu, si në Sofje, ashtu edhe nëpër fshatra, ata arritën ta ruanin mishin për një javë të tërë: e vendosën atë në dyshtemenë prej çimentoje dhe e mbuluan me një copë të lagur, cepat e së cilës ishin futur në një koritë me ujë të ftohtë, në mënyrë që copa të qëndronte e njomë në ditët e nxehta të korrikut.

Stançov, f. 145.

? Në ç’kushte jetonte familja e diplomatit të lartë bullgar? Duke pasur parasysh se këto ishin kushtet në të cilat gjendej elita e vendit, a mund të imagjinoni se në ç’kushte gjendeshin “njerëzit e zakonshëm”?

II-5. Fragment nga raporti konfidencial, nr. 162, i konsullit të përgjithshëm amerikan në Stamboll, Samuel Honaker, drejtuar Sekretarit të Shtetit të SHBA-së, Cordel Hull, mbi atmosferën e krijuar në Bullgari në shtator të vitit 1942

Stamboll, 4 nëntor 1942. Të gjithë filluan ta ndiejnë mungesën e ushqimit, veshjeve, qymyrit dhe druve për ngrohje. Sistemi i triskëtimit shpërndante nga pak ushqim, për pothuajse të gjithë, por në të vërtetë, ai nuk i mjaftonte askujt. Njerëzit rrinin në radhë të gjata përpara dyqaneve të ushqimeve. Bullgarët ishin të bashkuar rreth idesë se duhej t’i mbanin “territoret e reja” me çdo kusht. Megjithatë, kishte disa zëra që kundërshtonin, duke argumentuar se Bullgarisë së vërtetë, pra asaj pa territoret e pushtuara, i duhej të kujdesej edhe për mjetet e jetesës së popullsisë së këtyre territoreve të reja, sidomos Trakisë dhe disa rajoneve të Maqedonisë. Qeveria bullgare furnizonte me miell edhe fshatrat bullgare brenda kufirit grek, në zonën veriperëndimore të Selanikut. Kishte zëra se

më shumë se 300 000 veta kishin deklaruar se ishin bullgarë në ato zona, vetëm për të marrë miell. Kjo sigurisht që ishte thjesht propagandë. Askush nuk mund të pretendojë që Bullgaria do t'i lëshojë vetë territoret e pushtuara, pa qenë e detyruar.

Bulgaria – the Unmanageable Ally of the Third Reich [Bullgaria – Aleatja e pakontrolluar e Rajhut të Tretë], f. 90-91.

? Përse kishte grekë që e deklarorin veten bullgarë? Mendoni se ishte e lehtë për ata të bënin një gjë të tillë? (Kini parasysh periudhën historike që parapriu Luftën e Dytë Botërore në këtë rajon.)

► **Fig. 13. Radhë njerëzish në një dyqan në Lubjanë në kohën e Luftës**



► **Fig. 14. Radhë për të blerë mish në Zagreb**



? Në ç'konkluzion mund të arrini në lidhje me jetën në Lubjanë dhe Zagreb gjatë kohës së Luftës? A ka fotografi të tilla në vendin tuaj? Mungesa e gjithçkaje, veçanërisht e ushqimit, si dhe shpërndarja e prodhimeve të nevojshme me triskë apo duke lënë diçka peng, a ishin gjëra të zakonshme gjatë Luftës?

II-6. Kërkojmë që tregtarët mashtrues të detyrohen të mbajnë shiritat e turpit (fragment nga një gazetë serbe)⁴⁷

“Ne denoncojmë këtu haptazi dhe me përçmim të gjitha rastet e vjedhjeve nëpërmjet tregtisë së paligjshme dhe tregut të zi, dhe i kërkojmë çdokujt të na ndihmojë ne dhe qeverinë në këtë fushatë për të shpëtuar shoqërinë. Çdo qytetar i ndërgjegjshëm duhet të na informojë lidhur me këto raste – të cilat ne do t'i botojmë për t'i vënë damkën e turpit këtij lloji kriminelësh, pavarësisht nga posti që ata mbajnë. Gjithashtu, ftojme që të na dërgoni propozimet tuaja lidhur me masat që mund të merren për të mjekuar me sukses këtë plagë të shoqërisë sonë.

Sot po japim sugjerimin e një lexuesi, i cili mendon se lista e të dënuarve si kundërvajtës duhet të botohet në gazetën e përditshme. Ky lexues e di që kjo nuk mjafton si dënim për ta, por të paktën, lë një gjurmë të dukshme për krimet që kanë kryer. Dhe përderisa nuk mund t'i damkosim me hekur të nxehtë, me shenjën e turpit, ai propozon që të gjithë tregtarët e dënuar si kundërvajtës, duhet të mbajnë një shirit me nënshkrimin: “gjakpirës i popullit”, ose “tregtar në të zezë” ose edhe “spekulator me varfërinë e popullit”.

Srpski narod mendon se ky është një propozim logjik dhe i kërkon Qeverisë së Shpëtimit Kombëtar ta pranohet dhe ta zbatojë atë, sepse ka dhënë fjalën dhe është e detyruar të ruajë dhe të shpëtojë popullin nga të gjitha shqetësimet dhe fatkeqësitë, nga banditët komunistë në pyje, por edhe nga banditët në Terazije.

“*Srpski narod*” 3 qershor 1942.

⁴⁷ “*Srpski narod*”: gazetë zyrtare e Qeverisë kolaboracioniste të Shpëtimit Kombëtar, që drejtohej nga gjenerali Milan Nediç. Ishte gazetë e përditshme dhe botohej në Beograd.

? Komentoni kërkesën që tregtarët mashtrues të mbajnë shiritin e turpit. A jeni të një mendjeje me këtë propozim? A mund të gjeni një qëndrim të njëjtë (apo të paktën të ngjashëm) në vendin tuaj?

► **Fig. 15. Karikaturë turke**



TOMBUL TEYZE YURGUNCU KARŞISINDA:
Tombul Teyzenin kocası – Nafile bakma karsıcım, onun torbaları seninki gibi Allah vergisi değil..

Karikatur, 24 Eylül 1942 (Gökhan Akçura Arşivi)

Karikatur, 24 shtator 1942.

🔑 Përkthim: Tetoja e shëndoshë përballlet me mashtruesin. I shoqi i thotë: Mos ia vër re, e dashur! Gjnjtë e tij nuk janë si të tutë, që t'i ka dhënë Zoti!

II-7. Vështirësitë për të mbijetuar... Njerëzve në qytet u duhej të shitnin gjithçka që kishin, në mënyrë që të blinin pak ushqim

Ata ua shitën fshatarëve gjithçka që kishin në shtëpi; në këmbim, fshatarët u dhanë atyre ca ushqime. Së pari, sendet e florinjta dhe bizhuteritë, më pas shitën orenditë e shtëpisë: mobiljet, shtresat, veshjet. Njerëzit në qytet mbetën të zhveshur dhe këmbëzbathur, pa asgjë. Ndërsa fshatarët, si

fshatarët! Ushtritë e ndryshme u morën shumëçka fshatarëve, po ashtu edhe pushtuesit, kështu që çfarëdo që mundën të shpëtojnë nga grabitjet dhe të heqin mënjanë, u përpoqën ta shesin me sa më shumë leverdi. (...)

Fshatarët tanë ishin të pamëshirshëm edhe me njerëzit e mjerë dhe të uritur, për shkak të armiqësisë të vjetra midis shtresës aristokrate dhe fshatarësisë. Gjithmonë qyteti e shfrytëzoi fshatarin dhe nuk i dha asgjë si shkëmbim. Kështu që ai mendoi se i erdhi dita që të merrte hak për të gjitha.

Nikolić, f. 113.

? Si do e vlerësonit sjelljen e fshatarëve ndaj banorëve të qytetit? A keni dijeni për ndonjë material letrar apo film që trajton ngjarje të ngjashme me këtë? Sipas mendimit tuaj, a i paragjykon autori fshatarët?

II-8. Pasiguria e jetës gjatë Luftës në Shqipëri

“Ky burrë thotë se gjermanët ishin dje këtu. Ata morën batanije, ushqime, pesë pula dhe dy dhi. Pasi i nxorën njerëzit jashtë, me preteksin se do të kontrollonin, u vunë flakën shtëpive nga brenda. ‘Shumë nga fshatarët ikën dhe u fshehën, tha ai, sepse kishin frikë mos i merrnin robër.’ Geri i pyeti fshatarët nëpërmjet përkthyesit: ‘A kishin ndonjë shkak gjermanët për këto plaçkitje? A kanë ardhur herë tjetër këtu, dhe a ka pasur ngjarje të tilla?’ Një fshatar, shumë i shqetësuar, filloi të përgjigjej dhe vazhdoi të fliste deri sa Stefa e qëlloi lehtë në krah dhe ia ndali atë lumë fjalësh. Ai tha se ‘nuk e dinte përse e plaçkitën fshatin e tij’. ‘Mirë që morën gjithçka, vazhdoi ai, po përse duhej të digjnin shtëpitë?!’ Tani s’kanë ku të jetojnë dhe dimri ka ardhur tashmë.”

Mangerich, f. 136.

🔑 Ky paragraf është fragment i shkëputur nga jeta gjatë Luftës në Shqipëri, ku shfaqet pasiguria e jetës së njerëzve. Kjo është një histori e jetuar dhe e shkruar nga infermieret amerikane, të cilave, në nëntor të vitit 1943, iu rrëzua avioni aksidentalisht në Shqipëri; arritën të largohen nga Shqipëria vetëm pas një udhëtimi dymujor.

? A mendoni se jeta në fshat ishte më e vështirë se ajo në qytet? Shpjegoni qëndrimin tuaj. Ç'ndienin "njerëzit e zakonshëm" në situata të tilla – frikë, urrejtje apo diçka tjetër...?

II-9. Qytetarët e Beogradit mbjellin perime (artikull i botuar në gazetën e Beogradit në shtator të vitit 1942)

Misra dhe perime në mes të pallateve. Qytetarët e Beogradit – tashmë fermerë – janë mjaft të kënaqur nga prodhimet e kopshteve të tyre. "Fermerët urbanë", ata që i kthyen tokat djerr e të papërdorshme para ndërtesave ose fushat ku luanin fëmijët në kopshte, tashmë po marrin frytet e punës së tyre. Ndërkohë që të tjerët mbajnë radhë në treg, kopshtarët e rinj shfaqen krenarë në mes të jeshillëkut, cimbsin nga pak domate gjithë ditën dhe kujdesen për tokën e punuar. Me ngulm e përpjekje, njëloj si fshatarët, ata kanë treguar se ç'mund të arrihet me pak dëshirë të mirë dhe durim. Bashkia e Beogradit ka caktuar komisione të veçanta që të mbledhin informacion në terren, mbi çfarë kanë mbjellë njerëzit në këto kopshte. Gjithashtu, ekspertët japin këshilla praktike të cilat, të shoqëruara edhe me përvojën e pasur të fituar nga puna e deritanishme, janë të nevojshme për sezonin tjetër. U është bërë thirrje të gjithë kultivuesve, që të mbledhin dhe të heqin veç farërat e perimeve për sezonin e ri të mbjelljeve.

"Novo vreme", 25 shtator 1942.

🔑 Në Serbi, veçanërisht në qytetet e mëdha, gjatë viteve të Luftës mbizotëronte një situatë e rëndë. Ishte tepër e vështirë për njerëzit që të gjenin ushqimet e nevojshme. Për shkak të luftimeve ndërmjet forcave pushtuese dhe rebelëve, për shkak të kufijve të rinj, bllokimit të komunikacionit dhe ndalimit të lëvizjes së lirë të popullsisë dhe mallrave, qytetet u ndanë nga zonat bujqësore të vendit. Ushqimet kryesore (buka, mishi, yndyrnat) ishin rreptësisht të racionuara dhe shiteshin me sasi të kufizuara me triska. Gjithsesi, prodhimet kryesore mund të bliheshin në "tregun e zi", me çmime shumë më të larta se zakonisht. Në mënyrë që popullsia qytetare të mbijetonte në këtë periudhë kufizimesh, nxitej mbjellja e perimeve në të gjitha zonat e mundshme.

? A ka ndonjë rast të ngjashëm me këtë në vendin tuaj?

► Fig. 16. Të vdekur prej urisë, gjatë dimrit tragjik të vitit 1941/1942 në Greqi



Muzeu Historik Kombëtar, Athinë (Istoria, vëll. 16, f. 59).

🔑 Mungesa pothuajse e plotë e ushqimeve, sidomos në Athinë dhe qytetet e tjera të mëdha, sillte, si rezultat mosushqyerjen e shumicës së popullsisë dhe çdo ditë, vdekjen e shumë njerëzve për shkak të urisë.

II-10 dhe II-11. Faik Oktei mbi taksën për kapitalin turk

"Me sugjerim të Izmenit, taksapaguesit kategorizoheshin në dy grupe të veçanta: në Grupin M, që do të thotë myslimanët, dhe në Grupin G, pakicat jomuslimane [gayrimuslim]. Më vonë u shtuan edhe dy kategori të tjera: *Kategoria E*, për të huajt [ecnebi] dhe *Kategoria D*, për donmet, anëtarët e sektit *sabitan* të hebrenjve, të konvertuar në islam. [...]

Taksat duhet të paguheshin me para në dorë, brenda dy javëve. Lejohesh të paguaje edhe gjatë 15 ditëve pasardhëse, me vonesë, por për këtë shtohet një kamatë prej respektivisht 1 dhe 2 për qind të shumës fillestare. Nëse taksa nuk paguhej në fund të këtyre 30 ditëve, e gjithë pasuria e taksapaguesit dhe të afërmeve të tij konfiskohej, dhe ai vetë dërgohej në një kamp pune. Për vendimin që merrej, nuk mund

të kundërshtojë. Prona e atyre që nuk paguanin, nxirrej në ankand publik.”

Okte, f. 19, 25.

RRëfimi i mëposhtëm u përhap në popull në kohën e mbledhjes së taksës së pasurisë. Ai është tepër interesant, sepse nxjerr në pah karakterin e kësaj takse “kundër pakicave”

“Pasi u shpallën listat për *taksën e pasurisë*, Solomoni shkoi në kafene dhe fillon të pyesë:

-Mishon⁴⁸, sa pagove ti?

-Dhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë lira e 20 kurush.

-Shumë para paske paguar..., shumë para...

-Sa pagove ti, Kirkor⁴⁹?

-Njëzet mijë e nëntëqind e pesëdhjetë lira e 30 kurush.

-Po ti, Jani⁵⁰?

-Njëzet e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë lira e 40 kurush.

-Shumë paske paguar..., shumë...

-Ahmet bej⁵¹, po ti, sa dhe?

-Pesëdhjetë lira e 10 kurush.

Salamoni ngre duart nga qielli dhe thotë:

‘O i madhi Ataturk, sa mirë e ke thënë: *Sa i lumtur është ai njeri që thotë se është turk!*’

Aktar, f. 185.



Megjithëse Turqia ishte një vend asnjans, edhe ajo kishte probleme të ngjashme me vendet që ishin në luftë. Qeveria turke u përball me probleme serioze financiare, të shkaktuara nga kushtet e këqija ekonomike, inflacioni i menjëhershëm, mungesa e ushqimeve dhe gjërave të tjera të nevojshme. Si rezultat, në muajt e fundit të vitit 1942, qeveria vendosi një ngritje drastike të taksave. Taksa më shkatërruese ishte *Varlik Vergisi* ose *taksa e pasurisë*, e cila taksonte kapitalin e pronarëve që mendohej se po nxirrin fitime të mëdha për shkak të luftës. Ajo u administrua në një mënyrë të tillë, që rëndonte më tepër tregtarët e qytetit, pasuria e të cilëve ishte e lehtë për t’u llogaritur. Shumica prej tyre nuk ishin myslimanë dhe dukeshin se ishin të vetmit që kishin para për të ndihmuar në këtë situatë emergjence kombëtare.

Faik Oktei, njeriu që ishte përgjegjës për administrimin e kësaj takse, shkroi në vitin 1949 librin me titull: “Tragjedia e *taksës së kapitalit turk*”.



Pyetje të përgjithshme mbi nënkapitullin Ila.

Si ishin kushtet e jetesës në vendet e përfshira në luftë? Si reagonin njerëzit ndaj këtyre kushteve? A vuajtën të gjithë njëllot gjatë luftës? Nëse jo, kush vuajti më shumë?

Ilb. Civilët

II-12. Autoritetet gjermane kërcënojnë banorët e Beogradit

Drejtuar popullit të Beogradit

Nga ana e forcave të armatosura gjermane vijon gjithmonë e më tepër ankesa se popullsia civile nuk po tregon kujdesin dhe respektin e duhur ndaj oficerëve dhe ushtarëve gjermanë. Është sidomos e dukshme që një pjesë e mirë e këmbësorëve nuk

tregojnë kujdes që të hapin rrugën dhe shpesh, me shumë arrogancë, e bllokojnë atë.

Komanda e qarkut paralajmëron popullin se një sjellje e tillë do të marrë ndëshkim të ashpër në të ardhmen.

Beograd, maj 1941.

Kreiskommandatur

Božović, f. 129.

⁴⁸ Emër tipik hebre në Turqi.


⁴⁹ Emër tipik armen në Turqi.

⁵⁰ Emër tipik grek në Turqi.

⁵¹ Emër tipik turk.

? Çfarë i zemëroi autoritetet gjermane në Beograd? Bëni komente në lidhje me kërcënimin që ata bënë.

► Fig. 17. Afishë propagandistike gjermane



Nikolić, f. 2.

🔑 Fshatari serb shkon në "rrugë të gabuar", për shkak të premtimeve të rreme të armiqve të Gjermanisë (një komunisti, një britaniku dhe një hebreu), të cilët e shtyjnë të sulmojë një ushtar gjerman pas shpine. Ushtari gjigant gjerman i bën t'ua mbathin të padëshiruarit me pamjen e tij dhe e fal fshatarin serb që "gabo", duke e marrë atë nën mbrojtje.

II-13. Vendim i Këshillit Nacional Çlirimtar të Beranesë, më datë 21 korrik 1941

I. Që prej ditës së sotme, i gjithë pushteti qeverisës në territoret e çliruara – ai civil, gjyqësor dhe ushtarak – i

Jugosllavisë ose i forcave pushtuese, do të pushojë së funksionuari. Në këto zona, i gjithë pushteti civil, gjyqësor dhe ushtarak do të jetë në duart e popullit. Sot vendosim *Këshillin Nacional Çlirimtar*, të përbërë nga një kryetar, një sekretar dhe 19 anëtarë, i cili do të marrë në dorë të gjithë pushtetin. Krahinat do të caktojnë këshillat krahinorë dhe fshatrat, këshillat e tyre.

II. *Këshilli Nacional Çlirimtar* do të marrë në zotërim të gjitha pronat dhe fondet shtetërore të zyrave dhe bankave dhe do t'i përdorë këto fonde për të mbështetur çlirimin kombëtar.

III. Siguria personale dhe pasuria e të gjithë banorëve të kësaj zone do të garantohet prej *Këshillit* dhe të gjithë banorët janë të detyruar t'u binden kërkesave dhe vendimeve të *Këshillit*.

IV. Flamuri tringjyresh jugosllav do të valëvitet në territoret e çliruara. Prifti Aleksandër Bojoviçi caktohet kryetar i këshillit, profesori Simo Kastratoviçi caktohet nënkryetar dhe mësuesi Panto Malishiçi caktohet sekretar.

Lakić, p. 71-72.

🔑 Nga pikëpamja e përfaqësimit shoqëror, *Këshilli* ishte i përbërë nga 7 fermerë, 2 punëtorë dhe 12 intelektualë. 11 anëtarë të *Këshillit* ishin komunistë dhe pjesa tjetër ishin përfaqësues të partive lokale. Të gjithë politikanët lokalë e braktisën *Këshillin* që herën e parë që ai nisi të trajtojë çështje me rëndësi, duke thënë se "ishte e pamundur të bashkëpunojë me komunistët".

? Shikoni edhe një herë pikën e dytë dhe të tretë. A mendoni se ka një lloj kontradikte midis tyre. Shpjegoni qëndrimin tuaj.

II-14. Me fillimin e Luftës, e gjithë industria u vu në funksion të saj dhe puna kryhej në kushte të veçanta dhe të rrepta. Puna gjatë periudhës së Luftës në Rumani:

Ligji i miratuar për regjimin e punës gjatë luftës (2 tetor 1941)

Neni 2. Pezullohen të gjitha ditët e pushimit që përmenden në nenin 49 dhe 89 të Ligjit për Kontratat

e Punës të datës 5 prill 1929, me gjithë ndryshimet që ka pësuar më vonë ky ligj. (...) Neni 4. Kohëzgjatja e punës në sipërmarrjet industriale (që punojnë me tri turne) do të jetë 8 orë në ditë ose 56 orë në javë; në sipërmarrjet e tjera, kohëzgjatja normale e ditës së punës do të jetë 10 orë në ditë ose 60 orë në javë. Komandantët ushtarakë të sipërmarrjeve ushtarake, drejtuesit ushtarakë dhe drejtorët e sipërmarrjeve ushtarake, në bashkëpunim me inspektorët e punës, dhe në rastin e sipërmarrjeve joushtarake, inspektorët e punës, mund të autorizojnë, për më së shumti 3 muaj, shtimin e ditës së punës deri në 12 orë ose 72 orë në javë. Gjithashtu, ata mund të lejojnë që të punohet të dielave dhe ditët që janë pushim kombëtar, nëse nevojitet për arsye të prodhimit. [...]

Neni 31. Pikat e mëposhtme konsiderohen si krime sabotuese dhe do të ndëshkohen nga 5 deri në 20 vjet burg:

a) Ndalimi i punës – vetjak ose kolektiv – pa miratimin e komandantit ushtarak të sipërmarrjes ushtarake [...] ose të drejtuesit të njësisë ushtarake. Ndërsa në sipërmarrjet e tjera, nëse puna ndalet pa miratimin e inspektorit të punës, [...]

b) Shkatërrimi, prishja, vjedhja, falsifikimi, prodhimi me mangësi ose gabimet e qëllimshme, manipulimet ose keqpëdorimet e plotë ose të pjesshme të makinerive, pajisjeve, veglave të punës, materialeve dhe mallrave të prodhuara, si nga ana e punonjësve, ashtu dhe drejtuesve.

Murgesku (coord.), f. 343.

? Si ndikojnë këto masa në jetën e përditshme të punëtorëve gjatë luftës? A mund të spekulohet me ligjin duke u bazuar në këto masa? Për shembull, a është e mundur që dikush që bën një gabim në punë të cilësohet si sabotator?

II-15. Shërbimet Sekrete i raportojnë udhëheqësit të shtetit rumun në lidhje me gjendjen shpirtërore të popullit dhe pakënaqësitë e tij për kushtet e jetesës gjatë luftës. Gjendja shpirtërore në muajin maj të vitit 1943, sipas një raporti të Shërbimeve Sekrete.

INSPEKTORATI I RAJONIT TË POLICISË PLOESHT

(...) Funkionarët dhe familjarët e tyre janë të veshur keq. Janë të detyruar që të dalin në rrugë dhe të shkojnë në punë me rroba të përdorura, të cilat shpesh nuk u bëjnë më ose që nuk janë të përshtatshme për pozicionin e tyre si funksionarë publikë.

Gjithashtu, shumë prej tyre jetojnë në shtëpi (ose dhoma të mobiluara), në kushte johigjienike, çka shkakton uljen e rendimentit në punë dhe rrezikon shëndetin e tyre. Edhe moralin e kanë të ulët, sepse mallrat po shtrenjtohen gjithmonë e më shumë dhe nuk dinë se si do t'i sigurojnë në të ardhmen gjërat e nevojshme për vete dhe për familjet e tyre. Në të njëjtën gjendje shpirtërore ndodhen edhe punëtorët e fabrikave, si dhe drejtuesit dhe punëtorët e CFR-së⁵².

As funksionarët, dhe as punëtorët nuk e shprehin publikisht pakënaqësinë e tyre, sepse disa kanë frikë mos i hapin probleme vetes dhe të tjerë sepse e kuptojnë gjendjen e rëndë në të cilën ndodhet shteti.

Ata diskutojnë me njëri-tjetrin për gjendjen e vështirë në të cilën ndodhen, dhe shpresojnë se qeveria do të marrë masa shumë shpejt për të përmirësuar gjendjen.

Kuestori, I.Ciurea

Marturii documentare, tek "Revista Arhivelor", 2/1969, f. 20-21.

? Si ishte jeta e përditshme e punonjësve publikë? A e shprehin ata publikisht pakënaqësinë e tyre? Përse? Përse autoritetet interesoheshin për gjendjen shpirtërore të funksionarëve publikë?

⁵² Shkurtime për Sistemin Hekurudhor Rumun.

► **Fig. 18. Stërvitje për mbrojtjen civile në sheshin Bajazid të Stambollit**



Cumhuriyet Ansiklopedisi, vëll. 2 (1941-1960).

II-16. Përfaqësuesi ushtarak i Shtetit të Pavarur Kroat në Sofje raporton⁵³ për situatën në Maqedoninë e Vardarit që qeverisë nga Bullgaria

Pak ditë më parë, një shoku im erdhi në Sofje nga Shkupi, ku kishte punuar si menaxher i uzinës elektrike atje. Ai quhet Albert Shritofi. E pyeta rreth situatës në Shkup dhe në përgjithësi në Maqedoninë Bullgare; gjatë një bisede miqësore, ndër të tjera më tha:

‘Situata në pjesën e Maqedonisë që i është dhënë Bullgarisë është krejt e paqartë. Maqedonasit shfaqin një farë pakënaqësie ndaj regjimit të ri bullgar. Gjithashtu, 30% e bullgarëve që jetojnë

në Maqedoni nuk janë entuziastë për qeverisjen bullgare, sepse nuk gëzojnë të njëjtat të drejta si bullgarët e Bullgarisë. Një zhgënjim të madh kanë pësuar edhe intelektualët të cilët, pas studimeve në Beograd, kishin zënë poste zyrtare shtetërore në Jugosllavinë e vjetër. Këta njerëz nuk kanë më besim dhe kanë mbetur papunë. Ka, gjithashtu, nga ata që iu dha punë nga shteti bullgar, por që më vonë u pushuan dhe përsëri mbetën papunë. Gjithashtu arnautët⁵⁴ janë shumë të pakënaqur me qeverisjen e re dhe kanë nostalgji për Jugosllavinë. Nga ana tjetër, arnautët nën pushtimin italian janë të kënaqur, pasi italianët u kanë dhënë atyre shumë të drejta.

Turqit (myslimanë) kanë mbajtur një qëndrim të ngjashëm me atë që patën gjatë kohës së Jugosllavisë, por tashmë po shfaqin edhe ndjenja anglofile.

Tregtarëve serbë dhe hebrej iu është caktuar një afat tremujor, brenda të cilit janë të detyruar të shesin pronat dhe të boshatisin dyqanet e tyre, dhe ndoshta më pas do t’u vijë radha serbëve të Maqedonisë bullgare që të shpërngulen prej atje. Ndaj nesh, kroatëve, maqedonasit mbajnë një qëndrim shumë të përzemërt.

(...) Sipas gjasave, duket se në Maqedoninë bullgare ekziston një frymë e fortë për çlirim dhe për krijimin e Maqedonisë autonome...

Nënkolonel

Adam Petroviçi, përfaqësues ushtarak në Sofje

Dokumenti za borbata na makedonskiot narod za samostojnost i nacionalna država, II, f. 308-9.



Si mendoni, a është i besueshëm ky burim? Shpjegoni përse?

II-17. Gjendja në Maqedoni në vitin 1941, sipas Komitetit Rajonal të Partisë Komuniste Jugosllave

“Territore të mëdha maqedonase janë tashmë nën administrimin bullgar. Oficerët e policisë, xhandarët, kryetarët e komunave, sekretarët,

⁵³ Raporti i drejtohet Ministrisë Kroate të Mbrojtjes (Domobranstvo) dhe është i datës 21 tetor 1941.

⁵⁴ Shqiptarët (shënim i përkthyesit)

Ilogaritarët, noterët, nëpunësit e taksave, që të gjithë janë nga Bullgaria. Maqedonasve nuk u janë dhënë poste zyrtare dhe nuk kanë të drejtë të jenë kryetarë komunash. Me të drejtë, çdo maqedonas i ndershëm i bën pyetje vetes: ‘Ç’lloj lirie është kjo, kur shumadianët (serbët) janë zëvendësuar nga bullgarët, ndërkohë që maqedonët janë lënë të izoluar?’ Në rastin më të mirë, intelektualëve maqedonas u ofrohen poste në fshatrat bullgare, por kurrë në ato maqedonase. Justifikimi që jepet për këtë është i njëjtë me atë që përdornin serbët më parë – ‘ju nuk dini gjuhën zyrtare të shtetit!’

Terzioski, f. 309.

? Ç’ndryshime ndodhën (nëse pati të tilla) në administratën maqedonase gjatë vitit 1941? Çfarë shpjegimi jepnin autoritetet për këtë?

II-18. Fjala e mbajtur nga Emin Duraku në këshillimin e Komitetit Krahinor të Partisë Komuniste Jugosllave për Kosovën dhe Metohinë, në shkurt 1942

Populli shqiptar i Kosovës, tue përfshi edhe atë të Gjakovës, i vuejtun dhe i shtypun kombëtarisht, priste me padurim një ndryshim të gjendjes, priste çlirimin e tij nga regjimi reaksionar i qeverive jugosllave, mjerisht pa arritë me dallue çlirimin e vërtetë, pa dijtë me nda popullin jugosllav nga qeveria jugosllave – tue i ba përgjegjës edhe popujt e shtypun të Jugosllavisë për veprën shfrytëzgjësë e politikën reaksionare të qarqeve drejtonjëse jugosllave – arriti në atë gradë sa me preferue çdo farë ndryshimi qoftë, mjafton që t’i jepesh fund një periudhe më se 20 vjeçare eksploatimi dhe shtypjeje kombëtare. Prandaj nuk është për t’u çuditë që fashizmi italian, i përzimë me veprën tradhtarë të njerëzve të shitun (kolonës së pestë) të qeverisë shqiptare, të gjejë një mbështetje në shtresat e popullit kosovar e të pritët me gëzim deri sa të konsiderohet zmadhimi i çifligut t’imperializmit italian si çlirim kombëtar. Mirëpo, gjatë kohës së sundimit të fashizmit ndër këto vende, sa do që në kohë i shkurtër – u tregue qëllimi dhe puna e regjimit në fuqi. Turmat filluen, e dita ditës u pa kjartas, të

kuptojnë gjendjen e re, po mbesin të habitura e puthuajse të trondituna për atë çka iu doli. Këndeje sot kemi një ndryshim në mentalitetin e turmave, lidhjet dhe marrëdhëniet e kësaj pjese shqiptare me popullin e Shqipërisë politike, gjendja e vështirë ekonomike, vorfnimi gradual i shtresave popullore, konsequencat e luftës dhe gjendja ndërkombëtare e për më tepër lufta nacional-çlirimtare e popujve fqinj, kanë influence mbi popullin kosovar. Sot ai nisë të mendojë jo vetëm për jetën e tij të brendëshme, por edhe për raportet e veta me popujt fqinj...

? Emin Duraku (1918–1942) mori pjesë në Lëvizjen Antifashiste Nacional Çlirimtare. Ai ndoqi studimet në gjimnazin e Shkodrës për gjuhësi, ku dhe u vu në kontakt me grupin komunist të Shkodrës. Ai u arrestua në Tiranë në janar të vitit 1939 dhe u arratis nga burgu pas agresionit fashist të 7 prillit 1939. Në vitin 1940, u arrestua përsëri dhe u internua në Itali (në kampin e Ventotenes). Në vitin 1941, u kthye në Gjakovë ku zhvilloi aktivitete antifashiste. Si një nga anëtarët kryesorë të Lëvizjes Antifashiste Nacional Çlirimtare në Kosovë, Emin Duraku punoi për të nxitur popullin e Kosovës për të marrë pjesë në luftë kundër pushtuesve fashistë. Më 28 nëntor 1942, ai u plagos në një pritë në Lipjan dhe vdiq në një spital të Prizrenit më 5 dhjetor 1942.

II-19. Emil Satolo tregon për dashurinë e tij me një vajzë në lagje

Një vajzë me flokë të verdhë kalonte përpara shtëpisë ku jetonim (në *Nova Gradishka* ku ai shkollë në shkollë). Ajo ishte në klasë të tetë. Gjithmonë përpiqeshim ta shikonim kur kalonte, sidomos unë. E takonim edhe në park, dhe unë kënaqesha vetëm duke e parë. Një mbrëmje, në dhjetor, ajo m’u afrua dhe më tha: “Koleg, nëse po shkon në shtëpi, do më pëlqente që ta bënim rrugën bashkë.” Gati sa nuk u hodha përpjetë nga gëzimi. (...) Folëm për shumë gjëra, por kryesisht për tmerret e luftës. Kur arritëm tek shtëpia e saj, (...) Nevenka (kështu quhej ajo) tha papritur: “Eja nga unë nesër rreth orës 6, sepse

tani më duhet të shkoj.” Më dha dorën dhe unë ia shtrëngova me kënaqësi. Ndjeva butësi, ëmbëlsi, por edhe ftohtësi në dorën e saj, dhe një ndjenjë e këndshme më përshkoi gjithë trupin.

Me zor po prisja mbrëmjen e së nesërme. Shkova tek ajo, i rashë derës dhe ajo ma hapi menjëherë.

- Përshëndetje, koleg, si je?

- Mirëmbërë, Nevenka. Mos kam ardhur shumë herët?

Nga korridori hyra në dhomë, me ndrojtje dhe pak i plogët. Pranë dritares kishte një tavolinë dhe ajo më tha që mund të ulesha. U ula. Më pas më ofroi një gotë liker. Përplasëm gotat dhe bëmë gëzuar. Për ty koleg! (...) Po përpiqesha të kuptoja qëllimin e ftesës së saj. Folëm pak rreth shkollës, mësuesve dhe luftës. (...)

- A e di, koleg, se ideologjia përparimtare po e fiton luftën dhe nuk do kalojë shumë kohë kur ajo të mbërrijë edhe këtu tek ne.

- Ku e ke fjalën?

- Po ja, rusët janë përfaqësues të ideologjisë sonë përparimtare.

Tani m’u qartësua gjithçka; ajo donte të më fuste në radhët e progresistëve, ndërsa unë doja atë vetë. Mua nuk më duheshin idetë. (...) Doja të flisja për ndjenjat, ndërsa ajo interesohej vetëm për politikën. Ramë në një mendje që të takoheshim përsëri. Sidoqoftë, mendoja se i pëlqeja. Nja dy ditë

përpara se të takoheshim sërish, po mendohesha se si ta largoja Nevenkën nga bisedat e saj politike. Mendova t’ia shpjegoja unë asaj situatën politike. Do t’i tregoja për qëllimet e mia për të ngritur një familje me shumë fëmijë. Mendova se çdo gruaje do t’i pëlqente kjo bisedë. (Por nuk doli ashtu.)

Satolo, f. 93-94.



Gjatë Luftës, Emil Satolo ishte nxënës në shkollë të mesme. Ai jetonte në fshatin Puska dhe shkante në shkollë në Nova Gradishka (Kroaci). Satolo e mbështeti krijimin e Shtetit të Pavarur Kroat dhe lëvizjen e ustashëve, por i kritikoi aspektet e tyre kriminale. Sidoqoftë, ai ishte kundërshtar i partizanëve dhe komunistëve. Në kujtimet e tij, përveç të tjerash, ai shkruan edhe për dashurinë e tij me një vajzë në lagje.



Krahasoni marrëdhëniet midis një djali dhe një vajze në kohë lufte, me ato në ditët e sotme. Përse pati një keqkuptim ndërmjet djalit dhe vajzës? A janë qëllimet e djalit të ngjashme me tuajat? Po qëllimet e vajzës? Çfarë ideologjie mbështeste ajo dhe ç’anë mbante ajo në luftë? Ç’nënkuptonte ajo me fjalët “ideologji përparimtare”? Përse rusët konsideroshin si përfaqësuesit e “ideve përparimtare”?

IIc. Jeta e ushtarëve

II-20. Odise Elitisi, fitues i çmimit Nobel për letërsinë në vitin 1979, përshkruan përvojën e një ushtari grek në frontin shqiptar

E dinim tashmë që ndodheshim pranë vendit ku nuk kishte ditë jave ose ditë pushimi, të sëmure ose të shëndoshë, të varfër ose të pasur, sepse oshëtima, si një stuhi përtej maleve, vazhdonte të shtohet derisa, në fund, arritëm të dëgjonim gjëmimin e ngadaltë dhe të rëndë të topave dhe zhurmën e thatë dhe të shpejtë të mitralozëve. Gjithashtu, sepse gjithmonë e më shumë filluam të shkëmbehemi me vargje të plagosurish, të cilët largoheshin nga beteja duke ecur ngadalë. Ndërsa pjesëtarët e trupës mjekësore, me shiritin e Kryqit të Kuq në krah, ulnin barrelat

për të pushuar dhe dukeshin të dëshiruar për një cigare. Kur dëgjonin se ku po shkonim, ata tundnin kokën dhe fillonin të tregonin për gjakderdhjen dhe tmerrin që kishin parë. Por gjëja e vetme që ne ia vinim veshin, ishin ato zërat e tjerë që dëgjoheshin në errësirë, të cilët ishin ende të nxehtë nga zjarri dhe sqfuri i thellësive: “oi, oi mana mou,” “oi, oi, mana mou.” Dhe nganjëherë, por më rrallë, ndienim dihatjen e një frymëmarrjeje të mbytur, si gërhitje, dhe ata që e dinin thonin se kjo ishte trokitja e vdekjes. Ndonjëherë tërhiqnin pas edhe robërit që kishin zënë pak orë më parë, në sulmet e papitura të skuadrave tona. Robërve u vinte era verë dhe xhepat i kishin të mbushur me ushqime të konservuara ose çokollata, ndërsa ne nuk kishim asgjë; urat ishin

prishur dhe mushkat tona nuk mund të ecnin në dëborë ose nëpër baltën rrëshqitëse.

Elytis, f. 21.

► **Fig. 19. Litografi ku paraqitet një luftëtar grek i lashtësisë nga Beteja e Maratonës, një luftëtar i Luftës Greke për Pavarësi, të vitit 1821 dhe një 'evzon' (luftëtar grek i kohëve moderne)**



IEEE, To epos tou '40. Laiki Eikonografia, 167.

II-21. Ivan Šibli, pjesëmarrës në lëvizjen partizane në Kroaci qysh nga fillimi i saj, përshkruan në kujtimet e tij përvojën e luftës. Teksti i mëposhtëm përshkruan ditët e para kur Šibli "doli në mal" (shprehje popullore që nënkuptonte të hyje në radhët e partizanëve)

"Pjesërisht, tani jam partizan. Është e vërtetë që nuk kam pushkë, por kam marrë pleshta dhe e kam të gjithë trupin të mbuluar me një lloj yndyre të verdhë që kundërmon erë të keqe. (...) Përveç kësaj, në të brendshmet e mia nganjëherë mund të gjesh edhe ndonjë murr (...) – kafsha shtëpiake, më e afrueshme me të gjithë ushtarët e botës. (...) Nuk ia vlen që të përmenden këtu pleshtat dhe çimkat. Në fakt, ato janë insekte shumë të sjellshme, të cilat kënaqen duke t'u futur nëpër trup natën, por nuk të ngjiten në të brendshmet dhe në rroba."

Šibl 2, f. 13.



Si i përshkruan Šibli vështirësitë e jetës paritizane?

II-22. Në kujtimet e tyre nga lufta, partizanët veteranë i kanë kushtuar vëmendje të veçantë pjesëmarrjes së madhe të femrave në forcat partizane. Në kujtimet e tij, në kapitullin "Gratë luftëtare", Šibli shkruan:

"Në brigadën tonë ka shumë partizane femra. Shumica e tyre janë vajza fshatare nga Slavonia, Kozara dhe janë shumë të reja. Ato ecin në rresht me ne, luftojnë në beteja, sulmojnë fortifikimet armike; përballen me të gjitha vështirësitë e jetës partizane, së bashku me luftëtarët e tjerë.

Motrat Milija dhe Danika Zlokapa janë mitraliere. Ato kanë pak kohë që kanë ardhur, por janë bërë luftëtare me përvojë. Njeriut trim i mjafton të përballat vetëm me një sprovë. Milija është 16 vjeç dhe Danika është 18-të. (...)

Ato e mbajnë me radhë një mitraloz dhe një çantë shpine me municione dhe nuk lejojnë askënd që t'i ndihmojë. (...)

Gjatë sulmit në Sirac, një nga vajzat më trime të brigadës sonë dhe të gjithë Slavonias, Persa Bosanac u vra. (...) Ajo ishte një vajzë e hollë dhe elegante, 18-të vjeçare. Njerëzit thoshin: 'Persa nuk e njeh frikën.' ... Në betejën e Javoricës, gjatë mësymjes së marsit, pas sulmit që vazhdoi tërë ditën, ajo ishte ndër të parët që arriti në pozicionet armike dhe luftoi trup me trup me gjermanët, deri sa u shpartalluan. (...) Ajo u qëllua pranë shkollës në Sirac, në një nga sulmet e shumta që u bënë ndaj këtij objekti të fortifikuar. Persa ra. Doli ballazi, nuk e njihte frikën! (...) Në Javoricë, Katica Hacman, një vajzë nga Bilogora, po sulmonte nga krahu i Persës. Ato ishin shoqe të ngushta dhe gjithmonë qëndronin bashkë. Në sulmin e fundit, një e shtënë e armikut e qëlloi Katicën, e cila u plagos për vdekje. (...)

Në luftë dhe në kushte të vështira njerëzit bëhen të vrazhdë dhe të pashpirt. A do të kthehen edhe këto vajza luftëtare në gra të burrëruara? Ndoshta tmerret e luftës që po kalojnë, do t'u marrin atyre ato cilësi të mrekullueshme që e bëjnë një grua të jetë grua dhe ato tipare që duam të kenë gratë që ne dashurojmë."

Šibl 2, f. 308-311.

? Përse ishte e rëndësishme që partizanët të nxirrnin dukshëm në pah rolin aktiv që luajtën gratë në luftë? Përse kjo nuk ishte kaq e rëndësishme për ustashët? Sipas mendimit tuaj, a ishin gratë partizane vërtet të barabarta me burrat? (Shibli përmend vetëm nja dy shembuj të spikatur.) Shpjegoni kuptimin e paragrafit të fundit të Shiblilit për gratë luftëtare. Si e shikonte ai rolin e gruas?

II-23. Gratë në fshatrat e Grevenasë (Greqi) kërkojnë më tepër respekt dhe pjesëmarrje më të madhe në çështjet publike, meqë edhe ato kishin ndihmuar dhe kishin marrë pjesë në lëvizjen e rezistencës

- *Një mësuese*: "Ju i konsideroni gratë pa identitet të vetin, si kukulla në duart e burrave, por ato thonë: 'Sido që të jetë, unë jam diçka, mund të bëj diçka'; ato filluan të mendonin se mund të ishin të dobishme jo vetëm për të gatuar, për të larë dhe për të marrë urdhra. Ky ishte zgjimi i parë i madh i grave fshatare dhe kjo pati një ndikim të madh mbi to."

- *Një grua fshatare*: "Ne shkonim [në mbledhje], se ato na pëlqenin dhe na tërhiqnin. Donim vetëm që të dilnim pak nga ajo monotonia e përhershme. Sepse kështu ishin burrat në atë kohë – siç i thonë fjalës, si diktatorë..."

- *Një tjetër grua fshatare*: "Ne si gra kërkonim vetëm pak liri, të drejtën për të folur, të mos ishim pronë e burrave..., të punonim dhe të na rrihnin. Donim pak liri për veten tonë. Kështu që shkua në male, mbajtëm në kurriz municione, ndërtoam istikame për mitralozët, punuam ditë e natë, shërbyem edhe si ndërlihdhëse, pavarësisht se ishim femra; dhe për këtë kërkonim vetëm disa të mira për veten tonë. Pak liri, jo skllavëri, si të thuash, të ishim në gjendje të hapnim gojën."

Van Bouschoten, f. 101-102.

? Sipas tekstit të mësipërm, ç'arsye kishin gratë të hynin në lëvizjen e rezistencës? Po ju si mendoni, cilat ishin arsyet e tyre?

II-24. Kjo këngë është krijuar gjatë Luftës së Dytë Botërore nga një autor i panjohur dhe konsiderohet si këngë kombëtare maqedonase

PARTIZANIA E RE

Jam shumë e kënaqur dhe e lumtur
Që po bëhem një partizane e re,
Që po bëhem një partizane e re
Në malin Pelister.

Lamtumirë dhe më fal, atdhe,
Se po shkoj në betejë, betejë, betejë,
(...)

Ne u betuam atje,
Se do të luftonim kundër fashistëve.

Për të fituar lirinë tonë,
Për Maqedoninë tonë,
Lamtumirë dhe më fal!

The Women of Macedonia in the National Liberation War [Gratë maqedonase në Luftën Nacionalçlirimtare], f. 56.

? Shpjegoni përse krijoheshin këngë të tilla? A përmbajnë ato elemente propagande?

► Fig. 20. Heroinat e vitit 1940



IEEE, To epos tou '40. Laiki Eikonografi, f. 55.



Kjo litografi paraqet gratë e Epirit gjatë Luftës italo-greke në vitin 1940-1941, në malin e Pindit, që ndodhet në kufirin shqiptaro-grek, duke mbajtur në shpinë arka me municion.

► **Fig. 21. Gazetat partizane: Gazeta xhepi për trupat e ndërlihdjes, Zadar (Kroaci), 1944**



Muzeu i Historisë, Kroaci



Ç'tregon ky vizatim? Si e shihnin veten partizanët në krahasim me forcat e tjera antifashiste (që përfaqësohen nga flamujt e ndryshëm)? Si mendoni, a konsideroheshin partizanët nga ana e Britanisë së Madhe, SHBA-së dhe Bashkimit Sovjetik si partnerë të barabartë?

II-25. Partizanët e paepur gjatë luftimeve të gjata kundër gjermanëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre në Jugosllavi

Dëshmi e Zhivko Rodiçit

Kam parë tanke armike që nuk donin të qëllonin mbi luftëtarët tanë, por më keq, përpiqeshin t'i shtypnin ata. Terreni ishte i sheshtë, kështu që ishte më e lehtë për tanket që të manovronin dhe më e vështirë për luftëtarët tanë që të tërhiqeshin. Një nga luftëtarët tanë po vraponte përpara një tanku dhe u fsheh pas një mullari me bar; dhe më pas, tanku kaloi sipër tij dhe mullarit të barit.

Pas aksionit, e gjithë brigada i mori të plagosurit me barrela. Zakonisht ne e sulmonim armikun natën, ndërsa ai sulmonte ditën. Lodhja ishte aq e madhe, sa që mendonim se ishte më mirë të vriteshim, se nuk kishim më fuqi. Nuk ishte çështja tek ushqimi, sepse ushqime kishte, nuk ishte as çështje guximi, sepse askush nuk kishte frikë, por raskapitja ishte më e keqe se çdo gjë tjetër. Gjatë kësaj kohe, komandanti i njësisë sonë, Petar Marini, një djalë i pashëm, i guximshëm dhe trim, u vra vetëm prej lodhjes. Atë e zuri gjumi në këmbë dhe kështu që e qëlluan.

Albahari et al. (red.), f. 171 dhe 218.




Përpiquni ta vini veten në rolin e këtyre partizanëve. A mund ta imagjinoni t'ju zërë gjumi në këmbë?

II-26. Denço Znepolski, komandant i shquar i forcave guerrile bullgare, flet për marrëdhëniet ndërmjet burrave dhe grave në njësinë e tij dhe për furnizimet e pazakonshme që merrnin nga anlizet.

Si ne, në njësinë guerrile në Tran, ashtu edhe serbët, ishim shumë të rreptë për çështje morali. Ne nuk lejonim marrëdhënie intime dhe e kishim ngritur femrën e re në një kult që e mbronin nga çdo dhunim. Serbët ishin edhe më fanatikë se ne në këtë aspekt, dhe s'kishin si të ishte ndryshe!... Shumë kohë

më vonë, anglezët, sipas vendimeve të Konferencës së Teheranit të Tre të Mëdhënve, filluan të hedhin me parashuta armë dhe municione për forcat guerrile në Tran, si dhe furnizime të të gjitha llojeve për misionet e tyre ushtarake, dhe bashkë me to, edhe letra bixhozi dhe prezervativë. Edhe serbëve iu dërguan furnizime të tilla. Në fillim ata u fyen aq sa nuk thuhet, dhe erdhën tek unë dhe Vlado Triçkovi (në atë kohë unë isha komandant i njësisë guerrile të Tranit) duke mallkuar dhe kërcënuar që do të luftonin kundër anglezëve. Kur Vlado Triçkovi e mori vesh të gjithë historinë, duke qenë se ishte njeri i arsimuar dhe i ditur, qeshi dhe u shpjegoi atyre gjithçka. Ai u tregoi se që nga Lufta e Parë Botërore, çdo ushtar anglez ishte i detyruar të pajisej me mjete të tilla mbrojtëse, ashtu siç pajisej edhe me rroba, këpucë etj. Ai u tha se edhe ne kishim marrë në dërgesën e parë, në pakot e ndihmës mjekësore, prezervativë dhe letra bixhozi. Ai shtoi, gjithashtu, se ne shpërndamë pakot e ndihmës mjekësore dhe i lamë mënjane çfarë menduam si të panevojshme, dhe kjo qe e gjitha. Në një farë mënyre, ai arriti t'i qetësonte, por sërish Barkoja shkoi tek misioni anglez, i hodhi pakot e vogla përpara tyre dhe u tha me ironi: 'Faleminderit, por s'kemi nevojë për këto! Ne jemi ushtarë!'

Znepolski, f. 112-113.

 Si ishin marrëdhëniet midis forcave guerrile bullgare dhe atyre serbe? Si reagan këto grupe ndaj furnizimeve të çuditshme angleze? Komentoni reagimin e Barkos.

II-27. Oficeri Viktor Budesku, pjesëmarrës në betejën e Bërrylit të Donit – Stalingrad, tregon rreth kësaj ngjarjeje

Në mëngjesin e 11 dhjetorit, rusët filluan kundërmësymjen në të gjithë frontin. Për ditë dhe net të tëra, për shkak të topave dhe flakëhedhëseve, ushtarët nuk u furnizuan as me ujë, as me bukë. Ditë të tëra me pushkë në dorë, duke përhapur vdekje në radhët e armikut. Fusha përpara pozicioneve të tyre ishte mbushur me pirgje trupash të vdekur.

Kaluam dhjetë ditë dhe dhjetë net nën një trysni të vazhdueshme dhe me luftime të ashpra. Duke sikur shenjat e fitores do të shfaqeshin dhe do të largonin shqetësimin nga mendja e komandantëve dhe ushtarëve që ruanin pozicionet e tyre, për të ndalur vrullin e paparë të rusëve.

Por nuk ndodhi kështu. Rusët e rifilluan sulmin me më tepër vrull, me forca të reja të freskëta që erdhën nga prapavija. Për shkak të humbjeve të mëdha, fronti ynë nuk mundi të rezistonte më. Lamë pozicionin që e kishim marrë me aq sakrificë, dhe që nga ai çast, tërheqja jonë në stepën e Donit qe fatale. Për dikë që nuk ka qenë kurrë në mes të dimrit atje dhe për më tepër në kushte luftime, fjala stepë nuk ka ndonjë kuptim të veçantë.

Pikësëpari, ishte ngrica, një ngricë therëse, e shoqëruar nga erërat që frynin furishëm. Mbi këtë tokë djerr, shpesh binte një mjegull e dendur që dukej sikur kishte ardhur ta fundoste përgjithmonë tokën në humnerë. Dhe mbi të gjitha ishte ajo qetësi e plotë, absolute, që shkaktohej nga ngrirja e çdo gjëje përreth dhe që e bënte stepën një mjedis të kundërt me jetën, një armik të vërtetë jonjerëzor".

"Magazin istoric", tetor 2002, f. 93.



Betejat e Bërrylit të Donit – Stalingrad ishin nga më të tmerrshmet për ushtarët rumunë gjatë Luftës së Dytë Botërore, sepse iu desh të përballëshin edhe me armikun, edhe me kushtet tejet të vështira të motit.



Ç'qëndrim mbajnë ndaj luftës ushtarët që janë në front? A mendojnë për lavdinë dhe heroizmin? A janë të lumtur që po luftojnë?

II-28. Neagu Djuvara, historian dhe diplomat i njohur, kujton (në qershor të vitit 2002) periudhën kur mori pjesë në luftë, në Frontin Lindor


"Kur u ktheva nga fronti, pas afërsisht dhjetë ditësh që kalova në një qendër mjekimi, Odesa ra, kështu që mbeta jashtë çastit më të vështirë të luftës; atje ndodhi kasaphana më e tmerrshme. Një ish kolegu im nga shkolla ushtarake, i cili ishte dhe ndihmësi

i kolonelit, më tha se kishte parë vetë në listën e emrave që mbante koloneli, pak ditë përpara rënies së Odesës, se në regjimentin tonë, që në fillim përbëhej nga 1800 veta dhe më pas iu shtuan edhe 1200 rekrutë, vetëm 92 ishin ende të aftë të luftonin. Këtë kuptim kishte marrja e Odesës nga Antonesku. Kjo është ajo çka them edhe në televizion, sa herë më jepet rasti, që lufta atje ishte krejt absurde – gjermanët na kishin thënë: “Rrethojeni Odesën”, në mënyrë që ushtria ruse të mos jetë në gjendje të dalë prej andej, por ata nuk ngulmuan për këtë. Shtabi i ushtrisë rumune dhe Antonesku donin që ta pushtonim vetë Odesën (në të vërtetë, mendohet se nuk ishte Antonesku ai që e pati këtë mendim, por sidoqoftë e miratoi atë), që t’u tregonim atyre se kush ishim dhe sa të mëdhenj ishim, por ne nuk i kishim mjetet për të pushtuar një qytet të madh. Mund të fitohet edhe duke luftuar gjer në fund... Ne e pushtuam Odesën, sepse rusët u tërhoqën. Një mëngjes të bukur, edhe pse kishte mijëra njerëz që vdisnin çdo ditë në rrethinat e tij, hynë në qytet pa hasur qëndresë, sepse nuk kishte mbetur njeri në qytet – të gjithë ata që kishin mbrojtur Odesën ishin larguar. Ishte një nga gabimet e para që bëri Antonesku, por ne, kryesisht të rinjtë... - po jua them me ndershmëri – kur u nisëm për në luftë, u nisëm entuziastë, me mendimin që të lanim turpin e vitit të kaluar, kur dhamë Besarabinë dhe Bukovinën dhe më pas Transilvaninë, dhe më tej Kuadrilaterin, pa shtënë asnjë pushkë”.

Neagu Djuvara, Despre cucerirea Odessei (Mbi pushtimin e Odesës). <http://www.memoria.ro/index.php?option=articles&artid=381>

❓ A pasqyrohet në këtë tekst heroizmi? Cili ishte çmimi që pagoi ushtria rumune për ambicjen e saj për të pushtuar Odesën? A ndryshon qëndrimi i autorit në periudhën e luftës, me atë në çastin e tanishëm? Krahasoni këndvështrimin e djalit të ri, zemra e të cilit ishte e mbushur me heroizëm, me këndvështrimin e një njeriu më të pjekur, i cili vlerëson fitoret relative politike, por gjithashtu edhe humbjet në njerëz.

► Fig. 22. Ata që i kënduan Luftës



Epopeja e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, 1939-1944.

🔑 Kjo pikturë e Andon Lakuriqit paraqet grupmoshat e ndryshme të atyre që morën pjesë në luftë në njësitë partizane.

❓ Krahasoni këtë pikturë me tekstin III-4.

II-29. Ditari i Luftës i Fadil Hoxhës - Kur pranvera vonohet, Prishtinë 1980

Fshati Berbat i Malësisë së Gjakovës, 11 mars 1943
 "... Si partizanët e miqt tanë, ashtu edhe armiqtë po çuditen se si ndejtëm kaq shumë në një vend. Miqtë na këshillojnë që të largohemi prej këndeje e të rrijmë mëshëfun; armiqtë po përgatiten me na sulmue. Taktika jonë është: me e zënë armikun në befasi e mos me lejue që të na befasojë ai neve. Sot këtu – nesër të paktën një gjysmëdite rrugë larg na zen drita. Ne jemi të pabarabartë. Jemi pesëdhjetë veta, kurse okupatori ka regjimente e armata ushtarësh italianë e plot njësi kuislingësh."

[...]

Sojevë, 1 maj 1943

“Lajmet që mbërritën prej organizatave të Ferizajit, Prishtinës, Gjilanit e vendeve tjera – tregojnë se Lufta e Livoçit ka pasë jehonë të madhe dhe se, në shumë vende, flitet me simpati për partizanët dhe trimëritë e tyre në këtë luftë, tue vu në dukje se – një grusht partizanësh kanë bërë, gjatë tërës ditës luftë me dy kompani italiane, me të gjithë policët dhe karabinierët e Gjilanit e me një pjesë jo të vogël, ndoshta disa qindra vullnetarësh të fshatrave të Gjilanit, e se partizanët “e kanë bërë trimërinë ispat dhe e kanë koritë një ushtri të tërë.”

? Fadil Hoxha, ishte shqiptar nga Kosova dhe lindi në 15 maj 1916 në Gjakovë dhe vdiq në 23 prill 2001 në Prishtinë. Ai ishte udhëheqësi komunist i Ushtrisë Nacional Çlirimtare në Kosovë, komandant i njësisë partizane “Zenel Hajdini” dhe “Emin Duraku” dhe më vonë Komandant i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional Çlirimtare për Kosovën. Si komandant i njësisë partizane “Emin Duraku” në pranverën e vitit 1943, Hoxha mbajti shënime të cilat më pas i botoi në librin me kujtime me titull “Kur pranvera vonohet”, duke aluduar simbolikisht për vonesën e lirisë së popullit shqiptar të Kosovës. Në ditarin e tij të luftës mund të gjenden të dhëna për qëndrimin që kanë mbajtuar fshatrat shqiptare, serbe dhe malazeze ndaj Lëvizjes Nacional Çlirimtare, duke nxjerrë në pah bashkëpunimin dhe armiqësitë gjatë luftës.

II-30. Vështirësitë që hasin luftëtarët për t’u përshtatur me jetën si qytetarë

Dëshmi nga Dragomir Radishiçi: Sidoqoftë, Batalioni I i Brigadës XII e mbylli luftën pranë Zidani Mosti⁵⁵. Ai u ndal atje dhe më pas u kthye në Brestanica. Ishte data 12 maj 1945. Qëndruam aty për disa ditë, dhe më pas shkuam në Sveta Nedjelja pranë Zagrebit, ku qëndruam nga data 15 deri më 17 maj 1945 dhe festuam ditën e çlirimit të plotë të vendit.

⁵⁵ Në Slloveni.

⁵⁶ Në Kroaci, në bregdetin e Adriatikut.

Lufta kishte mbaruar. Mbizotëronte një atmosferë e vërtetë paqeje, por kjo vetëm për pak kohë. Pas kësaj filluan të shfaqen brengat. Nuk do të kishte më aksione, s’do të kishte më luftime; dhe ushtarët ndiheshin keq nga ky fakt. Në të vërtetë, na dukej sikur lumturia më e madhe në botë ishte të qëndroje mes luftëtarësh dhe të shkoje në betejë, por tashmë ishim në Shibenikun⁵⁶ e çliruar, ku mbizotëronte paqja dhe ne nuk ishim mësuar me këtë. Me fjalë të tjera, e kishim harruar atë mënyrë jetese.

Zgonjanin et al. (red.), f. 399.

? Përse ky ushtar thotë se “u shfaqën brengat”? A mendoni se të gjithë ushtarët u ndien njëlloj? A e dini se çfarë është SSPT (sindroma e stresit post traumatik)? A jeni të një mendjeje, se ky burim nxjerr në pah edhe elemente fanatizmi, ekstremizmi, çka është rezultat i zakonshëm i luftës? Shpjegoni qëndrimin tuaj.

► Fig. 23. Pasqyrë e gazetave të botuara nga njësitë ushtarake maqedonase në Jugosllavi që nga viti 1944



II-31. Gabimi i tmerrshëm i Zdravko Lazariçit

“Në fillim të prillit të vitit 1945 shkova në Osijek dhe pashë me sytë e mi kur qyteti u mor nga partizanët. Pak kohë më pas më nxorën përpara komisionit të

rekrutimit dhe më futën në ushtri. Një shoku im, Ivan Kosoveli, u frikësua aq shumë përpara komisionit, saqë në mënyrë të pavetëdijshme ngriti dorën dhe i përshëndeti me 'spremni' (me përshëndetjen e ustashëve). Për këtë arsye e morën për 'të paaftë mendor', dhe pas disa ditësh e mbyllën në Brod, ku dhe qëndroi 6-7 muaj. Pavarësisht nga kjo, vitin tjetër ai u pranua në shkollën e trajnimit të oficerëve në Osijek dhe iu dha grada rreshter-rezervist."

Prcela-Živić, f. 329.

IId. Kultura dhe arsimit

II-32. Rekomandime për mësuesit nga Inspektorati Rajonal i Shkollave në Manastir

1) Të bëhen të njohura ndjenjat kombëtare bullgare që ekzistojnë tek nxënësit dhe tek e gjithë popullsia dhe të forcohet tek brezat ndjenja e unitetit kombëtar dhe shtetëror, duke vënë theksin tek historia dhe kultura e popullit bullgar.

2) Popullit, dhe veçanërisht nxënësve, duhet t'u shpjegohet se për shkak të robërisë në të cilën ndodheshin, nuk u janë zhvilluar ndjenjat kombëtare bullgare dhe se ata duhet të bëhen të ndërgjegjshëm se i përkasin kombit dhe shtetit bullgar. Atyre duhet t'u bëhet e qartë se kombësia dhe shteti janë të pandashëm dhe për shtetin duhet të bëhen sakrificë, ashtu siç janë bërë më parë për kombësinë bullgare.

3) Atyre duhet t'u shpjegohet se në të kaluarën, në Maqedoni, mjetet kulturore për bashkimin e popullit bullgar u shkatërruan. Librat, shkollat, kishat, shoqatat, monumentet, festimet popullore, dhe veçanërisht këngët popullore, traditat dhe mitet bullgare u ndaluan gjatë regjimit turk dhe, si rezultat, një pjesë e popullsisë në Maqedoni i humbi ndjenjat bullgare.

4) Të theksohet fakti se si rrjedhojë e këtyre kushteve, në Maqedoni humbën njohuritë mbi të shkuarën



Trupat partizane përbëheshin vetëm nga vullnetarë. Aty nga fundi i luftës, partizanët filluan që të rekrutojnë ushtarë. Shumë djem të rinj u detyruan me forcë që të bashkohen me partizanët. Një prej tyre ishte Zdravko Lazariçi.



Përse shoku i Lazariçit bëri atë gabim të rëndë? Si e përjetoi ai (edhe pse në mënyrë të pandërgjegjshme) ndryshimin e pushteteve? Si reagojnë zakonisht njerëzit ndaj ndryshimit me dhunë të pushteteve?

bullgare, por nga ana tjetër, populli i lirë bullgar, në shtetin bullgar, pati arritje të mëdha.

5) Gjatë mësimdhënies duhet t'u kushtohet kujdes reagimeve që kundërshtojnë edukimin kombëtar, të cilat vijnë nga kampi i armiqve të Bullgarisë. Duhet shpjeguar qartë zhvillimet ushtarake në front dhe duhet të ushqehet tek nxënësit besimi se lufta do të përfundojë me sukses."

Terzioski, f. 78.




Ashtu siç ishte ndarë Maqedonia Jugosllave nga autoritetet bullgare, në dy njësi administrative, të emërtuara sipas dy qyteteve kryesore – Shkup dhe Manastir, ashtu u nda edhe sistemi arsimor në dy rajone. Në formën e rekomandimeve drejtuar mësuesve, ky burim paraqet ato pika që Inspektorati Rajonal i Shkollave në Manastir i konsideronte si qëllime kryesore që duheshin përmbushur (sigurisht që këto rekomandime nuk ndryshonin shumë nga ato në rajonin tjetër).



Çfarë rekomandimesh u jepeshin mësuesve në Maqedoninë Jugosllave? A e dini se çfarë ndodhi me Maqedoninë Osmane pas Luftërave Ballkanike dhe pas Luftës së Parë Botërore?

► Fig. 24. “Shkolla partizane”



Epopeja e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, 1939-1944.

Key Kjo pikturë e S. Capos titullohet “Shkolla partizane” dhe është tepër interesante, sepse paraqet rolin arsimor të luftës partizane. Ata që dinin si të shkruanin e të lexonin, u mësonin të tjerëve që nuk dinin.

II-33. Statuti i Klubit qendror kulturor “Kliment Ohridski” në Maqedoni

- 1) Të bashkojë të gjitha forcat e interesuara për zhvillimin e ndjenjave kombëtare bullgare të popullit maqedonas;
- 2) të ndërgjegjësojë popullin dhe t’i japë atij njohuri të plota për shtetin bullgar, perandorin dhe atdheun;
- 3) të punojë për të arritur bashkimin e të gjithë bullgarëve, në mënyrë që të krijojë Bullgarinë e Madhe në kufijtë e saj etnikë, historikë dhe natyrorë;
- 4) të punojë për të ngjizur identitetin e qartë bullgar në Maqedoni dhe ta edukojë rininë me frymën e shëndetshme kombëtare;
- 6) të kujdeset për integrimin e shpejtë e në çdo aspekt të Maqedonisë në Bullgari;
- 7) të punojë për bashkimin e të gjitha shtresave

shoqërore në një tërësi të vetme kombëtare dhe ekonomike;

8) të ushqejë dashuri për çdo gjë bullgare: historinë kombëtare bullgare, trashëgiminë kombëtare bullgare, ruajtjen e traditave dhe frymën kombëtare etj.”

Terzioski, f. 198-9.

Key Pas aneksimit të territorit të Maqedonisë Jugosllave nga Bullgaria, Drejtoria e Propagandës Kombëtare krijoi rrjetin e të ashtuquajturave “Komitete kulturore” në të gjitha qytetet e mëdha. Këto organe synonin të organizonin veprimtari arsimore e kulturore, si hapi i parë drejt krijimit të “universiteteve popullore”, të organizonin kurse nate për zhdukjen e analfabetizmit, të hapnin salla leximi e kështu me radhë. Shumë shpejt, këto komitete që morën emrin “Klube kulturore”, u bënë elemente të zakonshme në njësitë administrative në çdo nivel; qytet, bashki, njësi më të mëdha etj. Klubi qendror kulturor “Kliment Ohridski” u themelua në Shkup dhe statusi i tij është i vlefshëm për rolin e të gjitha klubeve kulturore në Maqedoni.

II-34. Qeveria e Antoneskut, pasi deklaroi se ka si qëllim të krijojë një sistem të ri edukimi për popullin rumun, nxiti një politikë arsimore nacionaliste, ku kulti i heronjve luante rolin kryesor

Kulti i heronjve në shkolla

Që shkolla të jetë një çerdhe e edukimit kombëtar për fëmijët dhe të rinjtë, duhet të pajiset me fotografi të mësuesve heronj, të cilat duhet të shoqërohen me shënime, lidhur me veprimtarinë e tyre në luftë dhe ç’kanë bërë për shkollën. Gjithashtu, në shkolla do të mblidhen fotografitë e fshatarëve të rënë në betejë, bashkë me historitë e akteve të trimërisë që kanë treguar. Kjo ka si qëllim të ngrrej lart figurën e tyre dhe të dëshmojë besimin që patën dhe sakrificat që bënë për atdheun.

Në këtë mënyrë, duke vendosur heronjtë e popullit tonë nëpër shkolla dhe duke i nderuar ata, do të krijohet libri i parë i historisë kombëtare për nxënësit. Bëmat e tyre do të ndikojnë në ndërgjegjen e fëmijëve dhe do të kenë ndikim thelbësor në formimin e tyre moral dhe kombëtar...

Përkujtimet të heronjve, çdo kopsht dhe shkollë fillore do t'i kushtojë një orë në javë. Programi i kësaj ore mësimi do të parashikojë përkujtimin e luftëtarëve në fshatra, duke përdorur mjetet e mëposhtme:

Fotografi të heronjve vendës...

Përshkrime prej heronjve të fshatit të cilët janë ende gjallë...

Harta të luftës kundër bolshevizmit (të vizatuara nga fëmijët)...

Rrugicat e heronjve: të mbillen në njërin krah të kopshtit të shkollës pemë që do të mbajnë emrat e heronjve. Këto pemë do të jenë *korija* ose *rruga* e heronjve vendës dhe do të mirëmbahen nga vetë fëmijët.

Çdo shkollë do të ketë një *kryq* që do të kujtojë heronjtë e fshatit.

Do të bëhen vizita në Varrezat e Dëshmorëve".

"Universul", 44/15.02.1942.

? Duke pasur parasysh treguesit e mësipërm, çfarë qëllimesh duhet të kishte arsimit në shkollat sipas Antoneskut? Ç'qëllim kishte përkujtimin e heronjve? A kanë nxënësit një model tjetër, përveçse atë të mësuesit? Cili është qëndrimi juaj ndaj "kultit të heronjve" në shkollat dhe "kultit të heronjve" në përgjithësi? A pasqyrojnë lufta e tyre bindjet tuaja të sotme? A ka projekte të ngjashme me këtë në shkollat e sotme?

II-35. Fragment nga një libër shkollor për arsimin fillor, botuar nga Fronti Nacional Çlirimtar (që udhëhiqej nga komunistët) në zonat e çliruara të Greqisë

Kush është 'fqinji yt'?

Kiki u zgjua sot me temperaturë të lartë. Gjithë natën, gati sa nuk u mbyt. E kishte fytin shumë të ashpër. Mamaja e Kikit i tha fqinjit të tyre që po shkonte në punë dhe e kishte rrugën andej nga banonte doktori, që ta lajmëronte të vinte. [...] Nënë nuk e zë vendi; sa herë dëgjon hapa në rrugë, vrapon tek dritarja të shikojë kush është. Kur do të vijë ky doktori?

Më në fund ai erdhi, e vizitoi fëmijën dhe tha:

- Duhet të keni shumë kujdes me fëmijën, zonjë. A

keni fëmijë të tjerë? Ata duhet t'i mbani të veçuar, sepse kjo sëmundje është ngjitëse. Merr këtë ilaç sa më shpejt dhe duhet t'ia japësh brenda një çerek ore.

Sapo iku doktori, mori shallin dhe çantën dhe vrapoi për në farmaci.

[...]

- *Tasia Joanidu*, - thotë farmacisti, ky preparat është gati dhe kushton 55 drahami. Ajo hap çantën dhe vëren se ka vetëm 35 drahami. Ç'mund të bëjë? Afrohet tek kasa.

- A mund t'ju jap tani të gjitha paratë që kam me vete dhe pjesën tjetër ta sjell mbasdite.

- Në asnjë mënyrë, - thotë me zë të lartë farmacisti. Do t'më bësh për budalla? Shko merr paratë dhe pastaj të të jap ilaçin.

Nëna vihet në siklet dhe fillon të qajë. Do të jetë vonë, fëmija im ka nevojë për këtë ilaç tani, jeta e saj është në rrezik.

Por farmacisti nuk ia vë veshin dhe njerëzit që janë aty e shikojnë me dyshim. Në këtë kohë, një punëtor ngrihet nga stoli në këmbë. Ai është i veshur keq dhe me fytyrë të vrarë.

- Si është puna, zonjë? Mos bëj kështu, njerëz jemi. Urdhëro, merri paratë që të duhen!

Nëna ulet që t'i puthë dorën punëtorit, por ai shpejton të ulet heshturazi në vendin e tij.

Ta aetopoula, 97-98, anatyposi ASKI.

? Si paraqitet punëtori në këtë burim? Përse paraqitet ai në këtë mënyrë?

► Fig. 25. Ilia Beshkov: Pa një hapësirë për të jetuar, 1942



? Ilia Beshkovi (1901-1958) është një nga artistët, karikaturistët dhe piktorët më të shquar bullgarë.

? Çfarë mesazhi përpiqet të japë ai nëpërmjet kësaj karikature?

II-36. Fragment nga *Raporti Konfidencial nr. 162* i konsullit të përgjithshëm amerikan në Stamboll, Samuel Honaker, dërguar Sekretarit të Shtetit të SHBA-së, Kordel Hull, mbi propagandën që zhvillohet në shkollat bullgare

Stamboll, 4 nëntor 1942

Një faktor tjetër që ndikon në mënyrë të veçantë në opinionin publik dhe si rezultat edhe në ndjenjat e popullit, është propaganda nacionalsocialiste që zhvillohet në shkolla. Ajo po vihet në praktikë duke mësuar nëpër shkolla gjeografinë, historinë dhe letërsinë e Bullgarisë. Çdo shkrimtar dhe mësues bullgar është propagandues i nacionalizmit bullgar. Të gjithë të rinjtë bullgarë të moshës 14-vjeçare, të cilët kanë mbaruar shkollën tetëvjeçare ose ata të moshës 19-vjeçare, që kanë mbaruar shkollën e mesme, e dinë përmendsh hartën e Ballkanit dhe i njohin shumë mirë mëtimet bullgare për territore të ndryshme të Ballkanit. Gjithashtu, dinë edhe arsyet për këto pretendime. Në muret e çdo shkolle ka harta të Bullgarisë të periudhave të ndryshme të historisë dhe ato janë gdhendur mirë në mendjen e çdo fëmije. Kështu që pretendimet territoriale janë kthyer në pjesë të interesave kombëtarë. Ato nuk shprehin vetëm qëndrimin dhe opinionin e familjes mbretërore dhe qeverisë, por gjithashtu atë të të gjithë popullit. Në këtë mënyrë, mësimi i formave të ndryshme të nacionalizmit ka fituar një rëndësi të madhe propagandistike.

Bullgaria – Aleatja e pakontrolluar e Rajhut të Tretë, f. 91.

? Përse ishte kaq e rëndësishme që në shkolla të zbatoheshin programe me frymë nacionaliste? A mendoni se diçka e ngjashme me këtë ekziston edhe sot në tekstet e Historisë, Gjeografisë dhe Letërsisë? Argumentoni mendimin tuaj.

► Fig. 26. Fotografi në një gazetë rumune: artikull mbi modën e veshjeve të grave (1942)



“Universul”, no. 30, 1 shkurt 1942.

? A mendoni se në këtë kohë kishte shumë lexues që interesoheshin për këtë artikull? Argumentoni mendimin tuaj.

► Fig. 27. Skenë nga filmi *Pafajësi pa mbrojtje*, i regjisorit Dragoljub Aleksic



Biblioteka e Filmit Jugosllav, Beograd.

Key Filmi u bë ilegalisht gjatë luftës, në Beograd. Aleksiči, një artist cirku, nuk kishte ndonjë eksperiencë në bërjen e filmave, ashtu si dhe bashkëpunëtorët e tij. Sidoqoftë, filmi u miratua nga censura dhe si i vetmi film serb në repertorin e kinemave vendase, të cilat shfaqnin vetëm filma gjermanë dhe ata nga vendet e tjera të Boshtit, ai u prit me sukses nga audienca.

II-37. Ligji rumun për organizimin e arsimit të hebrenjve (11 tetor 1940)

Neni 1. Në kuadër të arsimit privat, hebrenjtë janë të lirë të ngrenë shkollat e tyre fillore dhe tetëvjeçare. Neni 2. Në shkollat çifute që përmenden në nenin e mësipërm, mund të punojnë vetëm mësues hebrenj dhe në to mund të shkojnë vetëm nxënës hebrenj. Neni 3. Ata persona që i kanë të dy prindët hebrenj ose vetëm babanë hebre, pavarësisht nga besimi i tyre fetar, nuk mund të punojnë si mësues në shkolla të tjera ose në poste administrative. Ata nuk mund të jenë as nxënës ose studentë në shkollat fillore, tetëvjeçare ose ato të larta, shtetërore apo private dhe as në shkollat e minoriteteve të krishtera të etnive të tjera. Si përjashtim dhe duke e parë çdo rast veçan, Ministria e Arsimit Kombëtar, Kulturës dhe Artit mund të autorizojë ata persona që e kanë babanë hebre të krishterë dhe nënën të krishterë me etni të ndryshme, të punojnë në shkollat private dhe profesionale të krishtera, nëse janë pagëzuar dhe konvertuar në të krishterë deri në moshën 2 vjeç. Fëmijët e lindur nga marrëdhëniet jashtëmartesore do të gëzojnë statusin juridik të nënës së tyre. [...] Neni 5. Ministria e Arsimit Kombëtar, Kulturës dhe Arteve do të pushojë nga puna dhe do të transferojë të gjithë ata persona që përfshihen në dispozitat e nenit 3 të këtij ligji.

Evreii din România intre anii 1940-1944. vëll. I: Legislație antievreiască, f. 70-71.

? Si diskriminoheshin nxënësit hebrenj? A ekzistojnë edhe sot qëndrime të ngjashme ndaj hebrenjve apo grupeve të tjera etnike/fetare?

II-38. Ndryshimet në programin mësimor në Shqipëri gjatë pushtimit italian

Ministria e Arsimit filloi të vërë në veprim programin e saj të gjerë editorial për botimin e teksteve të shkollave të mesme. Siç duket, tekstet e shkollave të mesme pothuajse nuk ekzistonin dhe mësimet bëheshin me sistemin e shënimeve në fletore. Prandaj Ministria e Arsimit e mori në shqyrtim këtë problem dhe parashikohet se në fillimin e vitit të ardhshëm shkollor, një numër tekstesh, për të cilët janë duke punuar shkrimtarë dhe përkthyes të shumtë, do të jenë gati. Këto ditë doli nga shtypi teksti i parë, "Doktrina e fashizmit" e Benito Musolinit, me hyrje dhe shënime për shkollat nga Salvatore Valitutti, përkthyer nga prof. Kolë Shiroka. *Botimet e Ministrisë së Arsimit "Tomori", 6 gusht 1940, f. 2.*

? Komentoni titullin e tekstit të parë të përkthyer dhe botuar për shkollat e mesme në Shqipëri. Cila doktrinë kishte zënë vend kryesor në sistemin arsimor shqiptar?


► Fig. 28. Reklama filmash në kinematë e Beogradit në mes të shtatorit të vitit 1942



"Novo vreme" [Koha e re], Beograd 16 shtator 1942.

🔑 Nga titujt kuptohet se këta janë filma gjermanë, italianë dhe hungarezë. Me pushtimin e Serbisë, në prill të vitit 1941, të gjitha kinematë dhe sipërmarrjet e shpërndarjes së filmit u vunë nën "administrim rreptësisht të kontrolluar" dhe filloi të zbatohet censura; ndërkohë, kinematë që ishin pronë e hebrenjve, u konfiskuan. Filmat dokumentarë me propagandë gjermane dhe vendase ishin pjesë e detyrueshme e programit nëpër kinema.

► **Fig. 29. Fëmijë duke hyrë në shkollën fillore "Hasan Prishtina"**



🔑 Kjo fotografi është domethënëse për ndryshimet e bëra në shkolla pas pushtimit italian. Këtu shihen nxënësit duke hyrë në shkollën fillore "Hasan Prishtina". Kuptohet lehtë se uniformat që mbajnë fëmijët, janë uniformat e rinisë fashiste. Kjo ishte një nga mënyrat për të përhapur ndikimin fashist në shkollat shqiptare gjatë pushtimit.

II-39. Jeta në qendrën rinore "Italo Balbo"⁵⁷, një nga qendrat e shumta të ngritura nga fashistët në Shqipëri

Këta vizitorë shkojnë të shohin rininë fatbardhë, që ka privilegjin e lartë të gëzojë për të parën herë

këtu këtë hospitalitet fashist, ndër livadhet zbavitëse plot diell, ku çdo ditë marrin një edukatë të mirë fizike e morale dhe mësojnë ta duan fashizmin dhe Duçen. Të gjithë ditën mbi kodër, në ajër e diell, përveç se bëjnë ushtrime, banja, lojëra, valle e gjëra të tjera zbavitëse e sportive, mësojnë ta njohin Perandorinë, në të cilën Shqipëria ka fatin të bëjë pjesë dhe Sovranin e saj, jetën e Themeluesit të Perandorisë, gjestet heroike të Italo-Balbos, me emrin e të cilit është pagëzuar kolonia.

Tomorri, 11 gusht 1940, f. 2.

? Sipas mendimit tuaj, cili ishte qëllimi kryesor i një qendre të tillë? Për ç'qëllime shfrytëzohej argëtimi që ofrohej në qendër?

► **Fig. 30. Skuadra kombëtare e futbollit e NDH-së (Shtetit të Pavarur Kroat)**



? Përse futbollistët nderojnë me duar lart? Çfarë simbolizon sot ky veprim? Sipas mendimit tuaj, a duhet që sportistët të përfaqësojnë vendin e tyre, nëse nuk janë dakord me politikën zyrtare të tij?

⁵⁷ Vullnetar italian, i cili kishte luftuar në Shqipëri në vitin 1913, gjatë Luftërave Ballkanike. Gjatë Luftës së Dytë Botërore ai ishte një nga komandantët më të shquar të skuadrave të aviatorëve ushtarakë italianë.

Rumanisë dhe Kombeve të Bashkuara. Gjithashtu, është e ndaluar shpërndarja nga ana e bibliotekave të shkollave dhe universiteteve, e librave që mund të përmbajnë fragmente që cenojnë dispozitat e Konventës së Armëpushimit dhe që mund të prishin marrëdhëniet miqësore të vendosura me Kombet e Bashkuara.

“Universul”, 318/26 nëntor 1944.



A sollli regjimi i ri në Rumani demokraci dhe liri, siç u premtua në Deklaratën Mbretërore? Jepni argumente në mbështetje të përgjigjes suaj. Sipas jush, cilët janë nxitësit e këtyre kufizimeve në materialet mësimore? Përse mbahet ky qëndrim?

II-41. Ilija Jakovljeviç, i burgosur në kampin e ustashëve në Stara Gradishka (Kroaci), tregon rreth pastrimit të gjuhës që donte të arrinte Paveliç

“Në gazetën kryesore të ustashëve “Populli kroat”, me pakujdesi, dikush përdori fjalën ‘pogreb’ (shprehje serbe që do të thotë varrim). Poglavniku (titull që mbante Paveliç) mbeti i habitur, ‘oborri’ i tij u trondit, stafi i tij personal u tmerrua. Të gjithë

u alarmuan. Cili është kriminel? Në faqen e parë të gazetës “Populli kroat”, u botua dy herë radhazi një vërejtje e ashpër nga ana e zyrës personale të Poglavnikut, bashkë me një paralajmërim të Poglavnikut se ky kriminel do të ndëshkohej. (...) Po prisja që shumë shpejt ta shihja në kampin tonë këtë njeri (i cili përdori fjalën ‘pogreb’), por duke qenë se ishte stenografi personal i Paveliçit, ai u fal dhe ne na u mohua ky sensacion.”

Jakovljević, f. 205-206.



Me anën e veprimeve ndëshkuese, qeveria e ustashëve mori masa për “pastrimin” e gjuhës kroate nga ndikimet e huaja, kryesisht serbe. Duke pasur parasysh ngjashmërinë ndërmjet këtyre dy gjuhëve, ustasët u përpoqën (artificialisht) të krijojnë një gjuhë kroate që do të ishte krejt e ndryshme nga e paraluftës.



Përshkruani dhe shpjegoni qëndrimin e Jakovljeviçit ndaj Paveliçit. Ç’përshtypje krijoni për Paveliçin nga tregimi i Jakovljeviçit – sidomos në lidhje me anekdotën mbi fjalën serbe “pogreb”? A duhet që udhëheqësi i vendit të përfshihet në çështjet gjuhësore? Krahasoni imazhin që krijuat nga ky burim për Paveliçin, me atë të paraqitur në tekstin I-2.



Pyetje të përgjithshme mbi nënkapitullin IId.

Në këtë nënkapitull ka shumë shembuj në lidhje me propagandën që u përdor në arsim gjatë Luftës së Dytë Botërore. Bëni një listë me qëllimet e propagandës në vende të ndryshme dhe përpikuni të gjeni ngjashmëritë midis tyre. A u hoq propaganda nga sistemi shkollor pas Luftës së Dytë Botërore? Nëse jo, gjeni disa shembuj. A mund të jepni ndonjë shembull nga vendi juaj?

KAPITULLI III: Tmerret e Luftës

Krimet e tmerrshme të kryera gjatë Luftës së Dytë Botërore ishin rezultat i një morie faktorësh, rrethanash, qëndrimesh dhe ideologjish të ndryshme. Duke pasur parasysh këtë problematikë të gjerë dhe komplekse, në këtë kapitull do të trajtojmë me hollësi vetëm disa aspekte, si për shembull: gjendjen e vështirë të civilëve, si rrjedhojë e mugesës së një ndarjeje të qartë midis vijës së frontit dhe prapavijës; planet e Gjermanisë për të krijuar hapësira më të mëdha jetësore, çka solli edhe spastrimin e popullsisë nga territoret e pushtuara; egërsinë me të cilën zbatoheshin ideologjia gjermane, e cila bazohej në racizëm dhe antisemitizëm; mbajtja e kontrollit në territoret e pushtuara nëpërmjet ndëshkimeve të ashpra dhe të pamëshirshme ndaj popullsisë së pafajshme civile; dhe së fundi, rolin që luajti pushtimi fashist/nazist në nxjerrjen në sipërfaqe të tensioneve etnike. Ky i fundit ishte një nga shkaqet që bënë të mundur shpërthimin e luftërave civile në disa nga vendet e Europës Juglindore, ku të gjitha palët, të shtyra nga forcat pushtuese, nisën konflikte tejet të ashpra.

Lufta e Dytë Botërore e "pasuroi" fjalorin tonë me dy fjalë të tjera: *gjenocid* dhe *holokaust*. Sipas ideologjisë naziste për krijimin e një race të pastër, klasifikimi *Untermenschen* u zbatua jo vetëm për hebrenjtë, por edhe për romët, polakët, ukrainasit, rusët... Sidoqoftë, *Zgjidhja përfundimtare* konsiderohet si një çështje e veçantë, sepse u zbatua në mënyrë sistematike dhe pati pasoja të tmerrshme. Për këtë arsye, trajtohet në këtë kapitull si një ngjarje e veçantë, me natyrë të veçantë, me ecuri dhe qëllime krejt të ndryshme nga qëllimet dhe dinamika e luftës, por që, gjithsesi, u zhvillua brenda kuadrit të saj të përcaktuar. Fatkeqësisht, në Europën Juglindore, *Zgjidhja përfundimtare* u zbatua me një efektshmëri mizore, saqë numri i hebrenjve ra nga rreth 900 000, në më pak se 50 000.

Disa nga krimet e përmendura më lart janë ilustruar me anë të burimeve që vijnë dhe bëhen të larmishme qysh nga krimet e kryera në beteja, deri tek ato ndaj civilëve, gjatë operacioneve të raprezaljeve gjermane dhe italiane; e po ashtu, deri tek krimet nëpër kampet e përqendrimit, nëpër biruca, ose në operacionet partizane për hakmarrje, në periudhën e pasluftës etj.

IIIa. Vija e Frontit

III-1. Ligji ushtarak që zbatohet nga partizanët shqiptarë

"Vetëm në një rast u zunë robër disa italianë, dhe kjo ndodhi e jashtëzakonshme u deklarua me krenari të madhe nga Shtabi. U ftova të shkoja t'i shikoja me sytë e mi. Në një shtëpi në Vithkuq gjeta katër oficerë dhe katër ushtarakë italianë me grada të ndryshme. Dukej se i ishin nënshtruar fatit, sepse dihej që do të pushkatoheshin – të paktën oficerët. Megjithatë qëndronin shumë të qetë dhe nuk pranuan të jepnin informacion tjetër, me përjashtim të emrave dhe adresave të familjeve të tyre në Itali; u ndjeva i trishtuar, sepse pushkatimi i robërve ishte diçka që më indinjonte. Të mos pranoje robër në luftë, ishte një gjë krejt tjetër – italianët kishin kërcënuar dikur se do të pushkatonin dhjetë pengje

shqiptarë për çdo rob italian të kapur, gjë që nuk nxiste mëshirë. Plus kësaj, në luftën guerrile mbajtja e robërve është pengesë e madhe, pasi duhen ushqyer dhe duhen ruajtur mos arratisen; kështu që në përgjithësi nuk merreshin robër me vete. Përderisa luftëtarët guerrilas që kapeshin gjallë, pritej që të pushkatoheshin në vend, zakonisht pas torturimit, edhe forcat guerrile bënin të njëjtën gjë me robërit e tyre."

Smiley, f. 66.



Komentoni sjelljen e oficerëve italianë: a mund të quhet ajo heroike, edhe pse ata ishin pushtues në këtë luftë? Përse nuk pranoin të merrnin robër guerrilasit shqiptarë? Si ndikoi politika që ndoqën italianët në këtë aspekt?

III-2. Letra e komandantit të shtabit suprem të UNÇ-së e datës 22 janar 1944, dërguar misionit të aleatëve në lidhje me shtrirjen dhe armatimet e forcave armike

MISIONIT TË ALEATËVE

Berishë

I dashur zoti kapiten,

Kemi pasur urdhrin që të bëhet një hetim efikas i forcave të okupatorit të cilat kohën e fundit i ka në dispozicion në vendin tonë. Është shumë e vështirë për të ardhur deri te të dhënat e sakta, sepse kolona të ndryshme gjenden gjithnjë në parakalim, lëvizin dhe nuk rrijnë shumë ditë në një vend.

Sa u përket forcave vendore - ushtrisë shqiptare të mobilizuar nga ana e okupatorit dhe shërbëtorëve të tij - sipas informacioneve të verifikuara mirë gjendja është si vijon:

1. - Në Pejë - një regjiment me tre batalione me 3.000 ushtarë, 150 mitralozë dore, 24 mitralozë të rëndë me një bateri 65/17. Kanë shumë municion.
2. Në Gjakovë - dy çeta të batalionit të Prizrenit, të armatosura mirë. Janë gjithsej rreth 250 ushtarë.
3. Në Prizren - një batalion, një çetë e të shpërngulurve dhe një çetë 81.
4. Në Prishtinë - një regjiment me 3.000 vetë: 3 batalione, një çetë e mitralozëve, dy bateri, njëra 65/17 dhe tjetra 75/13.
5. Në Gjilan - një batalion i armatosur mirë me më shumë se 1.000 ushtarë.

Nuk ka tjetër ushtri shqiptare veç një numri të vogël, të shkapërderdhur sipas nevojave të shërbimit nga ana e forcave të lartpërmendura.

Ka mjaft bashibozukë, të cilët janë regjistruar si vullnetarë etj. Më shumë se kudo tjetër, vullnetarë të regjistruar ka në Plavë dhe Guci dhe janë të armatosur shumë mirë. Okupatori gjerman, me ndihmën e tradhëtarëve të popullit tonë, i ka mobilizuar dhe armatosur në mënyrën më të mirë të mundshme, madje edhe me minahedhës dhe me topa.

Në Mitrovicë okupatori paguan 800 xhandarë shqiptarë, 400 xhandarë serbë, një batalion bjellorus (bjellogardistë) prej 900 vetësh.

Këto informacione janë plotësisht të besueshme, të fituara nga një oficer dhe bashkëpunëtor yni shumë i ndërgjegjshëm, i cili është lojal me mish e me shpirt.

Tani po tentojmë të fitojmë më shumë të dhëna për forcat e armikut - për ushtrinë gjermane - për arsye se të dhënat e mëhershme nuk janë të vlefshme, sepse ushtria gjermane nuk rri në një vend, por lëviz herë këtu, herë në Shqipëri, e herë në territorin e okupuar nga ana e bullgarëve etj.

Kam dëgjuar se në afërsi të Vaut të Dardhës lëvizin disa ushtarë gjermanë. Në qoftë se ju vëreni diçka para nesh, na lajmëroni që të mund t'ua zëmë pritën dhe t'i shfarosim në kohë.

Mendoj se nuk është mirë që nuk e keni pranë vetes së paku një njësi partizane, pasi që tani jeni mjaft larg nga Shtabi i batalionit.

Me një përhëndetje të përzemërt antifashiste për të gjithë shokët

VDEKJE FASHIZMIT - LIRI POPULLIT!

pozicioni: Shtabi qendror i Ushtrisë NÇ dhe i njësisë partizane të Kosovës dhe Dukagjinit,

Komandant

22 janar 1944

Fadil Hoxha

http://www.znaci.net/00001/4_1_19.pdf

III-3. Letra e komisarit politik të shtabit suprem të UNÇ-së dhe Kk të Kosmetit e datës 14 prill 1944, mbi përmbajtjen e raportit lidhur me gjendjen politiko-ushtarake në regjion drejtuar sekretarit të komitetit krahinor të PKJ-së

1. Gjendja te ne është shumë e rëndë. Reaksioni që filloi me shpërnguljen e serbëve vjeshtën e kaluar ka përshkallëzuar gjatë dimrit dhe akoma vazhdon. Për të pamundësuar vëllazërimin dhe bashkimin e popujve të Kosovës që, megjithëse akoma në mënyrë të zbehtë por mjaftueshëm, ka filluar të realizohet, për të thelluar përçarjen e urrejtjes ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, si dhe për shkatërruar organizatën tonë, okupatori gjerman i ndihmuar nga reaksioni shqiptaromadhi ka filluar shpërnguljen e

popullsisë serbe nga Kosmeti, duke u lejuar masave shqiptare të përvetësojnë pronat e tyre. Në këtë drejtim, hiq ndonjë përjashtim, okupatori ka pasur sukses gjatë mobilizimit të masave shqiptare. Ka pasur burgosje, rrehje, plaçkitje dhe vrasje të popullatës së qetë serbe dhe ekzekutime masive siç ka ndodhur pas rastit të Ferizajit (34 viktima) në Pejë ku janë vrarë rreth 100 vetë. Vrasjet dhe plaçkitjet e serbëve më të ndershëm kanë vazhduar, kështu që popullata serbe, sidomos kolonistët, e kanë pasur të pamundur qëndrimin, prandaj ata janë detyruar që të shpërngulen në rrethana shumë të vështira. Këtë goditje okupatori e ka drejtuar veçanërisht atje ku ndikimi i partisë sonë ishte më i madh (rrethet: Ferizaj, Prishtinë dhe Pejë) kështu që atje edhe organizatat tona janë dobësuar, pasi që një numër i madh i anëtarëve të partisë dhe të Bashkimit të rinisë komuniste të Jugosllavisë janë detyruar të shpërngulen.

Qysh në vjeshtë okupatori ia ka dalë që të mobilizojë për ushtri dhe xhendarmeri, mëse 3000 shqiptarë, dhe t'i hedhë në Shqipëri kundër partizanëve. Tani janë ftuar 7 klasë në ushtri. Masat e shqiptarëve i përgjigjen thirrjes së okupatorit, por një pjesë e mirë e tyre nga frika prej okupatorit dhe mësymjeve të çetnikëve në Kosmet. (...)

http://www.znaci.net/00001/4_1_19.pdf

III-4. Trajtimi i robërve nga nacionalistët shqiptarë

“Sidoqoftë, ngjarja më e shënuar gjatë qëndrimit të ushtrisë në fshat ishte zënia rob e dy partizanëve, dy të burgosurit e parë të kësaj fushate. Ata ishin shumë të vegjël, 12 dhe 10 vjeç secili, dhe kishin ngelur pas gjatë tërheqjes së forcave nga Shupali, sepse kishin qenë të uritur dhe të pagjumë. Kur shkova t'i shihja, ata kishin ngrënë dhe kishin pushuar dhe, megjithëse ishin si të ndrojtur, ishin gati të miqësoheshin. E folura e tyre ishte e mbushur me zhargon komunist dhe na thanë se kishin pothuajse një vit që kishin ikur nga shtëpitë e tyre, afër Vlorës, për t'u bashkuar me partizanët. Të dy pretendonin se kishin luftuar kundër ballistëve dhe gjermanëve.”

Amery, f. 222-23.



Diskutoni rreth moshës së partizanëve të zënë rob. Ç'mendoni për fëmijët ushtarë? Cili është mendimi juaj për një ushtri që i rekruton dhe i përdor fëmijët? A ekzistojnë sot në ndonjë vend fëmijë ushtarë? Krahasoni këtë tekst me figurën 22.

Krahasoni qëndrimin ndaj të burgosurve në këtë fragment, me atë që paraqitet në burimin e mëparshëm. A është e mundur që të dalim në një përfundim të përgjithshëm, duke u bazuar vetëm në këto dy fragmente? Argumentoni qëndrimin tuaj.


► Fig. 32. Divizioni i katërt partizan në malet e Malit të Zi, 1944



Dedijer, *Dnevnik*.

► Fig. 33. Ushtarë rumunë mbi deve në Betejat e Kaukazit

PRIN NISIPURILE CAUCAZULUI



Soldatii romani folosesc cămilele ca mijloc de transport (P. P.)

“Universul”, no 272, 5 tetor 1942.



Duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e ushtarëve rumunë ishin fshatarë, komentoni shkurtimisht në lidhje me reagimin e ushtarëve ndaj udhëtimit me deve – një udhëtim shumë ekzotik për ushtrinë rumune. A mund të konsiderohet lufta si një mënyrë për të fituar përvoja të reja, jo domosdoshmërisht negative?

IIIb. Krimet

III-5. Njoftime, drejtuar popullit grek nga ana e komandantëve të ushtrisë gjermane në Greqi (1943)

“NJOFTIM

Kushdo që kapet duke këputur ose duke dëmtuar telat e telefonit, do të pushkatohet. Ky dënim do të zbatohet edhe për gratë dhe fëmijët.

Nëse autori i krimit nuk kapet, pesë persona nga fshati më i afërt do të merren dhe do të pushkatohen. Pjesa tjetër e fshatit do të ndëshkohet me gjoba. Zbatimi i këtij urdhri fillon që në datën e publikimit të tij.

Korfuz, 23 tetor 1943

Komandanti i ishullit të Korfuzit”

“NJOFTIM LIDHUR ME NDALIMIN E GREVAVE Çdo grevë do të konsiderohet si veprim armiqësor ndaj Autoritetev Pushtuese, edhe nëse nuk rrezikohen drejtpërdrejt interesat ushtarakë. Si të tilla do të konsiderohen edhe nxitjet ose përpjekjet për të organizuar greva.

Unë do të përdor çdo mjet që kam në dispozicion, që të ndaloj rreptësisht përpjekje të këtij lloji. Në të ardhmen, shkeljet e rënda do të ndëshkohen me vdekje. Dënimi me vdekje do të zbatohet kryesisht për nxitësit dhe udhëheqësit e këtyre veprimtarive. Pjesëmarrësit në greva do të dënohen me burg për një kohë të gjatë dhe do të dërgohen në kampe pune.

Athinë, 10. 9. 43

Komandanti ushtarak i Greqisë”

Fleischer, vëll. 2, f. 169.

III-6. Pamflet gjerman (tetor 1943), pas rapre-zaljeve të para masive në Greqi

“NJOFTIM POPULL I EPIRIT!

Ushtria gjermane ishte e detyruar të shkatërronte

fshatrat tuaj, sepse ju ndihmuat guerrilasit, të cilët vranë disa nga ushtarët tanë.

Duhet që t’i parandaloni sulmet e guerrilasve ndaj trupave gjermane.

Në rast se shikoni trupa guerrile, është detyra juaj që të njoftoni menjëherë repartin më të afërt ushtarak gjerman.

Në këtë mënyrë, ushtria gjermane do të mund të mbrojë jetën, familjen dhe pronën tuaj.

Ushtria gjermane nuk ka ardhur në Greqi si armike e popullit grek. Armiqtë tanë të vetëm janë guerrilasit, të cilët prishin qetësinë dhe rendin në vend. (...)

Që këtej e tutje, ju duhet të mbani marrëdhënie të mira me ushtrinë gjermane, në mënyrë që të rivendoset ligji dhe rregulli, dhe veçanërisht për të mbrojtur interesat tuaja vetjakë.

KOMANDA GJERMANE”

Fleischer, vëll. 2, f. 223.



A ishin në gjendje banorët e fshatrave të ndalnin sulmet guerrile ndaj trupave gjermane? A ishte vërtet qëllimi i ushtrisë gjermane në Greqi mbrojtja e jetës dhe e pronës së popullsisë vendase, siç pretendohet në këtë njoftim? Ç’mendoni për zbatimin e dënimit me vdekje për gratë dhe fëmijët për këto lloj veprimesh?

III-7. Urdhri i Hitlerit (shtator 1941), në lidhje me qëndrimin e ushtrisë në territoret e pushtuara në Europën Juglindore

“Në mënyrë që të çrrënjosisim veprimtarinë armiqësore, që në rastin e parë dhe pa asnjë ngurim, duhen marrë masa sa më të ashpra, në mënyrë që të vendoset autoriteti i forcave pushtuese dhe të ndalet përhapja e ideve të tilla. Duhet të kini parasysh se në këto vende jeta nuk ka vlerë, prandaj

frikësimi i popullsisë mund të arrihet vetëm me masa tepër të rrepta. Si kundërpërgjigje për jetën e një ushtari gjerman, duhet të dënohen me vdekje 50 deri në 100 komunistë. Mënyra e ekzekutimit duhet të ketë një ndikim tmerrues.”

Krizman, f. 520.

? Ushtria gjermane nuk i konsideronte këto ekzekutime si krime, pasi kryheshin në bazë të një urdhri të ligjshëm. A jeni ju dakord me këtë qëndrim? A mund të përcaktojnë rregullat apo ligjet gjithmonë në mënyrë të saktë se çfarë është krim dhe çfarë s’është i tillë?

► **Fig. 34. Raprezalje nga ana e ushtrisë gjermane në Greqi (fotografi e ekzekutimeve në masë në Agrinio, 1943)**



Fleischer, vëll. 1, f. 347.

III-8. Mizoritë gjermane gjatë pushtimit të Shqipërisë (korrik 1943)

“Kur po kthehesha, pashë të dilte tym nga disa fshatra të tjerë që po digjeshin dhe mendova se italianët u kishin vënë zjarrin për t’i ndëshkuar; e kisha gabim, sepse kur u takova me Safet Butkën dhe çetën e tij të Ballit Kombëtar, më tha se ky ishte fshati Barmash, dhe zjarrin ia kishin vënë gjermanët. Ai më tha se kishin djegur të gjallë gra dhe fëmijë në shtëpitë e tyre dhe i kishin qëlluar kur ishin përpjekur të shpëtonin; ai shtoi, gjithashtu, se një divizion gjerman sapo kishte mbërritur në Korçë nga Follorina. Ky ishte lajmi i parë që morëm për mbërritjen e gjermanëve në Shqipëri.”

Smiley, f. 52.

Qëndrimi që mbajtën ushtarët gjermanë ndaj ushtarëve italianë, pasi Italia kapitulloi (tetor 1943)

“Aty u vonuam përsëri, pasi fshatarët ngulmuam që të më tregonin varret e 65 oficerëve italianë. Gjermanët i kishin detyruar fshatarët që t’i varrosnin. Ata më thanë se i kishin parë kur gjermanët i kishin vrrarë, u kishin lidhur duart, i kishin rreshtuar, i kishin qëlluar me automatikë dhe i kishin dhënë fund jetës së të plagosurve me bajoneta. Pasi kishin parë këtë skenë, dukeshin shumë të frikësuar nga gjermanët dhe u qetësuan kur panë që po ikja.”

Smiley, f. 93.

? Cili ishte qëllimi i kësaj sjelljeje kaq të egër nga ana e ushtrisë gjermane? Kur mund të ketë ndodhur ngjarja e dytë? Në vendin tuaj, a kanë kryer gjermanët krime të ngjashme me ato të mësipërmet?

III-9. Don Pjetro Brinjoli⁵⁸: Meshë e shenjtë për njerëzit që ranë në luftë (pjesë nga një ditar)

25 gusht. Gra të dëshpëruara. Njëra prej tyre kërkon drejtësi.

⁵⁸ Don Pjetro Brinjoli ishte famulltar në ushtrinë pushtuese italiane në Slloveni dhe Kroaci. Gjatë luftës, ai shkroi një ditar që u botua në vitet 60. Ai i qëndroi besnik Italisë, por këtu përshkruan dhe dënon trajtimin e egër që i bëhet popullsisë së Sllovenisë dhe Kroacisë nga ushtarët italianë. Gjatë mësymjes italiane, në verë dhe vjeshtë të vitit 1942, pati djegie të fshatrave, pushkatim të robërve, internime në kampet e përqendrimit, grabitje... Për të gjitha tmerret që pa, Brinjoli fajësohte luftën dhe në një farë mënyre po përpiqej të gjente përgjigje për dëshpërimin e tij në këtë të keqe universale.

Në fshatin ku sapo hymë, si zakonisht, burgosëm të gjithë burrat. Në fillim të operacioneve, kur burgosëm burrat, njerëzit nuk u frikësuan, pasi nuk e dinin se çfarë i priste. Pasi lajmi se ç'po ndodhte u përhap⁵⁹, u krijua një lloj vale dëshpërimi. E njëjta gjë ndodhi në fshatrat "e çliuara".

Duke qenë se i grumbulluan burrat në livadh dhe i ruanin me roje, gratë u mblodhën jo shumë larg prej andej dhe luteshin që t'i lëshonin, duke qarë aq fort, sa edhe ushtarët më indiferentë u prekën nga kjo. Hera-herës, dikush e kërcënonte këtë turmë të mjerë, duke i thënë se të gjithë burrat do të pushkatoheshin, nëse gratë nuk ndalonin së përgjëruari. Për një çast gjithçka binte në qetësi, më pas dëgjonim një ngashërim me zë të ulët, dhe në fund ato fillonin të qanin edhe më me dënësë sesa më parë..."

Repe, *Naša doba*, 1996, f. 201.



Autori i këtij ditari jo vetëm që ishte dëshmitar, por edhe mori pjesë në këtë ngjarje. A ndihen shenja keqardhjeje në fjalët e tij?

► **Fig. 35. Fotografji të fshatrave të djegur dhe të shkatërruar gjatë raprezaljeve**



Fleicher, vëll. 2, f. 497.

III-10. Fragment nga intervista me Cveto Kobalin⁶⁰

"Pas disa ditësh, ata na grumbulluan për të na transportuar. Rreth 1000 veta do të transportoheshin me një tren të vetëm. Udhëtimi zgjati dy ditë. Në vagonin tonë, përgjatë rrugës vdiqën disa veta. Vapa ishte e tmerrshme, kushtet të padurueshme. Vagonët përdoreshin për transport bagëtish dhe nuk kishte asnjë vend që të mund ta përdornim si banjë. Më pas i morëm trupat e vdekur nga stacioni i trenit dhe i çuam në majë të kodrës ku ndodhej kampi i përqendrimit. Pak përpara se të hynim në Mauthausen, një nga të burgosurit u vra vetëm se mori një mollë nga toka... Nga përvoja ime, do të doja t'i thoja brezit të ri se a nevojshme është që të luftojë kundër dhunës. Asnjë formë dhune, edhe ajo me qëllimet më të mira, nuk mund të jetë e justifikuar..."

Repe, Intervistë (video) me Cveto Kobalin



Ç'mendim ka për dhunën Cveto Kobali, i mbijetuari i kampit të përqendrimit të Mauthausenit? A keni edhe ju të njëjtin mendim me të?

⁵⁹ Robërit pushkatoheshin ose dërgoheshin nëpër kampe përqendrimi.

⁶⁰ Cveto Kobali lindi më 15. 12. 1921. Në vitin 1941, u bë anëtar i lëvizjes së rezistencës në Slloveni. Në janar të vitit 1941, e arrestuan dhe e dërguan në kampin e përqendrimit në Aushvic dhe më pas në Mauthausen. Në verën e vitit 1944, ai u arratis nga kampi i punës në Linz (Austri) dhe u bashkua me partizanët në Slloveni. Në qershor të vitit 1944, një shtëpi botuese partizane ilegale botoi pamfletin e tij mbi kampin e Mauthausenit. Ky botim është teksti i parë i njohur mbi një nga kampet më të tmerrshme të përqendrimit (shiko ilustrimin).

► **Fig. 36. Faqja e parë e pamfletit mbi**



Ky pamflet u shkrua nga Cveto Kobali në qershor të vitit 1944 dhe është teksti i parë i botuar mbi një nga kampet më të tmerrshme të përqendrimit.

III-11. Një letër drejtuar Hitlerit⁶¹

Paraçin, 25 mars 1941

Për Adolf Hitlerin

Berlin

Manteli i drejtësisë është shqyer. Mbizotëron arroganca dhe dhuna. Të mëdhenjtë shtypin të vegjëlit dhe me arrogancën e tyre injorojnë Zotin;

ata nuk kanë zemër.

Hitleri, i etur për gjak, po nxiton të mbjellë mjerim dhe brengë në çdo fushë të globit. As atdheu ynë nuk u kursye. Ne ju dhamë dorën me ndershmëri, por ju doni shpirtin tonë. Me dëshirën tuaj për të pushtuar dhe shtypur, ju shkeleni mbi çdo gjë që ka qenë e shenjtë për ne përgjatë shekujve – ju nëpërkëmbni lirinë dhe nderin tonë, ju nëpërkëmbni krenarinë tonë. Ne, bijtë e një populli të lashtë, të themi ty Hitler, bir i Kainit – mjaft! Nëse nuk na e vë veshin, do të përballësh me muskujt tanë të fuqishëm. Do të derdhim gjakun tënd dhe me këmbë dragoi do të qëndrojmë mbi kokën tënde, që të mos ngrihesh më kurrë. Ki parasysht se ndoshta Zoti na ka caktuar ne të hakmerremi për gjithë veprat e tua të mbrapshta. Mbage mend këtë! (Nënshkruar) Svetolik Dr. Dragaçevac

Shef i distriktit (në pension)

Administrata e sigurimit të Rajhut, Berlin 16 maj 1942

Policia Sekrete dhe Shërbimi Sekret (SD) Einsatzkommando në Beograd

Subjekti: Shefi (në pension) i distriktit, Svetolik Dragaçevaci, Paraçin, Jugosllavi

Zyra e Fyhrerit, NSDAP. Po ju dërgojmë këtë letër të mbyllur të shefit të distriktit të lartpërmendur, me një përkthim të bashkëngjitur. Letra përmban fyerjet dhe akuzat më të ashpra, drejtuar Fyhrerit. Ju kërkujmë që të merrni të gjitha masat e nevojshme ndaj autorit të kësaj letre dhe të raportoni, në rast se arrini ta arrestoni.

Me urdhër të: (nënshkruar) Bastz

Arkivi Historik i Bashkisë Beograd, BDS, d-77.



Përpiquni të kuptoni arsyet pse u shkrua kjo letër. Sipas jush, kur e shkroi këtë letër, a ishte i ndërgjegjshëm Svetolik Dragaçevaci për rrezikun e mundshëm? Nëse po, atëherë përse

⁶¹ Mbi dokument ka një shënim në gjuhën serbe: "Personi vdiq në kamp përqendrimi, më 14 janar 1942." Ditën që u shkrua kjo letër, Jugosllavia u bashkua me Forcat e Boshtit. Pas dy ditësh, qeveria jugosllave u rrëzua nga një grusht shteti dhe më 6 prill filloi pushtimi gjerman. Ndaj mendohet se personi që e shkroi këtë letër nuk ishte plotësisht i ndërgjegjshëm për rrezikun që i kanosej.

e shkroi këtë letër?

III-12. Masat e marra nga gjermanët, si përgjigje ndaj kryengritjes në Serbi

“...Meqë dështimi e uli reputacionin e forcave tona të armatosura..., mendoj se për të vënë në vend prestigjin e humbur, është e nevojshme që të paktën në një zonë të caktuar të ndërmarrim veprime tejet të ashpra, në mënyrë që edhe pjesët e tjera të Serbisë të frikësohen nga ky shembull. (...) Gratë dhe fëmijët veprojnë si ndërlihdës dhe transportojnë furnizime, prandaj duhet ndëshkuar i gjithë populli dhe jo vetëm burrat...”

Sapo arriti në Serbi, vetë gjenerali Bohme urdhëroi që “brenda një kohe të shkurtër duhet të ndërmerren masa të ashpra, që të bëhen shembull drithërues për të gjithë Serbinë”.

Kjo politikë për shtypjen e qëndresës në vendet e pushtuara bazohej në urdhrat që vinin nga “rangjet më të larta”, nga shtabi qendror i Hitlerit. Ata i kishte

dhënë vetë Hitleri, nëpërmjet gjeneralit Keitel, më 16 shtator 1941. Diku theksohej se: “Në mënyrë që të shtypet kjo lëvizje që në embrion, duhet të merren masa sa më drastike... Përsa u përket këtyre masave, duhet pasur parasysh se në këto vende jeta e një njeriu shpesh nuk vlerësohet, prandaj ata mund të frikësohen vetëm nëpërmjet masave tejet të skajshme”.

Božović, f. 23.



Teksti i referohet kryengritjes së armatosur që shpërtheu në Serbi në verën e vitit 1941. Ngaqë populli mbështeti forcat kryengritëse, dhe si kundërpërgjigje ndaj humbjeve që pësuan, forcat pushtuese ndërmorën një valë të ashpër sistematike ndëshkimesh, të cilat gjatë vjeshtës së atij viti u shtrinë në të gjithë Serbinë. Në shtator të vitit 1941, gjenerali Turner, kreu i administratës pushtuese, i propozoi gjeneralit Bohme (gjeneral komandant në Serbi) të ndërmerre disa masa si kundërveprim ndaj kësaj

kryengritjeje.

III-13. Masakra ndaj civilëve në Kragujevac⁶²

Më 20 tetor, rreth orës 7 të mëngjesit, trupat gjermane, nën drejtimin e majorit Koenig, rrethuan qytetin.


“Më pas gjermanët ngushtuan rrethimin dhe mblodhën të gjithë burrat pa përjashtim...; ata i morën njerëzit nga rruga, nga shtëpitë, dyqanet, baret, kishat dhe nga kudo tjetër. Ata morën avokatët e klientët e tyre nga sallat e gjyqit, sekretarët; profesorët, mësuesit dhe studentët nga shkollat... edhe të sëmurët nëpër shtëpi, nuk i kursyen. Kështu mblodhën një numër të madh njerëzish, rreth 8-9 mijë veta, të cilët i futën nëpër hangarë topash...” Pushkatimet filluan në mëngjesin e datës 21 tetor. “Ata i vranë pengjet në këtë mënyrë: i merrnin


grupe-grupe... dhe nën mbikëqyrje të rreptë, i çonin tek vendet e pushkatimit që ishin pranë përroit Sushica, në Shumarie dhe nëpër hangarë topash. Vendi i ekzekutimit shtrihej në një sipërfaqe prej disa kilometrash. Atje i qëllonin me mitralozë, automatikë dhe pushkë automatike... ndërkohë, gjithë të tjerët që prisnin t’u vinte radha për të shkuar në vendin e ekzekutimit, dëgjonin krismat e mitralozëve, automatikëve dhe të shtënat e pushkëve, ndërsa ata që ishin duke u çuar në vendin e ekzekutimit shihnin me sytë e tyre të gjithë këtë skenë, përpara se të vriteshin edhe vetë.” “Ata (gjermanët) mëtonin në fletushkat që shpërndanin se kishin vranë 2 300 serbë, por kjo nuk është e saktë, sepse vetëm në Kragujevac, pa llogaritur numrin e të vranëve në fshatrat përreth, ata vranë 7 100-7 300 serbë.”⁶³

Božović, *Poruke streljanog grada*, f. 50.

⁶² Ekzekutimet gjatë muajit tetor në Kragujevac, Kraljevo dhe në qytete të tjera të Serbisë, të ndërmarra nga Verhmati dhe që shkaktuan mijëra të vdekur, janë shembull i qartë i karakterit të vërtetë të pushtimit. Nga fillimi i gushtit të vitit 1941, deri në mes të shkurtit të vitit 1942, 7 776 veta u vranë dhe u ekzekutuan gjatë luftimeve, ndërkohë që 20 149 veta u ekzekutuan nga skuadrat e pushkatimit gjatë këtyre raprezaljeve.

⁶³ Kjo shifër është konsideruar si shifër zyrtare për një kohë të gjatë. Në fillim të viteve 70-të, historiani serb Vencelav Glishiç, dhe më pas disa autorë të tjerë, kanë argumentuar se ky numër është i ekzagjeruar, megjithatë shifra reale mbetet më e lartë se 2 300 të vranë.


 Masakra e civilëve në Kragujevac u krye pasi njësitë partizane, në mes të tetorit, bënë një sulm pranë qytetit të Gornji Milanovacit, gjatë të cilit 10 ushtarë gjermanë mbetën të plagosur dhe 26 të tjerë u vranë (sipas “udhëzimeve për Serbinë”, për çdo person të vranë nga autoritetet pushtuese, do të merreshin peng 100 veta (dhe 50 veta, për çdo të plagosur). Njësitë kolaboracioniste vendase (“Trupat Vullnetare Serbe”) dhanë ndihmën e tyre në arrestimin dhe burgosjen e pengjeve. Pjesa e mësipërme është një fragment i shkëputur nga dëshmia e Danilo Mihailoviçit, oficer i lartë i policisë kolaboracioniste vendase, i cili shkoi në Kragujevac pak ditë pas masakrës.


 A e respektoi ushtria gjermane *ligjin e luftës*?
A dini ndonjë rast të ngjashëm në vendin tuaj?

III-14. Raport partizan rreth veprimeve të italianëve dhe çetnikëve në zonën e Likas, gjatë verës dhe vjeshtës së vitit 1942

“Sa herë u jepej mundësia, çetnikët i grabisnin dhe i vrisnin kroatët, sidomos simpatizantët a përkrahësit e NOB-së⁶⁴. Kështu ata vranë Ivan Sebeljin nga Glibodoli, baba i nëntë fëmijëve, Mijo Mesiçin nga Lipaci, Mijo Ferticin dhe gruan e tij, inxhinier Saticin nga Plasko, inxhinier Denisovin nga Drezniku. Kur kryenin vrasje ose grabitje, në shumicën e rasteve maskoheshin me kapele partizane, në mënyrë që për këto krime të fajësoheshin partizanët. Në shtator të vitit 1942, së bashku me italianët, ushtruan veprimtarinë e tyre në fshatin Ponikve dhe në rrethinat e tij, ku dhe grabitën dhe dogjën 96 shtëpi serbe. (...) Shpesh çetnikët i justifikonin krimet e tyre duke thënë se i kishin detyruar italianët që t’i bënin ato veprime, dhe shprehnin keqardhje për djegien e shtëpive të serbëve; por, thoshin ata, si kompesim digjnin më tepër shtëpi kroatësh.”

Jelić-Butić, f. 161.

 Qëllimi kryesor i çetave të çetnikëve ishte rivendosja e shtetit jugosllav, ku një Serbi e Madhe dhe homogjene nga pikëpamja etnike do të kishte vend mbizotërues. Për të arritur këtë, mendonin se duhej të “spastronin” popullsinë joserbe nga territoret që pretendoheshin prej tyre. Njësitë partizane ishin shpallur armiq të më të mëdhenj të tyre, dhe disa komandantë çetnikë pranuan të bashkëpunojnë me forcat italiane në fushatën e “hakmarrjes” dhe “spastrimit” në Dalmaci, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Mal të Zi, për të shkatërruar lëvizjen partizane. Një numër i madh civilësh kroatë, myslimanë dhe serbë u vranë gjatë këtyre fushatave.

 Si i justifikonin çetnikët krimet e tyre? Ç’kriter ndiqnin ata në përzgjedhjen e viktimave të tyre? Përse dhe në ç’raste ata digjnin shtëpitë e bashkatdhetarëve të tyre?

III-15. Krimet e çetnikëve kundër myslimanëve në Sanxhak, shkurt 1943

Të gjithë fshatrat myslimanë, në të tria zonat e përmendura më lart, janë djegur krejtësisht dhe asnjë shtëpi nuk ka mbetur në këmbë. E gjithë pasuria e njerëzve është shkatërruar, përveç një pjesë të bagëtisë, drithit dhe kashtës që ka shpëtuar. Është dhënë urdhër që të mblidhen ushqime për njerëzit dhe bagëtinë në vende të posaçme. Një pjesë e këtij ushqimi do të grumbullohet për t’u ruajtur dhe një pjesë do të përdoret nga njësitë ushtarake të cilat janë në terren dhe po merren me propagandë, në mënyrë që të drejtojnë dhe forcojnë organizimin e territoreve të çliruara. Duket se operacionet kanë patur si qëllim shfarosjen e plotë të popullsisë myslimane, pa dallim moshe apo gjinie.

Pajović, f. 315.

⁶⁴ Narodno Oslobođilačka Borba [Lufta Nacionalçlirimtare] – emri që partizanët i dhanë lëvizjes antifashiste.

III-16. Torturat e tmerrshme të kryera nga ustashët në burgjet e Sarajevës. Në këtë rast, viktima është një vajzë e re komuniste kroate

Dëshmi nga Shtefica Belak-Paviçiç

Më e keqja ishte kur në acarin e dhjetorit, ata më rrihnin, dhe në të njëjtën kohë më hidhnin ujë të ftohtë. Kjo ndodhte në bodrumin e godinës së Departamentit Mbikëqyrës të ustashëve dhe agjentët atje më rrihnin me turne. Më kujtohet se si nga trupi im i zhveshur dilte avull, dhe se si uji i ftohtë i dushit s'më linte të më binte të fikët e të rrëzohesha. Më pas më qëllonin me shqelma, me shkopa gome dhe kamzhikë. Trupi më ishte mbushur me njolla gjaku në ngjyrë blu dhe të zeza. Në qeli shtriheshim mbi betonin e dyshemesë. Pas gjithë asaj torture flisnim përçart nga temperatura e lartë. Ata na qëllonin me shkopa gome në shputat e këmbëve. Shumica prej nesh e kishte provuar këtë torturë. Disa mbijetuan, disa të tjerë jo.

Albahari, f. 431.

? Shtefica Belak-Paviçiçi mbeti gjallë pas torturash të tmerrshme. Nuk do t'i përgjigjeni ndonjë pyetjeje, vetëm përpiquni të imagjinoni se ç'pasoja mund të kenë për një njeri tortura të tilla.

► Fig. 37. Fotografi e sheshit kryesor në Beograd, më 17 gusht 1941



Arkivi Historik i Beogradit, Përmbledhje me fotografi

🔑 Këto ishin skena të përditshme gjatë pushtimit. Një iluzion se çdo gjë është "normale" (njerëz që shëtisin me rroba vere, një reklamë që fton njerëzit të shkojnë të shikojnë garat e kuajve, dhe klisheja e organizatës gjermane për pushime të organizuara 'Kraft durch Freude' [Forcë nëpërmjet dëfrimit] krah për krah tmerreve të pushtimit, me trupa njerëzish të varur në sheshin kryesor "Terazije", më 17 gusht 1941.

III-17. Autoritetet e policisë rumune raportojnë për gjendjen e romëve të internuar në Transnistria

Buletini i Inspektoratit të Xhandarmërisë, Odesa, mbi situatën në xhandarmëri, në muajin shtator 1943

Romët janë vendosur në zonën *Berezovca* dhe *Oceacov*; gjithsej janë 2 441 romë. Edhe këtë muaj romët janë përpjekur të mos kryejnë punë në bujqësi.

Ata janë shumë të pakënaqur që po dërgohen në Transnistria. Të gjithë përdorin çdo mënyrë të mundshme për t'u kthyer në vendin e tyre. Grupe të tëra me romë janë kapur duke u përpjekur që të kthehen në vendin e tyre, me dokumente dhe autorizime të rreme. Ata duhet të ruhen në mënyrë të vazhdueshme dhe të rreptë, që të mos arratisen nga kolonitë e Bugut.

Ata janë të zhveshur dhe të frikësuar prej dimrit që po afron. Sipas gjasave, do të vdesin gjatë dimrit për shkak të të ftohtët dhe urisë, ashtu siç vdiqën edhe dimrin e kaluar - vetëm kështu, me zhdukjen e tyre, do të zgjidhet në pranverë problemi i romëve në Transnistria.

Minoritati etnoculturale. Marturii documentare. Tiganii din Romania (1919-1944), dok. 339.

? Cilat qenë shkaqet kryesore për vdekjen e romëve të internuar? A morën autoritetet ndonjë masë për të mbrojtur njerëzit e internuar? Si e kishin planifikuar autoritetet zgjidhjen e "problemit rom"?

► **Fig. 38. Afishe me emrat e pengjeve të vrarë në pjesën e Sllovenisë së pushtuar nga gjermanët**



III-18. Ilija Jakovljeviçi përshkruan jetën në kampin e përqendrimit *Stara Gradishka* (pjesë e kompleksit të kampit të përqendrimit në Jasenovac)

“Poshtë qelisë sonë ndodhet një bodrum, i cili në pranverë mbushet me ujë që vjen nga lumi Sava, nëpërmjet kanalit të ujërave të zeza. Kanali lidhet me Savën. Kur në lumin Sava fillon të ngrihet niveli, grykëderdhja e kanalit duhet të mbyllet, në mënyrë që uji të mos kthehet mbrapsht. (...) Kur ustashtë morën në dorëzim burgun, nuk e dinin këtë gjë dhe e lanë kanalën hapur; uji i Savës u fut në kanal dhe e mbushi bodrumin plot e përplot. (...) Për të shuar etjen, njerëzit e ngratë⁶⁵ fusnin këpucët në bodrum nëpërmjet dritares (...), dhe në këtë mënyrë merrnin ujë për të pirë. (...); këpucët përdoreshin edhe për të pritur ujë të ndotur nga tubi i oxhakut. Një i burgosur që kishte për detyrë të pastronte çdo ditë korridorin përpara qelisë, më tha:

- Nga të gjitha punët që kam bërë në kamp, kjo është më e vështira. Kur derdh një kovë ujë në korridor, shikoj gishta poshtë derës së asaj qelie të mallkuar. Dikush merr ujë me dorë dhe e thith. Aty-këtu del ndonjë lugë. Ndonjë fatkeq i ngratë përpiqet të pijë ujë të pistë. Disa heqin këpucët që të fusin në to pak ujë, ndërsa të tjerë lëpijnë dyshtemenë për atë ujë të ndotur. Hapësira poshtë derës është shumë e vogël, kështu që kur derdh ujë, vetëm pak hyn në

qeli. Ndërkohë që disa hidhen për të pirë një pikë ujë, të tjerë thërrasin:

‘Mos i përplasni këmbët, mosni! Ndaloni një sekondë, se nuk po dëgjojmë dot kur hidhet uji!’

Jakovljeviç, f. 164-165.



Ilija Jakovljeviçi, politikan dhe anëtar i Partisë Fshatare Kroate përpara luftës, u burgos në kampin *Stara Gradishka*. *Stara Gradishka* ishte pjesë përbërëse e kompleksit të kampit të përqendrimit në Jasenovac. Numri i viktimave të Jasenovacit, pjesa më e madhe e të cilëve ishin serbë, por gjithashtu edhe hebrenj, romë, kroatë, boshnjakë dhe kundërshtarë të tjerë të regjimit të ustashtëve, ka qenë tepër i debatuar. Përlllogaritjet e përafërta të kohëve të fundit luhaten midis 70 000 deri 100 000 viktimave (për shembull shih: Igor Graovac, Dragan Cvetković: *Ljudski gubici Hrvatske 1941-1945. godine: pitanja, primjeri, rezultati...*, Zagreb, 2005).

III-19. Letër dërguar familjarëve nga kampi i përqendrimit “*Stara Gradishka*”

“Dje ai po qante në dhomën time (në dhomën e Dikës). A e dini që më shprehu një farë dashurie? I thashë që tani për tani, ta harronte këtë. Këtu dashuria nuk më intereson. Ai në fillim duhet të fitojë respektin tim, të ndreqë gabimet që ka bërë dhe të ndihmojë njerëzit. Më premtoi që do të bëhej i mbarë. Më tha se nuk do më linte as në çastet më të vështira. Përsa kohë do të ishte këtu, askush nuk do të më torturonte. Nëse vinte urdhri për ekzekutimin tim, do të vinte ta bënte vetë atë. Do të më qëllonte mbrapa kokës. Ai thotë se nuk dhemb, por sidoqoftë, nuk do të donte ta provonte vetë. Këto lloj bisedash bëjmë këtu. Nëpërmjet tij kam njohur edhe të tjerë. Jam bërë edhe fallxhore. U parashikoj atyre (ustashtëve) të ardhmen me letra; është e çuditshme si më dalin fjalët. (...) s’kam rrugë tjetër, ty të paktën do të të nxjerrin së shpejti, ndërsa mua s’më lënë të dal as për ajrim. Tri herë rrugë të mbarë! I mban mend të gjitha porositë që të dhashë për njerëzit e mi? Mos harro t’i japësh një puthje nga mami, vajzës sime të vogël.”

Jakovljeviç, f. 304.

⁶⁵ Të burgosurit e lënë pa ujë.



Kjo letër iu dha fshehtas Jakovljeviçit nga një prej bashkëvuajtësve të tij në kamp – një grua e quajtur Dika, anëtare e lëvizjes partizane. Jakovljeviçi pritej të lirohej pak kohë më pas. Në një pjesë të letrës, Dika përshkruan marrëdhëniet e saj të çuditshme me një nga të burgosurit e kampit, të cilin Jakovljeviçi e thërret me pseudonimin Shkëlqesia, sepse ai ishte një ustash dhe trajtohej më mirë se të burgosurit e tjerë në kamp (komunistët, hebrenjtë, romët, serbët).



Në fragmentin e parë përshkruhet se si ustashët i torturonin të burgosurit duke i lënë pa ujë. A është e mundur të gjendet një arsye e kuptueshme për një torturë të tillë? A lidhet kjo me faktin se në cilin krah luftuan ata, apo kishte të bënte me karakterin dhe natyrën e tyre vetjake? Ç'mendim keni për sjelljen e *Shkëlqesisë*? Cili është qëndrimi i tij ndaj të burgosurve, vrasjes së tyre dhe mbajtjes së tyre në kampe?

III-20. Një ushtar ustash përshkruan veprimet e tij mizore

“Ai (*Shkëlqesia*) vriste kohën në kamp – ishte, siç thoshte edhe vetë, nëpunës i lartë i një firme të madhe – dhe i kalonte netët në klube nate dhe hotele; me zor priste që të fillonte një jetë të re dhe t’i përkushtohej profesionit të tij. (...) *Shkëlqesia* është më shumë se një politikan. Ai është një bashkërendues dhe harmonizues i lindur në çdo fushë. Atij i vjen keq që nuk mund të jetë aktiv si ushtarak, edhe pse talenti i tij si strateg është i jashtëzakonshëm. Në një kohë të shkurtër, do ta pastronte vendin nga të gjithë armiqtë. Mendoni vetëm se me sa sukses e përmbushi detyrën që pati në Bosnjë! Kur hungarezët, pas rënies së tyre, i përzunë vullnetarët (e ushtrisë jugosllave), këta të fundit u kthyen në vendlindjen e tyre, në Bosnjë, toka e kohëve të vjetra, por gjithsesi vendlindja e tyre. Këta njerëz duhej të regjistroheshin.

- Si e bëre këtë?

- Shumë lehtë. U thashë të vinin dhe ata pranuan. Atyre iu tha se brenda një kohe të shkurtër do të dërgoheshin në një fshat ku do të ishin të sigurtë.

U kujdesa vetë që pasi të regjistroheshin, të ushqeheshin mirë. Më pas u transportuan në vagonë të mbuluar mirë.

- Ku u çuan?

- Në një stacion më të vogël. Nuk mund ta besosh, po për gjithë këtë aksion të duhen vetëm nja dy djem. Kishte nisur revolucioni dhe të arratisurit e kishin humbur fare. Ekzekutimi u bë nga romët. Më pas hoqëm qafe edhe ato qelbësiat. Më vjen keq që përveç romëve, m’u desh të vrisja edhe disa nga njerëzit tanë që morën pjesë në këtë punë. Ata e bënë gjithçka me iniciativën e tyre dhe autoritetet e ustashëve nuk mund të mbanin përgjegjësi për tekat e tyre. E di që ishte një humbje e madhe, por vendi kërkon që bijtë e tij më të mirë të sakrifkohen për të. Tani ishim të justifikuar – fajtorët ishin ndëshkuar. Raporti ishte një me njëqind. (...).

Nuk i justifikonte veprimet e tij si pasojë të urrejtjes ose ndjenjave të tij, por i pëlqente të përmendte disa motive më të larta. Kërkonte të gjente motive të tilla dhe ndoshta i gjeti gjatë spastrimit të Kroacisë nga serbët dhe ekonomisë kroate nga hebrenjtë.”

Jakovljević, f. 54, 57.



Autoritetet e ustashëve në Shtetin e Pavarur Kroat ndërmorën persekutimin e disa pakicave etnike, si serbët, romët dhe hebrenjtë. Pjesëtarëve të këtyre pakicave etnike iu hoq e drejta e pronës, u dërguan në kampe dhe u vranë. Në të njëjtën mënyrë u trajtuan edhe kroatët dhe boshnjakët, të cilët nuk pajtoheshin me regjimin e ustashëve. Politika e ndjekur ndaj hebrenjve ishte e ngjashme me atë që u zbatua në Gjermaninë naziste. Hebrenjve iu mohuan të gjitha të drejtat qytetare dhe martesat midis një hebreu dhe një personi me origjinë “ariane” u ndaluan, në bazë të “Ligjit për mbrojtjen e racës ariane dhe ruajtjen e nderit të popullit kroat”. Ky ishte një nga bashkëbisedimet që Ilija Jakovljeviçi pati në kampin *Stara Gradishka* me të burgosurin që njihej me emrin *Shkëlqesia*.



A mendonte *Shkëlqesia* se kishte kryer krime? Si i justifikonte veprimet e tij dhe si motivohej për të vrarë njerëz? Si e justifikonte ai vrasjen e njerëzve të tij?

III-21. Krimet e partizanëve në Bleiburg. Kolin Gunner, oficer i Këmbësorisë Mbretërore Irlandeze shikon me sytë e tij të burgosurit t'i kalojnë pranë...

"...trupat e Titos po i çonin ustashët drejt vdekjes. Në fakt, ustashët ishin jugosllavë që luftuan në krah të gjermanëve qysh në fillim. Tani, pas fitores së komunizmit të Titos, ata duhej të masakroheshin; të masakroheshin në kuptimin e plotë të fjalës. Vargu dukej i pafund dhe u drejtua nëpër urën Drava, në anën jugosllave. Burra, gra, fëmijë dhe bebe që mbareshin në krahë, të gjithë duke vdekur urie, lëviznin të ndjekur nga njerëzit e Titos të hipur mbi kuaj, dhe që mbanin në duar ata kamzhikët famëkeqë kozakë, me majë çeliku, 'nagajka', me të cilët mund t'ia shqyesh fytyrën një njeriu me një të qëlluar të vetme. Ata i përdornin këta kamzhikë si pa të keq..."

Bleiburg, f. 141-142.

Key Partizanët jugosllavë e konsideronin veten si luftëtarë që i respektonin ligjet e luftës dhe kishin neveri për krimet, dhe në çdo rast, donin të shfaqeshin të tillë. Pra, pretendonin se ishin ndryshe nga ushtritë kriminale fashiste. Megjithatë, nuk ngurruan të japin dënime me vdekje për të burgosurit dhe për civilët që cilësoheshin (ose edhe vetëm dyshoheshin) si bashkëpunëtorë me pushtuesin ose me autoritetet e ustashëve.

Në maj të vitit 1945, partizanët po i dëbonin ushtritë fashiste nga territori i Jugosllavisë drejt veriperëndimit. Ustashët, së bashku me një numër civilësh, po largoheshin nga Kroacia drejt kufirit të sotëm midis Sllovenisë dhe Austrisë, në mënyrë që të dorëzoheshin tek ushtria britanike (dhe jo tek partizanët). Gjithsesi, britanikët nuk pranuan që ustashët të dorëzoheshin tek ata. Shumë nga të burgosurit e luftës u vranë dhe u torturuan nga ushtarët e ushtrisë fitimtare. Kjo filloi qysh në qytetin e vogël të Bleigurgut (Austri), dhe vazhdoi edhe më pas, kur të burgosurit u detyruan të marshojnë drejt jugut, thellë në territorin jugosllav (ky marshim njihet si "Rruga e Kryqit").

? Nga se u shkaktuan ndëshkimet masive në fund të luftës? Krahasojini ato me manifestime të ngjashme të "furisë triumfuese" në vende të tjera (Hiroshima, Dresden, tek gjermanët e sudeteve, bashkëpunorët francezë etj.) A mund të justifikohen veprimet hakmarrëse në fund të luftës me faktin se ishte luftuar për një çështje të drejtë gjatë luftës?

III-22. J. B. Titoja flet për krimet e partizanëve në maj të vitit 19452

"Në lidhje me ata tradhtarë që mbetën brenda vendit, për çdo komb kjo është një çështje që i përket historisë. Dora e drejtësisë, dora e hakmarrjes së popullit tonë e kapi pjesën më të madhe të tyre dhe vetëm një pjesë e vogël arriti të arratiset jashtë vendit, duke u fshehur në krahët e mbrojtësve të tyre."

Bleiburg, f. 41.

? A është "dora e hakmarrjes" domosdoshmërisht "dora e drejtësisë"; a është kjo e njëjta gjë, ashtu siç paraqitet në këtë burim? Shpjegoni thënien: Çka është krim për një njeri, është drejtësi për një tjetër.

► Fig. 39. Viktimat (pikturë vaji nga Vladimir Filakovaci, Zagreb, 1943)



Muzeu Kroat i Historisë

⁶⁶ Krimet e kryera në fund të luftës mbetën për shumë vite një çështje tabu në Jugosllavinë e pasluftës.



Përshkruani këtë pikturë. Çfarë është ngarkuar në karrocë? Ç'mendoni për përdorimin e krimeve të luftës si subjekt në art? Sipas mendimit tuaj, cili ishte qëndrimi i autorit ndaj krimeve që paraqiten në pikturë?

III-c. Holokausti

III-23. Pjesë nga *Ligji Bullgar për Mbrojtjen e Kombit*

24 dhjetor 1940

Neni 21. Individët me origjinë çifute nuk lejohen që:
a) të marrin nënshtetësinë bullgare. Gratë me origjinë çifute nuk lejohen që të marrin nënshtetësinë e bashkëshortit;

b) të votojnë ose të kandidojnë në zgjedhjet politike ose në ato për organizata jofitimprurëse, përveç organizatave të hebrenjve;

c) të mbajnë poste shtetërore në administratën vendore ose në institucione të tjera publike – përveç organizatave të hebrenjve;

e) të martohen ose të bashkëtojnë me individë me origjinë bullgare; martesat e hebrenjve me bullgare, të lidhura pasi ky ligj ka hyrë në fuqi, konsiderohen të pavlefshme;

Neni 23. (...) Individët me origjinë çifute, që këtej e tutje nuk lejohen të vendosen në Sofje.

Neni 24. Individët me origjinë çifute nuk lejohen të zotërojnë ose të marrin me qera prona të patundshme, as vetë personalisht, as nëpërmjet të tretëve, ndërsa në fshatra, përveç banesës së tyre, nuk u lejohet të zotërojnë asnjë lloj ndërtese.
Neni 26. Në bazë të një raporti të bërë nga Ministri i Tregtisë, Industrisë dhe Punës, Këshilli i Ministrave ka të drejtë të ndalojë plotësisht ose të kufizojë pjesërisht punësimin ose investimin e kapitalit të hebrenjve në disa degë të tregtisë, industrisë dhe zejtarisë.

Brenda një muaji pasi ky ligj të hyjë në fuqi, të gjithë individët me origjinë çifute janë të detyruar të deklarojnë të gjitha pronat dhe pasuritë e tyre.

Mbijetesa. Përmbledhje me dokumente, 1940-1944, f. 157-161.



A ka ndonjë dokument të ngjashëm me këtë në vendin tuaj, lëshuar në të njëjtën periudhë historike? A ndiqej një politikë antisemite me detyrim në vendet e Europës Juglindore, vetëm për shkak të ndikimit gjerman? A mund të vendosnin vetë për këtë lloj politike aleatët e Gjermanisë? Gjithashtu duhet të analizohet edhe emri i këtij ligji: a kishte vërtet nevojë Bullgaria (apo ndonjë komb tjetër) të mbrohej nga hebrenjtë?

III-24. Deputetët bullgarë protestojnë ndaj dëbimit të hebrenjve⁶⁷

(...) Ka zëra se qeveria bullgare synon t'i dëbojë këta njerëz nga vendi. Këta zëra duhet të jenë të pabazuar dhe dashakëqij, sepse këta njerëz janë qytetarë bullgarë dhe dëbimi i tyre do të kishte pasoja negative jo vetëm për damkosjen e karakterit kombëtar të Bullgarisë, por do të ndikonte edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare në të ardhmen. Një komb i vogël nuk mund t'i shpërfillë aspektet morale. Karakteri i fortë moral do të jetë arma jonë më e fortë kundër padrejtësive në të ardhmen. Ka shumë rëndësi që ju, i dashur Kryeministër, të kujtoni se jo shumë kohë më parë, edhe ne vuajtëm pasoja të rënda morale dhe politike, për shkak të një legjislacioni të pazakontë që u formulua nga individë të papërgjegjshëm.

Cilën qeveri bullgare do të donim ta ngarkonim me një përgjegjësi të tillë në të ardhmen?

Hebrenjtë përbëjnë një numër të vogël në Bullgari; forca e shtetit ka mundësi dhe është e pajisur me shumë mjete ligjore, që të nënshtrojnë çdo element

⁶⁷ Në bazë të marrëveshjes midis Bullgarisë dhe Gjermanisë nga 22 shkurti 1943, 20 000 hebrenj duhej të shpërngulehin nga territoret e pushtuara nga Bullgaria (pothuasje i gjithë territori i sotëm i Maqedonisë, pjesë të Serbisë jugore dhe pjesë të Greqisë veriore). Në mars të vitit 1943 rreth 15 000 hebrenj nga këto territore u internuan në kampin e përqendrimit Treblinka. Qeveria bullgare nuk i internoi hebrenjtë bullgarë.

kriminal, pavarësisht nga etnia e tij. Prandaj është e panevojshme që të ndërmarrim masa të tjera dhe tepër mizore, të cilat mund ta bëjnë Bullgarinë pre të akuzave për pjesëmarrje në vrasjet masive. Këto akuza do t'i drejtohen pikësisht qeverisë së tanishme bullgare, por ato do t'i mbesin trashëgimi popullit bullgar, tani dhe në të ardhmen. Pasojat e kësaj politike janë lehtësisht të parashikueshme, prandaj nuk duhen lejuar. Ne nuk do të donim të mbanim asnjë lloj përgjegjësie për këtë. (...)

Mbijetesë. Përmbledhje me dokumente, 1940-1944, f. 216-218.



Kjo është një notë proteste (e datës 26 dhjetor 1943) nga ana e nënkryetarit të Sesionit të 25-të të Asamblesë Kombëtare Bullgare, D. Peshev dhe 42 deputetëve, drejtuar kryeministrit për mosdëbimin e hebrenjve jashtë kufijve bullgarë. Ata ngulmuan që masat kundër hebrenjve të merreshin në bazë të interesave politikë dhe jo bazuar në pikëpamjet etnike. Ata shtruan pyetjen nëse qeveria do të mernte përgjegjësinë e madhe historike të dëbonte nënshtrësit e saj të pafajshëm, në mënyrë që t'i shërbente një fuqie të huaj.



Komentoni fjalinë: *“Një komb i vogël nuk mund t'i shpërfillë aspektet morale.”* A do të thotë kjo se kombet e *“mëdha”* mund ta bëjnë këtë? Ç'probleme parashikonin për të ardhmen autorët e kësaj deklaratë?

III-25. Urdhër i lëshuar nga Komanda Ushtarake, Beograd

25 prill 1941

URDHËR

- 1) Të gjithë hebrenjtë në Beograd mund të blejnë ushqime dhe mallra të tjera nëpër sheshe dhe tregje vetëm pas orës 10.30 të mëngjesit. Shtësit nuk duhet t'u japin atyre mallra përpara kësaj ore.
- 2) Në çezmat publike dhe vende të tjera ku njerëzit

mbajnë radhë, hebrenjtë mund të qëndrojnë në radhë vetëm pasi qytetarët arianë të kenë mbaruar nevojat e tyre.

3) Të gjithë tregtarët ndalohen t'u shesin hebrenjve ushqime ose mallra të tjera me çmime më të larta dhe ilegalisht.

4) Hebrenjtë që nuk u binden urdhrave të mësipërme, do të dënohen deri në 30 ditë burg, ose do të gjobiten me 10 000 dinarë. Në varësi të vlerësimit që do të bëhet, mund të dërgohen edhe në kampe përqendrimi.

I njëjti ndëshkim do të merret për tregtarët që përmenden në pikën 3 të këtij urdhri.

5) Rajonet e policisë së Beogradit do të jenë përgjegjëse për zbatimin e ndëshkimeve, bazuar në urdhrin e mësipërm.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë. Datë 25 prill 1941, Beograd.

Koloneli dhe komandanti von Kaisenberg

Božović, Beograd pod komesarskom upravom 1941, f. 54.



Përse hebrenjtë nuk lejoheshin të blinin ushqime përpara orës 10.30 të mëngjesit? Cili ishte ndëshkimi, nëse nuk i bindeshin këtij urdhri?

III-26. Jon Antonesku dënon masakrat në Jashi⁶⁸

4 korrik 1941

Urdhër numër 255 i gjeneralit Jon Antonesku, udhëheqës i shtetit, drejtuar njërive ushtarake dhe xhandarmërive në vend, në lidhje me masakrën e përgjakshme ndaj popullsisë çifute në Jashi.

Disa ditë më parë, prishja e rendit në Jashi i vuri autoritetet dhe ushtrinë në një pozitë tejet të pavolitshme.

Kur lëshuam Besarabinë, ishte turp për ushtrinë, e cila pranoi të fyhej dhe të sulmohej nga ana e hebrenjve dhe komunistëve pa kundërvepruar.

⁶⁸ Më 30 qershor 1941, qeveria rumune deklaroi se 500 “komunistë hebrenj” u ekzekutuan në Jashi, sepse ata hapën zjarr kundër trupave rumune dhe gjermane. Në fakt, më 28-29 qershor u duk sikur pati të shtëna kundër trupave, por nuk pati të vrarë, e megjithatë u përhapën fjalë se komunistët hebrenj kishin ndërmend të sulmonin ushtritë në front, nga pas krahëve. Mijëra hebrenj u arrestuan dhe një pjesë u vranë. Komandanti i Divizionit të 14-të Rumun i internoi hebrenjtë e arrestuar. Sipas të dhënave zyrtare, nga 4 430 veta që u internuan dhe u hipën në dy trena, vetëm gjysma e tyre shpëtoi gjallë.

Turpi është edhe më i madh, kur ushtarët, me iniciativën e tyre dhe për një kohë të gjatë, grabisin, keqtrajtojnë ose sulmojnë popullsinë çifute dhe shpeshherë kryejnë edhe vrasje, siç ndodhi në Jashi. Popullsia çifute ka zhvatur, varfëruar, spekuluar dhe ka penguar zhvillimin e popullit rumun prej disa shekujsh. Nevoja për të hequr qafe këtë murtajë që u ka rënë rumunëve, është e padiskutueshme, por vetëm qeveria ka të drejtë të marrë masat e nevojshme. Këto masa janë në vazhden e zbatimeve dhe do të vihen në jetë në bazë të rregullave që unë vetë do të vendos.

Nuk është e mundur që çdo qytetar ose çdo ushtar të ndërmarrë zgjidhjen e problemit hebre duke vjedhur ose masakruar.

Nëpërmjet këtyre veprimeve tregojmë se jemi një popull i padisiplinuar dhe jo i qytetëruar dhe hedhim baltë mbi autoritetin dhe nderin e shtetit.

Nëpërmjet këtij urdhri, ndaloj plotësisht çdo veprim të ndërmarrë me nisma vetjake dhe ngarkoj me përgjegjësi autoritetet ushtarake dhe ato civile për të zbatuar me përpikëri këtë urdhër. Ata që e shkelin ose e kanë shkelur këtë urdhër, do të paditen dhe do të marrin ndëshkimin më të ashpër që parashikon ligji.

Gjeneral Jon Antonesku


Evreii din România între anii 1940-1944, vëll. II, dok. 98.



Cili është qëndrimi zyrtar i Jon Antoneskut për pogromin në Jashi? A ishte dënimi i akteve në Jashi shenjë e një qëndrimi prohebre? Sipas këtij urdhri, kush ishte përgjegjës për zgjidhjen e problemit hebre në Rumani? Edhe pse Antonesku akuzon minoritetin hebre për sulmet ndaj ushtrisë rumune, ai deklaroi se është kundër zbatimit të një "zgjidhjeje përfundimtare" për problemin hebre. A mendoni se ky ishte thjesht një reagim ndaj grabitjeve dhe krimeve të kryera nga disa individë? Cili mund të jetë rezultati i një qëndrimi të tillë nga ana e udhëheqësit të shtetit? Ç'mendoni për fajin kolektiv?

► Fig. 40. Karikaturë turke

Gazetelerden: Bir vapur dolusu Yahudi muhaciri İzmir limanından geçti...



Akbaba, 24 gusht 1939.



Përkthim: Një anije e mbushur me çifutë kaloi në portin e Izmirit. Çifutët thërrasin: "S'kemi asnjë grosh! Jemi të uritur! Ju lutemi, na lejoni të zbresim për pesë minuta dhe pastaj të kthehemi në anije të pasur!"



Cili ishte qëllimi i kësaj karikature? Ç'lloj paragjykimesh nxiti ajo?

► **Fig. 42. Një vajzë e panjohur që pret të dërgohet në internim (pranë Celjes në Slloveni)**



III-28. Vuajtjet e një vajze të vogël hebre nga Sarajeva

Rrëfim nga Hiba Zilxhiç-Çehajiç

Ngjarjet e tmerrshme që shoqëruan luftën kanë ndikuar thellë në fizionominë e mijëra të rinjve në Sarajevë, dhe ndër të tjerë, edhe tek vajzat e reja. Unë isha 16 vjeçe dhe shkoja në klasën e gjashtë të shkollës së mesme. Së pari, u prishën shkollat dhe në ndërtesat e tyre u fut ushtria. Në lagjen time jetonin shumë hebrenj. Unë kisha një shoqe shumë të ngushtë çifute, Rexhina Finci. Mamaja e saj kishte një dyqan të vogël në qoshen Bashçarshia. Shkoja në shtëpinë e tyre dhe shikoja se si jetonin me frikë çdo ditë, duke pritur të internoheshin nëpër kampe përqendrimi. Plaçkat i mbanin gati për t'i marrë me vete. Një ditë i morën për t'i çuar në kamp përqendrimi, por Rexhina arriti të largohej dhe

erdhi tek shtëpia jonë. Fatkeqësisht, edhe pse ne ngulmuam që të fshihej tek ne, ajo nuk pati forca që të qëndronte pa familjen e saj. Kështu që shkoi në kampin e përqendrimin, që t'i bashkohej fatit të familjes. Ky persekutim i hebrenjve dhe atmosfera e terrorit në familjet e tyre, çka e përjetova vetë, është një nga ndjesitë që ruaj nga ajo kohë. Në qytet u përhapën fjalë mbi kampet e përqendrimin në Gradishka dhe Jasenovac, si dhe për internimet dhe torturat që u bënin komunistëve dhe patriotëve atje. Vinin lajme rreth masakrave të llahtarshme të serbëve nëpër fshatra, rreth hedhjes së trupave në hone dhe humnera, rreth djegies së fshatrave, dhe më vonë, edhe për masakrat e çetnikëve ndaj myslimanëve pranë Drinos, për lumenj gjaku dhe për refugjatë që largoheshin për të shpëtuar kokën, pa e ditur se ku. Refugjatë nga Foça, Rogatica, Vishegradi kanë filluar të vijnë në qytet. Familjet e myslimanëve kanë strehuar fëmijë pothuajse të çmendur, pa prindër. Po përmend vetëm një pjesë të asaj atmosfere tmerrri. Pra, ky ishte fashizmi mizor dhe i pamëshirshëm.

Albahari et al. (red.), f. 495-496.

? Vlerësoni sjelljen e Rexhinës. Ç'do të bënit ju nëse do ishit në vend të saj? A ishte i lehtë vendimi që mori? Ku shfaqet në këtë burim mbizotërimi i humanizmit, edhe pse i rrethuar nga një regjim tejet shtypës e mizor?

III-29. Masa kundër hebrenjve në Greqi

Shënime rreth gjendjes së tanishme të hebrenjve në Greqi

Nga A.L. Molho


Kajro, 12 tetor 1943


Masat kundër hebrenjve dhe qeveritë kuislinge

(...) Është fakt se deri në muajin shkurt të këtij viti, hebrenjtë e Greqisë gëzonin *de jure* dhe *de facto* të njëjtin status si të gjithë qytetarët e tjerë grekë. Masat që u morën ndaj hebrenjve të Selanikut dhe të gjithë Maqedonisë që nga dita e lartpërmendur, u nxitën nga autoritetet pushtuese gjermane. Siç

thonë edhe vetë, vepruan në bazë të urdhrave shumë të saktë të marrë nga lart. Në mënyrë të vijueshme, autoritetet greke nuk kanë pranuar që të kenë të bëjnë me këto masa. Kisha Ortodokse ngriti zërin kundër tyre (Memorandumi i Kryepeshkopit të Athinës drejtuar autoriteteve gjermane). Me këtë protestë janë bashkuar edhe udhëheqësit politikë, si dhe organizatat profesionale dhe popullore. Trysnia e ushtruar nga opinionimi publik grek ka qenë kaq e madhe, sa që kryeministri kuisling, z. Joannis Rallis, u detyrua të deklarojë se do të ndërhynte në dobi të hebrenjve. Nuk bëhet e ditur nëse e mbajti premtimin e tij. Sidoqoftë, një gjë e tillë nuk është bërë zyrtare.

Dokumente mbi historinë e hebrenjve grekë, f. 280.

 Kur filluan të merren masa ndaj hebrenjve në Greqi, një numër i madh organizatash dhe institucionesh, duke përfshirë këtu kishën, policinë e Athinës dhe komunistët, i kundërshtuan ato dhe qenë të suksesshëm në këtë drejtim. EAM-i, organizata më e fuqishme e qëndresës në Greqi, qe më aktive në ndihmën që u dha hebrenjve, duke i fshehur ose duke i ndihmuar të arratisen, në mënyrë që të shpëtonin. Ajo bëri që të dështonin planet naziste, duke shkatërruar regjistrat e tyre mbi komunitetin hebre në Athinë; gjithashtu ndihmoi rabinët të largoheshin drejt territoreve të kontrolluara nga EAM-i. Shtypi ilegal i EAM-it botonte rregullisht thirrje drejtuar popullit për të ndihmuar bashkatdhetarët hebrenj, ndërkohë që kjo organizatë lehtësoi kalimin e hebrenjve grekë drejt Lindjes së Mesme, por edhe i rekrutoi ata në radhët e saj. Edhe kisha ortodokse i ndihmoi hebrenjtë, duke u përpjekur të ndalonte internimin e tyre. Kryepeshkopi Damaskinos u takua me përfaqësuesin e plotfuqishëm të Rajhut në Greqi dhe i drejtoi atij një ankesë serioze në lidhje me masat që po merreshin ndaj hebrenjve në Selanik (shiko Dok. I-40).

 Si reagues autoritetet greke ndaj masave që u morën kundër hebrenjve të Selanikut?

III-30. Fragment nga kujtimet e një hebriu grek në Selanik (1941-43)

“Në ditët e para të korrikut 1942, gazetat e Selanikut botuan një deklaratë zyrtare të komandantit ushtarak gjerman për Selanikun dhe Egjeun, në të cilën të gjithë meshkujve izraelitë nga moshë 18-45 vjeç u bëhej thirrje të paraqiteshin në sheshin “Elefterias” të shtunën në mëngjes, datë 12 korrik, dhe në rast të kundërt, kërcënoheshin se do të merrnin ndëshkime të ashpra. Që nga fillimi i pushtimit, ky ishte veprimi i parë zyrtar antisemit në Selanik. [...] Gjatë këtij grumbullimi pati abuzime me hebrenjtë nga ana e oficerëve dhe ushtarëve gjermanë. Disa prej atyre që vinin me vonesë u rrahën me grushta, shqelma dhe kamzhikë. Një grup marinarësh ushtarakë gjermanë shfaqën një egërsi të madhe në këto veprime. Anëtarë të policisë ushtarake gjermane (FG) i ndërsyen bulldogët e tyre kundër izraelitëve që guxuan të pinin duhan ose të mbulonin kokën prej diellit të nxehtë të korrikut. Të tjerë, që pasi u lodhën duke pritur për disa orë, u ulën në tokë, u rrahën nga njerëzit e Gestapos derisa u gjakosën. Izraelitë të tjerë u detyruan të bënin ushtrime të vështira fizike për shumë orë dhe u kërcënuan se do të rriheshin nëse ndalonin. Së fundi, grupe të tjera gjermanësh i detyruan izraelitët të bënin veprime poshtëruese (kapërdimje) përpara një turme të krishterësh kureshtarë. E gjithë kjo shfaqje u dokumentua me anë të fotografive që bënë gjermanët dhe reporterët, dhe të nesërmen u botuan në shtypin grek me përshkrime tipike antisemite. [...]

Më vonë pati edhe raste të tjera ku u morën masa arbitrare ndaj izraelitëve, si për shembull, dëbimi i 15 dyqanxhinjve nga tregu kryesor në rrugën Vas Irakliou (shitës perimesh e ushqimesh, kasapë etj.) dhe zëvendësimi i tyre me shitës të krishterë, të cilët u morën nga zona të tjera të qytetit. Nga kjo praktikë, prej së cilës përfitonin shitësit e krishterë, iu hap oreksi edhe konkurrentëve të tjerë me izraelitët, dhe pati ndërhyrje të shpeshta nga gjermanët për të dëbuar shitësit izraelitë nga tregjet kryesore dhe vendosjen në vend të tyre të tregtarëve të krishterë, të cilët ose ishin miq me gjermanët, ose u kishin dhënë rryshfet ndërmjetësve të njohur tashmë.”

Giakoel, f. 57-58, 98-99.

Key Ndër faktorët që ndikuan në numrin e hebrenjve që shpëtuan gjallë në Greqi duhet të mbahen parasysh: largësia nga zonat më të afërta nën kontrollin e rezistencës dhe prania e një lëvizjeje antifashiste të suksesshme, shkalla e asimilimit ose pranimit në shoqëri të këtij komuniteti, si dhe aftësia dhe dëshira e mirë e autoriteteve vendore. Shumica e hebrenjve që mbetën gjallë ishin greqishtfolës që jetonin në të njëjtat lagje me popullsinë ortodokse greke. Shkalla e asimilimit jo vetëm që e bëri më të vështirë gjetjen e tyre, por ndikoi gjithashtu në dëshirën e të gjithë popullit për t'i ndihmuar ata. Që pjesa më e madhe e hebrenjve grekë të shfarosur nga nazistët gjatë Luftës së Dytë Botërore ishin nga Selaniku, nuk kishte të bënte vetëm me faktin se atje gjendej komuniteti më i madh i hebrenjve në Greqi (në Selanik jetonin rreth 50 000 hebrenj, nga 73 000 që jetonin në të gjithë Greqinë), por në këtë rast ndikoi edhe një faktor tjetër: hebrenjtë e Selanikut flisnin spanjishten “sefaradite” (ladino) dhe jetonin kryesisht në lagje të veçanta, veçmas nga popullsia ortodokse greke. Popullsia çifute e qytetit u internua kryesisht në Aushvic. Arritën t'i shpëtonin nazizmit vetëm 17% e hebrenjve që jetonin në Greqi përpara luftës.

? Si ju duket sjellja e shitësve të krishterë që merrnin dyqanet e hebrenjve?

► **Fig. 43. Kampi i përqendrimit i Beogradit në Banjica**



Zločini fašističkih okupatora, f. 211.

► **Fig. 44. Kampi i përqendrimit Ushtica (pjesë e kompleksit të kampit të përqendrimit në Jasenovac), 1942**



Mataušić, Jasenovac 1941-1945.

Key Një grup grash dhe fëmijësh përpara *Shtëpisë së vajtimit* (Kuça Leleka).

? Përshkruani fotografinë. Ç'ndjenja shprehin fytyrat e të burgosurve? Shpjegoni emërtimn “Shtëpia e vajtimit”.

III-31. Letër dërguar zyrës së Paveliçit nga Rozalia Kremer, më 20 tetor 1941


“Jam mamaja e një vajze 17 vjeçe, që e thërrasin Bela dhe që quhet Beluska. Vajza ime u arrestua më 1 korrik 1941 pa ndonjë shkak, bashkë me hebrenj të tjerë nga Kustosija, ku ne kemi një dyqan të vogël. Vajza ime qëndroi pak ditë në rajonin e policisë në rrugën Petrinjska, ku unë i çoja edhe për të ngrënë. Një ditë kur po shkoja t'i çoja për të ngrënë, më thanë se nuk mund ta merrnin ushqimin, pasi ajo nuk ndodhej më në rajonin e tyre. Që nga ai çast, nuk kam mundur të gjej se ku ndodhet; është zhdukur pa lënë gjurmë.


Me sa di unë, nuk ndodhet në asnjë kamp, të paktën s'kam arritur ta gjej në ndonjë prej tyre, prandaj kam frikë nëse është ende gjallë ose jo. Duhet të them se vajza ime nuk është përzier kurrë në politikë. Ajo ka jetuar me mua në Kustosija që kur ishte e vogël, dhe më ndihmonte me dyqanin. Ajo ishte një vajzë e vogël dhe shumë e mirë, prandaj të gjithë në Kustosija e donin. Ajo ishte e sjellshme me njerëzit dhe gjithmonë e qeshur dhe e gatshme për t'i ndihmuar.

Ju kërkohet që të më njoftoni se çfarë ka ndodhur me vajzën time; nëse është ende gjallë dhe ndodhet në ndonjë kamp, më thoni ku, që t'i dërgoj rroba të trasha, sepse nuk mund ta kalojë dimrin me atë fustan të hollë që kishte veshur kur e morën.


Dua t'ju them gjithashtu, se burri im është shumë sëmure dhe përveç Beluskas, ne kemi edhe dy fëmijë shumë të vegjël që duan shumë kujdes nga ana ime, prandaj nuk është e mundur për mua që t'i bëj të gjitha punët vetëm. Vajza e madhe ishte ndihma ime e vetme."


Goldstein, f. 365-366.


 Kur u shkrua kjo letër, Belën tashmë e kishin vrarë.

 Si e paraqet znj. Rozalia kërkesën e saj? Përse nuk thotë ajo drejtpërdrejt se iu bë një padrejtësi e madhe, një krim? A mendoni se në disa raste edhe vetë viktimat kishin filluar ta pranonin këtë realitet kriminal si diçka normale? E njëjta pyetje mund të bëhet për ata që kryenin krime, si edhe për pjesën më të madhe të popullsisë që qëndroi në heshtje.

► **Fig. 45.** Faqja e parë e një katalogu nga ekspozita kundër hebrenjve në Zagreb, 1942



 *Përkthim:* Ekspozitë mbi zhvillimin e judaizmit dhe veprimtarisë së tij shkatërruese në Kroaci përpara 10 prillit të vitit 1941. Zgjidhja e problemit hebre në Shtetin e Pavarur Kroat (SHPK).

 Përshkruani figurën dhe kuptimin e saj. A ka patur edhe në vendin tuaj një ekspozitë të tillë? A mund ta imagjinoni se çfarë do të paraqitej në të?

KAPITULLI IV: Solidariteti njerëzor

Ky kapitull synon të hedhë një rreze optimizmi në çështjet e errëta të luftës dhe të tregojë se edhe ngjarjeve më tragjike në historinë e njerëzimit nuk u mungoi humanizmi, se dhe në rrethanat më kaotike të luftës, kishte njerëz të gatshëm për të ndihmuar të tjerët, ndonjëherë edhe duke marrë përsipër rreziqe dhe duke vënë sigurinë dhe jetën e tyre në rrezik.

Për më tepër, në këtë kapitull përfshihen disa burime të cilat paraqesin sjellje të pazakonta dhe të çuditshme të njerëzve gjatë periudhës së luftës. Në këto burime jepen situata të cilat nga pikëpamja morale ishin disi të paqarta: nuk ishin të kuptueshme, dhe pikërisht për këtë fakt ato na japin rastin që t'i analizojmë dhe t'i diskutojmë (për shembull: IV-1 dhe IV-2). Një qasje e dobishme ndaj tyre do të ishte *metoda e lojës me role*, p.sh., nëse nxënësve u caktohet të luajnë rolet e personave që gjenden në situatat e vërteta dhe të përpiqen të parashikojnë sjelljen dhe të kuptojnë ç'ndienin personazhet në situatat e përshkruara.

IV-1. Bashkëbisedim midis një partizani dhe një ustashi

"Përse më harxhon kot municionet, mor ustash, bir bushtre!"

Tashmë i konsideron municionet e ustashit si të tijat dhe i vjen keq për çdo plumb që ai harxhon.

"Hajde merri, mos ki frikë, ti bir bushtre",
- i përgjigjet ustashi.

Por kjo është vetëm hyrja në bashkëbisedimin kryesor, i cili ka karakter "politik". (...) Ustashi nuk e beson se partizanët ekzistojnë dhe mendon se ne jemi të gjithë çetnikë. Çetnikë dhe të jashtëligjshëm, janë të gjithë njëllor, luftojnë kundër kroatëve, në dobi të serbëve dhe hebrenjve. Ai (*ustashi*) i kërkon Svrabos të shajë mbretin Petar dhe mbretëreshën Maria, në mënyrë që të provojë se nuk është çetnik. Svrabo ia plotësoi dëshirën me shumë kënaqësi dhe menjëherë i kërkoi ustashit të shante Paveliçin. (...), dhe pikërisht në çastin kur ustashi mbeti pa fjalë, sepse ai as nuk donte, as nuk mund ta shante Paveliçin, dikush, i nxehur, qëllloi me automatik. Ai nuk qëllloi në shenjë, por kjo ndërpreu bisedën dhe Svraboja u tërhoq në vendstrehim.

'A je plagosur?' - pyet ustashi me shqetësim.

'Jo, nuk jam plagosur', - përgjigjet Svrabo.

'Përse e qëllon, maskara, nuk e sheh se unë po flas me të', - i bërtet ustashi atij që i ndërpreu bisedën. (...)

'Nëse e zë, betohem se do ta lë të iki', - thotë Svrabo me zemërgjerësi. Por në këtë thënie nuk kishte asnjë gram të vërtetë. Vetëm po të fluturojnë gomarët, Svraboja do ta linte të ikte një ustash."

Šibl 2, f. 203-204.



Në një numër të madh paragrafësh, Ivan Šibli përmend shprehje të vrazhda dhe fyese, të ngjashme me ato që luftëtarët e ushtrive ndërluftuese në Kroaci përdornin ndaj njëri-tjetrit. Në fillim të vitit 1943, luftime të ashpra u zhvilluan në Slavonia. Në bazat e tyre pranë Voçinit, armiqtë (në këtë rast partizanët dhe ustashët) ishin rreth 60 metra në vijë ajrore larg njëri-tjetrit, kështu që ushtarët e të dyja ushtrive mund të komunikonin pa vështirësi. Komandanti partizan i Šiblit, Milan Svrabiç- Svrabo, shpesh fliste me një nga ustashët. Ky është një nga bashkëbisedimet që filloi pas një të shtëne që erdhi nga ana e ustashëve.

❓ Sipas mendimit tuaj, a ishin të zakonshme biseda të tilla në beteja të tjera ose në luftëra të tjera, apo ishte kjo një ndodhi e pazakontë e ushtarëve të mërziur që kërkonin të argëtoheshin? A i miratoni biseda të tilla? Ç'mendoni për simpatinë që lindi midis dy ushtarëve? A janë ata të sinqertë? Deri ku shkon kjo simpati? Mendoni se ata dy ushtarë do të ishin të gatshëm të bënin diçka për t'i shpëtuar jetën njëri-tjetrit? A ka të drejtë Shibli kur pretendon se diçka e tillë është e pamundur?

► **Fig. 46. Njoftim në një gazetë rumune: Ndhmoni jetimët**



"Universul", nr. 249, 12 shtator 1943.

❓ Ky pllakat ka si qëllim të nxisë ndihmat për jetimët. Cilat ngjarje u bënë shkaku kryesor që fëmijët të mbeteshin jetimë? A morën ndonjë masë politikanët për të mënjeluar këto shkaqe?

IV-2. Festimi i ditës së emrit në një kamp përqendrimi

"Dy ditë më parë, shefi (*i kampit*) rastësisht u tha kuzhinierëve: 'Ta shohim se çdo të përgatitë për ditën e emrit të tij.' Tani më takonte mua ta tregoja veten se isha 'burrë' dhe jo 'një plakaruq'. (...) Pastrova qelinë, hoqa gjithçka nga tavolina, rregullova vendin pranë dritares, i futa sobës ca kartona dhe ashkla druri dhe mora borxh nga kuzhina disa gota – kishte mbetur vetëm të vija fotografinë e Paveliçit dhe qelia do të kthehej në një dhomë ku mund të prisje edhe njerëz të shquar. (...) Rashë në një mendje me Gaon që të vinte pasi të kishin ikur miqtë e veçantë, në mënyrë që të pinim dhe të flisnim lirshëm. Ata maskarenjtë nuk do të uleshin kurrë në një tavolinë me të, sepse ai është hebre. (...)

Rreth orës dhjetë u hap dera dhe hynë katër prej tyre, me shefin në krye.

- Spremn! [*Gati*] (*përshëndetja e ustashëve*) Urime, doktor!

- Faleminderit, i dashur Ante, më gëzove pa masë, sikur të kishte ardhur vetë sulltani! (...) Bëtë mirë që erdhët! Do të ishte festë e pakuptimtë, nëse burra të nderuar si ju s'do të vinin! (...)

U hodha verë nëpër gota, bëmë gëzuar në mënyrën tradicionale kroate. Na ndihmoftë Zoti që vitin tjetër të takohemi në Zagreb, të dehemi dhe të shkojmë nga njëri bar në tjetrin.

- Doktor, ty të pëlqen ta kalosh natën jashtë dhe të pish, apo jo?

- E kujt nuk i pëlqen? Burri më i keq është ai që është dorështrënguar me paranë. Sa të kesh para, prishi, kënaqu, bëj qejf! O zot, nuk do ta harroj kurrë që më erdhët sonte! Duhet të takohemi përsëri vitin tjetër, dhe mundësisht jo këtu. Do të marrim edhe një rom, të na këndojë dhe të na bëjë muzikë – pihet më mirë kur ka muzikë dhe këngë.

- Ku janë romët, mor malukat? Nuk ka më romë, – tha shefi duke buzëqeshur.

- Çfarë? Nuk i keni vrarë edhe muzikantët, apo jo?! S'jam dakord me këtë. Njerëzit e pazëvendësueshëm duhet të shpëtohen – kush do t'i zëvendësojë muzikantët romë?-kështu biseda u përqendrua tek gjenocidi.

“Ç’të keqe ju bënin romët? (i pyeti Jakovljeviçi miqtë e tij) – ata nuk janë politikanë.

- Po ç’ti duash romët? – u përgjigj një nga miqtë – as punojnë, as nuk shkojnë ushtarë. Nëse do ta dish, unë më mirë të shpëtoj një vllah (*këtu nënkupton një serb*). Të paktën ai punon dhe lëron tokën... Nëse pakësojmë numrin e tyre, nuk do të përbëjnë ndonjë rrezik.”

Më pas Jakovljeviçi, si njeri që njihte letërsinë, u recitoi disa poezi miqve. Në këtë kohë u dëgjuan zhurma që vinin nga bodrumi: ustashët po torturonin një të burgosur.

“M’u desh të kontrolloja veten mos mbytesha. Ndërkohë që unë përsërisja vargjet e poetit mbi lirinë, mua më ishte hequr ajo, dhe në emër të po asaj lirie, një krim tjetër po ndodhte në atë çast. (...) M’u desh të hiqesha si i trashë dhe të bëja sikur nuk e dija se çfarë po ndodhte në dhomën poshtë.”

Jakovljeviç, f. 173-179.



I sipërpërmenduri, Ilija Jakovljeviçi, ishte i burgosur në *Stara Gradishka* dhe gëzonte një status të veçantë në kamp. Si patriot i periudhës së paraluftës, i cili ishte “shmangur pak nga vija”, por sidoqoftë mund të bashkohej me ustashët në të ardhmen, gëzonte privilegje nga rojet e burgut. Megjithatë, këtyre privilegjeve mund t’u vinte fundi dhe ai të pushkatohej në çdo çast – siç ishte bërë me shumë të tjerë. Për këtë arsye, atij iu desh të mbante një miqësi të shtirur me rojet dhe administruesit e kampit. Në rastin që përmendet më sipër, atij iu desh të ftonte të gjithë administratën e kampit në qeli – për të festuar ditën e emrit të tij.



A ju duket qëndrimi i “personelit të burgut” i pazakontë dhe i çuditshëm? Sipas jush, a silleshin ata në të njëjtën mënyrë me të burgosurit e tjerë? Përse Jakovljeviçi kishte disa privilegje në kamp? Ç’mendim keni për “bisedën e rastësishme” të zhvilluar midis të burgosurit dhe të ftuarve të tij? Opinione të zakonshme të ustashëve e tmerronin Jakovljeviçin, por nuk mund ta shprehte hapur këtë. Ç’mendoni për këtë qëndrim të tij? Ç’do të kishit bërë ju nëse do ishit në vend të tij?

IV-3. Letra e intelektualëve drejtuar J. Antoneskut (prill 1944)

Në këtë çast, kur një fatkeqësi e tmerrshme po kërcënon popullin tonë, ne anëtarët e Akademisë Rumune dhe profesorët e universitetit të Bukureshtit, të Jashit dhe Kluzhit, dëshmitarë të eksodit dhe shkatërrimit të fshatrave dhe qyteteve rumune që janë kthyer në fushë beteje, pasi e kemi diskutuar gjatë, vendosëm t’ju bëjmë këtë thirrje.

Në rrethanat e tanishme, heshtja jonë do të ishte krim. Është detyra jonë që të flasim hapur dhe t’i shprehim mendimet tona të sinqerta udhëheqësit të shtetit: ne duhet t’i japim fund luftës sonë kundër Ruisë, Britanisë së Madhe dhe Shteteve të Bashkuara...

Z. Marshall,

Bombardimi i kryeqytetit, shkatërrimi i qyteteve të tjera, paralajmërimet e marra nga Londra, Uashingtoni dhe Moska, kthimi i Moldavisë në një fushë beteje janë të gjitha shenja që flasin për një shkatërrim të pashmangshëm. Populli rumun, që është rraskapitur nga një luftë tepër e gjatë, nuk mund të luftojë më. Dilni në rrugë dhe pyetni kalimtarët, shkoni në fshatra dhe qytete dhe dëgjoni zërin e popullit. Kudo do të gjeni dëshpërim në sytë e njerëzve dhe do të merrni të njëjtën përgjigje: JO! Për çfarë duhet të luftojmë? Interesat jetësore të shtetit dhe të popullit tonë kërkojnë që t’i japim menjëherë fund luftës, sado e rëndë të jetë kjo gjë. Sakrificat që duhet të bëjë Rumania është shumë më e vogël dhe më pak e dhimbshme sesa vazhdimi i luftës.

Scurtu et al., f. 439-440.



Toleranca politike që mbizotëronte në atë kohë ndaj opozitës, nxiti personalitete të shumta politike e kulturore t’i drejtonin kreut të shtetit protestën e tyre për politikën e ndjekur nga qeveria. Këto veprime, përgjithësisht nuk patën pasoja dhe autorët e tyre nuk u përdoqën.



Çfarë statusi shoqëror kanë autorët e këtij shkrimi? Ç’qëndrim mbajnë autorët rreth problemeve kryesore politike në Rumani në vitin 1944? A është ky qëndrim vetëm i autorëve? A rrezikoheshin autorët duke shkruar këtë letër?

IV-4. Fragment nga një letër e kryeministrit grek (7/10/43), drejtuar autoriteteve gjermane

“KRYETARI I KABINETIT

Nr. prot. E 312 1/10 KONFIDENCIALE

Shkëlqesisë së tij, përfaqësuesit të Rajhut në
Greqi

Dr. G.A. Altenburg

Athinë, 7 tetor 1943.

Shkëlqesia juaj,

Komandanti i policisë së trupave esese [SS] në Greqi ka lëshuar një urdhër, që të gjithë qytetarët grekë me origjinë izraelite të paraqiten për t’u regjistruar. Lajmi i këtij urdhri më bën të besoj se masat që u morën nga Komanda Ushtarake në Selanik kundër hebrenjve nuk do të përsëriten edhe këtu ndaj qytetarëve grekë me origjinë çifute.

[...] Mundësia që këta qytetarë grekë, të cilët jetojnë në tokën greke qysh nga kohët e lashta, të dëbohen nga vendi i tyre dhe të dërgohen në zona të panjohura, e mbush qeverinë dhe zemrën e çdo greku me hidhërim. Izrealitet e Greqisë së vjetër (bëhet fjalë për Greqinë përpara Luftërave Ballkanike) janë integruar plotësisht nga pikëpamja gjuhësore dhe historike me popullsinë vendase dhe kanë nxjerrë poetë të cilët shquhen për shpirtin e tyre grek.

Si qytetarë të ligjshëm, ata kanë luftuar në çdo rast për Greqinë dhe shumë prej tyre janë shquar në fushën e betejës.

Zelli, aftësia dhe ndjenja e përgjegjesisë i ka ndihmuar ata të dallohen si nëpunës civilë, veçanërisht si juristë dhe ushtarakë. Ata kanë arritur gjithmonë që të zgjidhin me sukses problemet e vështira dhe kanë luftuar me përgjegjësi për të mbrojtur interesat e shtetit.

Kisha greke i ka dhënë gjithmonë mbrojtje komunitetit izraelit në Greqi dhe e ka frymëzuar popullin grek me një frymë tolerance dhe zemërgjerësie në çështjet e besimit. Komuniteti izraelit i Greqisë së vjetër përbën një pakicë të parëndësishme, që sidoqoftë nuk gëzon ndonjë pushtet politik ose kulturor.

[...] Zbatimi i masave të tilla kundër grekëve izraelitë në Greqinë e vjetër do të lëndonte ndjenjat e njerëzve të cilët kanë përvetësuar në shpirt traditat e mëdha të shpirtit grek...”

Enepekidis, f. 50-51.

? Si e paraqet kërkesën e tij kryeministri grek? Përse nuk thotë ai drejtpërdrejt se holokausti është padrejtësi dhe krim? A rrezikonte ai duke shkruar këtë letër? Ç’do të bënit ju nëse do të ishit në vend të kryeministrit?

IV-5. G. Enesku⁶⁹ përpiqet të mbrojë romët

7 nëntor 1942

Njoftim

Më informuan se në mbrojtje të muzikantëve romë, George Enesku ndërhyri tek marshall Antonesku, duke deklaruar se nëse muzikantët e tij do të çoheshin në Bug, edhe ai do të shkonte me ta. *Minoritati etnoculturale. Marturii documentare. Tigania din Romania*

(1919-1944), dok. 281.

? Si mendoni, përse Enesku ndërhyri në dobi të romëve? A mund ta merrni me mend se ç’arsye kishte ai që veproi në këtë mënyrë?

IV-6. Memorandum i një grupi berberësh dhe parukierësh bullgarë drejtuar ministrave lidhur me Ligjin për Mbrojtjen e Kombit

11 nëntor 1940.

Të dashur zotërinj,

Sot, kur po jetojmë këto ditë të trazura që kërkojnë bashkimin e të gjithë popullit bullgar, janë marrë disa vendime kundër hebrenjve, të cilat janë kundër dëshirës së popullit bullgar dhe që e dëmtojnë atë. Ky vendim është kalimi i *Ligjit për Mbrojtjen e Kombit*. Nuk e dimë nëse do ta dëgjoni zërin tonë, që vjen nga ajo shtresë që është sakrifikuar më shumë për të mirën e popullit. Sot, së bashku me

⁶⁹ George Enesku (1881-1955) ishte muzikanti më i madh rumun dhe një nga muzikantët më të talentuar të shekullit të 20-të: ai ishte violinist dhe kompozitor i madh, dirigjent i shquar, pianist i kompletuar, violonçelist i zoti dhe mësues violine i famshëm.

bashkatdhetarët tanë hebrenj, po punojmë dhe nëse është nevoja do të vdesim së bashku në vijën e frontit, siç bënë baballarët tanë dhe të tyre. Ata nuk kanë bërë asgjë të gabuar, e megjithatë ju doni t'i shkëpusni nga trupi ynë, duke ua hequr të gjitha të drejtat që kanë. Nëse keni si qëllim të persekutoni mashtruesit hebrenj, atëherë duhet të persekutoni edhe mashtruesit tanë.

The Struggle of the Bulgarian People
[Lufta e popullit bullgar], f. 49.



A ka ndonjë dokument të ngjashëm me këtë në vendin tuaj? Nëse në atë kohë do të ishit berber në Bullgari, do ta kishit firmosur këtë memorandum?

IV-7. Ndhimja dhe mbështetja turke dhënë Greqisë

Falënderime nga Greqia

Do të lexoj më poshtë përkthimin e letrave të falënderimit që janë dërguar në Ministrinë tonë për përpjekjet e mia dhe të komisionit që unë drejtoj për t'i nisur ushqime gjatë Luftës së Dytë Botërore popullit të Greqisë dhe atij të Ishujve të Egjeut, të cilët po vuanin nga uria në kushtet e pushtimit:

Letër nga kryetari i bashkisë së Athinës:

“Me respekt ju kërkoj që të pranoni këtë album të qytetit të Athinës, të cilin po jua dërgoj si dhuratë modeste në shenjë mirënjohjeje për shërbimet që i bëtë popullit grek në një periudhë tejet të vështirë të historisë së Greqisë.”

Letër nga guvernatori i Kios:

“Jam shumë i lumtur që u njoftova nga zoti Kurvuazier, përfaqësues i Kryqit të Kuq dhe mik i mirë i vendit tim, mbi të gjitha detajet e përpjekjeve tuaja për t'i dërguar miell Kryqit të Kuq të Kios.

Si guvernator i kësaj krahine, doja t'ju shprehja mirënjohjen dhe falënderimet e mia për ndihmën tuaj, ndihmë që ia dhatë bujarisht popullit të ishullit të vogël Kios.

Gjithashtu, me respekt ju paraqes falënderimet e të gjithë Greqisë dhe qeverisë greke për ndihmat që nisët nga brigjet tuaja fqinje, drejt brigjeve tona. Ne gati sa nuk hidheshim përpjetë nga gëzimi kur shikonim *Luanin* [Arslan], anijen me flamurin kombëtar turk që vinte drejt portit tonë. Gjatë

historisë së tyre, popujt tanë kanë jetuar së bashku për një kohë të gjatë. Ne kemi ruajtur një miqësi të mirë dhe nderojmë kujtimin e kombit tuaj nga këto periudha bashkëpunimi, sepse kombi turk në kohë paqeje dhe lufte, në çdo takim të përbashkët na ka konsideruar si vëllezër, shokë dhe miq. Gjatë kësaj periudhe të tmerrshme që po kalojmë, duke na ndihmuar, ju konfirmoni mendimin tonë për kombin fisnik turk.

Me respekt, ju lutem të pranoni këtë dhuratë të vogël nga Kiosi, që po jua dërgoj me anë të zotit Kurvuazier.”

Erkin, f. 130-131.



Erkini ishte zyrtar në Ministrinë e Jashtme Turke gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në këtë rrëfim, ai flet për ndihmën dhe mbështetjen që Turqia dha në zona të ndryshme të Greqisë, përfshirë këtu edhe ishujt e Egjeut, që po vuanin nga uria prej mungesës së ushqimit. Këto janë disa letra ku shprehen falënderimet dhe mirënjohja e autoriteteve greke.



Ç'dini për historinë e marrëdhënieve greko-turke? A vërtetojnë këto burime paragjykimet për urrejtjen ndërmjet dy kombeve?

IV-8. Ish-ambasadori Nexhdet Kent rrëfen se si shpëtoi hebrenjtë turq në Marsejë, Francë

Një mbrëmje, një hebre turk nga Izmiri, i quajtur Sidi Iskan, e që punonte në konsullatë si nëpunës dhe përkthyes, erdhi në shtëpinë time shumë i shqetësuar. Ai më tha se gjermanët kishin grumbulluar rreth 80 hebrenj dhe i kishin çuar tek stacioni i trenit, me qëllim që t'i hipnin nëpër vagonët e bagëtive dhe t'i dërgonin në Gjermani. (...) U përpoqa ta qetësoja dhe më pas mora mjetin më të shpejtë dhe u nisa për në stacionin “Shën Sharl” të Marsejës. Skena që pashë ishte e pabesueshme. Vagonët për bagëtitë ishin mbushur me njerëz që qanin dhe rënktonin. Dëshpërimi dhe mërzia më pushtuan të tërin. (...) Kur mori vesh, oficeri i Gestapos që ishte përgjegjësi i trenit, që unë isha aty, erdhi dhe tërthorazi më pyeti se ç'kërkoja aty. Me aq mirësjellje sa munda, i thashë se këta njerëz ishin

qytetarë turq, që arrestimi i tyre ishte i gabuar dhe se duheshin lëshuar menjëherë. Oficeri i Gestapos më tha se po zbatonte urdhrat dhe se këta njerëz nuk ishin turq, por thjesht çifutë. Duke parë se nuk fitoja gjë duke bërë kërcënime të kota, iu ktheva Sidi Iskanit dhe i thashë: “Eja të hipim edhe ne në tren!” Duke shtyrë mënjanë një nga ushtarët gjermanë që u përpoq të më zinte rrugën, hipa në një nga vagonët, me Sidi Iskanin pranë meje. Tani ishte radha e oficerit të Gestapos të thërriste dhe madje të lutej. Nuk mund të dëgjoja se ç’thoshte dhe ndërkohë që oficeri i Gestapos vazhdonte të thërriste, treni filloi të lëvizë. Ka kaluar shumë kohë dhe nuk më kujtohet mirë, por mbaj mend se treni ndaloi ose në Arl ose në Nimes. Një numër oficerësh gjermanë hipën në vagon dhe menjëherë m’u afruan. I pashë ftohtë dhe as nuk i përshëndeta. Më thanë se ishte bërë një gabim, treni ishte nisur pasi unë kisha hipur në të, prandaj personat përgjegjës për këtë do të ndëshkoheshin. Sapo të zbrisja nga treni, do të nisesha për në Marsejë me një makinë që ishte në dispozicionin tim. U thashë që përderisa nuk ishte gabim që më shumë se 80 qytetarë turq kishin hipur në këtë vagon bagëtish, sepse ishin hebrenj, dhe se si përfaqësues i këtij kombi dhe kësaj qeverie që mendonte se besimi fetar nuk mund të ishte shkak për një trajtim të tillë, nuk bëhej fjalë që t’i lija vetëm, dhe prandaj ndodhesha aty. Oficerët thanë se ata do ta ndreqnin çfarëdo gabimi që të ishte bërë dhe pyetën nëse të gjithë në vagon ishin qytetarë turq. Të gjithë njerëzit rreth e qark meje, gra, burra dhe fëmijë qëndronin të ngrirë, duke parë këtë lojë që luhej me jetën e tyre. Besoj se si rezultat i mospranimit tim për të bërë kompromis me ta, si edhe pas urdhrit të marrë nga oficerët nazistë, zbritëm nga treni të gjithë së bashku; (...) nuk mund ta harroj kurrë atë që ndodhi më pas. Njerëzit që shpëtuan më përqaftonin, më shtrëngonin duart me një shprehje mirënjohjeje në sy.

Shaw, f. 342-344.



Komentoni mënyrën se si e zgjidhi ambasadori këtë situatë. Duke u përpjekur të shpëtonte jetën e këtyre njerëzve, a e vuri ai jetën e tij në rrezik? Ç’do të kishit bërë ju nëse do ishit në vend të tij?

IV-9. Pjesë nga ditari i një ushtari bullgar në Trakinë Perëndimore, krahinë greke nën pushtimin bullgar

23 maj 1941. Shkuam në Ksanti [Xanthi] për të marrë pjesë në paradë. Gjendja këtu ishte e njëjtë si në Gyumyurgjina [Komotini]. Kudo që ka kamp ushtarësh, ka gjithmonë fëmijë, pleq dhe gra që vijnë me pjata në dorë. Ne nuk kemi shumë ushqim për vete, por gjithmonë u japim njerëzve të uritur pak nga fasulet ose supa e ushtrisë.

Në mesditë, shumë fëmijë u mblodhën rreth depos. Sot dreka ishte e veçantë, kishte pjatë të dytë që mund t’i ndihmonte të uriturit, dhe shumë ushtarë ua dhanë ushqimin e tyre fëmijëve. Unë shkova lart në katin e dytë të mensës dhe hapa dritaret. Sytë më ndalën tek një grua e re, ndoshta një vajzë, e veshur me të zeza. Ajo po qëndronte tek qoshja aty pranë, duke parë fëmijët që ecnin me kujdes që të mos derdhnin supën që mbanin në pjatë. Lehtësisht mund ta kuptojë përse ishte veshur e gjitha me të zeza. Me siguri ndonjë i afërm i saj kishte vdekur në luftë, i ati, i vëllai, i shoqi ose i dashuri. Por çfarë priste atje tek kthesa? Ndoshta ishte edhe ajo e uritur dhe donte një copë bukë? Papritur, pa marrë parasysh pengesat, gruaja iu drejtua rrethimit. Disa djem të kompanisë sonë po qëndronin në fushë, pranë gardhit me tela. Gruaja iu afrua dhe munda të dëgjoj fjalët e saj të thëna me ndrojtje: “Qirre [Zotëri], bukë...”

Ajo gati sa nuk po qante, dhe djemtë e kuptuan këtë. Njëri prej tyre hapi çantën dhe i dha një fetë nga buka e tij. Ndoshta kjo copë do të shitej në tregun e zi, ku për një copë bukë mund të merrje gjithçka, nga dhrahmitë e zhveftësuar greke, deri tek unazat dhe byzylykët.

Gruaja po largohej, kur një zë urdhërues e bëri të ndalojë:

“Achtung! [Ndal!]”

Dobri⁷⁰ dhe Elena Djurov, f. 159-160.



A e merni dot me mend se si mbaron kjo histori?

⁷⁰ Dobri Djurov (1916-2002) – komandant i një brigade guerrilase, gjeneral ushtrie dhe ministër i Mbrojtjes.

IV-10. Stojan Petrov-Çomakovi, ambasadori i plotfuqishëm bullgar në Bukuresht, tregon një histori gazmore dhe prekëse për marrëdhëniet midis ushtarëve rumunë, të burgosurve rusë dhe komunitetit bullgar në Rumani gjatë Luftës së Dytë Botërore

Një të dielë, disa muaj pasi Rumania hyri në luftë, numri i njerëzve që vinin në meshën e shenjtë në kishë u rrit menjëherë, kur një grup të burgosurish luftime rusë erdhën të shoqëruar nga një ushtar rumun. Ai, ashtu siç i takonte, mbante një armë me bajonetën hapur. [...] Ai kishte varur armën tek një pemë dhe, siç e kishin zakon të gjithë ushtarët, po përpiquej të tërhiqte vëmendjen e një shërbyeseje, e cila kishte kohë që qëndronte në një ballkon aty pranë dhe po shkundte një qilim. Ndoshta ngaqë u kënaq që gjithçka po i shkonte mirë dhe po provonte të shkonte më tej me sukses, në vend që t'i mblidhte të burgosurit që mbikëqyrte dhe t'i dërgonte në kamp, ai i la të përziheshin me turmën e besimtarëve dhe të flisnin me ta.

Shpejt u bë e qartë se ata kishin simpati për njëritjetrin, dhe njerëzit filluan të grumbullojnë para për të burgosurit e luftës, dhe u dhanë, gjithashtu, edhe shumë cigare. Ishte e qartë se takimi kishte qenë i suksesshëm për të gjithë pjesëmarrësit, duke përfshirë këtu edhe ushtarin me vajzën, sepse të dielën e ardhshme në kishë erdhi dyfishi i të burgosurve. Ata i shoqëronte i njëjti ushtar, por kësaj here kishte veshur një uniformë të re dhe ishte rruar me kujdes. Edhe vajza kishte veshur një bluzë të re dhe po pastronte disa rroba po në atë ballkon. Edhe një herë u mblodhën para për të burgosurit e gjorë, përpara se të merreshin nga roja i tyre, i cili për pak sa nuk harroi armën, sepse e kishte mendjen t'i dërgonte puthje vajzës që skuqej nga turpi. [...] U bë e qartë se vizitorët tanë do të fillonin të vinin të organizuar në toga, kompani ose edhe batalione.

Fatkeqësisht, bordit drejtues të kishës iu desh t'u kërkonte autoriteteve rumune që të kufizonin numrin e atyre që dërgoheshin në kishë deri në 20 veta, dhe prej tyre vetëm gjysma mund të ishin duhanpirës.

Petrov-Chomakov, f. 346-347.



Përse lufta nuk i ndryshon ndjenjat e zakonshme njerëzore? A luajti kombësia ndonjë rol në këtë ngjarje?

IV-11. Një hebre grek përshkruan ndihmën që i dhanë atij dhe familjes së tij grekët ortodoksë gjatë pushtimit gjerman

“Me gjithë kërcënimet se do të burgoseshin, shumë johebrenj fshehën miqtë e tyre hebrenj nëpër apartamente, ose i ndihmuan të largoheshin nga vendi. Alfred Koheni, jurist nga Athina, kujton mbështetjen e natyrshme që i dhanë shokët dhe fqinjët e tij: ‘Nuk do ta harroj kurrë tmerrin që ndjemë atë natë, kur familja ime qëndronte e fshehur në një nga ato shtëpi dhe morëm vesh se gjermanët kishin lëshuar urdhër se çdo hebre që gjendej i fshehur do të ekzekutohej, ndërsa që i strehonin do të çoheshin nëpër kampe përqendrimi.


Atëherë, njëri nga ne tha se nuk ishte mirë që të qëndronim në shtëpi dhe të rrezikonim jetën dhe qetësinë e njerëzve të moshuar ose grave. Përgjigjja ishte: “Jo, duhet të qëndroni. Përse jetët tona qenkan më të shtrenjta se tuajat, biri im?”

Mazower, f. 287-288.



A ka patur raste të ngjashme në vendin tuaj? Çfarë do të bënit ju në një situatë të tillë?

► **Fig. 47. Hebrenj turq që qëndrojnë përpara konsullatës turke në Paris, në vitin 1943, për të marrë pasaporta dhe viza për t'u kthyer në Turqi**



The Jews of the Ottoman Empire and the Turkish Republic [Hebrenjtë e Perandorisë Osmane dhe Republikës Turke].

IV-12. Trajtimi njerëzor që u bëhet hebrenjve nga ana e zyrtarëve rumunë

“Unë jam Prisakaru George, rreshter i parë, shef i zonës Bacani, e cila përfshin edhe krahinën në të cilën ndodheni tani, dhe në emër të saj, ju uroj mirëseardhjen! E kuptoj shqetësimin që keni në zemër dhe dhimbjen që keni në shpirt kur mendoni që jeni të ndarë në këtë kohë lufte nga të afërmit tuaj, e kuptoj dhimbjen tuaj dhe ju këshilloj që të mos shkurajoheni, sepse pavarësisht nga mënyra se si lutemi, ne kemi të njëjtin Zot, dhe askush nuk na pyeti nëse donim të lindim rumunë, hebrenj, turq ose bullgarë. Ne të gjithë jemi qenie njerëzore dhe dua t’ju siguroj se kjo periudhë do të kalojë,

⁷¹ Qeveria e Antoneskut internoi kryesisht hebrenjtë nga Besarabia dhe Bukovina në Nister (jashtë territoreve rumune të periudhës ndërmjet luftërave), ku edhe ngriti disa kampe përqendrimi. Në shtator të vitit 1942, qeveria filloi t’i kthente mbrapsht hebrenjtë e internuar, dhe në periudhën që pasoi, u përpoq të mbështeste emigrimin e tyre në Palestinë. Gjenerali Antonesku mendonte se popullsia çifute duhej të largohej nga territoret rumune, por kjo nuk do të thoshte domosdoshmërisht eliminimin e tyre fizik; prandaj emigrimi konsiderohej si zgjidhje e përshtatshme për këtë problem.

dhe bashkë me të do të kalojë edhe çmenduria që mbizotëron mendjet e njerëzve. Të gjithë do të ktheheni nëpër shtëpitë dhe familjet tuaja dhe do t’i kujtojmë këto ditë si diçka të pakëndshme. Do të marr masa që ju të strehoheni nëpër shtëpitë e fshatarëve, sepse ju nuk mund të flini jashtë dhe, ndërkohë që do të rriini këtu, do të mundohem që të mbani kontakte me ata që keni lënë në shtëpi. [...]” Pas këtij fjalimi të papritur, dëgjoji me kujdes të gjitha pakënaqësitë tona dhe duke qenë se mora zemër nga sjellja e tij, i tregova edhe unë shqetësimet e mia, dhe ndër të tjera i tregova për qëndrimin jonjerëzor që mbajti policia në Hushi, e cila për të justifikuar kush e di se ç’lloj veprimtarie, i klasifikoi 12 prej nesh si “të dyshuar për komunistë”; dhe duke ditur rreziqet e mundshme, do të donim të dinim se ç’u bë me ta. Ai më premtoi se pas 2-3 javësh që do të qëndronim në zonën e tij, ky klasifikim nuk do të ekzistonte më.

Duhet kuptuar se ky qëndrim i shkëlqyer pati menjëherë pasojat e tij dhe autoritetet dhe banorët e Bogdanasit u sollën sikur të ishin vërtet vëllezërit tanë. Na sistemuan nëpër shtëpi, na dhanë ushqime, gratë na lanë dhe na arnuan teshat, dhe kur pas disa ditësh morëm urdhër se duhet të largoheshim nga Bogdanasi, na pushtoi të gjithëve një mërzë e madhe. Njerëzit na përcollën deri në Bacani, fshati ku do të qëndronim dhe me karrocet e tyre na transportuan edhe plaçkat tona dhe nuk pranuan që t’i paguanim për shërbimet e tyre”.

Istoria României in texte, f. 339-340.

🔑 Ky fragment tregon se internimi i hebrenjve, në kuadër të politikës antisemite që ndoqi qeveria e Antoneskut,⁷¹ nuk solli domosdoshmërisht zhdukjen e ndjenjave njerëzore tek disa zyrtarë, ushtarakë ose përfaqësues të xhandarmërisë. Ka shumë shembuj ku zyrtarët shfaqin sjellje njerëzore ndaj atyre që preken prej politikave të shtetit rumun. Një grup hebrenjsh u grumbulla në oborrin e rajonit të policisë në Hushi, dhe më pas u largua prej aty. Pas tri ditësh, duke ecur në këmbë, ata arritën në distriktin e Tutovas (20-21 qershor 1941), ku u paraqitën përpara shefit të xhandarmërisë së zonës, i cili u mbajti këtë fjalim.

❓ Duke ndihmuar hebrenjtë e internuar, a rrezikonte George Prisakaru veten dhe postin? Ç'mund t'i kishte ndodhur atij nëse eprorët e tij do të merrnin vesh se si u soll? Si do të kishit vepruar ju nëse do të ishit në vend të tij? A mendoni se ai mund të kishte bërë më shumë?

IV-13. Diplomati bullgar Ivan D. Stançov tregon se si një oficer gjerman e shpëtoi nga Gestapoja në Bullgari

Në të gdhirë, një vizitor i papritur më zgjoi. Ishte një oficer trupmadh gjerman. Ai më përshëndeti dhe më tha se 'zoti major' e kishte dërguar të më jepte këtë njoftim: 'Ju duhet të largoheni menjëherë nga Sofja. Të murrmit – kështu quheshin ata të Gestapos, për shkak të uniformave të tyre ngjyrë kafe – po vijnë t'ju arrestojnë.' E pyeta se përse

'majori' i tij, të cilin unë e dija që ishte pjesëtar i Shërbimeve të Inteligjencës Ushtarake në Bullgari shqetësohej kaq shumë për mua.

'Weil Sie doch ein Offizier und ein Herr sind!' [Sepse ju jeni oficer dhe zotëri!]

M'u përgjigj menjëherë, më përshëndeti me shpejtësi dhe u largua.

Unë mora trenin e parë për në Varna, dhe ndërkohë që po udhëtoja, po mendoja se sa me fat ishim që ekzistonte kjo lloj armiqësie ndërmjet Vermahtit dhe nazistëve... Më vonë, portieri më tha se një orë pasi unë isha larguar, 'një grup gjermanësh' më kishin kërkuar.

Stanchov, f. 172.

❓ A është gjithmonë e nevojshme dhe e saktë që të njësojmë "gjermanët" me "armikun"? Përse disa gjermanë vepronin kundër disa gjermanëve të tjerë? Ç'arsye kishte oficeri gjerman që ndihmoi Ivan D. Stançovin?

► Fig. 48. Spitali i fshehtë partizan "Franja", pranë Cerknos në Slloveni



🔑 Ky shërbim ilegal mjekësor i Frontit Çlirimtar – ndoshta misioni më humanitar gjatë luftës – ishte i organizuar shumë mirë, edhe pse gjendej në kushte shumë të vështira. Në janar të vitit 1945 kishte 281 spitale sekrete dhe 6 të ligjshëm (62 të tjerë ishin në ndërtim e sipër) me 2 260 shtretër gjithsej. Gjatë luftës, 11 321 të plagosur dhe të sëmurë mjekoheshin nga 30 mjekë, 652 infermiere dhe kujdestarë të tjerë ndihmës; 19 mjekë humbën jetën gjatë luftës.


IV-14. Alfonz Baroni, përfaqësues i fabrikës së karamelave dhe çokolatave “Bashkimi”, i drejtohet policisë së ustashëve (9 korrik 1941)

“Draga Gerberi, që banon në rrugën Ivkanceva 7/ III dhe që është çifute, u mor sot nga policia. Ajo është arkëtare në firmën tonë, dhe ishte lajmëruar që këto ditë duhej t’i bënte dorëzimet e kasafortës nëpunësit i cili kthehej nga leja dhe më pas do të largohej nga kjo firmë. Duke qenë se Draga Gerberi u mor nga apartamenti i saj pasi e kishte lënë punën, nuk pati mundësi të dorëzonte çelësat e kasafortës dhe as nuk bëri dorëzimet. Ka rrezik që çelësat të humbasin, dhe nëse nuk e hapim dot kasafortën, nesër, kur të vijë njerëz, do të gjendemi në një situatë të vështirë. Prandaj ju kërkohet që ta lejoni Draga Gerberin të dorëzojë çelësat e kasafortës së firmës sonë sa më shpejt të jetë e mundur.”

Goldstein, f. 370.

Ç’donte të arrinte Baroni me anë të kësaj letre? A mendoni se Baroni donte vërtet që e burgosura të lirohej për arsyen që ai përmend? A mund të ishte kjo një dredhi (apo thjesht një përpjekje), duke patur parasysh se autoritetet e Shtetit të Pavarur Kroat nuk do të merrnin parasysh asnjë arsye tjetër për ta liruar? Përse Baroni flet për të burgosurën që ai kërkonte të lirohej (të paktën përkohësisht) me mospërfillje?

► Fig. 49. Letër anonime nga një qytetar i Beogradit, drejtuar komandantit ushtarak gjerman në Serbi



Arkivi Historik i Beogradit, Administrata e Qytetit të Beogradit, SP III-48, k 157/15, 25 shtator 1941.

Kjo letër iu dërgua komandantit ushtarak gjerman në Serbi, gjeneralit Heinrich Dankelman, kur në Terazije, sheshi kryesor i Beogradit, u varën disa të burgosur, më 17 gusht 1941. Në këtë letër, komandanti gjerman dhe ndihmësit e tij kërcënohen se do të kenë të njëjtin fat me ata që u varën.

A do ta quanit këtë letër një akt heroik? Shpjegoni përse.

Pyetje të përgjithshme mbi kapitullin IV

Mendoni se humanizmi dhe solidariteti janë tipare vetëm të disa individëve zemërgjerë dhe të guximshëm, apo çdo njeri i gëzon këto tipare? A është e mundur që i njëjti person të veprojë si kriminel lufte në një situatë, dhe si njeri human dhe zemërgjerë në një tjetër? Argumentoni mendimin tuaj. Duke patur parasysh faktin se shpesh njerëzit duan të duken më të mirë sesa janë në të vërtetë, sa të besueshme janë disa nga burimet e mësipërme, të dhëna në formën e kujtimeve?

KAPITULLI V: Pasojat

Lufta e Dytë Botërore, si konflikti më i madh në historinë e njerëzimit, la pas një sërë gjurmësh të thella dhe të paharruara. Qëllimi i këtij kapitulli është që të sjellë më pranë nesh disa nga pasojat e luftës, nëpërmjet burimeve të mëposhtme – duke filluar me numrin e të plagosurve dhe të vrarëve, me shpërnguljen me forcë të popullsisë gjatë dhe pas luftës ose përmes natyrës së ndryshimeve politike në shumicën e vendeve të këtij rajoni.

Për shkak të hapësirës së kufizuar, disa nga pasojat e luftës preken pak ose nuk janë përmendur fare, për shembull, ndryshimet në strukturën etnike të popullsisë, shkatërrimet e luftës dhe rindërtimi pas saj, ndëshkimet e bashkëpunëtorëve të pushtesit pas luftës, ndryshimet politike pas luftës dhe lufta civile në rastin e Greqisë.

Va. Humbjet dhe viktimat e luftës

V-1. Në Konferencën e Paqes në Paris, Enver Hoxha flet për të vrarët dhe dëmet materiale që pësoi Shqipëria

“Sakrificat e popullit tonë qenë shumë të mëdha. Në një popullsi prej 1 milion banorësh, 28 000 u vranë. 12 600 u plagosën, 10 000 u internuan si të burgosur politikë në Itali dhe Gjermani dhe 35 000 u vunë të kryejnë punë të detyruar; nga 2 500 qytete dhe fshatra në Shqipëri, 850 u rrënuan ose u shkatërruan plotësisht; të gjitha llojet e komunikacionit, të gjitha portet, minierat dhe prodhuesit e energjisë elektrike u shkatërruan. Prodhimet bujqësore dhe gjëja e gjallë u grabitën dhe e gjithë ekonomia e vendit u shkatërrua. Nga ana tjetër, armiku pësoi këto humbje: 53 639 italianë dhe gjermanë u vranë, u plagosën ose u burgosën. Rreth 100 tanke dhe autoblinda u asgjësuan, 1 334 armë artilerie dhe mortaja u asgjësuan, 1 934 kamionë dhe 2 855 mitralozë u morën ose u asgjësuan, pa përmendur këtu pushkët, municionet dhe rezervat e asgjësuar ose të marra nga armiku.”

O'Donnel, f. 13.



A është plotësisht i besueshëm ky burim? Argumentoni qëndrimin tuaj.

► Fig. 50. 17 nëntor 1944



Epopeja e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, 1939-1944.



Kjo tablo e piktorit Bukurosh Sejdini paraqet pamjen e çlirimit të kryeqytetit shqiptar, Tiranës, nga partizanët.

V-2. Një gazetar zviceran përshkruan shkatërrimin e Podgoricës

Podgorica ka marrë pamje të tmerrshme! Ky qytet, i cili përpara luftës ishte i bukur dhe i përparuar, me një popullsi prej 15 000 banorësh, u bombardua pesëdhjetë e dy herë nga avionët anglo-amerikanë dhe është shkatërruar krejtësisht. Habitësh kur shikon ndonjë banor që kalon në mes të gjermadhëve; shumica e tyre janë të veshur keq, pa këpucë, dhe kanë mbetur pa energji elektrike. Janë pothuajse pa ushqim dhe jetojnë në mes të

gjermadhëve. Tmerroresh kur mendon se si do e kalojnë dimrin këta të mjerë.

Selhanović, f.14.



F.J.Roajoni ishte zyrtar i lartë i Lidhjes Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq me qendër në Gjenevë. Ai vizitoi Podgoricën menjëherë pas luftës dhe ka bërë një përshkrim të situatës në qytet në atë kohë. Roajoni botoi në gazetën *Tribune de Geneve* të datës 11 tetor 1945, artikullin me titull “Mali i Zi – shteti i vogël i zhgënjyer prej luftës”.

Tabelat

1. Numri i të vranëve në Jugosllavi sipas kombësisë

Kombësia	Koçoviç (1985)	Zherjaviç (1989)
Serbë	487.000	530.000
Malazez	50.000	20.000
Kroatë	207.000	192.000
Myslimanë	86.000	103.000
Sillovenë	32.000	42.000
Maqedonas	7.000	6.000
Të tjerë	145.000	134.000
Gjithsej	1.014.000	1.027.000

Žerjavić, f. 14, 57.



Llogaritja e parë e numrit të viktimave të Luftës së Dytë Botërore në Jugosllavi është ajo që u paraqit në raportin e Komisionit për Dëshmperblimet të qeverisë jugosllave. Autorit të kësaj përlllogaritjeje, një student i matematikës (!) Vladeta Vučkoviçit, iu la dy javë kohë për të kryer dhe për të përfunduar një detyrë kaq të vështirë, së bashku me udhëzimin se “numri duhej të ishte tejet bindës shkencërisht dhe statistikisht”. Llogaritja e tij për humbjet demografike (që përfshinin ata që u vranë në luftë, por edhe rënien e shkallës së lindshmërisë të shkakuar nga lufta, si dhe emigracionin) ishte 1.7

milion; por në përmbledhjen në fund të këtij shkrimi, ky numër cilësohet si *viktima*, që do të thoshte *të vranë në luftë*.

Kjo tabelë është bazuar në përlllogaritjet e kohëve të fundit, të bëra nga Bogoljub Koçoviçi dhe Vladimir Zherjaviçi (njëri autor serb dhe tjetri kroat). Saktësia e këtyre shifrave është, gjithsesi, për t’u vlerësuar. Për shembull, Instituti Silloven për Historinë Bashkëkohore është në mes të një projekti kërkimor, i cili tregon se përlllogaritja e viktimave sillovene është shumë e ulët. Autorët (T. Tominshek, M. Shorn dhe D. Dubaja) kanë identifikuar tashmë 87 000 viktima.


2. Humbjet që pësoi Greqia gjatë Luftës së Dytë Botërore

	Humbjet	Shifrat e paraluftës	Humbjet në %
Humbje në njerëz			
Vdekjet (1940 - 1944)	475 000	7 335 000	6,5
Humbje materiale			
Kafshë pune	855 000	2 005 000	42,6
Dhen, derra, shpendë	12 305 000	24 840 000	49,5
Pyje	5 000 km ²	19 189 km ²	25,0
Automjete (për pasagjerë, kamionë, autobusë)	11 300	17 200	65,7
Ura (mbi 6 metra të gjata)			90,0
Mjete hekurudhore (lokomotiva, vagonë etj.)	6 080	6 502	93,5
Ura hekurudhore (mbi 10 metra të gjata)	96	96	100
Ndërtesa	401 000	1 730 000	23,2
Anije tregtare (deri në prill 1945)	434	583	74,5

Ministria e Rindërtimit, Athinë 1946 (Istoria, vëll. 16, f. 63).

3. Humbjet e anijeve tregtare greke gjatë Luftës së Dytë Botërore*

	Flota greke më 1.09. 1939		Anijet greke të humbura deri më 2.09. 1945		Humbja në përqindje	
		Tonazhi gjithsej		Tonazhi gjithsej		
Anijet e mallrave	500	1 766 352				
Anijet e pasagjerëve	55	49 995				
Anijet oqeanike	1	16.690				
Të ndryshme	21	3 997				
Gjithsej	577	1 837 034	432	1 346 520	74%	73,3%
Anijet me vela dhe me motor	713	55 057	551	52 634	77,3%	95,4%
Shuma e përgjithshme	1 290	1 892 091	983	1 399 154		

 Në fillim të Luftës, flota tregtare greke ishte e nënta në botë për nga madhësia, kështu që përfshirja e saj që në fillim të luftës (edhe përpara 28. 10. 1940) në krahun e aleatëve ishte një faktor i

rëndësishëm. Flota tregtare greke pësoi humbjet më të mëdha si tonazh bruto në krahasim me çdo vend tjetër. Britania e Madhe ishte e dyta, me 54% të tonazhit bruto të humbur gjatë kësaj lufte.

* Të dhënat janë përpiluar nga Kristos E. Ntounias.

Vb. Shpërnguljet gjatë dhe pas Luftës

TABELAT 4. Emigracioni në Malin e Zi, 1941-1945

Qyteti:	Gjithsej	Meshkuj	Femra
1. Andrijevački	3.319	1.429	1.890
2. Tivar	253	113	140
3. Bijello Polje	495	221	274
4. Kotorr	1.343	602	741
5. Danilovgrad	2.129	949	1.180
6. Berane	876	404	472
7. Beranski	2.515	1.200	1.315
8. Kolashin	962	543	419
9. Nikshiq	2.099	980	1.119
10. Pljevlja	1.292	584	708
11. Podgoricë	3.434	1.635	1.799
12. Cetinë	1.899	925	974
GJITHSEJ:	20.616	9.585	11.031

Luburić, f. 74.

V-3. Fragment nga raporti i një zyrtari federal të Ministrisë së Brendshme Gjermane, drejtuar kreut të administratës civile të Stirias së Poshtme, mbi dëbimin në masë të sllovenëve (30 maj 1941)⁷²

Problemi më i vështirë për t'u zgjidhur në Stirian e Poshtme është spastrimi prej elementëve të huaj sllavë, të cilët nuk do të mund të asimilohen gjatë procesit të gjermanizimit. Nëse rigjermanizimi i Stirias së Poshtme do të jetë i suksesshëm dhe kjo zonë periferike juglindore e Rajhut gjerman do të bëhet një barrierë mbrojtëse ndaj Ballkanit gjithmonë të trazuar, popullsia vendase duhet të çlirohet nga çdo substancë që nga pikëpamja racore saboton gjermanizimin ose nga çdo prirje që e pengon atë. Detyra e Shoqatës Patriotike Stiriane mund të arrihet me sukses vetëm nëse kjo zonë pastrohet ashtu siç duhet. Prandaj është planifikuar

dëbimi i popullsisë, i cili do të vihet në praktikë në katër faza dhe në një mënyrë e cila ka qenë e suksesshme në procese të ngjashme në territore të tjera të rifituara nga Rajhu (veçanërisht në Lindje). Argumentet historike për marrjen e këtyre masave janë mëse të qarta. Të kuptuarit drejt të nevojës për të ndërmarrë këtë veprim, do të bëjë të mundur që të lihen mënjanë ndjenjat e tepërta njerëzore, të cilat janë gjithashtu pjesë e natyrës gjermane, sidomos kur kihet parasysh përballja e pamëshirshme e shkatërruese që kombësia gjermane ka pësuar këtu në Stirian e Poshtme prej atyre që tani duhet të largohen. Shpërnguljet drejt Serbisë dhe pjesërisht drejt Kroacisë do të bëhen me anë të trenave, të cilët do të transportojnë secili 1000 veta. Koha e fillimit dhe kohëzgjatja e këtij aksioni (tani për tani janë parashikuar një deri në dy trena në ditë) nuk është përcaktuar ende.

Ferenc, f. 43.

⁷² Gjermania ndërmjet dy luftërave botërore e konsideronte territorin slloven si territor gjerman dhe pas pushtimit donte që ta aneksonte zyrtarisht dhe ta kthente në kufirin jugor të Rajhut. Kjo do të arrihej brenda gjashtë muajsh (deri në fund të vitit 1941). Sllovenët duhej të dëboheshin ose të gjermanizoheshin dhe vendi të popullohej me gjermanë.



Cili ishte qëllimi i dëbimit të planifikuar të popullsisë? Cilat ishin pasojat e këtij plani?

V-4. Raport i komisionerit të lartë të provincës së Lubjanës, mbi programin e veprimtarive në rajon (24 gusht 1942)

Në lidhje me dokumentin konfidencial nr. 1362/2, të datës 16 gusht, më lejoni t'ju paraqes një përmbledhje të veprimtarisë që synoj të zbatoj në këtë provincë. (...)

1. Problemi i popullsisë slovene mund të zgjidhet në tri mënyra:

a. Duke e shfarosur atë;
b. Nëpërmjet dëbimeve;
c. Nëpërmjet shpërnguljes së elementëve kundërshtarë; kjo mund të arrihet duke zbatuar një politikë bashkimi të ashpër, por të drejtë, me qëllim që të hedhim bazat për një bashkëpunim të dobishëm dhe të drejtë. Kjo do të na japë mundësinë e asimilimit, i cili mund të arrihet me kohë. Prandaj duhet të vendosim cilën mënyrë do të zgjedhim.

2. Për dëbimin në masë të popullsisë na duhet të ndjekim një plan të përgatitur që më parë, i cili do të mund të zbatohet në të gjithë provincën. Do të ishte më mirë që të ngrinin kampe pune, në vend të kampeve të përqendrimit, ku njerëzit nuk bëjnë gjë tjetër, veçse rrinë kot.

3. Me qëllim që të zëvendësojmë popullsinë slovene me atë italiane, duhet të përcaktohen hapat e mëposhtëm:

a. Ku do të shpërngulet popullsia slovene;
b. Cila është popullsia italiane më e përshtatshme për t'u vendosur në territoret slovene. Në këtë rast duhet pasur parasysh se populli në veri dhe në pjesën qendrore është ai më i përshtatshmi;
c. Nëse e gjithë zona përgjatë kufirit do të italianizohet, gjerësia e kësaj zone duhet të përcaktohet (20-30 km);
d. Nëse e gjithë popullsia slovene do të shpërngulet, atëherë procesi duhet të fillojë në zonat përgjatë kufirit, zona në të cilat slovenët jetojnë nën sundimin italian.

Për mendimin tim, një zhvendosje e plotë ose edhe e pjesshme e popullsisë slovene do të jetë pothuajse e pamundur gjatë luftës.

Ferenc, f. 73-74.



Ndërkohë që politika e "butë" pushtuese italiane që e pasuksesshme, autoritetet ushtarake dhe ato civile, sipas udhëzimeve të Musolinit, morën të njëjtat masa, ashtu si edhe gjermanët në zonën e tyre të pushtimit. Masa të tilla ishin, p.sh., pushkatimi i të burgosurve dhe ekzekutimi në masë i partizanëve të zënë rob, pushkatimi dhe ekzekutimi i aktivistëve ilegalë të Frontit Çlirimtar, i banorëve të zonave të dyshuara për lidhje me lëvizjen çlirimtare, por, gjithashtu, edhe i njerëzve plotësisht të pafajshëm. (Gjatë gjithë periudhës së pushtimit italian, në Provincën e Lubjanës, forcat ushtarake italiane pushkatuan të paktën 416 persona, 238 grupe njerëzish, të barabartë me 1153 veta, që gjithsej do të thotë 1569 persona, pa llogaritur këtu ata të dënuar nga gjyqi ushtarak në Lubjanë dhe të internuarit në masë). Qëllimi përfundimtar ishte "spastrimi" i territorit kombëtar sloven dhe përgatitja e tij për vendosjen e italianëve pas luftës.



Cilat janë ngjashmëritë dhe ndryshimet midis planit gjerman dhe atij italian? (Krahasoni këtë burim me atë të mëparshmin.)

► Fig. 51. Refugjatë të ardhur nga Bosnja në Serbi, 1941



Milošević, *Izbeglice i preseljenici*, f. 246.



Më shumë se 400 000 refugjatë serbë nga gjithë territoret e Jugosllavisë u strehuan në territorin e Serbisë së pushtuar.

V-5. Persekutimi i pakicave gjermane në Rumani pas Luftës

1. Të gjithë burrat nga mosha 17 deri në 45 vjeç mund të internohen.
2. Gjithashtu, edhe të gjitha gratë nga mosha 18 deri 30 vjeç.
3. Nuk bëhet përjashtim për askënd që u përket kategorive të mësipërme, përveç grave me fëmijë më të vegjël se një vjeç dhe atyre të sëmura, të cilat nuk mund të punojnë.
- (...)
6. Të gjithë ata që do të internohen, do të dërgohen në rajonet përkatëse të xhandarmërisë, nga ku do të shpërndahen në vendet e grumbullimit, të caktuara më parë nga autoritetet e policisë dhe xhandarmërisë lokale; duhet të theksohet se vendet e grumbullimit duhet të jenë pranë stacioneve hekurudhore.
7. Ushqimi për ata që do të internohen, do të sigurohet nga vetë ata deri në vendet e grumbullimit; nga kjo pikë e më pas, ushqimi do të sigurohet nga autoritetet rumune (xhandarët dhe policët) për 2-6 ditë, periudhë në të cilën atyre do t'u jepet të paktën një vakt i ngrohtë në ditë.

Deportarea etnicilor germani din România in Uniunea Sovietică (1945), f. 38-39.



Pushtimi i Rumanisë nga Ushtria e Kuqe bëri që minoriteti gjerman në Rumani të vuante e të persekutohej. Shumë njerëz me etni gjermane u shpërngulën në BRSS. Ky dokument është Urdhri nr. 32.475-S, i lëshuar nga kreu i përgjithshëm i policisë dhe përmban detaje lidhur me internimin e popullsisë me etni gjermane (3 janar 1945).



A solli pushtimi sovjetik liri dhe demokraci në Rumani? A ju duket normale që të shpërngulet një pjesë e popullsisë, thjesht për shkak të përkatësisë së saj etnike? A ishin fajtorë të gjithë ata që u internuan? A ishte i interesuar ndokush në përcaktimin e fajtorëve që duheshin ndëshkuar dhe atyre që nuk ishin fajtorë? A dini ndonjë shembull tjetër të "fajit kolektiv" nga historia e shekullit të 20-të?

V-6. Përkujtesë personale e kryeministrit britanik Uinston Çurçill, drejtuar ministrit britanik të Punëve të Jashtme, në lidhje me internimin e qytetarëve rumunë me origjinë gjermane në Rusi (19 janar 1945)

Përkujtesë personale e Kryeministrit
10, Downing Street, Whitehall
19. L 1945
Nr. Protokolli M. 91/5

MINISTRIT TË PUNËVE TË JASHTME

Më duket se po mbajmë një qëndrim shumë aktiv ndaj internimit për qëllime pune të austriakëve, saksonëve, gjermanëve ose gjysmëgjermanëve të tjerë nga Rumania për në Rusi. Duke pasur parasysh atë që ka vuajtur Rusia, sulmin e paramenduar që Rumania ndërmori kundër saj, ushtritë e panumërta që Rusia angazhoi në front në këtë kohë, si dhe kushtet tejet të këqija të njerëzve në shumë pjesë të Europës, nuk e kuptoj përse thuhet se rusët po bëjnë gabim që kërkojnë që 100 ose 150 mijë njerëz të tillë të punojnë në metrotë e tyre. Gjithashtu duhet të kujtojmë se ne premtuam që fatin e Rumanisë ta lëmë kryesisht në duart e rusëve. Duke marrë në konsideratë atë që ka ndodhur, nuk më duket gabim që rusët të marrin çdo rumun, të cilësdo origjinë që të kenë dëshirë, për të punuar për ta në minierat ruse.

19. 1. 1945.

Deportarea etnicilor germani din România in Uniunea Sovietică (1945), f. 31.



Përshkruani nga pikëpamja morale qëndrimin e Uinston Çurçillit. A respektonte ky qëndrim të Drejtat e Njeriut që mbështeteshin nga Kombet e Bashkuara?

► **Fig. 52. Kthimi i Gardës Kombëtare Sllovene (Domobranci) në qershor të vitit 1945**



Key Garda Kombëtare Sllovene u krijua në shtator të vitit 1943 në Lubjanë, për të luftuar kundër Frontit Çlirimtar. Ajo u themelua nga gjermanët dhe anëtarët e saj ishin kryesisht katolikë dhe antikomunistë. Gjermanët, të cilët nuk i besonin Gardës Kombëtare, kërkuan që ata të konfirmonin besnikërinë e tyre me një ceremoni publike betimi për ditëlindjen e Hitlerit (20 prill 1944). Në fund të luftës, anëtarë të Gardës Kombëtare, së bashku me ushtrinë gjermane, u tërhoqën në Austri, ku forcat britanike i çarmatosën si bashkëpunëtorë të gjermanëve.

Në qershor të vitit 1945, britanikët i kthyen ata në Slloveni. 7 000 deri në 11 000 prej tyre u vranë në vende të ndryshme të Sllovenisë. Deri në vitin 1975, këto masakra iu mbajtën të fshehta opinionit publik në Slloveni. Gjatë viteve 1980, tema e vrasjeve në masë, përgjegjësia për këto vrasje dhe pasojat e tyre të dhimbshme për kombin slloven filluan të diskutohen haptazi nga intelektualët. Pas zgjedhjeve të para demokratike në vitin 1990, një ceremoni pajtimi u zhvillua në Kocevski Rog, ku ndodhet dhe pjesa më e madhe e varreve masive.

Vc. Ndryshimet në sistemet politike

V-7. Oferta e U. Çurçillit për një marrëveshje⁷³ me “përqindje”

Rumania	Rusia	90%	
	Të tjerët	10%	
Greqia	Britania e Madhe	90%	
	Të tjerët	10%	
Jugosllavia		50/50	
Hungaria		50/50	
Bullgaria	Rusia	75%	90%
Të tjerët		25%	10%

Bulgaria – the Unacknowledged Enemy of the Third Reich
[Bullgaria - Armiku i panjohur i Rajhut të Tretë], f. 96.

► Fig. 53. Populli i Athinës feston mbërritjen e ushtrisë britanike pas çlirimit



Istoria, vëll. 16, f.101.

🔑 Flamurët britanikë dhe amerikanë mund të shihen përkrah flamurit grek, bashkë me simbolet e EAM-it dhe Partisë Komuniste Greke (KKE).

V-8. Forcimi i autoriteteve të Lëvizjes Nacional Çlirimtare në Bosnjë dhe Hercegovinë

Propozim për konstituimin e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Bosnjës dhe Hercegovinës, si organizmi më i lartë legjislativ dhe ekzekutiv i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës.

1 korrik 1944

Paragrafi 1

Bazuar në shprehjen e lirë të dëshirës⁷⁴ së kombit të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe sipas vendimeve të marra në sesionin e dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë në Jajcë, më 29 dhe 30 nëntor 1943, Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar i shtetit të Bosnjës dhe Hercegovinës konstituon veten si organi më i lartë i autoritetit shtetëror në Bosnjë dhe Hercegovinë, si një njësi e barabartë federative brenda Federatës Demokratike Jugosllave.

Zgonjanin et al. (red) f. 399.

🔑 Gjatë vitit 1944, trupat partizane e forcuan autoritetin e tyre në të gjithë Jugosllavinë, duke përfshirë këtu edhe Bosnjën dhe Hercegovinën. Në vendimet e marra nga Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar i shtetit të Bosnjës dhe Hercegovinës, mund të kuptohet se si punuan ata sistematikisht për të arritur monopolizimin e pushtetit të pasluftës në duart e komunistëve.

❓ Komentoni faktin se në burim përmendet “shprehja e lirë e dëshirës së kombit”, megjithëse nuk u mbajtën zgjedhje në Bosnjë dhe Hercegovinë. A ka ndonjë shembull të ngjashëm me këtë në vendin tuaj?

⁷³ Kjo ofertë iu paraqit Stalinit më 9 tetor 1944.

⁷⁴ Në atë kohë nuk u mbajtën zgjedhje demokratike në Bosnjë dhe Hercegovinë.

V-9. Në maj të vitit 1945, Josif Horvati, gazetar dhe historian, pa me sytë e tij largimin e ustashëve dhe mbërritjen e partizanëve në Zagreb

"8 – Eca nëpër Tushkanac. Rrugës ecja i gëzuar si fëmijë – nuk na ishte lejuar të kalonim këtej qysh prej katër vitesh e një muaji. Kjo gjë e vogël më bëri të ndiej se ishim të lirë, po fillonim një jetë të re. Një ndjenjë shumë e çuditshme në zemër; mendja e njeriut nuk mund ta kuptojë se frika ka kaluar. (...) 9 – Ushtria që erdhi, po kalon nëpër qytet, duket e çrregullt, por e mirarmatosur, luftëtarë të vërtetë. (...) një ushtri e çrregullt dhe luftëtarë të pistë: sa të rreme janë të gjitha ato tablo mbi skenat e luftës – në to, luftëtarët janë gjithmonë të pastër, të rregullt, të krehur dhe të rruar mirë – kjo i kalon caqet e idilizmit ose stilizimit – është budallallëk i kotë. (...) 14 – Për shkak të motit të nxehtë, fjeta keq. Takova

mamanë dhe më pas dola për një shëtitje. Më kërkuan të shkoj në HIBZ (Instituti i Botimeve Bibliografike Kroate), për të regjistruar disa të dhëna vetjake. Atmosfera atje ishte për të ardhur keq. Një mësues ishte caktuar oficer politik në HIBZ dhe nuk e kishte fare idenë e kësaj pune. Shkova në shtëpi me Fricikan; në shtëpi kishte filluar paniku, sepse nja dy veta me uniforma kishin marrë me vete Cigon; por ky incident përfundoi mirë, sepse Cigon e liruan pas gjysmë ore. Vetëm se humbi kutinë e tij të shtrenjtë të veglave."

Josip Horvat, *Preživjeti u Zagrebu*, f. 229-231.



Ç'mendoni për veprimet e qeverisë së re partizane që përshkruhen në pjesën e mësipërme? Sipas jush, a iu nënshtrua ditari i Horvatit një censure vetjake?

► Fig. 54 dhe fig. 55 Hyrja e partizanëve në Zagreb, më 8 maj 1945



Muzeu i Qytetit të Zagrebit.



Përshkruani fotografinë: A kuptohet lehtë se fotografia pasqyron një ngjarje historike? Përse sheshi kryesor i Zagrebit është i zbrazët?

Mitingu në sheshin "Ban Jelačić" në Zagreb, në maj të vitit 1945, pasi partizanët morën pushtetin



Galeria e Arkivit të Shtetit, Zagreb



Përse sheshi kryesor është i mbushur plot me njerëz, vetëm pak ditë pasi partizanët hynë në Zagreb? Cilat ishin arsyet e mundshme për pjesëmarrjen e njerëzve në mitingun e organizuar nga pushteti i ri?

V-10. Fragment nga raporti i mbajtur në një nga mbledhjet e Partisë së Punës Bullgare (Komuniste), ku vihet në dyshim gjykimi i anëtarëve të regjimit të kaluar

20 janar 1945

Rendi i ditës: Shkëmbim idesh dhe opinionesh rreth gjykimit në të dy gjyqet. (...)

Ministri Minço Neïçev: Shokët që janë caktuar prokurorë të popullit, po veprojnë plotësisht gabim. Ata kërkojnë të gjejnë krimin më të rëndë, ndërkohë që krimet e tjera i cilësojnë si më të lehta. Ata kërkojnë dënimin me vdekje vetëm për ata që janë më shumë fajtorë, dhe për të tjerët (të cilët nuk janë po aq fajtorë sa të parët) kërkojnë dënime më të lehta. Ata nuk po kërkojnë të gjejnë prova të mjaftueshme që është kryer një krim i rëndë, i cili meriton dënimin me vdekje, por kërkojnë ta lënë këtë dënim për ata që kanë bërë krime akoma më të rënda.

Georgi Çankov: Linja që po ndjekin prokurorët tanë nuk është linja e popullit..., por si njerëz që qëndruan të veçuar nga lufta e popullit bullgar, ata vetëm po masin shkallën e fajit. Prokurorët tanë nuk po veprojnë ashtu si populli, i cili kërkon të gjejë edhe provën më të vogël që do të provojë se këta kriminelë janë fajtorë...

Traiço Kostov: Në asnjë mënyrë nuk mund të biem në një mendje me mënyrën se si po veprojnë shokët prokurorë. Unë propozoj: për regjentët – dënim me vdekje për të tre..., për këshilltarët – Sevovin dhe katër të tjerët – dënimin kapital... Për kabinetin e parë të Filovit, është e qartë – dënim me vdekje. (...)

Për kabinetin e dytë të Filovit: të merret i njëjti vendim. (...)

Sipas Krestomacisë së Historisë Bullgare 1944-1948, f. 484-485.



Si u morën vendimet – në bazë të fajit të kryer, apo bazuar mbi kritere të tjera? A duhet që këto vendime t'i marrin udhëheqësit politikë apo duhet që t'i marrin institucionet juridike përkatëse?

V-11 dhe V-12.

Fragment nga raporti i ministrit të Drejtësisë, lidhur me numrin e njerëzve të dënuar nga Gjykata e Popullit në Bullgari

Nga raporti i dr. Minço Neïçevit, ministër i Drejtësisë, drejtuar Komitetit Kombëtar të Frontit për Atdheun:

"(...) Nga data 23 dhjetor 1944 deri më 31 mars 1945, Gjykata e Popullit ka gjykuar 145 raste, me 10 907 të akuzuar. Ata kanë marrë dënimet e mëposhtme: 2 680 – janë dënuar me vdekje; 1 921 – me burgim të përjetshëm; 1 376 – 19-20 vjet burg; 962 – me 15 vjet burg; 727 – me 10 vjet burg; pjesa tjetër, 3 241 – me më pak se 10 vjet burg. Pothuajse të gjitha pronat e të dënuarve janë konfiskuar."

Manov, f. 21.

Memorandum i Britanisë, lidhur me gjyqet dhe zbatimin e vendimeve ndaj të ashtuquajturve kriminelë luftime në vendet e çliruara dhe satelite

Ambasada Britanike në Uashington, 31 mars 1945

2. Edhe pse individët e ekzekutuar pas gjyqeve të kohëve të fundit në Bullgari cilësohen si "kriminelë luftime", nga paditë dhe rrethanat në të cilat zhvillohen këto gjyqe bëhet e qartë se ato kanë karakter politik. Është miratuar një ligj, i cili shërben për të hequr qafe kundërshtarët politikë të atyre që tani janë në pushtet.

3. Një spastrim i tillë, megjithëse po zbatohet në mënyrë të pjesshme, do të krijojë një zbrazëti në jetën politike të vendit, duke bërë të mundur që pushtetin qeverisës ta marrë vetëm një parti dhe ajo të vendosë diktaturën.

Bullgaria- Armiku i panjohur i Rajhut të Tretë, f. 222-223.



Kur dihet se numri i njerëzve të dënuar me vdekje në gjyqin e Nurembergut ishte disa dhjetëra vetë, dhe ata që u dënuan në Japoni akoma më pak, si mund ta shpjegoni numrin kaq të madh të personave të ekzekutuar nga gjykatat e popullit në Bullgari? Si i komentonte Ambasada Britanike në Uashington këto gjyqe?

► **Fig. 56. Udhëheqësve ushtarakë, politikë dhe shtetërorë maqedonas u bëhet një pritje e ngrohtë në Shkupin e çliruar – kryeqyteti i Maqedonisë Jugosllave (13 nëntor 1944)**



V-13. Një fragment që përshkruan pushtimin e Bullgarisë nga Ushtria e Kuqe dhe marrjen e pushtetit nga Fronti për Atdheun

Për katër dekada e gjysmë, data 9 shtator 1944 u festua dhe u përkujtua si data e “kryengritjes popullore antifashiste” dhe e “revolucionit socialist”. Në fakt, ai ishte një grusht shteti, me ndihmën e një shteti tjetër, ushtria e të cilit hyri në Bullgari pasi na kishte shpallur luftë. Asnjë plumb nuk u qëllua kundër Ushtrisë së Kuqe të Stalinit në Bullgari. Përkundrazi, u prit si çliruesja e vendit... Guerrillasit filluan të dalin “triumfues” nga pyjet dhe hynë nëpër qytete e fshatra duke valëvitur flamuj të kuq dhe duke hedhur parrulla. “VDEKJE FASHIZMIT, LIRI POPULLIT!” Fjala më e përdorur dhe që dëgjohej më shpesh ishte **VDEKJE!**

(...) Nuk pati ndonjë kryengritje, sepse qeveria e Frontit për Atdheun e kishte marrë pushtetin pa

gjakderdhje. Por qenë ata që erdhën në pushtet, të cilët filluan të derdhnin gjak që ditën e parë të marrjes së pushtetit. E gjithë kjo ndodhi me miratimin e heshtur të “bratushki– vëllezërve (rusëve)”.

Manov, f. 11-12.

❓ Si e konsideron autori ndërrimin e regjimit? Cili ishte roli që luajti Ushtria e Kuqe në këtë ngjarje, dhe nga ana tjetër, cili ishte roli i partizanëve dhe i Frontit për Atdheun? Si e paraqesin fitimtarët këtë ngjarje?

► **Fig. 57. Populli i Beogradit mirëpret ushtrinë bullgare**



🔑 “Rroftë ushtria vëllazërore bullgare” – me këtë thirrje i priti populli i Beogradit fqinjët e tyre. Bullgaria mori pjesë në Luftën e Dytë Botërore në krahun e koalicionit kundër Hitlerit nga shtatori i vitit 1944, deri në maj të vitit 1945. Ushtria bullgare, së bashku me guerrillasit jugosllavë dhe pjesë të Frontit të Tretë Ukrainas, luftoi në territoret jugosllave, hungareze dhe austriake.

❓ **Pyetje të përgjithshme mbi nënkapitullin Vc.**

Ç’ndryshime pati në sistemin politik në vendin tuaj pas Luftës së Dytë Botërore? A ndodhi ndonjë ndryshim tjetër i madh në dhjetëvjeçarët pasardhës dhe për ç’arsye? Krahasoni vendin tuaj me vendet fqinje.

KAPITULLI VI: Kujtimet e Luftës

Ky kapitull na paraqet një panoramë disi të ndryshme të ngjarjeve të luftës dhe nga një këndvështrim disi më në largësi. Kjo për shkak të kalimit të kohës dhe shkëputjes që ndodh kur kujtimet për të kaluarën dhe intervistat regjistrohen, ndërsa vetë ngjarjet kanë shumë kohë që kanë ndodhur. Pas disa kohësh, pjesëmarrësit në ngjarjet e luftës mund t'i shikojnë përvojat e tyre ndryshe ose nga një këndvështrim tjetër. Është interesante të shohësh në këto rrëfime se si ndryshon pikëpamja e rrëfyesit dhe të përpiqesh të gjesh arsyet për këtë ndryshim. Arsyet mund të jenë të ndryshme (të ndryshojnë historinë dhe rolin që këto personazhe luajtën në të me qëllim; ndryshime të shkaktuara nga ndryshimi i bindjeve politike të rrëfyesit me kalimin e kohës, nga harresa, nga ndikimi i të tjerëve, etj.).

Një lloj tjetër këndvështrimi në largësi mundësohet nga burimet e mëposhtme që përbëhen nga tekste të shkruara, p.sh., mbi ngjarje të vërteta që kanë ndodhur. Ky lloj këndvështrimi shihet më qartë në veprat letrare. Midis tyre mund të gjejmë një spektër të shumëllojshëm: nga ato që janë të mbushura me ideologji dhe s'janë bindëse, janë pa jetë, histori bardhë e zi, deri tek ato ku paraqitja me vërtetësi dhe vlerat artistike plotësojnë njëra-tjetrën dhe krijojnë një rrëfim të plotë. Shembuj nga kjo gamë rrëfimesh do të paraqiten në paragrafët që vijojnë.

VI-1. Intervistë e Jozhe Pozharit, jetim i Luftës së Dytë Botërore (i lindur në vitin 1932 në Slloveni)

“E kujtoj luftën si një ëndërr të keqe, e cila fatkeqësisht ishte e vërtetë. Sidoqoftë, kujtimet e tjera më zbehen, kur kujtoj atë ditë që ushtarët italianë më morën babanë, Jozhenë, dhe e pushkatuan në Podpeç, së bashku me pesë fshatarë të tjerë nga Bresti.

Kujtimet e mia të vogëlisë janë të dhimbshme. Në atë kohë jeta ishte shumë e vështirë. Unë dhe motrat e mia, Milka dhe Marija, vëllai im, Marini, babai im, Jozheja dhe nëna ime, Ivanka, jetonim së bashku në një fermë të vogël. E nxirrnin bukën e gojës duke punuar në bujqësi. Edhe pse babai ishte mjeshtër për të bërë karroca, ai nuk mund të gjente punë. Jeta jonë ishte e ngjashme me atë të familjeve të tjera në fshatin Brest dhe në lagjen tonë.

Çdo gjë ndryshoi, ose më mirë të them u shkatërrua, kur morën babanë dhe e pushkatuan. U bëra edhe më keq kur nënën, në vitin 1944, e dërguan në një kamp përqendrimi gjerman. Në atë kohë isha 12 vjeç dhe në fillim u kujdesa për shtëpinë dhe familjen. Më vonë, për Milkan, Marijan dhe vëllain, Marinin, u kujdes teza ime, Alojzija Grudeni, nga Lubjana dhe për mua u kujdesën fqinjët tanë. Qëndrova me ta deri në vitin 1945, kur nëna u kthye nga kampi i

përqendrimit.. Jeta vazhdonte. Në një farë mënyre ia dolëm mbanë, por do të kishte qenë më mirë nëse do kishim pasur babanë pranë, atëherë kur kishim më tepër nevojë... Edhe tani është e dhimbshme për mua kur qëndroj përpara varrit të babait në Tomishelj dhe mendoj për vdekjen e tij, në një kohë që kishim aq shumë nevojë për të.
Brest, prill 2003.

“Ilegalčki Borec”, Lubjanë 2003.



Si do t'i përshkruanit ju kujtimet e Jozhe Pozharit? Kujtoni numrin e madh të të vrarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe përpiquni të imagjinoni se sa histori të ngjashme me këtë mund të ketë...

VI-2. Fragment nga romani gjysmëbiografik i Fikret Demiragut

“Ishte data 28 prill 1941. Ishim kapur rob një muaj pasi kishim zbarkuar në Greqi, dhe pas 11 muajsh që ishim futur në ushtri. Ishte e vështirë të besohej që më shumë se gjysma prej nesh nuk kishin qëlluar asnjëherë gjatë gjithë karrierës sonë ushtarake. Kjo, sepse pjesa më e madhe e qipriotëve shërbenin si trupa rezervë.

Kur iu afruam rrugës, vumë re një ushtar të shkurtër gjerman. Ai ishte i pari ushtar gjerman që kisha parë dhe m'u duk i lodhur dhe i mërziur. Nuk kishte asgjë në pamjen e tij që ta bënte këtë ushtar nazist të veçantë ose superior! E vetmja gjë që e dallonte ishte automatiku, të cilin e mbante të drejtuar nga mijëra të burgosur që po zbrisnin nga malet."

"Report" nr. 46, f. 14.



Në kohën e luftës, Qiproja ishte koloni e Mbretërisë Britanike. Shumë grekë dhe turq qipriotë u bashkuan me "Regjimentin qipriot" dhe luftuan kundër Gjermanisë naziste. Shumë prej tyre u kapën rob dhe u dërguan nëpër kampet gjermane.



Përse ndihej i dëshpëruar Bilal Denizali, personazhi i novelës së mësipërme? Si e përshkruan ai ushtarin gjerman? Ai u befusua që një ushtar gjerman nuk dukej "i veçantë ose superior". Përse priste ai që ushtari gjerman të ishte i tillë?

VI-3. Komandanti partizan bullgar Denço Znepolski rrëfen se si u rishkrua, pas Luftës së Dytë Botërore, historia e rezistencës

Jam shumë i bindur se historia nuk mund të shkruhet sipas urdhrave të marra disa dhjetëvjeçarë më vonë. Historia u bë gjatë betejave të partizanëve, por që në interes të disa njerëzve që të manipulonin faktet dhe t'i shkruanin në përputhje me dëshirat e tyre... Deri këtu mirë, por kur na futën në burg, në vitet 1951-1954, shumë njerëz filluan të infektoheshin nga "humbja e kujtesës" dhe filluan ta keqinterpretojnë të vërtetën historike dhe të nxirrnin dëshmi të rreme, në mënyrë që e kaluara e tyre të përputhej me pozitat aktuale që mbanin në parti dhe në hierarkinë shtetërore. Sikur të ishte kusht që për t'i pasur biografitë e tyre më të vlerësueshme, duhej të shpalleshin komandantë të mëdhenj gjatë luftës së armatosur kundër fashizmit! Në të vërtetë, disa prej tyre patën përvojë të mjaftueshme në luftë dhe nuk kishin nevojë të zmadhonin ose sajonin histori nga jeta e tyre përpara 9 shtatorit, por... kështu janë njerëzit!

Znepolski, f. 316.



Cilët janë ata që e rishkruajnë historinë? Për ç'qëllime e bëjnë këtë?

► Fig. 58. Afresk i punuar nga Borko Lazeski



Ky afresk përfaqëson Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit maqedonas gjatë Luftës së Dytë Botërore (1941-1945).

► Fig. 59. Skenë nga filmi Republika Uzhice



Kinoteka Jugosllave, Beograd.



Ky është film i regjisorit Zhika Mitroviç, xhiruar në vitin 1974. Republika Uzhice është përfaqësues tipik i "filmave me partizanë" të lustruar dhe me nota romantike.

VI-4. Gjenerali Ctin Sanatesku flet rreth informimit “publik”, që nuk është në përputhje me realitetin në vijën e frontit (Pjesë nga ditari i tij)

“15 dhjetor 1942. Sot e kanë radhën për t’u lexuar gazetat e datës 23 dhe 24 nëntor [1942]. Në kronikën e bërë nga “Universul” thuhet: “Në zonën e Donit të Poshtëm, trupat rumune dhe gjermane, të cilat po zhvillojnë prej disa ditësh një luftë të ashpër mbrojtëse, zmbarsën sulmet e vazhdueshme të armikut dhe shpartalluan një regjiment kalorësie, i cili arriti të çajë pozicionet e tyre, por që mbeti i rrethuar”. Nuk ka nevojë për shumë shpjegime sepse, nëse u shkatërrua vërtet një regjiment i kalorësisë, kjo do të thotë se 1/12 e gjithë kalorësisë ruse që luftoi në këtë front u shkatërrua, pasi aty kishte tri divizione kalorësie. Zoti kronist, më lejo të të tregoj se si ishte gjendja në atë kohë: Divizioni V, VI, XIII, XV dhe një pjesë e Divizionit XIV u rrethuan plotësisht. Korpusi XI Gjerman dhe Divizioni I i Kalorësisë Rumune u detyruan të kalojnë në pjesën lindore të Donit dhe Armata e 48-të Gjermane e mjeteve të koracuara u gjendën në një situatë ku nuk mund të ndërhynin, çka detyroi gjeneralin Heim – i quajtur edhe “Romeli i vogël” – të merrte komandën. Armiku arriti në Cir, në lindje të Oblivskaias, duke bllokuar hekurudhën që furnizonte trupat në Stalingrad. Siç mund ta shikoni, zoti kronist, kjo ishte katastrofë... Kam vënë re, zoti kronist, se ju vetëm kopjoni komunikatat e rreme gjermane, për të mbushur dy kolonat e gazetës; gjë për të cilën paguheni. Tani e kuptoj pse askund tjetër nuk u shkruan më tepër gënjeshtër, sesa në komunikatat zyrtare mbi luftën...”

Sănătescu, f. 87-88.



Komentoni përse ndryshonin pikëpamjet e ushtarakëve, me atë çka paraqitej në shtyp. Përse shtypi e shtrembëronte të vërtetën? A ishte i motivuar ky shtrembërim?

► Fig. 60. Gjorgje Andrejeviç-Kun (1904- 1964), *Pushkatimi*, 1943



Grafika jugosllave, 1900-1950. Katalog i ekspozitës, dhjetor 1977 – shkurt 1978. Beograd, 1977, Katalog. Nr. 12.

VI-5. Në tregimin e saj të shkurtër, *Takimi*, Andjelka Martiçi përshkruan një djalë që kërkon të atin partizan

“Duke i kthyer kurrizin shtëpisë së tij të bërë shkumb e hi, ai menjëherë filloi të ecë drejt pyllit nga i cili dëgjoheshin të shtënat e largëta. Fshati i djegur mbeti pas në luginë. Djali nuk e ktheu asnjëherë kokën që ta shikonte. Të afërmit e tij kishin mbetur atje, prandaj nuk do t’i shihte më kurrë dhe nuk do ta dëgjonte zërin e tyre.

Kishte hyrë në pyllin e mbuluar me gjethe të thata dhe tani dëgjonte cicërimat e zogjve që çuditshëm përziheshin me krismat e largëta. Tek ato krisma donte të shkonte ai. Atje luftonin partizanët, dhe me ta ishte i ati, njeriu i vetëm që i kishte mbetur në këtë botë. A do ta gjente vallë? Duhej ta gjente, duhej. Pastaj mund të rrinte me të dhe i ati do t’i jepte një pushkë me të cilën do të mund të hakmerrej për fshatin e tij në luginë, dhe për shtëpinë e tij, kopshtin me pemë. (...)

Luftimet pushuan. Filloi të dëgjonte disa zëra që mërmërisnin. Partizanët nuk mund të ishin larg prej andej. Djali ndjeu zemrën t’i rrihte fort nga gëzimi që do të takonte të atin...”

Ai u takua me partizanët dhe...

“Një çast më pas, po qëndronte me kokën mbështetur tek trupi i një partizani të vvarë në betejën e sapozhvilluar. Lot të mëdhenj i rridhnin faqeve dhe shpatullat e tij të dobëta dridheshin nga e qara me dënësë. Partizanët e tjerë qëndronin rreth e qark në heshtje. Askush nuk e qetësonte, askush nuk i thoshte fjalë ngushëllimi. Gjithsesi, sa vlenin ato? Dhimbja nuk mund t’i zbutej!

Papritur, ai tundi kokën me vendosmëri, fshiu lotët me duart që i ishin bërë pis, dhe më pas u përkul sipër të atit. Me duart e tij të vogla i mori pushkën të atit, e vuri në krah dhe u drejtua me hap të rëndë nga kompania të cilën i ati e kishte drejtuar deri pak çaste më parë. Askush nuk kishte forcë ta ndalte.”

Martić, f. 118-120.



Letërsia partizane për fëmijë është një lloj i veçantë i letërsisë në Jugosllavinë komuniste të pasluftës. Një nga përfaqësuesit më të njohur të kësaj letërsie ishte Andjelka Martići.



A mendoni se ngjarje të tilla ndodhën me të vërtetë? (Një fëmijë që humb prindët, bashkohet me partizanët dhe bëhet luftëtar.) A duhen lejuar fëmijët që të bëhen ushtarë në situata me rrezikshmëri të skajshme? (Nuk është e rëndësishme nëse diçka e tillë është e pëlqyeshme, por nëse diçka e tillë është e lejueshme – a janë të pranueshme veprimet e komandantit partizan, i cili lejoi që këto gjëra të ndodhnin?) A idealizohet tregimi i Andjelka Martićit? Argumentoni qëndrimin tuaj. Krahasoni këtë fragment me tekstin III-4 dhe figurën 22.

VI-6. I Arratisuri – këngë e shkruar nga lakovos Kambanellisi

I ARRATISURI

Nga Mauthauzeni, shkruar nga lakovos Kambanellisi

*Janosh Ber nga veriu,
Nuk e duron dot gardhin me tela,
Merr zemër e niset,
E vrapon në fshatrat poshtë në fushë.*

*Më jep pak bukë, zonjë,
Dhe rroba të ndërrohem,
Kam rrugë për të bërë,
Dhe liqene për të kapërcyer.*

*Kudo që kalon ose ndalet,
Përhap frikë dhe tmerr,
Dhe një zë, një zë të fshehtë: “
Fshihuni, fshihuni nga i arratisuri”.*

*S’jam vrasës, o të krishterë,
As bishë që t’ju ha,
Ika nga burgu
Për të shkuar në shtëpi.*

*Oh, çfarë zhgënjimi,
Në tokën e Bertolt Brehtit.
Janoshin ua dorëzojnë esesve,
Dhe dërgohet për t’u ekzekutuar.*



Mauthauzen është teksti i një kënge të kompozuar nga Mikis Theodorakis, muzikanti me famë botërore dhe një nga kompozitorët më të mirë të Greqisë, bazuar në tekstin e shkruar nga lakovos Kambanellisi. Kjo këngë u kompozua në vitin 1965 dhe u inçizua në vitin 1966. lakovos Kambanellisi lindi në vitin 1922 dhe konsiderohet si një nga themeluesit e dramës greke të pasluftës. Atë dhe një shokun e tij e kapën dhe e dërguan në Mauthauzen, ku qëndruan dy vjet e gjysmë. Sipas Kambanellisit, Janosh Beri ishte polak i cili, pasi u kap, u ekzekutua publikisht.



Si ndihet i arratisuri? Përse të gjithë refuzonin ta ndihmonin atë?

VI-7. Ivlin Uofi [Evelin Waugh] përshkruan sulmin partizan (shkëputur nga pjesa e fundit e trilogjisë së tij mbi luftën, *Shpata e Nderit*)

“Karvani ynë nisi të kalojë nëpër një zonë të mrekullueshme fshati. Dukej sikur gjendeshe në mes të një pikturë me bojëra uji të shekullit të kaluar. Vargje me specat që shkëlqenin, vareshin nga strehët e çatave të kasolleve. Gratë që punonin në

ara, herë na përshëndetnin, e herë mbulonin fytyrën. Nuk kishte dallim të dukshëm midis territoreve të “çliruara” dhe atyre që vuanin nën shtypjen e pushtuesit. (...)

Në më pak se një orë, panë grumbullin e shtëpive. U zgjodh për të qëndruar një vend 500 jardë larg prej andej, i fshehur mirë nga shkurret dhe ku vrojtuesit mund të qëndronin të qetë dhe të sigurtë. (...)

Në orën nëntë e gjysmë, në zonën poshtë tyre filluan të shtënat e pushkëve. Gjenerali partizan dukej i shqetësuar. (...) Një korrier partizan u dërgua të shikojë se ç’po ndodhte. Para se të kthehej, të shtënat ndaluan. Kur raportoi, përkthyesi i tha gjeneralit Spitz:

“S’është asgjë, ishte një gabim.” “Na humbi përparësinë e befasisë.”

De Soza, i cili kishte dëgjuar dhe kuptuar raportimin që bëri korrieri, i tha Gait (pseudonimi i Uofit): “Kur kishte mbërritur Brigada e Dytë, Brigada e Parë i kishte ngatërruar luftëtarët e saj me forcat armike, dhe kishte filluar sulmin. Askush nuk është qëlluar, por ashtu siç thotë edhe aleati ynë, kemi humbur përparësinë e befasisë.”

Në luginë nuk pati më qetësi. Në 15 minutat që pasuan, filluan të shtënat e herëpashershme: disa nga muret e shtëpive, disa nga rrethimi; më pas, në orën 10 fiks, sapo në orën e përpiktë të gjeneralit Spitz akrepi i minutave preku kulmin, në qiellin blu filloi të dëgjohej buçima e dy aeroplanëve (mbështetja ajrore britanike). Ata u ulën afër tokës njëri pas tjetrit. I pari lëshoi njëkohësisht dy raketa, të cilat nuk qëlluan në shenjë dhe shpërthyen në pyllin aty pranë, ku tashmë ishte grumbulluar një pjesë e forcave sulmuese. I dyti qëlloi në shenjë. Të dyja raketat e tij ranë drejt e në mur, duke ngritur në ajër një re gurësh. Më pas, avionët u ngritën lart dhe bënë një rrotullim. Gai, që kujtonte bombarduesit në Kretë, të cilët vazhdimisht pikasin dhe bombardonin trupat në tokë, priste që ata të ktheheshin. Por avionët sa vinte e largoheshin dhe zhurma e tyre po venitej. Piloti që ishte dërguar për t’i vrojtuar ata, erdhi pranë nesh. “Punë e paqme”, tha ai. “Tamam në kohë, tamam në shenjë.”


“Ka qe e gjitha?” pyeti Gai.


“Po, kaq. Tani partizanët mund të bëjnë diçka.” Por partizanët s’bënë asgjë.

“Me sa duket”, i shpegoi përkthyesi gjeneralit Spitz, “sulmi duhet shtyrë. Një autokolonë me mjete të blinduara është lajmëruar dhe po vjen këtu.” “Ç’bëjnë njerëzit tuaj në këtë rast?”

“Përballë një autokolone gjermane me mjete të blinduara, shpërndahen. Ky është sekreti i fitoreve tona të mëdha e të shumta.”

Waugh, f. 288-291.

 Ivlin Uofi, autori i kësaj pjese, mori pjesë në luftën e zhvilluar në territorin kroat (Topusko, Vis), si anëtar i misionit ushtarak britanik pranë forcave partizane. Misioni kishte si qëllim të vrojtonte situatën dhe të informonte aleatët se cilët po luftonin me të vërtetë kundër gjermanëve në Jugosllavi (partizanët apo çetnikët).

 Në cilin lloj letrar mund ta klasifikojmë përshkrimin e bërë nga Uofi, përveç atij luftarak (humoristik, komik, aksion, komedi-aksion...)? Duke u bazuar në tekstin e mësipërm, cilat ishin marrëdhëniet që ekzistojnë midis shkrimtarit dhe partizanëve? A është krejt i shpikur ky fragment, apo është i bazuar në ngjarje të vërteta? Krahasojeni atë me tekstin II-25.

► Fig. 61 dhe fig. 62. Dy postera filmash grekë me temë nga Lufta e Dytë Botërore

Tradhtia, 1964



Soldatos, vëll 1, f. 147.

Thanas, ç'bëre gjatë luftës?, 1971

Soldatos, vëll. 2, f. 4.

VI-8. Fragment nga romani i parë i Dobrica Çosiçit, *Dielli është larg*

“Rrethanat e bënë takimin të veçantë. Koha ndaloi në mesnatë. Stuhia filloi me zhurmë, sikur vetë vdekja të ishte takuar me vdekjen e vet. Kompania ishte e rrethuar, njerëzit ishin të uritur, të rraskapitur dhe gjumi nuk i zinte nga të ftohtit dhe frika. Komisar i ngriti dhe i mbledhi në kasollen e shtabit. Ajo ishte mbushur me tym. Anëtarët e partisë u ngjeshën me njëri-tjetrin, duke u dridhur nga të ftohtët dhe duke mermëritur protesta të përgjumura për këtë mbledhje në këtë orë. Ata u mbështetën tek njëri-tjetri dhe disa prej tyre filluan menjëherë të dremisin, pa arritur të dëgjojnë rendin e ditës të mbledhjes. Poli filloi të flasë:

⁷⁵ Mal në Serbinë Qendrore.

⁷⁶ Lumë në Serbinë Qendrore.

⁷⁷ Mal në Serbinë Jugore.

⁷⁸ Emri me të cilin zakonisht thirreshin bashkëpunëtorët, ruajalistët dhe lëvizja nacionaliste “Ushtria Jugosllave në Atdhe”, që ishin edhe armiku kryesor politik dhe ushtarak i lëvizjes partizane, të udhëhequr nga komunistët.

⁷⁹ Gjenerali Dragoljub-Drazha Mihailloviç, udhëheqësi i lëvizjes çetnike.

“Shokë, ka vetëm një çështje për t’u diskutuar: çfarë do të bëjmë në këtë situatë? Ne të shtabit nuk jemi të një mendjeje deri tani. Secili ka mendimin e vet dhe duket se askush nuk do të ndërrojë mendje. Kështu janë punët...”

Ndërkohë që Poli fliste, Vuksani po mendonte: “Si mund të mos jenë në një mendje, këta janë udhëheqës dhe komunistë të vjetër!? Do të thotë që njëri prej tyre është oportunist... Por kush mund të jetë vallë?... Sigurisht që Profesori ka të drejtë: këtu në Jastrebac⁷⁵, ne jemi zotër; përse duhet të largohemi nga baza jonë... Por Gvozdeni është budalla. Ka atë mentalitetin e tij tipik prej borgjezi të vogël. Përderisa një njeri ka pronë private, nuk mund të mbështetesh tek ai për revolucionin. Lëre të hajë e të flejë dhe të presë që gjermanët të ikin. Çfarë po ndodh me të? Ai ka qenë njeri besnik... E çuditshme! (...) Përse vallë, do që të shkojmë në Morava⁷⁶ dhe Kopaonik⁷⁷, kur atje s’mund të shkohet se janë çetnikët?⁷⁸ Njerëzit atje janë gënjyer dhe janë kundër nesh... Kjo do të thotë të largohesh nga beteja...”

(...) Ndërkohë që Poli po fliste, Gvozdeni dhe disa të tjerë vazhdonin ta ndërprisnin, kështu që Poli iu desh t’i tërhiqte vërejtje disa herë.

“... Kjo nuk duket si një mbledhje partie! Ky duket si sherr. Ata duhet të ndëshkohen dhe ne duhet të zgjedhim një kryetar tjetër... Edhe kompania do të shkatërrohet. Si e kanë hallin këta? I ka zënë paniku. Ky s’është një grup muzikor!”

(...) “Poli ka plotësisht të drejtë! Duhet të mos flisni më kot për “terrenin”. Kudo që gjermanët kanë pushtuar, është “terreni” ynë. (...) Nëse braktisim Jastrebacin, do të humbim plotësisht kontrollin politik të kësaj zone. Njerëzit do të zhgënjehen prej nesh. Njerëzit e Drazhës⁷⁹ do të marrin pushtetin dhe ky do të jetë fundi për ne të gjithë...” (f. 24, 25)

(...) “Kur u bashkova me partizanët, - vazhdoi George, - ai Vuksani pa dhëmbë më tha: ‘Rusët do të hedhin ushtarë me parashuta; i presim nga dita në ditë. Lufta do të mbarojë brenda muajit.’ Shumë net me radhë ishim gati të ndiznim zjarre, kur dëgjonim avionë sovjetikë. Vera iku, filloi të binte bryma,

më pas filloi ngrica, më pas dëbora gjer në mes, por Hitleri vërdallisej për qark Moskës. 'E si është gjendja tani?' - pyes ynë. 'Do të përfundojë gjithçka në pranverë', - më thotë ai. 'Mirë, - i them. Nuk e kam problem të pres deri ditën e Shën Jorgjit.' Por ja tek jam ende këtu, i zhytur në borë deri në gju, në Jastrebac, si ari polar". (f. 42)

(...) "Vuku u kollit dhe rrudhi vetullat pastaj me një zë të dridhur tha:

'Gjyqi ushtarak e ka dënuar shokun Gvozden me vdekje...'

Një psherëtimë erdhi nga turma dhe disa prej tyre filluan të shikojnë njëri-tjetrin. Vuku ndaloi, sikur priste që dikush të thoshte diçka, dhe më pas vazhdoi:

"... sepse... në pikën më kritike të luftës sonë, ai u përpoq të shkaktonte revoltë në kompani, dhe kështu që është fajtor për tradhti në luftë. Po, u bë tradhtar!... Ky është vendimi ynë i përbashkët!" (...) Vetëm se Gvozdeni u irritua edhe më shumë kur dëgjoi këto fjalë, ktheu kokën dhe vështrroi Vukun, i cili kishte mbetur si i shushatur (...) 'Mjaft!... Mos hidhni më baltë mbi mua! Zëri i tij dëgjohej si një shpatë e thyer. Ai bëri dy hapa para, drejtoi trupin, ngriti kokën me zemërim dhe me mospërfillje i hodhi një vështrim çetës; dhe tha me një zë të dridhur:

'Kur flitet për drejtësi, nuk ka kohë për fjalë. Duhet të nxitoni. Mos humbni kohë me mua'... .. 'Atëherë, shokë, nëse ndokush nga ju nuk ka një pallto të mirë, mund të marrë xhaketën time të lëkurës'. E zbërtheu atë me një lëvizje të shpejtë dhe e hodhi përpara çetës". (f. 144)

Çosić, f. 24, 25, 42, 144.

Key *Dielli është larg*, romani i parë i prozatorit dhe politikanit Dobrica Čosić (1921 -), botuar në vitin 1954, përbënte një risi në "letërsinë e luftës nacionalçlirimtare dhe revolucionit". Heronjtë në të, anëtarët e një çete partizane që përpiqet të dalë nga rrethimi i armikut, nuk janë "heronj pa faj dhe pa frikë", por njerëz me dyshime, frikë, madje edhe me dyshime ideologjike.

? Si i përshkruan autori marrëdhëniet midis partizanëve të kësaj kompanie? A mendoni se kjo është një ngjarje e vërtetë? Argumentoni qëndrimin tuaj.

► **Fig. 63. Pikturë nga Guri Madhi, ku paraqitet sulmi partizan ndaj trupave gjermane**



Epopeja e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, 1939-1944.

► **Fig. 64. Pikturë e Fatmir Haxhiut, e cila paraqet një episod beteje gjatë Luftës së Dytë Botërore**



Epopeja e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, 1939-1944.

? A ju duken realiste këto dy piktura? Shpjegoni përse.

VI-9. Teksti i mëposhtëm është shkëputur nga libri *Delirul* i Marin Predas, botuar në vitin 1975. Autori përshkruan një ngjarje nga këndvështrimi i një ushtari. Në të mund të vihet re rrëfimi me nota realiste, ku idealizmi përballet me realitetin tragjik të luftës.

Në orën katër, e udhëhequr nga komandanti i saj, kompania nisi sulmin. Stefani u bashkua me kompaninë. Ai kishte qenë duke pikturuar. “O Zot, - mendoj papritur, - tani mund të vdes;” dhe kjo gjë e çuditi dhe e trembi, ngaqë i erdhi menjëherë dhe pa e menduar më parë. Si është të vdesësh, të mos jesh më? Dhe pa e patur mendjen, dhe pa e kuptuar pa se si përpara tij, aty-këtu ushtarët binin një nga një, disa menjëherë dhe disa duke u hedhur në tokë, duke kërkuar më kot të gjenin mbrojtje në atë fushë të zhveshur. Instiktivisht u hodh edhe ai në tokë, dhe vetëm atëherë kuptoi se përballë tyre dikush kishte hapur zjarr të pandërprerë dhe shfarosës. Edhe kapiteni ishte shtrirë pak hapa larg tij. Krismat pushuan.

“Sulm!” - dëgjoi të thërriste Stefani kapitenin. “Hidhuni përpara!”

Dhe ai vetë u hodh i pari në sulm, duke vrapuar përpara. Luftëtarët e shpërndarë të kompanisë rifilluan menjëherë sulmin, por papritur mitralozët e armikut nisën të qëllonin me breshëri gjithandej, kështu që ushtarët u shtrinë përsëri në tokë.

“Përpara!” - thirri komandanti pasi pushuan krismat. Por këtë herë urdhri nuk u zbatua. Duke turfulluar nga inati, komandanti filloi përsëri të mallkonte dhe të kërcënonte. Më kot... Komandanti thirri përsëri: “Kompania, në sulm!”

Dhe u ngrit, dhe filloi të vraponte që ushtarët ta ndiqnin pas. Ata e ndoqën, por u gjendën edhe një herë tjetër nën breshërinë e mitralozëve armikë, dhe komandanti mori disa plumba në bark. Të shtrirë përdhe, ushtarët e dëgjonin se si përpëllitej për vdekje dhe shante ata që mbanin barrelën që s’vinin ta merrnin. Ngadalë, duke u zvarritur, ushtarët filluan të tërhiqen dhe lanë pas në fushë, të vvarë e të plagosur, gjysmën e kompanisë. Ata që mbanin të


plagosurit, ishin në krye të detyrës, por nuk mund të merrnin të plagosurit përtej vijës së frontit, sepse kishte shumë të tillë.

Preda, f. 394.




A jep ky rrëfim një imazh heroik të luftës? Përse ushtarët nuk iu bindën urdhrit? A i bën kjo ata tradhtarë? A mund ta kontrollojë dikush veten në një situatë të tillë? Komentoni se si këndvështrimi i autorit është i ngjashëm me atë të luftëtarëve. Si referencë, përdorni dëshmitë e Neagu Djuvaras dhe Viktor Budeskut.

► **Fig. 65. Një pjesë e pllakatit komik *Ekspresi ballkanas*, nga Branislav Keraci dhe Branko Plavshiçi, bazuar në skenarin e Gordan Mihiçiçit**



“Stripoteka”.

 Ky pllakat u paraqit si një përmbledhje e filmave që ishin shumë të njohur në vitet 80-të, të cilët përdorën humorin e zi për të përshkruar përvojat e luftës të një grupi të parëndësishëm hajdutësh. Duke u përpjekuar të mbijetojnë, u bënë pjesëmarrës “të veçantë” të lëvizjes së rezistencës, kundër dëshirës së tyre. Kjo qasje humoristike ndaj zhanrit partizan sipas filmave amerikanë “Uestern”, që u përvijua në vijimësi nga kinematografia jugosllave për gati katër dhjetëvjeçarë, ishte një risi. Kjo mund të konsiderohet edhe si pjesë e një përpjekjeje të përgjithshme për të rivlerësuar subjektin e historisë zyrtare të Luftës së Dytë Botërore, të pastruar ideologjikisht dhe politikisht; por për të rivlerësuar, gjithashtu, edhe interpretimin artistik në këtë zhanër kinematografik i cili, gjithsesi, u konsumua duke u përdorur shumë.

VI-10. Atmosfera në burgun e Kolashinit

Portat u hapën dhe pas tyre u shfaq një grup rojash të fuqishëm. Një varg i gjatë të burgosurish të lidhur dy e nga dy, i shoqëruar prej britmave të fëmijëve dhe ofshamave të grave, përshëndesnin me zë të lartë ata që po linin pas, ndërkohë që kalonin portën dhe filluan të hipnin në kamionë. Hapat dhe lëvizjet e tyre oshëtinin dhe herë pas here dëgjohej ndonjë fjalë nga ato që flisnin. E gjithë kjo gumëzhitje mbytej prej zhurmës së makinave, deri sa më në fund u dëgjua zëri i një gruaje që këndonte në kamionin e parë:

Shpirti po më qan, zemra po më dridhet,
lamtumirë shokë të dashur, lamtumirë...

Kukoviçi vrapoi jashtë furishëm, sikur ta kishin përvëlur me diçka të nxehtë dhe nisi të thërrasë me të madhe diçka që nuk kuptohej, por dukej sikur donte që diçka të ndalonte. Jovan Markoviçi filloi të ulërasë si një ari i plagosur, dhe kur pushonte, mund të dëgjoje edhe Rajaceviçin të bënte si qen dhe Risto Obradoviçin të ulërinte si ujk. Kënga e grave dëgjohej pak, dhe u duk sikur u shua, por nga kamioni i dytë u dëgjua zërat e fortë, kumbues, dhe të lartë të burrave:


Lamtumirë kodra e lugina,
lamtumirë Kolashin i përgjakur...

Porsi zjarr, kënga u përhap te të gjithë. U krijua një kaos i plotë, dhe rojat qëlluan dhjetë a më shumë herë mbi kokat e atyre që këndonin. Në këtë kohë u dëgjuan britmat e Kukoviçit: “Mos qëlloni, të poshtër! Mos qëlloni, ju qelbësira!” dhe zhurmat u pakësuan dhe kënga u përhap si zjarri që përfshin gjithçka:

O Polimlje, qyteti im i vegjëlisë,
të kam gjithmonë në mendje...

Tashmë po këndonin burra dhe gra, si ata që nuk kishin hipur ende nëpër kamionë, edhe ata që qëndronin në këmbë në fushë. Edhe ata që nuk po largoheshin, ata që po prisnin orët e tyre të fundit, këndonin gjithashtu. Edhe shef Ançiçi, që ishte përzënë prej grupit të parë dhe që nuk u fut as në grupin e dytë, u përpoq të këndonte me ta, ashtu shtrënguar në radhën e fundit, i kërrusur, i zbehtë, me rroba të leckosura, pa rrip, të cilin të burgosurit, me përbuzje, e quanin “kapistër”, pa grada ose stema mbi xhaketën e tij.

Lalić, f.167-168.

 Mihailo Lalić (1914-1992) është një ndër shkrimtarët e shquar malazezë. Veprat e tij i kushtohen kryesisht luftës nacional çlirimtare në Malin e Zi. Romanet e tij më të rëndësishëm janë: *Mali rënkues*, *Dasma*, *Fati i luftës* etj. Ai qe shkrimtari i parë që fitoi çmimin *Njegosh*, në vitin 1963. Ai fitoi gjithashtu çmimin *NiN* për letërsinë, në vitin 1973 dhe çmimin e *21 Korrikut*, çmimi më i lartë që është dhënë nga Bashkia e Beranesë.

VI-11. Pjesë nga romani *Duhani i Dimitar Dimovit*

Varvara nuk dukej edhe aq keq – të paktën jo aq keq sa pritej në ato kushte të vështira, ku nuk mund të plotësoje as nevojat më elementare për të rregulluar paraqitjen tënde. Por ajo vetë mendonte se dukej keq.

- “Dukem si shtrigë”, - mendoi ajo e trishtuar dhe i ra ndërmend se krehëri i kishte humbur në betejën e fundit...

Të ka humbur durimi, je plotësisht e dërrmuar nga kjo mëdyshje midis jetës dhe vdekjes. Kjo lloj jete të ka shkatërruar, të ka bërë të jesh në humor të keq, të

humbësh tiparet si femër, tani që fitorja po afron, kur duhet të jesh e freskët dhe tërheqëse, kur të mungon pak dashuri. Ke sakrifikuar gjithçka për partinë, por ke humbur gëzimin e jetës. Jeta partizane i vë njeriut kufizime të paimagjinueshme dhe kërkon vetëmohimin e tij. Mund t'ia dalësh mbanë, por vetëm me mendje. Ky është shkaku i konfliktit brenda teje, i nervozizmit tënd, i pamundësisë të pranosh dualizmin që ekziston tek gjërat dhe njerëzit, që bën të mundur zhvillimin e tyre...

(...) "Ç'do të bësh kur të marrim pushtetin?" "Atë që do të më urdhërojë partia të bëj."

Unë për vete do të vishem mirë... Gjëja e parë që do të bëj, është të lahem dhe të vishem mirë... Që të mos dukem si plakaruqe! (...) Komunistët duhet ta duan jetën (...) Jetën mund ta duash, kur për njerëzit dukesh e bukur, e rregullt dhe e pastër...

(...) Tani ajo (Irina) donte të qëndronte në qetësinë e pishave të Çamkoria, nën qiellin e mbushur me yje dhe të priste pa lëvizur atë që do të ndodhte. Sepse çfarëdo që të ndodhte, ajo ishte e paprekshme. Shkatërrimi i botës së vjetër nuk ndikonte tek ajo, dhe bota e re nuk e trembte. Ajo kishte investime jashtë shtetit, të cilat askush nuk mund t'ia prekte, dhe atë natë ishte e bindur se komunistët nuk hakmerreshin me gratë. Prapëseprapë, ishte e ndërjegjshme se kishte diçka tjetër së cilës nuk mund t'i shpëtonte, diçka më të tmerrshme sesa t'i merrnin pasurinë ose më të tmerrshme se hakmarrja e të uriturve. Dhe ky ishte shkatërrimi i saj i brendshëm. Ishte hiri që kishte mbetur prej gjithçkaje kishte kaluar deri tani, dhe nga ajo natë e tmerrshme, e cila i kishte lënë, tashmë, një plogështi të zymtë...

(...) Kjo ishte e vërteta! (...) Mendja realiste e qetë dhe e fortë e Irinës nuk kishte frikë ta pranonte, prandaj menjëherë nuk u zemërua, as nuk u frikësua. Ndërkohë që qindra gra të llastuara qanë si fëmijë dhe u ra të fikët, sepse mbi qilimat e tyre shkelën çizme ushtarake me baltë, ose sepse shtëpitë e tyre të mëdha u mbushën me të pastrehë. Ato nuk mund ta kuptonin se kjo ishte rrjedha e pakthyeshme

e jetës, dhe se ajo përbëhej nga ngjarje të cilat vareshin nga njëra-tjetra dhe që ekzistenca parazitare e njërës, në mënyrë të pashmangshme shkaktonte zemërimin e tjetrës...

Dimov, f. 564-569, 628, 667.



Dimitar Dimovi (1909-1966) – ka qenë shkrimtar dhe skenarist i njohur bullgar, i diplomuar si veteriner. Ai ka bërë mbi 40 punime shkencore. Romani i tij më i njohur është *Duhani*, i shkruar në vitin 1951. Me kërkesë të udhëheqësve të Partisë Komuniste Bullgare, ky roman u rishikua dhe iu shtuan më shumë personazhe nga lëvizja e rezistencës. Me gjithë ndërhyrjen jo letrare, *Duhani* u bë një nga librat më të parapëlqyer në Bullgari për breza të tërë. Fragmentet e mësipërme paraqesin gjendjen psikologjike të dy grave krejtësisht të ndryshme – partizanes Varvara dhe një gruaje të shtresës së lartë, Irinës – në fund të Luftës së Dytë Botërore.



Si i shikonin ndryshimet e afërta në jetën e tyre këto dy gra? Çfarë presin ato nga këto ndryshime? Ku ngjasojnë me njëra-tjetrën këto dy gra?

VI-12. Një qipriot turk, Qemal Rexhep Susuzlui, rrëfen ditët e burgut që i kaloi me një udhëheqës qipriot grek, Glafkos Kleridesin⁸⁰

Kur mbërritëm atje, në shkurt të vitit 1942, mbi bluzat tona në shpinë dhe mbi gjunjët e pantallonave, na ishte vulosur një trekëndësh i kuq. Kjo masë merrej për të dalluar lehtë të burgosurit që mund të arratiseshin nga kampi. Kryqi i Kuq shpërndau formularë, me anë të të cilëve mund të njoftonim familjarët se ishim akoma gjallë. Kush mund ta besonte këtë? Kampi ishte ndarë në disa katrorë të

⁸⁰ Ata së bashku u dërguan nga kampi POW në Selanik, në Stalag (kamp të burgosurish gjermanë për oficerët e rangjeve të ulëta). Ky përshkrim i Susuzluit mbi përvojën e tij në Stalag është dhënë për gazetën "Yeni Demokrat", në vitin 1993.

rrethuar me tela me gjemba. Në ndërtesën përballë tonës mbaheshin pjesëtarë të forcave ajrore. Kishim marrëdhënie shumë të mira me ta, edhe pse na ndante teli me gjemba. Ndër ta ishte edhe piloti i forcave ajrore, Glafkos Klerides. Ai na bënte shenjë se donte të kalonte në zonën tonë, dhe kërkonte disa rroba si tonat që të mos dallohej. Ai çau përmes telit me gjemba dhe kaloi në anën tonë. Sapo erdhi, filloi të krijonte një organizatë, në mënyrë që të zgjidhte problemet e qipriotëve. U bënë zgjedhje, dhe u zgjodh kryetar. Glafkos Kleridesi ishte përgjegjës për të gjithë qipriotët, kurse unë isha përgjegjës për të gjithë të sëmurët”

Ulus Irkad, f. 15-16.

► **Fig. 66. Skenë nga filmi shqiptar *Kur zbardhi një ditë***



Hoxha, f. 160-1

🔑 Kjo foto është marrë nga një skenë e filmit *Kur zbardhi një ditë*, me temë nga Lufta e Dytë Botërore (Tiranë, 1971). Në të paraqitet një luftim midis partizanëve dhe ushtarëve gjermanë. Është interesante të vihet re se në pothuajse të gjithë filmat mbi Luftën e Dytë Botërore, trupat gjermane janë më të shumta se partizanët, por në fund janë partizanët ata që fitojnë betejën. Kjo foto e ilustron shumë mirë këtë ide.

? Krahasoni këtë foto me tekstin VI-7.

VI-13. “VËLLAI IM RAMIZ”, poezi kushtuar Ramiz Sadikut dhe Boro Bukmiroviçit

RAMIZ O VËLLA

Landovicë, a i pe dy trima?
Landovicë, a të rroku shungullima?
A pe oj, ne pritë?
Në luftën që se ndanë,
Nën plumbat e tradhtarit
Boro e Ramizi kur ranë?
Landovicë, a ndjeve oj?
Dy trima dy heroj?!
Bac o vëlla Ramiz!
O shok, e krah o pris!
Me ty o, flamurtar
Nën yllin çlirimtar,
U ngrit i ulti rob
Punëtor e katundar!
Me ty lulëzoi vëllaznimi,
Dora dorës iu shtri...
Me ty-dita agoi
Mbi gjak e tirani...
Prisi-i shkelun me shekuj
Me ty nga balta u ngrit!
Dhe robi-i krrusun në shekuj
E pa të bardhën dritë!
Bac, o vëlla Ramiz!
O shok, e krah o pris!
Me ty o proletar,
nën yllin çlirimtar,
u zgjue i ulti rob
puntor e katundar!

🔑 Kjo poezi u shkrua nga Esat Merkuli, dhe i kushtohet dy herojve të popullit nga Peja, shqiptarit Ramiz Sadiku dhe malazezit Boris Bukmiroviç, të dy të vvarë nga fashistët italianë në Landovicë të Prizrenit në vitin 1943. Një e veçantë e këtyre dy personalitetëve është se kur fashistët ofruan lirim të Ramiz Sadikut, ky i fundit refuzoi të largohet pa shokun Boris Bukmiroviç, dhe të dy u ekzekutuan nga fashistët. Këta dy heronj, për një kohë të gjatë kanë qenë frymëzim në krijimin e besimit dhe tolerancës mes dy popujve në Kosovë.

**Pyetje të përgjithshme mbi kapitullin VI**

Bëni një intervistë me gjyshen/gjyshin tuaj – mbani shënim kujtimet e saj/tij mbi Luftën. Analizoni pamjet: Ç’pasqyrojnë ato? Interpretoni fotot dhe shkruani një ese të shkurtër. A përkshkruan ndonjëri nga autorët një çast të lumtur nga jeta e tij gjatë Luftës?

Ditët e festave kombëtare që lidhen me Luftën e Dytë Botërore

<i>Shteti</i>	<i>Data</i>	<i>Festa</i>	<i>Përshkrimi</i>
Shqipëria	29 Nëntor	Dita e Çlirimit	Çlirimi i vendit në vitin 1944
Bosnjë dhe Hercegovina	25 Nëntor	Dita Kombëtare	Mbledhja e parë e ZAVNOBIH- ut (Parlamenti partizan, 1943)
Bullgaria	-	-	-
Kroacia	22 Qershor	Dita e Luftës Antifashiste	Fillimi i Luftës (1941)
Komuniteti qipriot grek	28 Tetor	Dita ‘Jo’	Greqia nuk pranon ultimatumin e Italisë (1940)
Maqedonia	11 Tetor	Dita e Rezistencës	Fillimi i rezistencës (1941)
Greqia	28 Tetor	Dita ‘Jo’	Greqia nuk pranon ultimatumin e Italisë (1940)
Rumania	-	-	-
Sllovenia	27 Prill	Dita e Rezistencës	Krijimi i Frontit Çlirimtar (1941)
Serbia dhe Mali i Zi	-	-	-
Turqia	-	-	-



Bibliografia

- Ayhan Aktar, *Varlık Vergisi ve Türkleştirme Politikaları* [Taksa e kapitalit dhe politikat e turqizi-mit], Stamboll, 2000.
- Ta aetopoula. *Anagnostiko tritis kai tetartis taxis* [Shqiponjat e vogla. Libër leximi për klasat e treta dhe të katërta], 1944, Redaktuar nga 'Eleftheris Elladas', Ribotim.
- Nisim Albahari et al. (red.), *Sarajevo u revoluciji* [Sarajeva në revolucion], Sarajevë, 1979.
- Julian Amery, *Sons of the Eagle: A Study in Guerrilla War*, [Bijtë e shqipës: Studim i luftës guerrile], Londër, 1984.
- *Bashkimi*, qershor 1944.
- *Bleiburg*, grup autorësh, redaktor Marko Grčić. Zagreb, 1990.
- Branislav Božović, *Beograd pod komesarskom upravom 1941* [Beogradi nën administrimin e Këshillit të Komisarëve, 1941]. Beograd, 1998.
- Branislav Božović, *Poruke streljanog grada* [Mesazhet e qytetit të vrarë]. Beograd, 1961.
- Don Pietro Brignoli, *Sveta maša za moje ustreljene* [Meshë e shenjtë për njerëzit e mi të pushkatuar]. Gorica, 1995.
- България - своенравният съюзник на Третия райх [Bullgaria – Aleatja e pakontrollueshme e Rajhut të Tretë], Sofje, 1992.
- Хрестоматия по история на България 1944-1948 [Krestomaci e historisë së Bullgarisë 1944-1948], Sofje, 1992.
- Nicholas J. Costa, *Shattered Illusions, Albania, Greece and Yugoslavia* [Iluzione të copëtura: Shqipëria, Greqia dhe Jugosllavia], New York, 1998.
- Ivan Cvitković, *Ko je bio Alojzije Stepinac* [Kush ishte Alojzije Stepinac], Sarajevë, 1986.
- Dobrica Ćosić, *Daleko je sunce* [Larg është dielli], Beograd, 1963.
- Vladimir Dedijer, *Novi prilozi za biografiju Josipa Broza Tita I-II* [Të reja të tjera për biografinë e Josif Broz Titos I-II]. Rijeka-Zagreb, 1981.
- *Deportarea etnicilor germani din România în Uniunea Sovietică (1945)*, [Internimi i rumunëve me etni gjermane në Bashkimin Sovjetik (1945)], red. Hannelore Baier, Brashov, 1994.
- Dimitar Dimov, *Тютюн* [Duhani], Sofje 2000. Dobri and Elena Djurov, *Мургаш. Мемоару*, [Mourgash. Kujtime], Sofje, 1983.
- *Dokumenti za borbata na makedonskiot narod za samostojnost i nacionalna država, tom втори*, [Dokumente mbi luftën e popullit maqedonas për liri dhe shtet kombëtar, II] Shkup, 1981.
- Dragojlo Dudić, *Dnevnik 1941* [Ditar 1941], Beograd, 1957.
- Polychronis K. Enepekidis, *To Olokaftoma ton Evraion tis Ellados 1941-1944* [Holokausti i hebrenjve të Greqisë, 1941-1944], Athinë, 1996.
- Feridun Cemal Erkin, *Dışişlerinde 34 yıl Anılar-Yorumlar* [34 vjet në politikën e jashtme, Kujtime-Komente]. Ankara, 1980.
- *Evreii din România între anii 1940-1944, vol. I: Legislație antievreiască* [Hebrenjtë e Rumanisë në vitet 1940-1944, vëll. I.: Legjislacioni antisemit], red. Lya Benjamin, Bukuresht, 1993.
- *Evreii din România între anii 1940-1944, vol. II* [Hebrenjtë e Rumanisë në vitet 1940-1944, vëll. II], red. Lya Benjamin. Bukuresht, Edit. Hasefer, 1996, dok. 44.; dok. 98.
- Tone Ferenc, *Okupacijski sistemi na Slovenskem* [Sistemet pushtuese në territoret sllovene]. Lubjanë, 1997.
- Hagen Fleischer, *Stemma kai svastika. I Ellada tis Katochis kai tis Antistasis 1941-1944, vol. II* [Kurora dhe kryqi i thyer. Greqia e pushtuar dhe rezistenca, 1941-1944, vëll. II]. Athinë, 1995.

- Giomtov Giakoel, *Apomnimevmata 1941-1943* [*Kujtime 1941-1943*], Selanik, 1993.
- Ivo Goldstein, *Holokaust u Zagrebu* [*Holokausti në Zagreb*], Zagreb, 2001.
- *Hitlers Weisungen für die Kriegsführung 1939-1945*, (red. W. Hubatsch).
- Josip Horvat, *Preživjeti u Zagrebu. Dnevnik 1943-1945* [*Mbijetesa në Zagreb. Ditar 1943-1945*], Zagreb, 1989.
- Josip Horvat, *Hrvatski mikrokozam između dva rata (1919-1941)* [*Mikrokozmosi kroat ndërmjet dy luftërave (1919-1941)*]; u *Rad Jugoslavenske akademije znanosti i umjetnosti* [*Në punimin e Akademisë së Arteve dhe Shkencave Jugosllave*]. Zagreb, 1983.
- *Hylli i dritës*, "Misioni Katolik Oriental në Lushnje", dhjetor 1940, 601.
- Demir D. Hysolli, *Life or Death for Freedom*, [*Liri a vdekje*], USA, 1995.
- John Iatridis (red.), *I Ellada sti dekaetia 1940-1950. Ena ethnos se krisi* [*Greqia gjatë dekadës 1940-1950. Një komb në krizë*], Athinë, 1984.
- "Illegalčki Borec" [*Luftëtari ilegal*], Lubjanë, 2003.
- *Istoria tou Ellinikou Ethnous* [*Historia e kombit grek*], vëll. XVI. Athinë, Ekdotiki Athinon, 2000.
- *Izvori za Osloboditelnata vojna i Revolucija vo Makedonija, 1941-1945* [*Burime mbi luftën çlirimtare dhe revolucionin në Maqedoni, 1941-1945*]. Vëllimi I, libri III. Shkup, 1970.
- Ulus Irkad, *Cypriots Together in the Second World War* [*Qipriotët të bashkuar në Luftën e Dytë Botërore*], përkthyer nga Metin Kemal, "Raporti i miqve të Qipros", Nr. 46, vjeshtë 2003.
- Ilija Jakovljević, *Konclogor na Savi* [*Kampi i përqëndrimin në lumin Sava*], Zagreb, 1999.
- Fikreta Jelić-Butić, *Četnici u Hrvatskoj 1941-1945* [*Çetnikët në Kroaci 1941-1945*], Zagreb, 1986.
- Konstantin Katsarov, *60 години живяна история* [*60 vite histori e jetuar*], Sofje, 1993.
- Danail Krapčev, *Избрани статии*, [*Artikuj të zgjedhur*]. Sofje, 1992.
- Jure Krišto, *Sukob simbola, politika, vjere i ideologije u Nezavisnoj Državi Hrvatskoj* [*Konflikt simbolesh, politikash, besimi dhe ideologjish në Shtetin e Pavarur Kroaf*]. Zagreb, 2001.
- Bogdan Krizman, *Pavelić i ustaše* [*Paveliçi dhe ustashët*], Zagreb, 1978.
- Fitzroy MacLean, *Rat na Balkanu* [*Lufta në Ballkan*], Zagreb, 1964.
- "Magazin istoric" ["Revista historike"], Bukuresht, tetor 2002.
- Agnes Jensen Mangerich, *Albanian Escape: The true story of U.S. army nurses behind enemy lines* [*Arratisje nga Shqipëria: Historia e vërtetë e infermiereve amerikane pas vijës së frontit armik*]. The University Press of Kentucky, 1999.
- Georgi Manov, *Черната скала*, [*Shkëmbi i zi*], Sofje, 1997.
- Anđelka Martić, *Vuk na Voćinskoj cesti* [*Ujku në rrugën Voćin*], Zagreb, 1971.
- Mark Mazower, *Stin Ellada tou Hitler. I empeiria tis Katochis* [*Në Greqinë e Hitlerit. Përvoja e pushtimit*], Athinë, 1995.
- *Memoari patrijarha srpskog Gavrila* [*Kujtimet e patriarkut serb Gavriilo*], Beograd, 1990.
- *Minoritati etnoculturale. Marturii documentare. Tigani din Romania (1919-1944)* [*Minoritetet etnokulturore: romët e Rumanisë (1919-1944)*]. Dëshmi dokumentare, red. L. Nastasa, A. Varga, C. A. Andreescu, Kluzh Napoka, 2001, dok. 339.
- Bogdan Murgescu et al., *Istoria României în texte* [*Historia e Rumanisë në burimet e shkruara*]. Bukuresht, 2001.

- E.C.W. Myers, *Greek Entanglement* [Ngatërresa greke], Londër, 1985 (botimi i parë: 1955).
- Arkivat Kombëtarë Brashov, Bashkia e Qytetit Bod, dosja 76/1944, f. 83.
- Kosta Nikolić, *Strah i nada u Srbiji 1941-1944: Svakodnevní život pod okupacijom* [Frikë dhe shpresë në Serbi, 1941-1944: Jeta e përditshme gjatë pushtimit], Beograd, 2002.
- "Novo vreme" [Koha e re], 25 shtator 1942.
- James O'Donnel, *A coming of age: Albania under Enver Hoxha* [Ardhja e një epoke: Shqipëria nën Enver Hoxhën], New York, 1999.
- Faik Okte, *The tragedy of the Turkish Capital Tax* [Tragjedia e taksës së kapitalit turk], Croom Helm Limited 1987.
- Branko Petranović, Momčilo Zečević, *Jugoslavija 1918-1988, tematska zbirka dokumenta* [Jugosllavia 1918-1988, Përmbledhje tematike burimesh], Beograd, 1988.
- Stoyan Petrov-Çomakov, *Духът на дипломацията*, [Shpirti i diplomacisë], Sofje, 2002.
- "Politika", 28 mars 1941.
- Ivor Porter, *Operaçijunea Autonomus* [Operacioni i pavarur], Bukuresht, 1991.
- John Ivan Prcela, Dražen Živić, *Hrvatski holokaust* [Holokausti kroaf], Zagreb 2001. Marin Preda, *Delirul* [Çmenduria], Kraiova 1975. Enver Redžić, *Muslimansko autonomaštvo i 13. SS divizija* [Lëvizja myslimane për autonomi dhe divizioni i 13-të eses (SS)], Sarajevë, 1987.
- Božo Repe, *Sodobna zgodovina. Zgodovina za 4. letnik gimnazij* [Historia bashkëkohore. Historia e klasës së katërt e shkollave fillore], Lubjanë, 2002.
- Božo Repe, *intervistë me Cveto Kobal* (video), Memorial Center Mauthausen.
- Božo Repe, *Naša doba* [Koha jonë], Lubjanë, 1996.
- Milan Ristović (red.), *Report of the chef rabbi of Yugoslavia, Dr. Isak Alkalaj, on the events in Yugoslavia between end March and end June 1941: "Naši doživljaji i utisci o poslednjim događajima u Jugoslaviji"* [Raport i kreut të rabinëve në Jugosllavi, dr. Isak Alkalaj, mbi ngjarjet në Jugosllavi midis fundmarsit dhe fundqershorit 1941: Përvojat dhe përshtypjet tona mbi ngjarjet e fundit në Jugosllavi], "Tokovi istorije", 1-2/1997, f. 181-182.
- Constantin Sănătescu, *Jurnal* [Ditar]. Bukuresht, 1993.
- Emil Sattolo, *Tragom istine* [Duke kërkuar të vërtetën], Nova Gradishka, 2002.
- Ioan Scurtu et al., *Istora României între 1918-1944* (culegere) [Historia e Rumanisë ndërmjet viteve 1918-1944 (përmbledhje tekstesh)], Bukuresht, 1982.
- Stanford J. Shaw, *Turkey and the Holocaust* [Turqia dhe holokausti], Londër, 1993.
- David Smiley, *Albanian Assignment* [Me detyrë në Shqipëri], Londër 1984. "Srpski narod" [Populli serb], 3 qershor 1942. Ivan Stančov, *Дипломат и градинар*, [Një diplomat dhe një kopshtar], Sofje, 2000.
- Ivan Šibl, *Sjećanja 1-3* [Kujtime 1-3], Zagreb, 1986.
- Rastislav Terzioski, *Denacionalizatorskata dejnost na bugarskite kulturnoprosvetni institucii vo Makedonija* [Veprimtaria shkombëtarizuese e institucioneve arsimore e kulturore bullgare në Maqedoni], Shkup, 1974, sipas: Arkivit Historik të KPJ, vëllimi VII, Beograd, 1951.
- *Борбата на българския народ в защита и за спасяване на българските евреи по време на Втората световна война*, [Lufta e popullit bullgar për mbrojtjen dhe shpëtimin e hebrenjve në Bullgari gjatë Luftës së Dytë Botërore], Sofje, 1978.
- *Оцеляването. Сборник документи 1940-1944*, [Mbijetesa. Përmbledhje me dokumente 1940-1944], Sofje, 1995.
- Tito-Churçill: *Strogo tajno* [Tito-Çurçill: Tepër konfidenciale], përgatitur nga B. Biber, Zagreb, Lubjanë, 1981.
- "Tomori", 6 gusht 1940, 2; 11 gusht 1940, 2.

- Stajko Trifonov, *Българският национален въпрос 1919-1944 в: Нови студии по българска история 1918-1948*, [Problemi kombëtar bullgar (1919-1944), në Esetë e reja mbi historinë bullgare 1918-1948], Sofje, 1992.
- "Universul", 79/2 03. 1942, p. 4; 5/01. 1942, p. 1; 291/28. 10. 1944; 44/15. 02. 1942; 318/26. 11. 1944.
- Riki Van Bouschoten, *Anapoda chronia. Syllogiki mnimi kai istoria sto Ziaka Grevenon (1900-1950)* [Vite të vështira. Kujtesa kolektive dhe historia në Ziaka Grevenon (1900-1950)]. Athinë, 1997.
- Ivan Venedikov, *По делата им ще ги познаете*, [Ju do t'i njihni nga bëmat e tyre], Sofje, 1993.
- Aleksandar Vojinović, *Ante Pavelić*, Zagreb, 1988.
- Evelyn Waugh, *The End of the Battle (the "Sword of Honour" trilogy)* [Fundit i betejës (Trilogjia "Shpata e nderit")], Boston/NewYork/London, 2000.
- Ahmed Emin Yalman, *Yakın Tarihte Gördüklerimiz ve Geçirdiklerimiz vol 3 (1922-1944)* [Gjëra të para dhe të jetuara në në shkuarën e afërt vëll. 3 (1922-1944)], Stamboll, 1970.
- Zbornik dokumenata i podataka o NOR naroda Jugoslavije, tom XIV, knjiga 1. Dokumenti çetnikog pokreta Draže Mihailovića 1941-1942 [Përmbledhje dokumentesh dhe faktesh mbi luftën e Lëvizjes Nacionalçlirimtare Jugosllave. Dokumente mbi lëvizjen e çetnikëve të Drazha Mihajloviçit, libri nr. 1], Beograd, 1981, dok. nr. 34.
- Žarko Zgonjanin, et al. (ed.), *Kozara u Narodnooslobodilačkom ratu. Zapisi i sjećanja. Knjiga šesta*. [Kozara në Luftën Nacionalçlirimtare. Tekste dhe kujtime. Vëllimi VI], Beograd, 1978.
- Zloçini fašističkih okupatora i njihovih pomagača protiv Jevreja u Jugoslaviji [Krimet e pushtuesve fashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre ndaj hebrenjve në Jugosllavi], Beograd, 1952.
- Dencho Znepolski, *Посмъртна изповед*, [Rrëfim pas vdekjes], Sofje, 1998.
- *Ženite od Makedonija vo Narodnooslobiditelnata vojna* [Gratë e Maqedonisë në Luftën Nacionalçlirimtare], Shkup, 1976.
- Vladimir Žerjavić, *Opsesije i megalomanije okoJasenovca i Bleiburga* [Obsesion dhe megalomani mbi Jasenovacin dhe Bleiburgun], Zagreb, 1992.
- D. Živojinović, D. Lučić, *Varvastvo u ime Hristovo. Prilozi za Magnum crimen* [Barbarizmi në emër të Krishtit, Kontribut në Magnum Crimen], Nova knjiga. Beograd, 1988.
- Lakić Zoran, *Narodna vlast u Crnoj Gori 1941-1945 (Pusheteti popullor në Malin e Zi 1941-1945)*, Cetinë-Beograd, 1981.
- Lalić Mihailo, *Svadba (Dasma)*, Podgoricë, 1966.
- Luburić Radoica, *Društvo Crne Gore u Drugom svjetskom ratu (Shoqëria e Malit të Zi gjatë Luftës së Dytël Botërore)*, Podgoricë, 1995.
- Pajović Radoje, *Kontrarevolucija u Crnoj Gori 1941-1945, çetnički i federalistički pokret (Kundërrevolucionari në Malin e Zi 1941-1945, lëvizjet çetnike dhe federaliste)*, Cetinë, 1977.
- Selhanović Jadranka, *Podgorica-život iznova (Podgorica – Të rinisësh jetën)*, Podgoricë, 2009.
- Stanišić Milija, *Dubinski slojevi Trinaestojulskog ustanka u Crnoj Gori (Aspekte të veçanta të kryengritjes së 13 korrikut në Malin e Zi)*, Podgoricë, 2005.
- Stanišić Slavko, *Stvaranje Crnogorske narodne omladine*, „Istorijski zapisi”, br. 2, (Themelimi i Rinisë Popullore Malazeze, "Të dhëna historike", Nr 2), Titograd, 1968.
- Zbornik dokumenta NOR, tom III, knj. 4. (Përmbledhje me dokumente nga Lufta Nacional Çlirimtare, Volumi III, Libri 4), Beograd, 1953.
- Hermann Neubacher, *Sonderauftrag Südost 1940-1945. Bericht eines fliegenden Diplomaten*, Musterschmidt, Göttingen second, revised edition, 1957.

Bibliografia e figurave

- "Akbaba", 24 gusht 1939.
- Arkivat e Qytetit të Beogradit

- Beograd, Narodna biblioteka Srbije, Zbirka plakata (Biblioteka Kombëtare e Serbisë, Beograd, Koleksioni i pllakateve).
- Rifat Bali, *Musa'nin Evlatlari, Cumhuriyet'in Yurttaşları [Bijtë e Moisiut, qytetarë të Republikës]*, Stamboll, 2003.
- Muzeu i Historisë në Kroaci
- *Cumhuriyet Ansiklopedisi [Enciklopedia e republikës]* vëll. II (1941-1960), Stamboll, 2002.
- Vladimir Dedijer, *Dnevnik, 1941-1942 [Ditar, 1941-1944]*, botimi i 2-të, Beograd, 1951.
- Epopeja e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, 1939-1944, Tiranë, 1980.
- Hagen Fleischer, *Stemma kai svastika. I Ellada tis Katochis kai tis Antistasis 1941-1944, vol. 2 [Kurora dhe kryqi i thyer. Greqia e pushtuar dhe rezistenca, 1941-1944, vëll. II]*, Athinë, 1995.
- Galeria e Arkivit të Shtetit, Zagreb.
- Abaz Hoxha, *Filmi artistik shqiptar 1957-1984*, Tiranë, 1987.
- *Istoriki kai Ethnologiki Etaireia tis Ellados (IEEE), To epos tou '40. Laiki eikonographia [Epika e viteve 40-të. Ikonografia popullore]*, Athinë, 1987.
- Istorijski Arhiv Beograda, Zbirka fotografija [Arkivi Historik i Beogradit, Koleksioni i fotografive].
- Istorijski Arhiv Beograda, Uprava Grada Beograda [Arkivi Historik i Beogradit, Administrata e qytetit të Beogradit]. SP III-48, k 157/15, 25 shtator 1941.
- *Jugoslovenska grafika 1900-1950. Katalog izložbe*, Beograd, decembar 1977-februar 1978 [Grafika jugosllave 1900-1950. Katalog ekspozite, dhjetor 1977 – shkurt 1978], Beograd, 1977.
- Jugoslovenska Kinoteka, Belgrade [Biblioteka e Filmit Jugosllav].
- "Karikatur", 24 shtator 1942.
- Jure Krišto, *Sukob simbola, politika, vjere i ideologije u Nezavisnoj Državi Hrvatskoj [Konflikt simbolesh, politikash, besimesh dhe ideologjish në Shtetin e Pavarur Kroaf]*, Zagreb, 2001.
- Nataša Mataušić, *Jasenovac 1941-1945*, Zagreb, 2003.
- Slobodan D. Milošević, *Izbeglice i preseljenici na teritoriji okupirane Jugoslavije 1941-1945 [Refugjatët dhe të shpërngulurit në territorin e Jugosllavisë së pushtuar 1941-1945]*, Beograd.
- Muzeu i Qytetit të Zagrebit.
- Muzeu Historik Kombëtar i Athinës.
- Biblioteka Kombëtare Serbe, Beograd.
- Kosta Nikolić, *Nemački ratni plakat u Srbiji 1941-1944 [Pllakatet gjermane gjatë Luftës në Serbi 1941- 1944]*, Beograd, 2001.
- "Novo vreme" ["Koha e re"], Beograd, 16 shtator 1942.
- www.pavelicpapers.com
- Branko Petranović, Nikola Žutić (ur.), *27. mart 1941. Tematska zbirka dokumenata [27 mars 1941. Përmbledhje tematike dokumentesh]*, Beograd, 1990.
- Giannis Soldatos, *Istoria tou Ellinikou Kinimatografou [Historia e kinemasë greke]*, vëll. 1-2, Athinë, 1999. "Stripoteka"
- *The Jews of the Ottoman Empire and the Turkish Republic [Hebrenjtë e Perandorisë Osmane dhe Republikës Turke]*, London, New York, 1993.
- "Universul", Bukuresht, nr. 30, 1 shkurt 1942; 15 maj 1942; nr. 272, 5 tetor 1942; nr. 281, 14 tetor 1942; nr. 249, 12 shtator 1943; 6 tetor 1944; 26 tetor 1944.
- Aleksandar Vojinović, *Nije sramota biti Hrvat ali je peh [Të jesh kroat nuk është turp, por fat i keq]*, Zagreb, 1999.
- Muzeu i Luftës i Athinës, Koleksioni britanik.
- *Zločini fašističkih okupatora i njihovih pomagača protiv Jevreja u Jugoslaviji [Krimet e pushtuesve fashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre ndaj hebrenjve në Jugosllavi]*, Beograd, 1952.

Hartat

■ Harta 1: *Lufta e Dytë Botërore, 1939-1942* - Harta 50 (f.178) tek : Paul Robert Magocsi, *Historical Atlas of Central Europe [Atlas historik i Europës Qendrore]* (University of Washington Press, 1993, 2002).

■ Harta 2: *Europa Juglindore pas Luftës së Dytë Botërore* – Harta 52 (f.186) tek: Paul Robert Magocsi, cituar më lart.

JEPNI VLERËSIMIN TUAJ PËR KËTË LIBËR!

Mendimi juaj si lexues është me shumë rëndësi për ne, në mënyrë që të vlerësojmë punën e bërë dhe të planifikojmë nismat tona të ardhshme. Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Europën Juglindore (CDRSEE), së bashku me një numër kolegësh dhe bashkëpunëtorësh kanë kryer një punë të madhe dhe kanë shfrytëzuar burime të çmuara për projektin “Mësimdhënia e Historisë Moderne të Europës Juglindore”, rezultat i të cilit është ky libër që keni në duar. Në mënyrë që të vlerësojmë frytshmërinë e metodës së përdorur, dobinë e kësaj sipërmarrjeje dhe vlerën e punës sonë, do të dëshironim që të jepnit vlerësimin tuaj për këtë projekt. Ju lutemi, na jepni opinionin tuaj të sinqertë, duke na kushtuar pak kohë dhe kujdes nga ana juaj.

Pasi ta lexoni këtë libër ose ta keni përdorur në klasë, ju lutemi, shkoni në faqen tonë të internetit, dhe tek seksioni “Librat e Punës të Historisë” plotësoni një formular vlerësimi. Formularin e vlerësimit mund ta gjeni në adresën: <http://www.cdsee.org/jhp/index.html>

Nëse dëshironi, mund të na shkruani në adresën elektronike: info@cdrsee.org dhe komentet tuaja do t’i dërgohen drejtpërsëdrejti njërit prej koordinatorëve të PHP-së.

Gjithashtu, mund të na shkruani edhe në adresën postare:

Center for Democracy and Reconciliation in Southeast Europe (CDRSEE)
Krispou 9, Ano Poli, 54634 Thessaloniki, Greece

